

# ENVER HOXHA

VEPRA

69




**PROLETARE TË TË GJITHA VENDEVE, BASHKOHUNII**

**ENVER HOXHA**

**VEPRA**

**BOTOHET ME VENDIM TË KOMITETIT  
QENDROR TË PARTISË SË PUNËS TË  
SHQIPËRISË**



**ENVER HOXHA**



INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE-LENINISTE  
PRANË KQ TË PPSH

# ENVER HOXHA

VELLIMI

69

DHJETOR 1978 — SHKURT 1979

**SHTËPIA BOTUESE «8 NËNTORI»  
TIRANË 1990**



## PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 69-të

Vëllimi i 69-të i Veprave të shokut Enver Hoxha përfshin fjalime, diskutime, biseda e shënime të periudhës dhjetor 1978-shkurt 1979. Pjesa më e madhe e tyre botohen për herë të parë.

Përmbajtja e materialeve të këtij vëllimi u përgjigjet problemeve politike e ekonomike që përballonin Partia e populli, në atë periudhë, nga zhvillimet e brendshme në vend, si dhe nga ato të situatës ndërkombëtare.

Duke i analizuar e trajtuar këto probleme që ishin në qendër të veprimtarisë së Partisë, shoku Enver Hoxha nënvizon domosdoshmërinë e forcimit të udhëheqjes së Partisë në ekonomi. Lidhur me këtë theksohet edhe një herë ideja se kur themi Partia udhëheq ekonominë, duhet të kemi parasysh që çdo anëtar i saj kudo që punon, në sektorët ekonomikë, në prodhim e në drejtim, lufton dhe punon për zbatimin e politikës ekonomike të Partisë. Dhe kjo reflektohet në plotësimin e tërë treguesve të planit. Autori insiston këtu në faktin që këta tregues duhet të merren të lidhur ngushtë me njëri-tjetrin, si hallka të një zinxhiri, i cili është i fortë në qoftë se i ka të forta të gjitha hallkat e tij. Nëse dobësohet njëra hallkë, atëherë dobësohen edhe të tjerat që lidhen me të. Prandaj është e domosdoshme që se-

cili duhet të kuptojë se nga neglizhenca e tij pengohen edhe sektorët e tjerë, se këto neglizhenca e pengesa janë me pasoja të rënda, sepse e futin ekonominë në rrugën e shpërpjesëtimit dhe të zhbalancimit.

Në kushtet konkrete të momentit, theksohet në vëllim, nuk ka vend për eufori të pabazuar. Partia duhet t'i bëjë njerëzit të ndërgjegjshëm, se përpara do të dilnin pengesa e vështirësi të reja, jo të lehta. Ato kërkojnë që secili e të gjithë së bashku t'i përvishen seriozisht punës për realizimin e tejkalimit e planeve, kërkojnë masa të forta organizative, forcimin e kontrollit e të regjimit të kursimit, kudo e në çdo gjë, kërkojnë kuptimin dhe zbatimin e ligjeve ekonomike të socializmit si edhe përmirësimin e metodës e të stilit të punës e të drejtimit.

Gjithashtu, theksohet se njerëzit tanë duhet të kuptojnë mirë se realizimi e tejkalimi i planit ka të bëjë me forcimin ekonomik e politik të situatës së brendshme e të pozitës ndërkombëtare të vendit tonë. Bota është në zhvillim, vë në dukje shoku Enver Hoxha, por zhvillimi i saj aktual është kërcënues, për lirinë, për pavarësinë dhe për sovranitetin e popujve. Prandaj është detyra e secilit të luftojë për ndërtimin e socializmit, që vendi ynë të rrezatojë në botë fuqinë ekonomike e politike të Partisë e të shtetit tonë, vitalitetin e rendit socialist.

Me interes janë edhe orientimet e rëndësishme që jepen për përmirësimin e përsosjen e vazhdueshme të mekanizmit ekonomik përmes trajtimit dialektik të tij. Me anë të kësaj, theksohet në vëllim, të nxitim e të stimulojmë prodhimin me forcat tona të artikulave të ndry-

shëm. Në këtë kuadër shtrohen detyra sidomos për uljen e kostos së prodhimit, për rritjen e rendimentit të punës, për forcimin e disiplinës etj.

Në trajtimin e këtyre problemeve një vend i veçantë i kushtohet nevojës së përmirësimit të vazhdueshëm të metodës e të stilit në punën e organeve të Partisë e atyre shtetërore, në qendër e në bazë. Shoku Enver Hoxha ngul këmbë dhe orienton që këto të jenë të zhdërvjellëta në punën e tyre dhe në zgjidhjen e problemeve. Si kuadrot që punojnë në to, edhe vetë forumet, porosit ai, duhet të karakterizohen nga një veprimtari konkrete, pa shumë llafe, pa teorizime e perifrashime, nga një veprimtari e frytshme që u jep zgjidhje në vend problemeve që lindin. Kjo kërkon dinamizëm, mendim dhe shpirt praktik për të përcaktuar masa konkrete që shpien në plotësimin e detyrave, në kapërcimin e pengesave e të vështirësive.

Duke u ndalur te ky problem i rëndësishëm, autori kritikon ato mbledhje pune ku vihet re formalizëm, ku bëhen analiza të përgjithshme e të pathëlluara, të shkaqeve të mosrealizimeve që bëjnë disa drejtues të Partisë e të pushtetit në rrethe e në dikasteret qendrore dhe ku nuk dalin qartë cilat kanë qenë dobësitë dhe kush e ka konkretisht përgjegjësinë për mosrealizimet. Normat e Partisë, theksohet në vëllim, kërkojnë që të metat e gabimet e cilitdo të vihen mirë në dukje dhe të merren masat e nevojshme që ato të ndreqen. Ato shtrojnë nevojën që të zhvillohen gjerësisht kritikën nga poshtë-lart për drejtuesit e çdo instance. Nuk ka njeri të pagabueshëm, prandaj kur gabon, cilitdo qoftë ai, duhet të kritikohet nga masat, sepse vetëm kështu ecin

punët përpara, luftohet tendenca për t'ua lënë përgjegjësinë të tjerëve. Puna e Partisë, si kudo, edhe në këtë drejtim nuk i duron burokratizmin, indiferentizmin, familjaritetin. Zbatimi i vijës së saj kërkon shprehjen dhe rrahjen e gjerë të mendimeve, tërheqjen gjerësisht të mendimit të masave, sepse kështu bëhet e mundur gjetja e rrugës më të drejtë për zgjidhjen e çdo problemi dhe për plotësimin e çdo detyre.

Në këtë vëllim gjejnë pasqyrim dhe analizohen shkencërisht mjaft probleme ndërkombëtare të momentit dhe hidhet dritë për ecurinë e ngjarjeve e të proceseve të zhvillimit botëror. Analizat, konkluzionet që nxjerr udhëheqësi i Partisë për këto probleme e procese i sheh të lidhura ngushtë me detyrat që u dalin Shqipërisë socialiste, komunistëve, kuadrove e punonjësve të vendit tonë për t'i kuptuar si duhet e për të jetuar me situatat. Rrethimi i egër kapitalisto-revizionist, situatat e turbullta në botë diktojnë nevojën që të punojmë e të luftojmë për t'u bërë ballë rreziqeve të shumta. Ne jemi një popull, një Parti e një shtet që nuk presim ndihma nga askush. Është në dorën tonë të ecim përpara me luftë dhe vetëdije për të ndërtuar një ekonomi socialiste të fortë, për të kapërcyer vështirësitë. Ne e kemi zgjedhur vetë këtë rrugë dhe do ta çojmë gjer në fund atë.

Trajtimi i problemeve në vëllimin e 69-të të Veprave të shokut Enver Hoxha, ndërsa i bën jehonë kohës në të cilën janë krijuar materialet e këtij vëllimi, kanë një vlerë të madhe për punën e veprimtarinë e Partisë, të shtetit e të masave punonjëse sot. Idetë e konkluzionet, përgjithësimet e orientimet e tij janë mësim të

---

*çmuara për zgjidhjen e detyrave të mëdha e të ndërli-  
kuara që shtron sot e në perspektivë zhvillimi socialist  
i vendit.*

*Vëllimi është i pajisur me tregues.*



# PARA POPULLIT PËRGJEGJËSI PËR MOSREALIZIMET KANË DREJTUESIT E PARTISE E TË PUSHTETIT NË RRETHI E NË BAZE

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

6 dhjetor 1978

Para se të marrim në shqyrtim pikën e parë të rendit të ditës, desha të flisja shkurtimisht për disa gjëra.

Sido që ky problem është me rëndësi të madhe, për ne nuk është i huaj, pse jemi marrë gati çdo ditë me planet gjatë këtyre tre vjetëve, bile deri edhe te kalliri i misrit. Por kështu nuk kemi bërë mirë, sepse humbet përgjegjësia.

Çështja e dytë që dua të vë në dukje është që sa të jetë e mundur të mos bëjmë përsëritje.

E treta, të mos i bëjmë agjitacion e propagandë njëri-tjetrit këtu, në Byronë Politike, por t'i themi katër të vërtetat ashtu siç janë, të thuhet shkaqet përse

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit «Mbi plotësimin e pritshëm të planit të vitit 1978 dhe për projektplanin e zhvillimit të ekonomisë e të kulturës për vitin 1979».

s'janë bërë edhe ç'duhet të bëjmë në të ardhmen. Rëndësi ka të marrim masa për të siguruar realizimin e detyrave.

E fundit që doja të vija në dukje është se materialet që vijnë nga Qeveria dhe nga Komisioni i Planit duhet të jenë të plota për Komitetin Qendror, për arsye se edhe këtu ka ekspertë, të cilët duhet t'i studiojnë këto materiale. Kjo është e nevojshme, gjithashtu, edhe sepse si specialistët tanë edhe ata të aparateve qendrore shtetërore duhet të bëjnë më shumë shkëmbim mendimesh me njëri-tjetrin. Por këtu, në Byronë Politike, dhe flas më parë për veten time, pastaj për shokët e tjerë me të cilët bashkëpunoj, nga të gjitha këto materiale që keni ju, duhet të mos jenë më të gjata se 5 faqe. Të paktën për vete, unë jam në gjendje të them disa mendime duke u bazuar në këto faqe. Ju, shokë, po të doni, mund t'i kërkonit të tëra materialet, për këtë s'kam ç'të them se kjo varet nga kërkesat e secilit. Po shokëve me të cilët punoj unë, në aparatën e Komitetit Qendror, ua them zyrtarisht të mos më japin më shumë se 5 faqe, kurse për problemet e tjera që janë më pak të rëndësishme apo të dorës së dytë, akoma më pak faqe duhet të më jepen.

Kush kërkon sqarime rreth kësaj çështjeje? Ja, për shembull, unë do të dëshiroja të më sqaroheshin dy gjëra:

Përse vazhdohet të mos realizohet plani i qymyreve? Gjendjen e Minierës së Valiasit unë e di, se kjo thuhet edhe këtu në material, po mos ka ndonjë shkak tjetër?

E dyta, për naftën shifrat që pasqyrohen në mate-



rial janë të kontrolluara dhe të caktuara sipas nevojave dhe trajtimit shkencor apo janë vënë sipas dëshirave të naftëtarëve dhe të ministrisë, për «të qenë brenda»? Është parë interesi i ekonomisë? Këto pyetje kisha unë.

*Pasi iu përgjigj pyetjeve të bëra shoku Xhafer Spahi, në atë kohë ministër i Industrisë dhe i Minerave, dhe pasi diskutuan edhe shokë të tjerë të Byrosë Politike, fjalën e mori shoku Enver Hoxha, i cili tha:*

Jam dakord me projektplanin që na është paraqitur nga Këshilli i Ministrave. Natyrisht ky është i studiuar mirë, por çështja tash qëndron te përpjekjet që duhen bërë për ta realizuar atë, duke pasur parasysh edhe vërejtjet që i janë bërë planit të vitit 1978.

Në përgjithësi, ne këtu, në Byronë Politike, kritikojmë shokët e bazës për ato detyra që nuk i kryejnë mirë, ashtu sikundër kritikojmë njëri-tjetrin për mosrealizimet që vërtetohen në këtë ose në atë sektor. Duhet të kemi parasysh që si në qendër, ashtu edhe në rrethe, ka gjëra shumë të mira, por herë pas here vërtetohen edhe të meta e gabime. Në çdo rast normat e Partisë kërkojnë që reciprokisht, kur vërehen të meta e gabime nga kushdo qoftë, këto duhet të vihen mirë në dukje, të pranohen arsyetimet e shëndosha dhe të merren masat e nevojshme që gabimet të ndreqen atje ku vërtetohen.

Për ne, udhëheqësit kryesorë, me sa shoh unë, mungojnë kritikata nga poshtë-lart. Këtë e them si për vete, ashtu edhe për gjithë shokët e tjerë. Këtë unë nuk e shoh nga prizmi sikur ne jemi të pagabueshëm. Në parim nuk ka njeri të pagabueshëm dhe në një rast të tillë,

kushdo qoftë, ai duhet të kritikohet. Natyrisht, ne nuk kërkojmë të kritikohemi për t'u kritikuar, por kur shihet se diçka në punën e ndonjërit nga ne nuk ecën mirë, atëherë të bëhet edhe kritikë. Ne, të udhëheqjes, duke ndier përgjegjësinë që na ka ngarkuar Partia, duhet t'ua vëmë në dukje shokëve të metat e gabimet e konstatuara, të diskutojmë me ta për kritikën që u bëhen. Kritika që bëhet mund të jetë personale, por ajo mund të jetë edhe kolektive.

Unë, për shembull, nuk bie shpesh në kontakt me shokët e bazës që ata të më bëjnë ndonjë kritikë. Edhe sekretarët e Partisë, sidomos ata të Komitetit Qendror, konstatojnë se kritikohen shumë më pak nga poshtë, kurse ministrat, natyrisht, jo edhe aq shumë. Sidoqoftë këta kritikohen më shumë nga sekretarët. Kjo çështje, mendoj unë, duhet të gjykohej drejt. Respekti për udhëheqësin duhet të jetë i bazuar në qëndrimet politike të tij, në zbatimin me konsekuencë të vijës së Partisë, në mbrojtjen e saj dhe në kryerjen mirë të detyrave që i ngarkohen. Kur udhëheqësi vepron kështu, atëherë të gjithë e respektojnë. Por diçka ideale dhe të përsosur këtu nuk ka, pse të gjithë, kush më shumë e kush më pak, kemi nga një të metë, prandaj, për ta zhdukur atë, një kritikë, qoftë edhe e lehtë po të jetë kjo, pse ndër-gjegjja jonë, në përgjithësi, është më e lartë, prapë na bën mirë, sepse jemi në gjendje ta kuptojmë drejt kritikën.

Kjo është me rëndësi të madhe për ne, për arsye se, kur nuk ushtrohet kritika ndaj nesh, kjo ka konsekuencë të rënda në mbarëvajtjen e punës. Mund të jetë liberal ose shumë liberal një komunist ose një kuadër në

bazë dhe qëndrimi i tij është me pasoja negative, por në qoftë se ndonjëri nga ne këtu do të ishte liberal edhe sa një e dhjeta e atij të bazës, atëherë qëndrimi në këto pozita i një udhëheqësi do të ishte shumë më i rrezikshëm, sepse qëndrimi i udhëheqësit ka të bëjë me zbatimin e vijës, me orientimin dhe me kontrollin e zbatimit të tij, me instruktimin e shokëve me të gjitha normat e Partisë.

E thashë që ministrat kritikohen më shumë nga sekretarët e Komitetit Qendror të Partisë, kurse drejtorët në ministri, si dhe gjithë kuadrot e tjerë më poshtë, natyrisht kritikohen edhe më shumë. Megjithatë, mendoj, e ndoshta e kam edhe gabim, që disa drejtorë në ministri kanë njëfarë imuniteti, tek ata duket njëfarë prepotence në disa çështje. «Plani, — thonë ata, — është i palëvizshëm». Kjo ose ajo detyrë vërtet është e vendosur në plan dhe duhet realizuar, por këtu dëmtojnë shumë qëndrimi liberal ose sektar i kuadrove të tillë. Kështu ndodh që kur baza kërkon furnizimin e ndërmarrjes me lëndë të parë, këta drejtorë nuk paraqiten te ministri për t'i thënë: «Shoku ministër, do ta ndërrojmë këtë situatë apo nuk do ta ndërrojmë, sepse në filan fabrikë nuk po na ecën mirë puna, dhe burimi i kësaj të keqeje nuk qëndron poshtë, po te ne, këtu lart. Unë shkoj e i kërkoj fabrikës të prodhohen çokollatat sipas planit, mirëpo kjo detyrë nuk po realizohet, sepse nuk ka ardhur kakaoja nga importi». Në vend që drejtori apo nëpunësi në dikaster ta bëjë këtë, ai, kur vete në bazë, kërkon me këmbëngulje të realizohet plani. Po si ta realizojë planin e prodhimit ajo fabrikë apo ai kolektiv e drejtori ndërmarrjeje, kur nuk ka lëndën e parë?

Ta realizosh, i thonë nga ministria, se plani është plan! Ose një rast tjetër, kombinatit të tekstileve drejtori i ministrisë i kërkon të realizojë metrazhin e tekstileve sipas kualiteteve të parashikuara në plan. «Bukur, ne do të punojmë,» — i përgjigjen shokët e kombinatit, — por ju nuk na keni siguruar lëndën e parë të planifikuar, pambukun apo fijen sintetike». «Jo, — i hidhet drejtori në ministri, — plani është plan, bëj si të duash, mbushë si ta mbushësh, mjaft që të dalësh me plan të realizuar». Atëherë ç'ndodh? Për hir të planit prodhohen edhe mallra që nuk nevojiten e shtohen stoqet. Edhe kjo nuk është e drejtë.

Pse ndodhin të tilla qëndrime? Këto ndodhin, më duket mua, nga një kuptim i shtrembër i planit nga disa funksionarë, nga mungesa si duhet e përgjegjësisë, nga moskokëçarja që kanë ata për detyrën dhe nga tendenca e tyre për t'ia ngarkuar për çdo gjë përgjegjësinë bazës. Sipas funksionarëve të tillë, në qoftë se ndërmarrja në këto kushte nuk e realizon planin, përgjegjësia duhet t'i bjerë asaj. Këtu kemi të bëjmë me tendencën për shkarkimin e përgjegjësisë dhe me lënien e stafetës të tjerëve, gjë që është shumë e rrezikshme, në vend që, në rastin konkret, drejtori i ndërmarrjes ose i dikasterit, nëpunësi apo kuadri të vejë të diskutojë me ministrin e t'i raportojë realisht se si janë punët. Në rast se plani pengohet për mungesë të atyre lëndëve që duhet të vijnë nga importi, brenda mundësive duhet luftuar që këto të vijnë dhe t'i sigurohen bazës që plani të realizohet. Detyrat dhe mundësitë tona janë të përcaktuara me ligj dhe këtë duhet ta dimë dhe të jemi të qartë. Pikërisht këtu lind edhe përgjegjësia e minis-

trisë dhe e drejtorëve që mbulojnë sektorë të caktuar në të.

Si duhet kuptuar kjo gjë? Ajo të kuptohet në mënyrë të atillë që ndërmarrja planin do ta realizojë me një numër të caktuar punëtorësh, me fonde të caktuara materiale e monetare dhe me këtë ose atë rendiment e tregues të tjerë tekniko-ekonomikë e financiarë. Në një ndërmarrje mund të ketë shumë mangësi, por, për sa i përket lëndës së parë, për rëndësinë që ka, duhet të përcaktohet që në fillim, fjala vjen, se sa pjesë do të marrë ajo nga prodhuesit e brendshëm dhe për këtë do të interesohet vetë, por për disa materiale të tjera parashikohet t'ia sigurojë medoemos ministria që të vijë nga importi ose nga qendra, sepse nuk ka se si t'i gjejë vetë ndërmarrja. Mirëpo drejtuesit e ndërmarrjeve, që tash në vendin tonë janë me qindra, nuk bien dot në kontakt përherë me ministrin. Ata takohen me drejtorët e ndryshëm në dikaster. Por ka nga këta drejtorë dikasteresh që jo vetëm nuk marrin vetë përgjegjësi, por as që ua shtrojnë si duhet ministrave problemet që dalin. Kam parasysh këtu jo thjesht për t'i vënë ata në korent të gjendjes, por t'ua ngrenë në mënyrë të studiuar, duke dalë edhe me propozime konkrete, për të marrë vendime e masa përkatëse. Nga të tilla qëndrime pa përgjegjësi krijohen zhbalancime në plan. Këtu, mendoj unë, duhet të gjejmë edhe një pjesë të zbatimit të gabuar të normave të Partisë nga ana e një apo disa drejtorëve të tillë. Punonjësi me përgjegjësi në bazë e do Partinë, e do shtetin, e respekton ligjin dhe disiplinën në përgjithësi. Ai nuk dëshiron t'i thyejë këto, por, në fakt, ka raste që ai nuk sheh

nga ata që ka më lart të bëjnë përpjekje për rrugëzgjdhje sa më të drejta e operative. Raste të tilla në praktikë kemi ndeshur shpeshherë edhe ne, edhe ju shokë të Qeverisë, bilc juve ju ka takuar të shikoni, gjithashtu, që disa njerëz edhe të gënjejnë, të justifikohen, duke ju thënë: «Po ja, plani nuk u realizua se na ka munguar edhe kjo, edhe ajo», duke i përzier kështu të gjitha gjërat, si ato që varen nga puna e kolektivit punonjës ose e drejtuesve të ndërmarrjes, edhe ato që nuk varen prej tyre.

Prandaj kritikata, më duket mua, janë të dobishme si ato nga sipër-poshtë, por edhe ato nga poshtë-lart. Bile edhe neve këtu na bëni kritika, na thoni gabimet që kemi. Jemi ne të kritikueshëm apo të pakritikueshëm? Lejohet nga normat e Partisë që ne të udhëheqjes të kritikohemi kur jemi për t'u kritikuar apo nuk lejohet? Sigurisht që lejohet! Atëherë, na bëni kritikë! Por duhet pasur parasysh, gjithashtu, që baza të mos ia ngarkojë të tëra të metat e gabimet qendrës dhe të kërkojë që edhe qimen nga qulli t'ia nxjerrë udhëheqja kryesore, se pastaj asgjë nuk mund të ecë përpara. Në qoftë se Partia në bazë nuk e bën si duhet detyrën, këtë nuk mund ta bëjë vetëm qendra. Kjo të kuptohet mirë. E kemi për detyrë t'i japim bazës ndihmë të kualifikuar, por në qoftë se shokët e bazës, drejtuesit e Partisë dhe të pushtetit në rreth nuk punojnë, atëherë nuk ka si bëhet. Aq më keq kur drejtuesit në rreth e në bazë justifikohen për mangësitë, duke thënë se e kanë fajin ata lart, e ka fajin dikasteri, e ka fajin ajo, e ka fajin kjo. Jo, shokë, për këtë drejtuesit e rrethit duhet të nxjerrin përgjegjësinë e tyre. Pa merrni e stu-

dioni dokumentet e udhëheqjes! Se jo për çdo gjë do t'ju vijnë shokët e udhëheqjes atje. Aty, në bazë është gjithë Partia, këtë ta kuptojmë mirë, se më duket që nuk e kuptojmë si duhet. Unë mendoj, dhe jam i sigurt, se Partia në bazë tash ka një nivel të lartë drejtimi, organizimi, kulture dhe aftësie teknike që mund dhe duhet t'ia lehtësojë medoemos barrën udhëheqjes kryesore dhe jo të kërkojë prej saj, si i thonë fjalës, edhe «majn e gjilpërës». Një qëndrim i tillë është i palejueshëm dhe nuk duhet të veprohet kështu. Me të tilla tendenca ka mundësi të fshihen të gjitha të metat në karakterin e punonjësve në bazë, të punëtorëve dhe të drejtuesve atje.

Nuk mund të themi se udhëheqja kryesore nuk ka përgjegjësi për të metat dhe dobësitë e bazës. Patjetër që ajo ka përgjegjësi, por kanë përgjegjësi përpara popullit për çdo gjë që nuk ecën mirë edhe tërë udhëheqësit kryesorë në rreth dhe drejtuesit në bazë, sepse çfarë thotë populli në këto raste? Ai pyet: «Po ç'bën ky Komiteti Qendror, apo ç'bën Qeveria për këtë ose atë çështje? Pse mungon ky artikull në treg, apo pse nuk realizohet ky objektiv i caktuar?». Njerëzit, fjala vjen në Fier, nuk thonë që ky artikull mungon nga se drejtori i ndërmarrjes bujqësore, në vend të punonte ashtu siç e kërkojnë situatat, për mosrealizimet e planit s'bëhej fare merak, derisa dorëzoi çelësat. Jo, ka njerëz që nuk thonë kështu dhe që përgjegjësinë ia ngarkojnë Partisë. Pra edhe në këtë rast na bie neve përgjegjësia që lejojmë njerëz të tillë të livadhisin. Ne përgjegjësi për këto mungesa do të mbajmë dhe do të luftojmë e do të mobilizohemi që të zbatojmë detyrat dhe do të

marrim edhe masat e nevojshme. Por krahas kësaj ne do të kërkojmë që detyrat të zbatohen mirë në bazë. Drejtuesit e bazës do t'i kritikojmë kur nuk i kryejnë ato dhe kur është e nevojshme do të merren edhe masa ndaj tyre. Këto çështje t'i kemi mirë të qarta, sepse shumë ngjarje të padëshirueshme na ngjasin.

Nuk dua të them se në këtë drejtim nuk punohet. Jo, por çështja është se gjatë këtyre tre vjetëve të zbatimit të planit të gjashtë pesëvjeçar janë vërtetuar njëqind deficite. Produkti shoqëror nuk është realizuar në masën e planifikuar. Ky fakt duhet të na bëjë të reflektojmë thellë. Unë mendoj se disa deficite ishin edhe të paevitueshme, por jo të ishin në një masë kaq të madhe, sepse të tilla deficite të mëdha, të jemi të ndërgjegjshëm, janë shumë të rënda për vendin tonë dhe ato duhet t'i eliminojmë.

Këto probleme që kanë të bëjnë me realizimin e planeve Komiteti Qendror i ka diskutuar disa herë, Këshilli i Ministrave dhe kryesia e tij një herë në muaj bëjnë vazhdimisht mbledhje për çështjet ekonomike dhe nxjerrin detyra për zgjidhjen e tyre, të cilat ia bëjnë të njohur bazës. Partia, që nga qendra e deri në bazë, është në dijeni për të gjitha këto. Prandaj mendoj që edhe këtu, në Komitetin Qendror, shoku Prokop [Murrja], duhet të bëjmë që të organizohet më mirë puna për ndihmën që i duhet dhënë bazës për zbatimin e vendimeve që marrin Komiteti Qendror dhe Qeveria. Unë nuk shkarkoj nga përgjegjësia edhe shokët e tjerë sekretarë, duke filluar nga vetja. Për këto probleme e për të tjera unë diskutoj këtu me shokët. Mirëpo, në rast se këta nuk punojnë me të gjitha hallkat e Par-



tisë, në qoftë se nuk mbajnë sa duhet lidhje me njerëzit dhe, si rrjedhim, nuk vihen si duhet në korent të situatave, atëherë unë, që nuk shkoj dot shpesh në bazë, në ndërmarrje e kooperativa, nuk informohem si duhet për gjendjen reale të punëve. Këtë gjë duhet ta kuptoni drejt, shokë! Çështja është që të gjithë ne sekretarët e Komitetit Qendror, qoftë Prokopi, Hekurani, Ramizi, Hysniu apo unë, duhet t'i shërbejmë sa më mirë forcimit të punës së Partisë për realizimin e planit, i cili është në radhë të parë një plan politik dhe ideologjik, pastaj edhe plan ekonomik. Partia ka përgjegjësinë kryesore në luftën për realizimin e tij dhe këtu nuk ka dualizëm. Të gjithë ne që jemi komunistë, që nga unë si anëtar i Partisë, që punoj si Sekretar i Partisë i Komitetit Qendror, dhe deri tek anëtar i thjeshtë, që punon si minator, tornitor, kooperativist etj., të tërë kemi përgjegjësi të madhe për realizimin e detyrave të Partisë dhe të planeve ekonomike.

Prandaj edhe propaganda e Partisë në të gjitha hallkat duhet të punojë mirë. Të mos e harrojmë këtë. Propaganda e Partisë lufton dhe duhet të luftojë më mirë që komunistin ta bëjë politikisht dhe ideologjikisht të ngritur që t'i kuptojë drejt dhe qartë përgjegjësitë që ka dhe jo të lejojë që për tre vjetët e parë të pesëvjeçarit deficitet nga mosrealizimi i planit në bujqësi të zënë 61 për qind të të gjithë deficiteve të planit. Atëherë çfarë kanë kuptuar politikisht ata komunistë që punojnë në këtë sektor? Si mund të themi që ata janë ideologjikisht të ngritur? Si ka punuar këtu Partia dhe si është bërë puna propagandistike dhe organizative e saj? Me se do ta matim ne nëse punon apo

nuk punon mirë Partia? Unë mendoj se me shkallën e realizimit të detyrave. Dhe kur themi Partia, kuptojmë të gjithë komunistët që punojnë në këtë apo atë sektor prodhimi, por edhe ata që punojnë në organet e Partisë e të pushtetit, në organizatat e masave e kudo gjetkë.

Nuk është hera e parë që i thonë këto gjëra Komiteti Qendror, Byroja Politike apo Qeveria. Shokët kryesorë në rrethe, sekretarë të komiteteve të Partisë, kryetarë të komiteteve ekzekutive, bile edhe drejtorët e ndërmarrjeve dhe kuadro e punonjës të tjerë në bazë këto çështje i dinë po aq mirë sa dhe ne, ndoshta edhe më mirë, për arsye se jo vetëm të gjitha udhëzimet i kanë të shkruara, por i dinë edhe nga praktika dhe nga shkollat që kanë kryer. Si mund t'i flasim ne një sekretari partie rrethi, drejtorit të një ndërmarrjeje bujqësore apo një kryetari kooperative për orizin, kur ata merren konkretisht e vazhdimisht me të? Apo ç'mund t'u flasim ne më mirë për lulediellin sesa mund t'u flitnin atyre kooperativistët e Donofrosës? Kujt i foli shembulli i kësaj kooperative bujqësore, qiellit? Specialistëve të bujqësisë u foli. Atëherë ku është këtu puna propagandistike, shpirti organizativ i drejtuesve të Partisë në rreth, i organizatave të Partisë, çështje këto për të cilat po flasim kaq shumë? Këtu duhet të shikojmë të metat në punën tonë dhe të mos e lejojmë më një situatë të tillë.

E thashë që në fillim dhe nuk jam i pari që them se ekzistojnë kudo, në radhë të parë edhe këtu te ne, shfaqje të rutinës e të zvarritjeve të punëve. Po pse t'i zvarritim këto, pse t'i përsëritim?!

Siç e thashë më sipër, deficitit kryesor në gjithë

mosrealizimin e planit për tre vjetët e pesëvjeçarit, 61 për qind, vjen nga bujqësia. Prodhimi bujqësor është rritur afërsisht sa është rritur edhe popullsia. Po pse, bujqësia vetëm për të përballuar shtesën e popullsisë punon? Po për sigurimin e prodhimeve bujqësore që nevojiten për kafshët, për eksportin, për lëndët e para për industrinë, për shtimin e rezervave etj., etj., a mendohet? Ku po shkojmë kështu, more shokë? A jemi të ndërgjegjshëm për situatat që jetojmë apo jo? Unë mendoj dhe jam i bindur se politikisht dhe ideologjikisht nuk ka asnjë kuadër drejtues që të mos jetë i ndërgjegjshëm kur dëgjon për këtë deficit të madh të prodhimit bujqësor. Mirëpo nuk mjafton vetëm të jemi formalisht të ndërgjegjshëm, por të bëjmë të gjitha përpjekjet që këtë gjendje ta përmirësojmë, ndryshe nuk mund të ecet.

Duhet të dimë edhe një gjë që sabotimi që na bëri udhëheqja kineze na ka prekur në disa sfera, sidomos në industri, por të shohim edhe mungesën e organizimit, të disiplinës e të kontrollit, si dhe shfaqjet e vetëkënaqësisë. Sepse, kur është fjala për bujqësinë, ne nuk kishim për të marrë as traktorë, as farëra dhe asnjë material tjetër nga Kina. Po kështu mund të themi edhe për mjaft sektorë të tjerë.

Tejkalimi diçka i prodhimit bujqësor, në krahasim me vitin e kaluar, siç e tha edhe shoku Spiro [Koleka], është një gjë pozitive, por ai jo vetëm nuk e mbulon gjithë mosrealizimin e planit në bujqësi, përkundrazi, shohim se deficitet janë shtuar. Ka rritje prodhimi, por në fakt s'ka realizim plani. Prandaj këtu na dalin probleme që duhet t'i gjykojmë mirë dhe thellë. Këtë

nuk mund ta bëjmë tani, por që t'i gjykojmë e t'i analizojmë, kjo është e domosdoshme.

Nga raporti që na është paraqitur del se shtesa mesatare vjetore e prodhimit shoqëror është siguruar nga rritja e numrit të punëtorëve dhe aspak nga rritja e rendimentit. A nuk duhet të na bëjë kjo të mendojmë thellë?! Medoemos duhet të mendojmë. Në bujqësi në vitin 1978, në krahasim me vitin 1975, numri i punonjësve është rritur më shumë, por kjo nuk është shoqëruar me rritjen e prodhimit. Kjo do të thotë se këta njerëz punojnë me rendiment të ulët, pra vërtetohet ajo që thuhet se, veçanërisht në disa rrethe e zona, lufta dhe përpjekjet për prodhimin nuk janë si duhet, se ka dembelë e dembelizëm.

Në përgjithësi, në bujqësi nuk kanë punuar si duhet shumë rrethe, sepse nuk është vetëm Lushnja që ka krijuar deficite. Të rritet fuqia e krahut të punës në bujqësi, të realizohen të ardhurat e familjes kooperativiste, duke ndarë nga 14 lekë për ditë-punë dhe të mos realizohet plani i prodhimit bujqësor, kjo nuk duhet lejuar. Nuk mund të ecet më gjatë kështu! Materiali i Qeverisë dhe ju vetë i keni sqaruar të tëra, prandaj tani duhet të kalohet në masa konkrete për t'i realizuar ato në praktikë.

Gjithashtu shohim se të ardhurat kombëtare janë rritur me ritme më të ulëta nga detyrat e planit, bile ndonjë vit janë më të ulëta edhe në krahasim me rritjen e popullsisë. Kjo është alarmante dhe nuk duhet në asnjë mënyrë të ecë kështu. Për këtë, ashtu siç thuhet në material, por edhe siç e theksuan edhe shokët në

diskutimet e tyre, duhet të forcohen drejtimi shtetëror dhe kontrolli.

Situata që është krijuar ka sjellë edhe mosrealizimin e akumulimit. Të mos harrojmë se kjo ka shkaktuar edhe ngadalësimin e ritmeve të riprodhimit të zgjeruar socialist, gjë që duket qartë edhe në deficitet e krijuara. Kjo situatë duhet t'i bëjë Partinë dhe organet e pushtetit të mendojnë më shumë për të marrë masa, sepse krijohet edhe rreziku i inflacionit. Këtë rrezik ne nuk do ta lejojmë, por është fakt se të ardhurat e popullatës për çdo person shtohen, kurse sasia e monedhës që vihet në qarkullim nuk mbulohet plotësisht me mallra dhe sidomos me strukturën e nevojshme të tyre. Këtë gjendje ne duhet ta ndreqim.

Qeveria dhe Partia më duket se nuk tregohen të rrepta ndaj atyre rasteve të ndërmarrjeve që vazhdojnë të planifikohen me humbje, si dhe ndaj atyre që, në vend që të dalin me fitime, dalin me humbje. Unë nuk ekskludoj këtu vështirësitë e krijuara për mungesa të importit, të shkaktuara nga kinezët, por me këto të mos i mbulojmë ato të meta që nuk kanë të bëjnë fare me këto mungesa. Unë nuk shikoj përmirësime në këtë drejtim shumë serioz, përkundrazi ndërmarrjet me humbje vazhdimisht janë shtuar. A mund të ecet më kështu? Jo, në asnjë mënyrë!

Drejtuesit e nëpunësit që nuk janë prodhues të drejtpërdrejtë të të mirave materiale, sepse këto i prodhojnë punëtorët e fshatarët, por që pagën e marrin fikse, kur harrojnë përgjegjësinë që kanë për realizimin e punës e të prodhimit, mua më duket se duhen ndëshkuar. Ndaj këtyre të jemi më të rreptë. Që nga

Çlirimi kanë kaluar disa dekada. Partia dhe lufta e puna e përditshme kanë nxjerrë me mijëra kuadro të shëndoshë, të devotshëm e revolucionarë, prandaj nuk na lejohet të lëmë në krye të punëve nga ata njerëz që nuk duan të kuptojnë ligjet e Partisë dhe të shtetit tonë dhe të mos kryejnë detyrat. Sot kudo ka njerëz shumë më të zotë dhe ata që nuk janë në gjendje t'i kryejnë detyrat të zbresin menjëherë dhe pa hezitim poshtë. Njëfarë sentimentalizmi i sëmurë që ekziston në këtë çështje, të kemi parasysh, shokë, mund të na e dëmtojë Partinë në të ardhmen, ta dobësojë atë. Kështu ka ngjarë procesi i dobësimit dhe i degjenerimit në partitë revizioniste. Të mos e harrojmë këtë eksperiencë të hidhur.

Plani dhe përpjesëtimet e nevojshme për vitin 1979, në krahasim me vitin 1978, përcaktohen drejt, por duhet ndërgjegje, kërkohet mobilizim, kontroll dhe organizim, ndryshe të gjitha këto që themi do të nge-len në letër. Kur krahasojmë planin e prodhimit bujqësor me realizimet e vitit 1978 që është 26 për qind më i madh, ose shtesat e tjera të prodhimeve e të shërbimeve në degë e sektorë të ndryshëm, vëmë re se detyrat përpara i kemi të mëdha, prandaj kjo duhet të na bëjë të reflektojmë thellë. Ne duhet të pyesim veten me shumë seriozitet dhe të gjykojmë me shqetësim: i themi këto gjëra për t'i vënë në letër, apo i vendosim për t'i realizuar? Me gjithë vendimet që kemi marrë, fakt është se jo kurdoherë planin dhe detyrat e ngarkuara i kemi realizuar.

Për sa i përket realizimit të planit në bujqësi për këtë vit, parashikohet që prodhimi bujqësor të arrijë

afro 82 për qind, kurse në bimët e arave vetëm 71 për qind. Mua më duket se është një shprehje vetëkënaqësie ajo që thuhet në material se edhe pse realizohet kështu plani, përsëri nevojat e vendit me drithëra buke plotësohen. Kjo shprehje është thjesht vetëkënaqësi, sepse fakti është fakt. Është e vërtetë se edhe me këtë prodhim që është arritur plotësohen nevojat e vendit me bukë, po nën pretekstin e kohës fshihen në mosrealizimin e prodhimit bujqësor shumë të meta subjektive, si mungesë organizimi, disipline dhe moszbatimi të shërbimeve të domosdoshme agroteknike. Atëherë ç'duhet të bëjmë përpara kësaj situatë që të tërë e dimë? Nuk dua të zgjatem më shumë rreth këtyre dobësive e të metave që vihen re, por propozoj t'u tërhiqet vëmendja nga ana e Komitetit Qendror të Partisë sekretarëve të parë dhe kryetarëve të komiteteve ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve të Lushnjës, Sarandës, Korçës, Krujës e Durrësit. Këto masa t'i marrë vesh gjithë Partia. Pra, këta shokë ne duhet t'i qortojmë. Në qoftë se nuk do ta marrim një masë të tillë, që prapë më duket shumë e lehtë, atëherë do të vazhdohet të ecet kështu si deri tash. Njerëzit kanë cipë dhe sedër dhe përpara Partisë do të thellohen përse po qortohen këta shokë. Ata po qortohen se detyrat e caktuara nuk i kanë kryer.

Unë jam dakord me planin e prodhimit bujqësor e blegtoral, si dhe me rendimentet e planifikuara, por më vjen keq për një gjë, që nuk shikoj asnjë përqindje rritjeje për të mbuluar deficitet e krijuara. Duke mos e prekur këtë çështje, kjo, me fjalë të tjera, do të thotë që gjithë ato deficite që janë vërtetuar, fshihen, nuk

zihen fare në gojë. Planet e viteve të kaluara ne i kemi quajtur të drejta dhe të realizueshme, duke marrë parasysh mesataren e përparuar. Mirëpo të mos bësh fjalë për deficitet e krijuara, pranimi i tyre si një çështje «ja që ngjau», mendoj se nuk krijon siguri në të ardhmen për realizimin e rendimenteve të bimëve të arave për vitin 1979 sipas parashikimeve të planit pesëvjeçar. Unë jam realist dhe nuk pretendoj që të gjitha deficitet e tre vjetëve 1976, 1977 dhe 1978 të plotësohen gjatë planit të vitit 1979, po të paktën të plotësohet një pjesë e tyre, në mënyrë që të mos mbetet fare në harresë kjo çështje, ndryshe kështu ne pranojmë që detyrat kanë qenë fiktive dhe nuk na jepet siguri për realizimin e planit të vitit që vjen dhe më tej. Gjithë ato deficite që janë krijuar nuk mund të arrihen, po ka rëndësi që edhe një pjesë e vogël të plotësohet, sepse prapë ky është një hap përpara.

Unë shfaq pakënaqësinë time të madhe për mosrealizimin e planit të perimeve, veçanërisht të patateve dhe të foragjereve. E them me plot bindje se këto produkte nënvleftësohen, si nga vetë Ministria e Bujqësisë, edhe nga baza. Mendoj që në këto drejtime në bujqësi të merren masa shumë serioze nga Partia dhe nga Qeveria. Prandaj propozoj të qortohet edhe Ministria e Bujqësisë dhe shtabi i saj për mosrealizimin e këtyre detyrave kapitale, siç janë realizimi i planit të zarzavateve. Unë do të ngul këmbë derisa të rroj për këtë problem, sepse ato janë njëlloj si edhe buka për popullin. Zarzavatet janë bukë, janë ushqime me vlera të mëdha e të shumanshme, ashtu siç është, gjithashtu, me vlerë të madhe edhe ushqimi i bagëtive. Këtë de-



tyrë me forcë e kemi thënë e përsëritur, por nuk po realizohet. Për prodhimin e patateve jam dakord me shokun Adil, të mos kultivohen ato në mënyrë ekstensive, sepse kështu shkojmë në kundërshtim me parimin e përqendrimit, siç e kemi diskutuar dhe e kemi parë në Plasë. Po t'i shpërndajë rrethi apo kooperativa 20 hektarë këtu, 20 atje, atëherë nuk interesohet njeri fare për këto prodhime.

Përgjegjësi të madhe dhe të rëndë në sektorin e bujqësisë veçanërisht kanë edhe organizatat e masave, organizata e gruas, e rinisë dhe ajo e bashkimeve profesionale. Këto të fundit, më duket mua, e sidomos organizatat e bashkimeve profesionale në ndërmarrjet bujqësore as nuk ndihen fare në punëtorët e bujqësisë. Unë propozoj që aparatet e bashkimeve profesionale në qendër e në rrethe ta kthejnë fytyrën më shumë nga punëtorët e bujqësisë, sepse punonjësit e çerdheve dhe të fabrikave është më lehtë për t'u mobilizuar. Sigurisht, puna për forcimin e organizimit e të disiplinës është në radhë të parë punë partie, po organizatat shoqërore janë leva të Partisë dhe këto leva duhet ta ndihmojnë Partinë. Mendimi im është se organizatat e masave nuk i ndihmojnë sa duhet dhe si duhet organet e pushtetit dhe të Partisë. Ato bëjnë një punë rutinë dhe burokratike, e kam fjalën në drejtim, pse baza e tyre është më përpara nga drejtuesit. Ky është mendimi im, mund edhe të gabohem. Në këto organizata në bazë unë nuk kam vajtur, por kam përshtypjen që sipër bëhen disa leksione dhe punë të tjera, po baza, me gjithë dobësitë e saj, është më përpara nga drejtuesit. Prandaj e theksoj veçanërisht

për bashkimet profesionale që të punojnë më shumë me punonjësit e bujqësisë, në qoftë se duam t'u mësojmë këtyre disiplinën proletare në punë. Po kush do t'ua mësojë këtë? Partia, po nëpërmjet organizatave të masave.

Të jemi të ndërgjegjshëm se do të na duhet të kapërcejmë shumë vështirësi, të cilat nuk do të jenë të lehta për ne, po duhet luftuar për t'i kapërcyer. Këto nuk mund të kalohen po nuk morëm masa organizative të forta, në qoftë se nuk do të bëjmë kontrolli të fortë, po nuk bëmë kursime në çdo drejtim, po nuk kuptuam dhe nuk zbatuam ligjet ekonomike të socializmit, në teori dhe në praktikë, në të gjitha fushat, po nuk përmirësuan stilin dhe metodën tonë të punës, duke luftuar rutinën dhe burokratizmin.

Për të gjitha këto, të themi se nuk kemi folur, të themi se nuk janë zbatuar, të themi se nuk ka përparime, do të gabojmë dhe do të ishim shumë pesimistë, po këto i theksoj që të ecim gjithnjë përpara, se kemi shumë për të bërë në këto drejtime. Vetë ne, udhëheqja, po i vëmë në dukje këto dobësi. Ka këtu gjëra që mund të kapërcehen, ka të tjera që s'kapërcehen aq lehtë, siç është sigurimi i materialeve që presim të vijin nga importi ose realizimi i marrëveshjeve etj., etj., po këto për të cilat po flasim këtu dhe që varen nga ne, mendoj dhe jam i bindur se mund të kapërcehen, siç u kapërcyen.

E gjithë kthesa pozitive që është e domosdoshme dhe jetike të bëjmë, më duket mua, duhet të ndihet në realizimin e planeve, sepse kështu do të forcohet ekonomikisht dhe politikisht situata e brendshme dhe e:

jashtme e vendit tonë. Ne duhet të jemi të ndërgjegjshëm politikisht dhe ideologjikisht ç'ka na sjell minusi dhe ç'ka na sjell plusi. Është në dorën tonë të ecim përpara me luftë dhe me vetëdije për të kapërcyer vështirësitë ose të qëndrojmë në vend numëro, gjë që do të ishte shumë e rëndë, ose të ngelim prapa, gjë që ka pasoja akoma më të rënda për atdheun tonë socialist.

Natyrisht, ne kemi zgjedhur rrugën e parë, të ecim kurdoherë përpara, po të mos harrojmë për asnjë çast se, që të ecim përpara, duhet të kemi parasysh dhe të zbatojmë deri në një të gjitha këto që po vendosim këtu dhe të gjitha ato që na kanë ngarkuar Kongresi i 7-të i Partisë, Komiteti Qendror dhe Byroja Politike, ndryshe çdo gjë do të mbetet vetëm në fjalë, ose do të zbatohet përgjysmë.

Këto kisha për të thënë, shokë. Nuk kam gjë tjetër më shumë, pse çështjet konkretisht janë trajtuar edhe më parë këtu, ashtu siç u ngritën edhe sot në mënyrë konkrete në diskutimet e shumë shokëve që folën. Prandaj të gjitha këto t'i kemi parasysh dhe t'i vëmë në jetë.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH,  
që gjendet në AQP*

## ATYRE DREJTUESVE QË BËHEN PENGESË NË PUNË, T'U TREGOHET VENDI

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve  
të Komitetit Qendror të PPSH*

7 dhjetor 1978

**SHOKU ENVER HOXHA:** Dje bëmë mbledhjen e Byrosë Politike. Keni menduar ndonjë çikë ju, shokë, se çfarë do të bëjmë më tej, apo nuk mundët të reflektonit për arsye se koha ishte e shkurtër? Them kështu, se duhet të dalim sa më parë nga situata ku gjendemi në lidhje me realizimin e planeve. Si mund të lejohet që një ndërmarrje të prodhojë sipas dëshirës së drejtuesve të saj pa përfillur planifikimin dhe pas-taj t'u thotë organeve të shpërndarjes merrini këto, se ne i bëmë!

**SHOKU HEKURAN ISAI:** Mbrëmë ne u mbledhëm dhe biseduam me njëri-tjetrin, shoku Enver, thirrëm edhe shokët ndihmës që të mendojnë e të reflektojnë dhe ata për këtë çështje. Kaq kemi bërë tani për tani. Ne menduam që nga diskutimet e bëra në mbledhjen e Byrosë Politike të përgatitim një protokoll prej 4-5 faqesh, ku të nxjerrim problemet që u trajtuan dhe

këtë material ta nisim në rrethe që ta ketë sa më parë në dorë gjithë Partia.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Unë jam dakord që ky protokoll të bëhet, bile sa më parë, po për përgatitjen e tij duhet të punoni edhe ju, shokë sekretarë të Komitetit Qendror, bashkë me specialistët që kemi këtu, në aparat, dhe jo t'u lihet vetëm këtyre kjo çështje, me qëllim që të kapet e të trajtohet mirë gjithçka do të shënohet në këtë protokoll. Gjithashtu kam mendimin që protokollin të mos jetë kaq i gjatë sa keni menduar ju, se edhe 4-5 faqe prapë më duken shumë. Mendimi im është që për çdo problem aty të bëhet vetëm nga një paragraf, ku të trajtohen shkurtimisht ato çështje që na shqetësojnë, nga problemet kryesore duke hequr nga teksti që keni përgatitur fjalët e tepërta e duke u përpjekur për t'i shprehur mendimet me sa më pak fjalë, në mënyrë të shtrënguar, koncize. Në fillim të thuhet, për shembull, që në këtë çështje ekzistojnë shfaqje të burokratizmit, prandaj duhen marrë masa që kjo gjendje të përmirësohet. Këtë rrethet dhe baza ta zbërthejnë e të mendojnë vetë më shumë se ç'duhet bërë që të ndreqin situatën.

Në këtë protokoll, duke u mbështetur në diskutimet që u bënë, të thuhet sa është arritur realizimi i planit në këta tre vjetët e fundit në bujqësi, në drithërat e bukës dhe në të gjitha prodhimet e arave, dhe të vihen konkretisht të dhëna për mosrealizimin e planit. Ky mosrealizim është i dënueshëm, pse i shkakton ekonomisë së vendit tonë socialist një dëm të jashtëzakonshëm.

Prandaj Partia, pushteti dhe organizatat e masave,

të theksohet, kanë përgjegjësi të madhe. Për asnjë prej tyre nuk mund të bëhet përjashtim. Për këtë gjendje të jemi të ndërgjegjshëm dhe të merren masa për ta shëndoshur atë etj.

Gjithashtu të theksohet se konstatohet që në mjaft raste prodhohet në mënyrë kaotike, pa kontroll, pa cilësi dhe jo në kohë.

Domethënë, duhen shënuar aty ato që thashë dje në mbledhje. Nuk e kam fjalën që të merren e të kopjohen fjalët e mia një për një, por të nxirren konkluzione nga të gjitha diskutimet e shokëve, të bëhet një përmbledhje e tyre. E theksoj edhe një herë, në këtë përmbledhje në asnjë mënyrë të mos bëhen shpjegime, por të nënvizohet që, megjithëse të gjitha këto probleme udhëheqja e Partisë i ka shtruar shumë herë, bile me ngulm, konstatohen rezultate të pakënaqshme dhe të dënueshme. Duhet të ndryshojë kjo situatë, e cila flet për vetëkënaqësi, për mungesë të ngritjes ideopolitike të punonjësve e kuadrove dhe për një kuptim jo të drejtë të rrethimit kapitalisto-revizionist të vendit tonë.

Këto çështje t'i bëhen të njohura tërë Partisë. Të qortojmë rëndë komunistët, sepse ata kanë përgjegjësi për deficitet e krijuara, sidomos në bujqësi, ku disa drejtues kryesorë, veçanërisht për mosrealizimet, u përmendën me emra. Por të tillë si këta ka edhe në sektorë të tjerë, ndonëse nuk përmenden me emër. Megjithatë, duhet bërë e ditur se nuk janë vetëm këta përgjegjës, se ka edhe të tjerë më poshtë që mbajnë përgjegjësi, po më tepër përgjegjësi kanë shokët që janë në udhëheqje të rrethit.

Konstatohen shfaqje të liberalizmit në bazë, por

njëkohësisht shfaqje të liberalizmit ka edhe në udhëheqjet e rretheve, që nuk marrin masa në kohë deri edhe në përjashtimin nga Partia të atyre që nuk realizojnë detyrat. Bile kjo masë të njoftohet, se ka raste që ndonjë drejtues kritikohet, se punët ku drejton ai nuk shkojnë mirë dhe ai jo vetëm nuk e kupton dhe nuk e pranon kritikën që i bëhet, por me megalomani dorëzon edhe çelësat. Dhe këtij personi, udhëheqja e rrethit i jep vetëm një vërejtje, në vend që ta përjashtojë nga Partia, sepse largohet nga fronti i punës e kapitullon. Njerëz të tillë jo vetëm që duhen ulur nga përgjegjësia, por duhen përjashtuar fare nga Partia. Të tilla vendime i shërbejnë forcimit të Partisë, mbrojtjes së diktaturës së proletariatit, mbrojtjes së pastërtisë së marksizëm-leninizmit.

Në material të përdoren shprehje lakonike, jo të gjata. Ata që do ta lexojnë protokollin, po të duan t'i zbërthejnë, le t'u referohen materialeve të mëparshme dhe t'i rilexojnë, sepse ka shumë që i harrojnë, bile ka nga ata që kanë harruar shumë nga porositë e direktivat e dhëna.

Në mbledhjen e Byrosë Politike u fol edhe për probleme të tjera, si për shembull për ndërtimin e një fabrike etj. Më pëlqeu shumë diskutimi i Hakiut [Toska], kur foli për këtë çështje.

Prandaj, po e theksoj, që për protokollin të vihen në punë specialistët tanë këtu, në aparatin e Komitetit Qendror, dhe të mos lihet ta bëjë këtë ndonjë nga specialistët e Komisionit të Planit të Shtetit, se atë që kishte për të parashtruar Komisioni i Planit na e paraqiti, prandaj s'ka ç'të na thotë tjetër.

Para se të vendosim për planin e ardhshëm, të gjitha ato që u thanë në mbledhjen e Byrosë Politike, duhet të mos i marrë era, por të shikohen me vëmendje, të gjykojmë mbi to e të reflektojmë.

**SHOKU HEKURAN ISAI:** Shoku Haki në diskutimin e tij kishte shumë propozime konkrete.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Kishte, por të tëra, natyrisht, nuk mund të thuhet dot në materialin që do të përgatitet. Ka shumë gjëra për të thënë, por të gjithë shokët, kur të mblidhen për të diskutuar, duke u nisur edhe nga orientimet që u dhanë në Byronë Politike, të mos ndalen në gjërat e vogla, por kryesisht në problemet e mëdha që na shqetësojnë.

Kryesorja për paraqitjen e planit Byrosë Politike dhe Kuvendit Popullor nuk është vetëm përgatitja e raportit, por hartimi konkretisht i planit, përgatitja si duhet e gjithë Partisë për këtë plan. Ja, të gjitha materialet e Komitetit Qendror, domethënë të gjitha orientimet e Partisë kanë shkuar poshtë, në bazë, por pa shikoni ç'gjëra na dalin? Shikoni si veprohet? Ka mungesë disipline, mungesë kontrolli, ka liberalizëm e shfaqje të tjera negative.

Në të gjitha plenumet e Komitetit Qendror, në ato ku janë marrë në analizë probleme ekonomike, të tilla si këto që na dolën tani, ne i kemi ngritur hollësisht, gjatë e gjerë. Po të përmbliidhen të gjitha ato materiale që u kanë shkuar shokëve të Partisë në bazë, si për shembull raporti i plenumit dhe fjala ime, bëhen shumë. Me këtë dua të them se materialet nuk kanë munguar. Atëherë pse konstatohen këto të meta shqetësuese? Kjo duhet të na preokupojë dhe t'i vëmë mirë



njerëzit përpara përgjegjësisë. Por që t'i vësh ata që duhet përpara përgjegjësisë, nuk do të thotë vetëm t'u kërkohet llogari, por edhe t'u thuhet konkretisht ku janë të metat që ata t'i shohin e t'i korrigjojnë. Pra, duhen kritikuar njerëzit atje ku janë për t'u kritikuar, që me të vërtetë të shkunden. Në rast se diku nuk ka kontroll dhe disiplinë në punë, Partia duhet t'i tregojë vendin atij që i shkel këto. Kur udhëheqja thotë që duhet të kesh disiplinë në punë dhe ta ka shpjeguar gjerë e gjatë teorikisht, këtë duhet ta vësh në jetë. Pse kush do ta vendosë këtë disiplinë? Cilin pret drejtuesi i fabrikës së pijeve alkoolike që të vërë disiplinë për të kontrolluar shishet e konjakut? Mos pret që të vete unë këtëj t'i kontrolloj? Atëherë ku është ndërgjegjja këtu, ku është organizata e Partisë?

Kemi folur e flasim për eksportin. Ky është një problem jashtëzakonisht i rëndësishëm dhe i tillë ka qenë kurdoherë, aq më shumë aktualisht. Po ç'vihet re në këtë drejtim? Mosrealizime. Atëherë ku është ndërgjegjja, ku është disciplina? Prodhimi nuk realizohet. kontrolli nuk bëhet si duhet, çmimet nuk caktohen në rregull. Të gjitha këto kanë disa shkaqe. Të themi se nuk shpjegohet mirë rëndësia e të gjitha këtyre çështjeve, nga ana ime këtë nuk mund ta pranoj.

Prandaj protokoli të bëhet siç thamë, mjaft konkret. Firmose ti, Ramiz [Alia] në emër të Byrosë Politike dhe t'u kalojë sa më parë komiteteve të Partisë. Kjo çështje të bëhet objekt diskutimi edhe në mbledhjen e plenumeve dhe t'i vëmë në lëvizje të gjithë shokët e Partisë e jo vetëm drejtuesit kryesorë, por edhe ata që janë zgjedhur anëtarë të plenumit të komi-

tetit të Partisë. Edhe këta ta zbërthejnë mirë këtë material, të përgatiten që ta shpjegojnë atë në organizatat-bazë, duke e detajuar dhe duke e ilustruar me gjendjen konkrete dhe me detyrat e ndërmarrjes ku militon e ku shkon të punojë këtë material. Pra, të flasin konkretisht për rrethin e jo për tërë Shqipërinë.

Më duket se shumë herë, në mjaft mbledhje pune ka formalizëm, diskutohet sa për të thënë që u diskutua. Një nga shokët përgatit një material, e lexon atë dhe pastaj pyet: «Kush ka për të diskutuar?». Por nuk flet njeri, se të tjerët vijnë të tërë të papërgatitur dhe ai që flet në fillim, u vesh pastaj atyre që lexoi edhe disa fraza boshe dhe me kaq mbaron kjo punë. Në fakt, me këtë mënyrë, punë konkrete nuk bëhet fare. Partia nuk do llafe në erë, shokë, ajo kërkon të realizohet plani i naftës, i eksportit, i misrit, i grurit, i ullirit, i lulediellit etj. Për këtë qëllim Partia të vërë në lëvizje të gjitha levat që t'i realizojnë së bashku detyrat, ndryshe nuk mund të ketë rezultate. Kështu siç punojnë disa, tregon se janë larg të kuptuarit drejt dhe të vërtetë të situatës. Mirëpo, në qoftë se do të vazhdohet kështu, një mëngjes me siguri që do të gjendemi përpara vështirësish të reja.

Ekonomia jonë është e shëndoshë, pa plagë e pa sëmundje, por na duhet t'i luftojmë çdo ditë ato dobësi e mangësi që konstatojmë. Këto çështje mund t'i zgjidhim jo me ekspediente të pafektshme ose me efekte shumë të vogla. Zhvillimi i ekonomisë kërkon të realizohen detyrat në bazë të planit që kemi caktuar, plan ky, i bazuar në mendimet e punonjësve. Por duhet të pranojmë se krahas realizimeve, kemi edhe mosrealizimi-

me. Po lejuam të tilla, si mund të zhvillohet më tej ekonomia? Kjo nuk është aspak normale. Deficitet që janë krijuar duhen plotësuar. Kjo arrihet duke realizuar e tejkaluar planet. Fakt është se në këtë drejtim është bërë një punë e dobët ideopolitike e organizative. Mosrealizimet kanë shkaqe objektive, por kanë edhe shkaqe subjektive, por këto duhen përcaktuar qartë, cilat janë objektive dhe cilat janë ato subjektive. Për shembull, në rast se një detyrë nuk u realizua se nuk kishte çelik, kjo, natyrisht, ndodhi për shkaqe objektive, pse pa çelik nuk mund të bësh as këtë, as atë vegël apo pajisje. Kurse kur ke të bësh me anën subjektive, kjo nuk llogaritet materialisht si çeliku, sepse subjektivja ka një shtrirje të gjerë, këtu përfshihen gjithë puna politike, ideologjike, organizative, disiplina, normat, përvetësimet, shpërdorimet e plot të tjera si këto.

Në këtë drejtim Partia duhet të bëjë një punë të madhe, por që nuk bëhet si duhet. Se në praktikë nuk përcaktohen konkretisht cilat janë shkaqet objektive dhe cilat ato subjektive të mosrealizimeve. Edhe kjo, fakti që nuk përcaktohen këto, ka shkaqet e veta, po baza këto nuk i përcakton.

Në qoftë se lënda e parë, me të cilën do të prodhohet një artikull, nuk vjen nga jashtë, kuptohet që në këtë zë, plani nuk do të realizohet dhe ky është një shkak objektiv. Në këtë rast plani duhet lëvizur, të hiqet ky prodhim dhe të zëvendësohet me prodhimin e një tjetri.

Mirëpo ç'ndodh disa herë në të tilla raste? Veprohet padrejtsisht: meqënëse për muaj të tërë nuk është

prodhuar ai artikull ngaqë nuk kishte material, pra për shkaqe objektive, kur vjen materiali bëhen përpjekje të jashtëzakonshme, duke punuar për shumë ditë me radhë jashtë orarit. Kjo jo vetëm dëmton shëndetin e punëtorëve, por s'ka dyshim që nga ngutja do të dalin edhe shumë skarcitete. Pse ngjet kjo? Ndërmarrja, kur nuk i vjen lënda e parë, e ngre zërin për këtë gjë, kurse ata më lart në dikaster nuk e çajnë kokën për t'i dhënë zgjidhje kësaj gjendjeje, por dinë vetëm t'i thonë ndërmarrjes që «plani është ligj, prandaj ke apo s'ke lëndë të parë, realizoje këtë plan», pa se si do ta realizojë kjo, asnjë gjë nuk i thonë. Por ka edhe raste kur ndërmarrja kundërshton, duke thënë: «S'ka mundësi, prandaj shikojeni edhe një herë planin». Dhe, në fakt, në këtë rast ai duhet shikuar.

Duhet kuptuar drejt edhe interpretimi e zbatimi i ligjit se ka moskuptime nga njerëzit. Një grua më shkruan se vrasësi i vëllait të saj duhet dënuar me vdekje dhe, se meqë gjykata nuk i dha këtë dënim, thekson ajo, unë do të vete ta vras vetë. Ajo kujton se duhet të zbatohen qorrazi ligjet.

Ja tani, në kushtet objektive të krijuara, thamë që të ulet konsumi i energjisë elektrike në masën 35 për qind. Kjo është e domosdoshme të bëhet për arsye objektive, por as përpjetet njeri që të bëjë llogari se ç'pasoja do të ketë në prodhim e në plan një masë e tillë dhe ku do të reflektohet ulja, cilat janë ato ndërmarrje që preken dhe t'i thonë konkretisht këto. Pra e kam fjalën që njerëzit të preokupohen, se plani ulet në këtë masë, prandaj të mendohet se çfarë do të bëhet që të mund të kompensohet kjo ulje. Gjithçka në këtë rast

duhet bërë me llogari, me laps në dorë, jo duke sfor-  
 cuar vend e pa vend punëtorët me punë jashtë orarit.  
 Punëtorit mund t'i kërkojmë të punojë ndonjë orë në  
 ditë jashtë orarit, vetëm sa ta kompensojë atë boshllëk  
 që u krijua. Por komiteti ekzekutiv apo dikasteri ve-  
 tëm i kërkojnë llogari ndërmarrjes pse nuk realizoi  
 planin dhe as që e marrin parasysh se më parë duhet  
 t'i plotësojnë asaj të gjitha ato kushte që i kanë për-  
 caktuar vetë. Kështu nuk është ligji. Vërtet duhet të  
 kërkojmë nga klasa punëtore, por në radhë të parë se-  
 cili, aq më tepër kuadrot në qendër, të kërkojnë nga  
 vetja.

Nuk e thashë pa qëllim në mbledhjen e Byrosë  
 Politike se kritikant që bëhen nga poshtë në shumë raste  
 nuk merren parasysh. Të gjitha faktet që përmendëm  
 këtu, e vërtetojnë një gjë të tillë. Kur ndërmarrjes nuk  
 i vjen lënda e parë, ajo shqetësohet që t'i mbulojë  
 punëtorët me punë, kurse nga lart, dikasteri, në vend  
 që ta ndihmojë konkretisht, i thotë: «Dërgojini të pu-  
 nojnë në fshat». Mirëpo atyre që dërgohen të punojnë  
 në fshat rrogën do t'ua paguajë ndërmarrja. Pra fon-  
 di i pagave nuk mbështetet me prodhim. Kurse fsha-  
 tarët meqë erdhën këta nga qyteti, vetë nuk punojnë,  
 sepse punën e tyre e bëjnë punëtorët, dita e punës e  
 këtyre shkon në favor të kooperativës, ndërsa punëtorë-  
 ve u jep rrogën shteti. Po të veprohet kështu, kjo tre-  
 gon se nuk ecet me llogari. Atëherë ç'i thonë kësaj? Ky  
 nuk është as plan, as ligj. Prandaj them se pikërisht  
 këto gjëra duhen shpjeguar e ndrequr duke marrë ma-  
 sat e duhura.

Partia si udhëheqje, dhe kur flasim Partia si udhë-

heqje, të mos kuptojmë vetëm forumet udhëheqëse të saj, por edhe punën drejtuese të pushtetit, edhe tërë masën e komunistëve që punojnë në një qendër pune, të gjithë duhet të drejtojnë e të ndihmojnë politikisht, ideologjikisht, teknikisht, organizativisht dhe moralisht. Për shembull, në një ndërmarrje ka disa organizata-bazë. Partia atje i di ku qëndrojnë dobësitë. Prandaj të metat e dobësitë që ekzistojnë t'i konstatojnë e t'i nxjerrin vetë komunistët e ndërmarrjes, kudo ku janë shpërndarë. Këta të vrasin mendjen për të shëndoshur gjendjen. Si anëtarë partie ata duhet të mendojnë se ç'masa duhet të merren, masa politike, ideologjike, organizative dhe teknike për ta çuar punën përpara. Këto probleme po të jetë nevoja i ngrenë në organizatën-bazë të Partisë, bile edhe në mbledhjen e përgjithshme të komunistëve, pavarësisht se cili është rendi i ditës së mbledhjes. Nuk ka gjë të keqe kur komunisti nuk i përmbahet rendit të ditës kur ka një problem të rëndësishëm të punës në repartin ku punon. Ai i thotë me këtë rast mbledhjes se çështjen që do të ngrejë, ai ia ka shtruar sekretarit të byrosë së Partisë të ndërmarrjes, po ky nuk ia ka marrë parasysh. Prandaj le të diskutojmë për problemin që është në rend të ditës, por unë do të ngre këto çështje që e shqetësojnë repartin tim. Në qoftë se edhe të tjerët kanë në repartet e tyre probleme të tilla dhe flasin në atë mbledhje, atëherë del se rendi i ditës që është caktuar nuk i përgjigjet fare situatës që po zien në ndërmarrje. Aty nuk po realizohet plani e nuk ulet skarciteti, kurse sekretari bën dy mbledhje me radhë për një problem tjetër, që nuk është preokupant në momentin e dhënë, kur

në ndërmarrje ka çështje të tjera që janë shumë preokupante, të cilave duhet t'u japim zgjidhje sa më parë. Natyrisht, do të bëhen edhe mbledhje për probleme të politikës së jashtme, që njerëzit të jenë të qartë, por ama në këto mbledhje të mos flasim sa për të folur, se kështu nuk zgjidhet problemi, por të trajtojmë situatat ndërkombëtare që të jetojmë me to e të vëmë gishtin se ku duhet të luftojmë konkretisht që vështirësitë e krijuara të kapërcehen, që detyrat dhe plani i ndërmarrjes të realizohen me sukses.

Në qoftë se baza i ngre problemet, por përgjegjësit më lart, dikasteret, nuk ndihmojnë për t'i zgjidhur ato, atëherë duhet të dalim me konkluzionin se dikasteret qendrore nuk i dëgjojnë bazën, klasën punëtore, komunistët e thjeshtë. Po të ndodhë kështu, ky nuk është një qëndrim marksist. Si të mos dëgjohen punëtorët? Duhet t'i mësojmë njerëzit në bazë që, në qoftë se kësaj ose asaj çështjeje që ngrihet, nuk i shkohet deri në fund, nuk analizohet, ata nuk duhet të tërhiqen derisa problemi i ngritur të gjejë zgjidhje. Ndryshe, klasa punëtore, organizata e Partisë, duke qënë të bindura se kanë të drejtë, bëhen bllok, marrin vendim e u tregojnë vendin atyre drejtuesve që bëhen pengesë në punë dhe në vend të tyre zgjedhin të tjerë që janë luftarakë dhe u japin rrugë në kohë e drejt problemeve. Duke vepruar kështu ne e forcojmë Partinë, ndryshe organizata-bazë në ndërmarrje e kudo do të mbetet diçka formale, pse tek ajo do të dominojnë drejtuesit e ndërmarrjes. Nuk mund të kuptohet roli udhëheqës i organizatës së Partisë, kur në të dëgjohet vetëm zëri i drejtuesve.

Në Parti udhëheqin dhe duhet të udhëheqin ata njerëz që Partia i ka zgjedhur dhe që janë të predispozuar të dëgjojnë zërin e komunistëve, zërin e masës. Këta duhet të çojnë në masat eksperiencën e madhe të Partisë, që është më e pasur dhe e plotësuar me cilësi më të larta sesa eksperiencia e një anëtari të thjeshtë partie, të cilin do ta përgatitim që edhe ky në të ardhmen të jetë një kuadër drejtues.

Llogari për detyrat e ngarkuara duhet t'u kërkohej vartësve por ama është e dënueshme që, nën pretextin e kërkesës së llogarisë, drejtuesit të bëhen prepotentë, të japin vetëm urdhra dhe të mos punojnë vetë për realizimin frontal të detyrave. Prapa këtyre qëndrimeve fshihen shumë të këqija, prandaj këto nuk duhen lejuar, bile, siç e theksova, bartësit e tyre duhet të dënohen.

Kërkesa e llogarisë në vetvete kërkon edhe gjakftohtësi, edhe gjykim të drejtë, sepse kur bëhet me inat, me prepotencë, drejtësia kalon në pjesën më të madhe në padrejtësi. Është çështje psikologjike kjo. Pastaj me prepotencën fshihen gjëra të tjera, qëndrime jo të drejta, sidomos atje në qendrën e punës, në kooperativë, ndaj punonjësve të thjeshtë. Se kur i flet tjetrit me inat, ti mund të kesh të drejtë, por të mos harrojmë se secili ka edhe anën subjektive ndaj tjetrit dhe kjo nuk të lë të gjykolesh kurdoherë objektivisht. Atëherë kush do t'i gjykojë më mirë këto qëndrime? Organizata-bazë e Partisë, mendoj unë. Kush e pruri atë shembullin dhe në mbledhje? Më duket se ti, Hekuran, the që në mbledhjen e Komitetit të Partisë të Rrethit të Fierit, kur u dënua shefi i tregtisë, disa anëtarë të byrosë



nuk folën fare. Ata ose nuk kanë qenë të bindur dhe kishin rezerva për masën e marrë, ose nuk ishte shpjeguar mirë kjo situatë. Ka edhe një mundësi tjetër: që ata të jenë liberalë në pikëpamjet e tyre dhe të thonë me vete: «E pse të tregohemi kaq të ashpër me këtë njeri për një gabim kaq të vogël?». Prandaj duhej shpjeguar mirë se ky nuk ishte një gabim i vogël. Vetëm gjesti që bëri ky njeri, duke hedhur çelësat tej, është një gabim i rëndë, sepse në këtë situatë, me këtë gjest ai bën një veprim të dënueshëm. Partia e ka thënë, që kur një komunist a punonjës nuk është dakord me një drejtues, atëherë ka të drejtë ta ngrejë çështjen në organizatën-bazë. Po pse nuk u bënë këto veprime? Njerëz të tillë ne duhet t'i bindim, se qëndrimet e padrejta që mbahen në raste të tilla janë thikë me dy presa, sepse restaurojnë në praktikën e punëve tona njëfarë diktature jo të proletariatit, por të drejtuesve. Diktatura jonë e proletariatit nuk pranon tjetër përveç parimeve marksiste-leniniste. Që ta forcojmë atë vazhdimisht dhe ta ruajmë pastërtinë e marksizëm-leninizmit duhet t'i shikojmë problemet konkretisht, me anët e mira dhe me të këqijat, të gjykojmë drejt e me gjakftohtësi para se të dënojmë, të lavdërojmë apo të dekorojmë një person.

Të gjitha këto duhen shpjeguar qartë, pastaj të merret edhe mendimi i të tjerëve me seriozitetin më të madh. Mund të ndodhë që këta ta hedhin poshtë këtë ose atë propozim, dhe në këtë rast mund të rishikohet çështja dhe mund t'i jepet edhe vërejtje atij që e ngrihti kështu ose ashtu problemin dhe propozoi këtë ose atë masë. Megjithatë, mendimin e tij ai e tha. Nesër,

në qoftë se del e kundërta e kësaj që u vendos, ky person, jo për hakmarrje, por në mënyrë marksiste e ngre këtë çështje, atëherë hapen procesverbalet dhe gjendet se kush kishte të drejtë dhe kush nuk kishte, ç'të këqija sollti ky vendim që morën ata në atë kohë dhe ç'duhet bërë për t'i vënë në vend gjërat. Kështu zgjidhen punët në Parti, në qoftë se duam që këto t'i zgjidhim si duhet, që Partinë ta kemi të fortë dhe ekonomia jonë të ndërtohet në rrugë socialiste, në luftë me gjithë këto vështirësi të mëdha që na shkakton rrethimi kapitalisto-revizionist dhe që nuk janë pa efekte për vendin tonë.

Të themi që këto gjëra shtrohen për herë të parë, nuk është e drejtë. Të themi se kuadrot tanë, sidomos ata të moshës 35 vjeç e lart, nuk i dinë dhe nuk janë rrahur me vaj e me uthull për këto probleme, edhe kjo nuk pranohet. Një shoku 20 apo 25-vjeçar mund t'i mungojë eksperiencia në këto çështje, por 35-vjeçarit jo, sepse ai ka mbaruar shkollën e lartë, ka qenë në organizatën e rinisë, mund të jetë pranuar në Parti 24-25 vjeç. I thonë pra 10 vjet të tërë që ka punuar në vende të ndryshme. Pa le pastaj ç'mund të themi për 45-vjeçarit që i ka hasur disa herë në jetë këto gjëra, jo vetëm teorikisht, por edhe në praktikë, pra ka eksperiencë që të bëjë një punë të shëndoshë partie. Në rast se nuk vepron kështu, atëherë dalim në konkluzionin se ai ka kaluar kontrabandë, ka zënë një vend ku nuk i takon të qëndrojë, domethënë ndaj tij eprorët janë treguar dhe po vazhdojnë të tregohen liberalë, duke e mbajtur përsëri në atë vend ku ai nuk po e justifikon besimin që i është dhënë. Ky liberalizëm mund të ishte

I lejueshëm deri në njëfarë mase kur ishim të shtrënguar për kuadro. Po tani ky kuadër, që shërben për 10 apo 12 vjet me radhë si shef i tregtisë, pra, me gjithë këtë eksperiencë të gjatë, vjen çështja dhe na hedh çelësat dhe ne ta pranojmë këtë qëndrim e veprim shumë të gabuar të tij pa i dhënë një dru të mirë? Kjo nuk duhet të lejohet!

*SHOKU HEKURAN ISAI:* Ju, shoku Enver, keni plotësisht të drejtë. Këtë vërejtje që po bëni, duhet ta shikojmë një çikë më thellë, sidomos lidhur me udhëheqjen e Partisë në ekonomi. Në këtë drejtim ne kemi defekte, prandaj mendoj ta bisedojmë dhe ta shtrojmë çështjen në frymën që e shtroni ju, që çdo komunist të punojë si duhet e të preokupohet seriozisht, duke ngritur në Parti çështje konkrete. Sigurisht në këtë drejtim ne kemi rritje, kemi zhvillim që as mund të krahasohet me atë të viteve të mëparshme. Megjithatë më duket se udhëheqja e Partisë në ekonomi e ka defektin që keni konstatuar ju.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Hekurani e ka çështjen tek ajo që e theksova edhe dje në mbledhjen e Byrosë Politike, që për një anëtar partie mund të thuhet se është i mirë, kur ai lufton për të realizuar e për të tejkaluar planin dhe arrin rezultate.

Kjo nuk do të thotë që komunizmi të kuptohet siç llogotiste Hrushovi që e identifikonte atë me një pjatë gulash. Kjo është antimarksiste. Puna e Partisë duhet të konsistojë në radhë të parë në ngritjen e njeriut të ri, me botëkuptim të shëndoshë, të njeriut të zhvilluar politikisht e ideologjikisht, që kupton si duhet ligjet e ekonomisë sonë socialiste. Përse t'i kuptojë këto

gjëra? Për të ndërtuar e për të mbrojtur socializmin. Dhe që të ndërtohet socializmi, është e domosdoshme që ai t'i shërbejë këtij, duke vënë të gjitha forcat mendore e fizike, të tëra aftësitë që ka, me një ndërgjegje revolucionare të lartë që duhet të na karakterizojë, sepse kështu forcojmë diktaturën e proletariatit, forcojmë, në fakt, Partinë. Dhe kjo duhet forcuar vazhdimisht, sepse pa Partinë e klasës punëtore, pa ideologjinë e saj dhe pa zbatuar normat e saj, socializmi nuk mund të ndërtohet, nuk mund të ecim përpara. Në qoftë se veprohet ndryshe, nuk i shërbehet socializmit.

Anëtarët e Partisë sonë duhet t'u futen thellë këtyre çështjeve, për të cilat biseduam, dhe puna e tyre, qoftë politike, ideologjike apo organizative, deri te përpjekjet që duhet të bëjnë ata për ngritjen e tyre nga ana teknike, kërkohet që të ketë një objektiv të caktuar, duke ua përshtatur kushteve të vendit dhe kohës të gjitha ato çka dinë dhe çka mësojnë dhe të mos mbeten deri këtu, pse marksizëm-leninizmi na mëson që duhet ta zhvillojmë më tej situatën. Në qoftë se zbatohet si duhet ky mësim, në qoftë se vëzhgohet drejt zhvillimi i fenomeneve, me siguri që do të konstatohen momente që tregojnë se nuk mund të ecet më me këtë organizim, me këtë punë politike ose me këto kërkesa që shtrohen aktualisht, por se është e nevojshme të bëhet një hop tjetër përpara në këto drejtime. Siç e theksova, një gjë e tillë duhet bërë në rrugën marksiste-leniniste, në përshtatje me situatat, t'u shpjegohet të tërëve se vërtet do t'i bëjmë të gjitha, more shokë, por për këtë qëllim do të na duhet të bëjmë edhe sakrifica, prandaj i duhet vënë gjoksi punës. Kësaj i thonë që ta kuptosh

marksizëm-leninizmin në kushtet e sotme të zhvillimit të shoqërisë, në zbatimin e normave dhe në krijimtarinë e së resë, se kështu nuk gabon. Kështu mund të ecim më tutje, pa u stepur, pa u trembur nga vështirësitë, por edhe pa eufori. Të mos merren çështjet lehtë-lehtë, por duke e parë realisht situatën, gjithmonë të udhëhequr nga doktrina jonë marksizëm-leninizmi.

*SHOKU RAMIZ ALIA:* Marksizëm-leninizmi është udhërrëfyes për ne që t'u përgjigjemi si duhet këtyre situatave, këtyre momenteve të reja, sepse ai ka vitalitet dhe është i pashtershëm në energji. Domethënë po t'i drejtohesh marksizmit, tek ai mund të gjesh të gjitha zgjidhjet, sepse të mëson, të sugjeron, të jep mundësi t'i përgjigjesh çdo detyre aktuale, çdo situatë të krijuar.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Revizionistët modernë na akuzojnë ne, marksistë-leninistët, si dogmatikë. Por kjo nuk është e vërtetë. Kush është me të vërtetë marksist-leninist, nuk mund të jetë dogmatik.

Këto gjëra duhet t'i kuptojmë mirë. Ne e kemi thënë dhe do ta themi përsëri domosdoshmërinë e forcimit të pandërprerë të Partisë. Por të mos mendohet se meqë e kemi thënë një herë, fajin e kanë ata të bazës, pse faj kemi të tërë dhe këtë duhet ta kuptojmë mirë dhe drejt.

*SHOKU RAMIZ ALIA:* Ajo që thatë ju për çështjen e Partisë është e drejtë. Të gjitha këto janë thënë, po ka nevojë për t'i shikuar, sepse ç'është e vërteta ka rutinë. Situatat kërkojnë një veprim më energjik, një tendosje nervore e fizike të madhe, nga çdo komunist

që secili të jetë në frontin e vet, në krye të punës.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Pikërisht këtë dua të theksoj. Në Shkollën e Partisë, në kurset e në format e edukimit është e domosdoshme të mësohet teoria jonë e marksizëm-leninizmit, të sqarohen çështjet politike, por asnjëherë dhe në asnjë mënyrë të mos bëhen orvatje që të mësohet teoria e shkëputur nga praktika, të mos thuhet vetëm me fjalë që të mos shkëputemi nga praktika, por çdo tezë teorike ta bëjmë të qartë, duke e lidhur ngushtë me praktikën. Ka me mijëra dhe me dhjetëra mijë punëtorë të ndërgjegjshëm, luftarakë, patriotë, me koncepte të drejta e të qarta përparimtare, që e duan me gjithë shpirt Partinë, e duan marksizëm-leninizmin, e duan Shqipërinë socialiste dhe diktaturën tonë të proletariatit, por teorinë marksiste-leniniste nuk e njohin thellë. Pa shikojeni Spiro Lerën, Shyqyri Kanaparin. Ata mbase s'e njohin thellë teorinë, por në jetë, në punën e në veprimtarinë e tyre gjen të shprehur thelbin e teorisë sonë. Sa vjet ka Shyqyriu që me traktorin e tij punon për llogari të viteve të ardhshme! Teorinë, pra, ai mund të mos e njohë, por ai është hero.

Prandaj them unë se teoria ka vlerë vetëm kur lidhet me praktikën dhe ne duhet t'i ndreqim në këtë drejtim të gjithë ata që hiqen si teoricienë, që bëjnë referate teorike dhe s'kanë haber, ose mund të kenë haber, por e nënvleftësojnë faktin se kujt po i flasin. Në qoftë se në këto referate ata do të gërshetojnë mirë teorinë me rezultatet e normave e me të gjitha këto çështje që kanë të bëjnë me kryerjen sa më mirë të punës, atëherë ky do të jetë një referat teorik i ilustruar

me zbatimin e teorisë në praktikë, ndryshe do të jetë një gjë formale e mbështetur në formula që mbeten si dogma pa vlerë. Në qoftë se bëjmë vetëm konsiderata të tilla, si Lenini ka thënë kështu, Marksi ka thënë ashtu, kjo është bërë kështu dhe ajo është ashtu, nuk kemi bërë gjë. Ç'kanë thënë klasikët tanë janë të palëvizshme, ata i kanë thënë ato dhe ne duhet t'i dimë mirë, por ama të shikojmë një çikë konkretisht se si i zbatojmë në praktikë ato që kanë thënë ata.

*SHOKU RAMIZ ALIA:* Se si janë sëmundjet e ndryshme, tifoja, fruthi etj., këto i tregon edhe manuali mjekësor, por ta shikosh konkretisht te njeriu në ç'mënyrë paraqitet kjo apo ajo sëmundje, për shembull, tifoja, ç'duhet bërë me të etj., ky është një problem tjetër. Pra, vërtet do të nisemi nga teoria, por ama çdo çështje duhet shikuar edhe në praktikë, te personi konkret.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Natyrisht, ashtu është. Gripi këtë emër ka për të gjithë ata që i zë, por ama mjeku shikon se në ç'shikallë paraqitet kjo sëmundje te një person apo te një tjetër. Kështu virulencën e gripit spanjoll e matim në praktikë, sepse teorikisht shpjegohet se sa për qind e rrezikon jetën e njeriut kjo sëmundje, mirëpo mjekët kanë parë praktikën, për shembull, dhe kanë konstatuar se në 100 veta kanë vdekur 10 ose më shumë apo më pak. Pra teoria ekziston që ta njohësh mirë sëmundjen e të dish se si ta mjekosh, kurse praktika të mëson se si duhet ta njohësh atë konkretisht dhe si të veprosh në raste të ndryshme.

I sollëm këta shembuj për të bërë analogji me çështjen për të cilën folëm më lart, pra, për zbatimin.

në praktikë të teorisë sonë, marksizëm-leninizmit. Të tëra ato që na mësojnë Marksi, Engelsi, Lenini e Stalini janë ligje teorike, të cilat ne duhet t'i dimë mirë. Pastaj të shikojmë se si i zbatojmë këtu, në kushtet e vendit tonë. Pra teorinë edhe mund të mos e zotërosh mirë, por rëndësi ka ta zbatosh. Është më mirë ta kuptosh përpara, pastaj ta zbatosh, por është gjithashtu mirë kur me punën e mirë që kryen, zbaton ligjet e teorisë, sepse do të vijë koha që edhe atë ta kuptosh.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga biseda  
e incizuar që gjendet në AQP*



## REHABILITIMI I GJITHË REAKSIONIT TË ZI

Shënime

7 dhjetor 1978

Në Kinë situata vazhdon të jetë e turbullt, vazhdon të turbullohet «që të qartësohet», siç ka thënë Maoja, por, në të vërtetë, që të mos qartësohet kurrë. Në fakt, lufta në mes fraksioneve të ndryshme është e vazhdueshme; herë ngrihet e herë ulet dhe askush nuk mund të përcaktojë me saktësi se çfarë po ngjet konkretisht në Kinën e Mao Ce Dunit. Ajo që të gjithë e përcaktojnë saktë është se atje ka luftë për pushtet midis klanesh rivale, kush e kush të dominojë pushtetin dhe Partinë e ashtuquajtur Komuniste të Kinës.

Siç e kam theksuar edhe në shënime të tjera të mëparshme, janë pikërisht këto rryma të ndryshme, pjesëlla të politikës antimarksiste që kanë zhvilluar tërë kohën Partia Komuniste e Kinës dhe Mao Ce Duni, që e shkaktojnë këtë gjendje aktuale kaotike në Kinë. Në kohën e Mao Ce Dunit dhe të Çu En Lait kaotizmi në politikë, në ekonomi dhe në sektorë të tjerë ekzistonte, por duhet thënë se Mao Ce Duni që drejtonte ushtrinë, dhe bashkëpunëtori i tij i ngushtë Çu En Lai, i cili drejtonte ekonominë, kishin vendosur mbi pushtetin

kinez një diktaturë jomarksiste, diktaturë të klanit personal, dhe i kishin dhënë kësaj ngjyrën e diktaturës së proletariatit. Në fakt, në kohën e Mao Ce Dunit e të Çu En Lait atje as nuk mund të bëhej fjalë për diktaturën e proletariatit. Kjo u vërtetua gjatë periudhës kur ata ende nuk ishin të plotfuqishëm në Kinë, pra edhe kur kjo u çlirua dhe u vendos gjoja demokracia e re, edhe në kohën e Revolucionit Kulturor. Por pas vdekjes së tyre, kjo «diktaturë e proletariatit» në Kinë, siç e quanin ata, ky autoritet i vendosur në këto forma, me këtë ideologji, në këtë gjendje kaotike mendimi e veprimi, u venit dhe shpërtheu lufta për pushtet, kush e kush të rrëmbente thelën më të madhe.

Aktualisht, siç po duket, rivalitetet janë koncentruar në dy pole, në polin e Hua Kuo Fenit dhe në polin e Ten Hsiao Pinit. Tash këto dy pole të kundërta po luftojnë ndërmjet tyre. Natyrisht, bëhet një luftë speciale kineze, me batica e me zbatica, të shkaktuara nga grumbullime fraksionesh të ndryshme, që militojnë në të dy klanet kryesore.

Në përgjithësi mund të thuhet se të dy klanet kryesore synojnë një objektiv të përbashkët: ta kthejnë sa më shpejt Kinën në një vend kapitalist, imperialist, në një fuqi të madhe. Prandaj të dy klanet janë në ethe prej kali për realizimin e dy qëllimeve, që janë: njëri — «katër modernizimet» dhe tjetri — kush duhet të paraqitet si udhëheqësi frymëzues i këtyre «modernizimeve», kush është lidhësi i kësaj politike të re që do ta çojë vendin drejt një fuqie imperialiste të madhe botërore, klan i Ten Hsiao Pinit apo ai i Hua Kuo Fenit? Kjo luftë ka anën e përbashkët, njëkohësisht ka

edhe karakteristika të veçanta. E përbashkëta është se as njëri, as tjetri klan nuk e harrojnë objektivin kryesor, shndërrimin e Kinës në një fuqi të madhe. E veçanta është se nga cili klan duhet të udhëhiqet Kina gjatë periudhës për realizimin e «katër modernizimeve»; cili klan do të sundojë atje, cili do të fitojë besimin e imperializmit amerikan dhe të fuqive të tjera imperialiste e kapitaliste të zhvilluara.

Si mund të gjykohet rreth këtyre problemeve?

Natyrisht, pozitat janë të qarta: në pushtet, në udhëheqje, mund të themi se superior është Hua Kuo Feni, i cili është edhe kryetar i partisë, edhe kryeministër, kurse Ten Hsiao Pini vjen në plan të dytë. Por një gjë e tillë është vetëm në sipërfaqe. Për arritjen e objektivave që përmendëm më lart, çështja se kush e ka në dorë ushtrinë në Kinë ka rëndësi të madhe, por për ne është e pamundur të përcaktohet drejt se kush e ka atë në dorë. Ushtrinë mund ta ketë në dorë Hua Kuo Feni ose mund edhe të mos e ketë ai, por Ten Hsiao Pini. Hua Kuo Feni, si rregull, është komandant i përgjithshëm i ushtrisë, por varet shumë me kë janë shefat e ndryshëm ose «zotërit e luftës», siç i quanin më përpara, dhe që aktualisht e ruajnë këtë karakter në ushtrinë kineze. Pra, ka rëndësi se nën vartësinë e kujt është shumica dërrmuese e këtyre njerëzve në ushtri. Këtë gjë, siç e vura në dukje, nuk mund ta dimë dhe ta përcaktojmë drejt ne, por edhe sikur ta përcaktojmë dhe të themi se Hua Kuo Feni është ai që ka shumicën e tyre në dorë, përsëri duhet mbajtur parasysh fakti që ushtria kineze është një ushtri me karakter kaotik, e paorganizuar, që nuk i përngjet aspak ushtrisë së një

vendi socialist, për arsye se vetë Kina nuk është vend socialist. Domethënë ushtria kineze nuk është një ushtri popullore, s'është armë e diktaturës së proletariatit, sepse në Kinë nuk ekziston kjo diktaturë, por ajo, gjithashtu, nuk është as dhe një ushtri, si të thuash, e tipit të ushtrive amerikane, franceze apo japoneze, me tradita kapitaliste, ku ka organizim dhe ku është vendosur një strukturë e ndiqet një politikë e tillë ushtarake që urdhri i komandantit bën që ushtria të jetë në duart e tij si *perinde ac cadaver*<sup>1</sup>.

Pra, në ushtrinë aktuale kineze nuk ekziston një situatë e tillë: atje nuk ka organizim, veçse një kaos të madh, prandaj kësaj do t'i duhet kohë që të bëhet një instrument i efektshëm në duart e një fuqie kapitaliste. Këtu nuk është vetëm çështja e sigurimit të armatimeve, të cilat, natyrisht, do të luajnë një rol të madh, por edhe problemi i frymës së disiplinës ushtarake borgjezo-kapitaliste, imperialiste, që duhet të vendoset në një ushtri ku nuk ka ekzistuar kurrfarë discipline, pale disiplinë proletare. Pra, të themi që në Kinë «zotërit e luftës» bëjnë qind për qind ligjin në ushtrinë e tyre, mund dhe të gabohemi, por dhe që këta «zotër të luftës» të jenë plotësisht të bindur dhe të nënshtruar ndaj Ten Hsiao Pinit, përsëri edhe kjo do të jetë *hasardé*<sup>2</sup>. Pastaj mund të ndodhin edhe ndryshime që disa

---

1. Latinisht — si një kufomë. Këtu është përdorur në kuptimin e një ushtrie, ushtarët e së cilës i zbatojnë urdhrat e komandantit në mënyrë të pandërgjegjshme, mekanikisht dhe komandanti e vërtit si të dojë.

2. Frëngjisht — shprehje jo korrekte apo hipotezë e guximshme.

«zotër» të kalojnë nga Ten Hsiao Pini te Hua Kuo Feni ose në të kundërtën. Sidoqoftë, Hua Kuo Feni ka njerëzit e vet, sikundër edhe Ten Hsiao Pini ka të vetët në ushtri.

Pra, fuqia kryesore, që bën ligjin aktualisht në Kinë, është në lëvizje. Atje ekziston një gjendje kaotike dhe luftohet me synimin që të krijohen bërthamat e një pushteti të shëndoshë të një ose të dy klaneve. Nuk mund të themi se klani i Hua Kuo Fenit nuk dominon tash në Kinë, ashtu si nuk mund të themi që nuk dominon klani i Ten Hsiao Pinit. Por fakt është se në Kinë ekziston një situatë amullie, një situatë përpjekjesh për pushtet, siç e kam thënë edhe në shkrime të mëparshme.

Është e vërtetë që Hua Kuo Feni e likuidoi «katërshen», domethënë nuk u mbështet tek të katër figurat, të cilat ishin kreatyrat e Mao Ce Dunit, siç ishte edhe Ten Hsiao Pini. Çështja qëndron në atë që Hua Kuo Feni u propagandua si pasardhësi i Maos dhe i caktuar nga vetë ky në postin e kryetarit të partisë. Domethënë tash Huaja synon që gjithë opinioni pro Maos në Kinë të jetë ose të bëhet mbështetës i Hua Kuo Fenit, pa «katërshen». Natyrisht, kjo mbështetje e tij nën flamurin e Mao Ce Dunit do të thotë që Huaja të adoptojë politikën e hartuar nga Çu En Lai dhe të aprovuar nga Mao Ce Duni, domethënë orientimin politik për marrëdhëniet e Kinës me botën e jashtme, për aleancat e saj me shtetet kapitalisto-imperialiste dhe për zhvillimin e ekonomisë. Duhet thënë se Hua Kuo Feni, në përpjekjet për të adoptuar këtë program, kishte parasysh edhe mentalitetin e gjithë kësaj Kine

të madhe të frymëzuar nga idetë kaotike të Mao Ce Dunit. Edhe Hua Kuo Feni, pas marrjes së fuqisë, për njëfarë kohe eci me «katërshen», kështu që Ten Hsiao Pini u likuidua edhe nga ky. Mirëpo, më pas, Hua Kuo Fenit iu desh të likuidonte edhe «katërshen», për arsye se edhe ajo «po përgatiste puç» në Kinë. (Gjatë kësaj kohe Ten Hsiao Pini grumbulloi forcat dhe doli në sheshin Tien An Men, ku u godit.)

Më pas, siç e dimë, në Kinë u krijuan situata të tilla që Ten Hsiao Pini rierdhi në fuqi. Natyrisht, ardhja e këtij në fuqi solli situata të reja. Në këtë kohë për Hua Kuo Fenin nuk kishte më vlerë një ardhje kaq e bujshme në fuqi e Ten Hsiao Pinit. Nga ana tjetër Revolucionit Kulturor i Mao Ce Dunit, si dhe veprimet për ngritjen e Hua Kuo Fenit në postin e caktuar, për Ten Hsiao Pinin gjithashtu, nuk kishin vlerë. Ky problem nuk shtrohej nga Ten Hsiao Pini dhe grupi i tij. Prandaj gjatë kësaj kohe ne asistojmë në veprime përgatitore për një luftë klanesh, e cila do të zhvillohej në vazhdim të thellimit të rigrupimeve e të reformimit të radhëve të klaneve. Kështu që brenda në Kinë nuk mund të ekzistonte veçse një rrëmujë më e madhe nga ajo që mendonte Mao Ce Duni, një rrëmujë që nuk kishte formën e Revolucionit Kulturor. Kjo, në vetvete, do të thoshte përmbysje e Revolucionit Kulturor të Maos dhe, në të njëjtën kohë, në heshtje dhe nën rrogë, shpallje e një «revolucionit tjetër kulturor» të Ten Hsiao Pinit. Domethënë kjo ishte periudha e revanshit. Në këtë periudhë punonin të dy klanet. Tek-tuk, ku më shumë e ku më pak, në Pekin e në provinca

të ndryshme të Kinës filluan të merreshin masa për heqjen e kuadrove të mëparshëm nga postet që kishin dhe për zëvendësimin e tyre me të rinj. Të mëparshmit gjoja ishin përkrahës të «katërshes», kurse të rinjtë ishin ata që «katërshja» i kishte dënuar.

Gjithashtu gjatë kësaj periudhe u përgatitën dhe u konkretizuan çështje të tjera politike me rëndësi të madhe, të cilat do të zhvilloheshin në kuadrin e «katër modernizimeve». Natyrisht, paternitetin e kësaj vije, siç kam thënë, e mori Ten Hsiao Pini. Dhe menjëherë, nga të katër anët e botës u dërguan, siç dihet, delegacione politike, ushtarake e tregtare për të kërkuar kredi, për të marrë hua shtetërore dhe bankare, për të nënshkruar kontrata të majme tregtare me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me Japoninë dhe me vende të tjera kapitaliste, duke pasur për objektiv inkuadrimin e Kinës në tregun kapitalist. Në këtë drejtim u arritën mjaft rezultate, të cilat janë aq të shumta, saqë nuk mund t'i numëroj dot në këtë shkrim të shkurtër. Këto rezultate u kurorëzuan, sidomos, me Traktatin Kino-Japoncz. Ky traktat, pavarësisht se në dukje nuk është një pakt ushtarak, në fakt ka vlerën e një pakti të tillë dhe është nën patronazhin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Këtë të vërtetë e konfirmon më së miri edhe formimi në Japoni para nja pesë muajsh i «shoqërisë së miqësisë» në mes Kinës, Japonisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Përse të formohet në Japoni kjo shoqëri e këtyre «tre miqve të ngushtë»?! Përgjigjja është plotësisht e qartë: «Miqte» kanë për qëllim përgatitjen e një lufte kundër socialimperializmit sovjetik. Pikërisht për

këtë luftë ndihmohet Kina, fuqizohet ajo me armatime moderne, me teknologji të re, me kredi të shumta, lidhet edhe me traktat me Japoninë.

Gjatë kësaj kohe Hua Kuo Feni, për t'i dhënë lustër vetes, u nis e shkoi në Rumani e në Beograd. Mirëpo këto vizita nuk i sollën shumë fitime udhëheqësit kinez; për arsye se udhëheqjet e këtyre dy vendeve janë të diskredituara, revizioniste, shërbëtore të kapitalistëve, bile agjentura të kapitalizmit amerikan e botëror dhe të socialimperializmit sovjetik.

Kurse Ten Hsiao Pini ndërmori një turne aziatik. Ky, në radhë të parë, mori përsipër ratifikimin dhe nënshkrimin e Traktatit Kino-Japonez, që ishte baza e gjithë politikës së madhe kineze. Me këtë Ten Hsiao Pini doli në Kinë si një figurë e fuqishme, më e fuqishme se Hua Kuo Feni. Ai bëri shumë vizita në një numër vendesh të Azisë që t'i siguronte këto për «miqësinë» e Kinës ndaj tyre dhe mundësisht për t'i lidhur pas qerres së saj.

Pra, Hua Kuo Feni zgjodhi Evropën, kurse Ten Hsiao Pini Azinë, meqë politika kineze kryesisht është një politikë ksenofobe dhe hegjemoniste në botë, por veçanërisht në Azi, dhe në këtë kontinent figura dhe veprimtaria politike e Ten Hsiao Pinit kanë më tepër rëndësi nga ajo e Hua Kuo Fenit.

Për sa u përket marrëveshjeve me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me Japoninë, me Gjermaninë Perëndimore, me një fjalë, me afaristët e me senatorët e këtyre vendeve, të gjitha këto i bën Ten Hsiao Pini si zëvendëskryeministër *de jure*, por *de facto* si kryemi-



nistër dhe si udhëheqës kryesor i Kinës, pavarësisht se mbi kokë ka Hua Kuo Fenin.

Ky i fundit, me qëndrimet dhe me veprimet e tij, të jep përshtypjen e një Bude të vërtetë, kurse Ten Hsiao Pini paraqitet më agresiv e më i hedhur në politikë dhe në veprimtarinë konkrete. Qëllimi i veprimtarisë konkrete të Ten Hsiao Pinit është të marrë plotësisht në dorë fuqinë, pa dhënë përshtypjen se dëshiron t'u ngrejë këmbët Hua Kuo Fenit dhe grupit të tij. Këtë veprimtari ai e fillon me metodat e jashtme gjoja demokratike, të frymëzuara nga Mao Ce Duni. Dhe kjo formë e luftës për pushtet, nën maskën e demokracisë, përfaqësohet nga dacibaot e vëna në muret e Pekinit. Nëpërmjet tyre bëhet e qartë se kush duhet rehabilituar, kush duhet dënuar, kush është kriminel e kush është njeri «i madh» në Kinë.

Dacibaot e vendosura i këndojnë himne Ten Hsiao Pinit, kurse Hua Kuo Fenin e përmendin shumë pak. Kjo formë veprimi «demokratike» u bë në një mënyrë aq skandaloze, saqë nga të gjithë u kuptua se imponohet nga grupi i Ten Hsiao Pinit, i cili, në vend që ta mbronte ngjitjen e Hua Kuo Fenit, po e dëmtonte. Ishte shumë e qartë: bëhej një luftë joparimore ose, më mirë të themi, luftë fraksionesh. Atëherë u përdor taktika që midis dacibaove, që këndonin hosana për Ten Hsiao Pinin, të vihej edhe ndonjë dacibao e humbur për Hua Kuo Fenin. Në këto dacibao (natyrisht, të vëna nga grupi i Hua Kuo Fenit), u duk, gjithashtu, dënimi i ashpër i Revolucionit Kulturor dhe i gjithë atyre që morën pjesë në këtë «revolucion», veçanërisht kundër kryesorëve, të cilët u likuiduan.

Kështu, grupi i Ten Hsiao Pinit dhe ai i Hua Kuo Fenit filluan sulmet e maskuara, por kuptohej haptazi që ato drejtoheshin kundër Mao Ce Dunit. Domethënë në Kinë po zhvillohej një luftë sistematike e grupit të Hua Kuo Fenit dhe të Ten Hsiao Pinit kundër Revolucionit Kulturor, kundër së ashtuquajturës katërshe, pra, kundër përkrahësve kryesorë të këtij «revolucioni», por edhe përkrahësve të tjerë, si dhe kundër udhëheqësit e frymëzuesit të tij, Mao Ce Dunit. Njëkohësisht në këtë luftë goditej edhe Hua Kuo Feni, sepse ai për njëfarë kohe, siç e vura në dukje, mbështeti veprimtarinë e Revolucionit Kulturor, vazhdoi bashkëpunimin me «katërshen» dhe e demaskoi Ten Hsiao Pinin si revizionist, duke e shkarkuar nga të gjitha funksionet. Pra, kjo veprimtari, si dhe goditja që iu bë demonstruesve e përkrahësve të Ten Hsiao Pinit në prill 1976, në sheshin Tien An Men, ishte e lidhur me këta persona: Mao Ce Dun, Hua Kuo Fen dhe «katërshe».

Në këto situata, Ten Hsiao Pini po merr revanshin. Hua Kuo Feni me gjithë pozat e Budës e ndien se po i hyn ujët nën rrogëz, po kjo nuk do të thotë dorëzim nga ana e tij. Aktualisht vihet re se Hua Kuo Feni përpiqet të mbajë afër një pjesë të atyre anëtarëve të Byrosë Politike, të cilët janë implikuar në veprimtarinë kundër Ten Hsiao Pinit, dhe gjithë opinionin që përkrah sentimentalisht ose me bindje Mao Ce Dunin, duke thënë: «Mao Ce Duni nuk ka gabuar. Çdo gjë që ka bërë, ai e ka bërë mirë». Kjo është një armë me rëndësi në duart e Hua Kuo Fenit, por Ten Hsiao Pini nga ana e tij, me situatën që krijoi dhe që e ushqen vazhdimisht, po

merr masa drakoniane në ushtri, në Byronë Politike dhe kudo.

Me fjalë të tjera, aktualisht, ne asistojmë në një periudhë kur në Kinë po bëhet rehabilitimi i gjithë reaksionit të zi, të dënuar nga Revolucioni Kulturor ose edhe para tij. Pra, të gjithë elementët reaksionarë po rrehabilitohen dhe po vendosen në postet që ata kanë pasur në kohën kur u pushuan, u dënuan ose u persekutuan. Shkurt, kjo është elita e Ten Hsiao Pinit, tek e cila ky element borgjez, kapitalist, reaksionar, monarkist kërkon të mbështetet e me të të krijojë atë pushtet në udhëheqje e në ushtri që të stabilizojë gjendjen dhe të likuidojë përfundimisht jo vetëm kundërshtarët e vet, radikalë, por edhe Hua Kuo Fenin.

Tash për tash duket që grupi i Ten Hsiao Pinit heziton të marshojë me të katra drejt një lufte civile ose drejt likuidimit të Hua Kuo Fenit, për arsye se do të shtohen turbullirat e mëdha që ekzistojnë në Kinë. Veçse këto turbullira as tash, as në të ardhmen nuk do t'u pëlqejnë imperializmit amerikan dhe kapitalizmit botëror, që kanë hyrë në tratativa të thella ideologjike, politike, ekonomike dhe ushtarake me Kinën. Reaksioni botëror, që e mbështet Kinën, dëshiron që atje të vendoset rregull dhe disiplina e fortë kapitaliste, me fjalë të tjera, disiplina fashiste, dhe jo të ekzistojë një gjendje kaotike, e cila vë në rrezik të ardhmen e ndihmës që Kina i jep reaksionit botëror dhe anasjelltas të ndihmës që reaksioni botëror i jep asaj.

Prandaj, në këto situata, ne shohim që Ten Hsiao Pini deklaron se «nuk dëshiron» të bëhet kurrë krye-

ministër, se Hua Kuo Feni «është një udhëheqës i shquar i partisë», se Mao Ce Duni «është njeri i madh», se «pa Mao Ce Dunin nuk mund të kishte Kinë» e të tjera, e të tjera dëngla të tilla si këto, për të cilat Hua Kuo Feni s'ka asnjë fije besimi. Por kjo është një taktikë e përkohshme e Tenit, që do të zgjasë derisa të stabilizohet mirë situata e reaksionit në Kinë. Flas për këtë se Ten Hsiao Pini si person mund të rrojë edhe disa vjet dhe pastaj duhet të zëvendësohet nga një njeri tjetër i fuqishëm dhe i përshtatshëm për ta mbajtur të grumbulluar reaksionin përpara popullit kinez, i cili, mendoj unë, në vazhdimësi do të jetë në lëvizje dhe në turbullira.

Pra, Ten Hsiao Pini po vë në zbatim parullën e tij të famshme: «Nuk ka rëndësi nëse macja është e bardhë apo e zezë, rëndësi ka që ajo të kapë minj». Për të nuk ekziston kurrfarë ideologjie ose ekziston ideologjia kapitaliste, fashiste, por jo ideologjia marksiste-leniniste.

Ne mund të themi se dhe në arenën ndërkombëtare opinioni nuk është i favorshëm për situatën në Kinë; shtetet e botës nuk janë të sigurta për gjendjen aktuale dhe për të ardhmen e saj. Natyrisht, reaksioni botëror dhe revizionistët modernë, me përjashtim të revizionistëve sovjetikë, të cilët janë drejtpërdrejt në luftë me imperializmin kinez, kanë frikë për fatin e investimeve të tyre në Kinë. Në këtë drejtim edhe kinezët janë prudentë. Këta përpiqen të marrin më shumë e t'u paguajnë më pak të tjerëve. Gjithashtu, edhe ata që u japin hua kinezëve jo vetëm mendojnë dhe veprojnë për të kundërtën, pra që t'u japin sa më pak e t'u marrin sa më shumë, por shikojnë që edhe ato çka u japin atyre

të jenë të sigurta e të mos u humbasin. Prandaj edhe ecin me prurë në këto marrëdhënie me Kinën. Pastaj kjo e fundit, e ka lënë mënjanë praktikën e mëparshme të buzëqeshjes dinake, dhelparake, përrulëse ndaj këtyre vendeve kapitaliste e revizioniste dhe tash, duke u treguar si partnere gjoja e barabartë me to, kërkon haptazi ndihmën e tyre të madhe. «Pa këtë ndihmë, — u thonë kinezët imperialistëve, — Kina nuk mund të arrijë objektivat që ka caktuar ose që i kemi caktuar së toku, domethënë që ajo të bëhet një fuqi e tillë e madhe imperialiste që të rezistojë, të dobësojë ose të likuidojë fuqinë imperialiste sovjetike».

Për të gjitha këto arsye udhëheqja aktuale kineze shpejton të konkretizojë sa më parë që të jetë e mundur huatë e shumta prej miliarda dollarësh nga të katër anët e botës. Ajo shpejton, gjithashtu, të blejë teknologji e armatime moderne nga kushdo qoftë. Prandaj, me qindra delegacione, të përbëra prej 50 e kusur vetash, i bien kryq e tërthor gjithë botës kapitaliste dhe konkludojnë marrëveshje të ndryshme. Kurse brenda në Kinë grupi i Ten Hsiao Pinit, duke rehabilituar gjithë borgjezinë, kërkon të zërë absolutisht të gjitha kyçet e pushtetit, të ekonomisë, të ushtrisë dhe të asaj të famshme partie «komuniste» të Mao Ce Dunit.

Dihet se pranë Komitetit Qendror ka ekzistuar Zyra e Përgjithshme, për të cilën unë kam folur. Në krye të kësaj Zyre ishte roja e Mao Ce Dunit, i cili, natyrisht, u bashkua me Hua Kuo Fenin e me «katërshen» dhe u implikua në Revolucionin Kulturor e në përpjekjet për likuidimin e demonstratës së Tien An Menit, pra dhe në likuidimin e Ten Hsiao Pinit. Thuhet se tash ky person,

që quhet Van Tun Hsin, shkarkohet nga detyra, hiqet nga Byroja Politike, duke u akuzuar si kriminel. Në një afishe, të firmosur nga një shkrimtar, kryetari Hua Kuo Fen këshillohet që në udhëheqje të Zyrës së Përgjithshme të Komitetit Qendror të caktojë një person tjetër dhe pikërisht 75-vjeçarin Jan Shan Kun. Cili është ky njeri? Ky është ish-kryetari i Zyrës së Përgjithshme në kohën e Liu Shao Çisë. Pra, nëpërmjet tij dhe kësaj Zyre, Liu Shao Çia kishte hedhur në dorë gjithë partinë, se në Kinë si në kohën e Liu Shao Çisë, ashtu edhe në kohën e Mao Ce Dunit, nuk kanë ekzistuar komitete partie. Në Partinë Komuniste të Kinës ka ekzistuar pushteti personal që zbatohet nëpërmjet kësaj Zyre të Përgjithshme dhe atij që ishte në krye të saj.

Pra, ky farë Jan Shan Kun, që Revolucioni Kulturor e shkarkoi nga detyra e kryetarit të Zyrës së Përgjithshme dhe e dënoi rëndë, tash kërkohet të rivendoset në krye të kësaj Zyre. Më parë ai akuzohej se ishte agjent i sovjetikëve, se i kishte dhënë të fshehtat e Partisë Komuniste të Kinës ambasadorit të Bashkimit Sovjetik në Kinë. Këtë gjë na e kanë thënë vetë me gojën e tyre Mao Ce Duni dhe Kan Sheni.

Tani hezitime ka dhe pazarllëqet bëhen. Do ta lëshojë Hua Kuo Feni nga duart e veta Zyrën e Përgjithshme të Komitetit Qendror apo jo? Do ta marrë në duart e tij këtë Zyrë Ten Hsiao Pini apo jo?

Mendimi ynë është se kjo Zyrë nuk ka shumë rëndësi. Rëndësinë asaj ia jep pushteti personal i krijuar në Kinë. Dhe që kjo Zyrë përfaqëson një parti ose një organ të një partie marksiste-leniniste, s'është e vërtetë. Zyra e Përgjithshme e Komitetit Qendror të së

është quajturës Parti Komuniste e Kinës është një gardë pretoriane në duart e një grupi njerëzish, e cila sundon jashtë ligjeve marksiste-leniniste në Kinë.

*Marrë nga libri:*

*Enver Hoxha, «Ditar për çështje ndërkombëtare» (botim i brendshëm), nr. 11, f. 468*

# KONTROLLI PUNËTOR LUAN ROL TË RËNDËSISHËM KUR KUPTOHET E ZBATOHET DREJT

Shënime

9 dhjetor 1978

Duke parë vendimet e shumta e të njëpasnjëshme që kemi marrë për shfrytëzimin e makinerive të ndryshme që disponojnë ndërmarrjet, më ka tërhequr vëmendjen e, natyrisht, edhe më ka shqetësuar fakti se ato në shumë prej tyre janë lënë mënjanë, nuk shfrytëzohen me kapacitet të plotë ose janë hedhur andej-këtej, pa u riparuar, gjë që përbën një dëm të pallogaritshëm për ekonominë tonë socialiste.

Fakt është se te punonjësit tanë ndërgjegjja nuk është akoma në atë shkallë që t'i tronditë ata e t'i vënë gishtin kokës për këto veprime të palejueshme në një kohë kur ekonomia jonë jo vetëm ka nevojë të madhe për këto makineri e pajisje, por edhe nuk i leverdis që të sjellë të reja, kur ato që ka janë në gjendje pune ose edhe kur kanë ndonjë defekt t'i riparojë dhe t'i futë në përdorim.

Për këtë situatë u informova edhe nga krycartikulli që lexova në gazetën «Zëri i popullit» dhe nga një



artikull tjetër në faqen e dytë. Të dy këto shkrime flisnin për keqpërdorimin e makinerive e të materialeve të ndryshme që gjenden nëpër depo. Sigurisht që këta artikuj janë rezultat edhe i vërejtjeve që u bënë në mbledhjen e Sekretariatit të Komitetit Qendror, ku u tha se nga tërë makineritë e ndryshme që ka Ministria e Ndërtimit, vetëm 70 për qind e tyre janë në punë, kurse të tjerat nuk shfrytëzohen. Në artikull flitej edhe për rolin e kontrollit punëtor.

Për këtë gjendje të makinerive mbajnë përgjegjësi drejtuesit e dikastereve që i kanë në vartësi këto ndërmarrje, prandaj, për sa thashë më sipër, i vura në dijeni shokët e Sekretariatit e të Këshillit të Ministrave.

Po konstatoj me keqardhje, u thashë atyre, dhe jam tepër i shqetësuar që, pas gjithë atyre vendimeve që kanë marrë Byroja Politike, Komiteti Qendror edhe Kongresi i 7-të i Partisë për shfrytëzimin maksimal të makinerive e pajisjeve, përsëri vërehen mangësi të theksuara. Këto vendime nuk po zbatohen, se nga aparatet shtetërore dhe të Partisë nuk ekziston ai interesin dhe kontroll që duhet. Kjo çështje është ngritur shumë herë në Byronë Politike, në Komitetin Qendror e në Qeveri dhe përsëri akoma nuk është vënë në vijë. Prandaj të merren sa më parë masa urgjente organizimi e kontrolli në të gjitha ndërmarrjet që kanë makineri e materiale të tjera dhe që nuk janë të nevojshme të qëndrojnë në to. Një kjo.

E dyta, u thashë shokëve, të merren masa të forta organizative dhe makineritë që kanë defekte e nuk

punojnë, të çohen menjëherë për riparim dhe të vihen në punë.

E treta, makineritë që nuk u hyjnë në punë ndërmarrjeve që i kanë tani, të çohen menjëherë në ato ndërmarrje që mund të kenë nevojë për to.

Këtë problem do ta shtroj edhe në mbledhjen e Plenumit të Komitetit Qendror që do të mbahet në janar për të diskutuar për planin e vitit 1979. Aty do t'i vë para përgjegjesisë të gjithë ata shokë kryesorë që nuk kontrollojnë zbatimin e vendimeve.

Kjo është me të vërtetë shqetësuese për ne. Konstatoj më keqardhje se disa herë ka një liberalizëm të madh në këtë drejtim. Ndodh që flitet me zjarr kur diskutohet për këto probleme, por, kur vjen fjala për zbatimin e tyre në jetë, atëherë puna çalon. Kjo tregon se ndërgjegjja politike e punonjësve tanë nuk është në nivelin e kërkuar dhe për këtë u bie një barrë e rëndë Partisë dhe levave të saj, pushtetit e organizatave të masave që nuk punojnë si duhet për ta ngritur sa më lart këtë ndërgjegje të klasës dhe ta mbajnë përherë ndezur luftën kundër këtyre qëndrimeve të palejueshme.

Në artikullin në fjalë pashë edhe diçka tjetër që më tërhoqi vëmendjen. Në një nga ndërmarrjet ku ekzistonte një situatë e tillë, megjithëse kishte një grup të kontrollit punëtor, ai nuk kishte funksionuar për një vit të tërë. Është e kuptueshme që ky grup, po të mos e shtyjë njeri, mund të mos funksionojë edhe për dhjetë vjet të tjerë. Me sa del nga artikulli, anëtarët e këtij grupi as nuk dinin çfarë të kontrollonin: punën e vet që e kishin lënë pa bërë, apo atë të një ndërmarrjeje

tjetër që nuk e kishte kryer si duhet detyrën? Në qoftë se grupi i kontrollit punëtor ngarkohet të veprojë vetëm në ndërmarrjen e vet, një kontroll i tillë nuk do të ketë efekt, pse kërraba do të tërheqë nga vetja dhe do të bëhen përpjekje për të fshehur të metat dhe gabimet. Në këtë ndërmarrje, ashtu si dhe në çdo ndërmarrje tjetër, për mbarëvajtjen e punëve janë përgjegjëse organizatat përkatëse të Partisë dhe levat e tyre, organet e pushtetit, bashkimet profesionale, të rinisë etj., të cilat, së bashku, duhet të punojnë që të zbatohen normat dhe ligjet ekonomike. Vetëm kështu do të përparojë ndërmarrja dhe do t'u pritët rruga fenomeneve të tilla.

Që të ketë në çdo ndërmarrje një grup të veçantë kontrolli punëtor, kjo është e drejtë dhe nuk ka asgjë të keqe. Sa herë lind nevoja, nën udhëheqjen e Partisë, ky grup hidhet në veprim, në qendrën e tij të punës ose dhe jashtë saj. Rëndësi ka që anëtarët e këtij grupi të mos fshehin gabimet që konstatojnë. Kështu duhet kuptuar direktiva e madhe e Partisë për kontrollin punëtor në bazë të mësimëve të Leninit, por ajo akoma nuk po kuptohet e nuk po zbatohet plotësisht në rregull, megjithëse është përsëritur disa herë. Që duhen organizuar kontrole punëtore për të parë se si venë punët nëpër ndërmarrje të ndryshme, kjo është më se e nevojshme, por, që ky kontroll të jetë sa më i efektshëm, është mirë që njerëzit e caktuar për kontroll jo vetëm që duhet të jenë nga më të ndërgjegjshmit, por me ata duhet bërë edhe një punë paraprake: të udhëzohen e të kualifikohen, sidomos lidhur me objektin që do të kontrollojmë. Kjo është abëcëja e punës së tyre. Mirëpo një gjë e tillë, me sa konstatojmë, nuk

bëhet gjithmonë. Është e kuptueshme që po u veprua kështu, rezultatet nuk do jenë ato që priten. Organizatat e Partisë, ato të bashkimeve profesionale në disa ndërmarrje zhvillojnë një punë rutinë e me plot të metat në këtë drejtim. Në to gjoja ekzistoka një grup i kontrollit punëtor, i përbërë prej vetë punonjësve të ndërmarrjes, të cilët, në një përqindje të madhe bëjnë ndonjë kontroll sa për të larë duart, si të thuash.

Kontrolli punëtor luan dhe do të luajë një rol të rëndësishëm, në rast se kuptohet e zbatohet drejt. Ky është një problem i madh për socializmin. Mirëpo, kështu siç është kuptuar dhe siç është vënë në veprim në disa raste, për të cilat fola më lart, ai nuk jep rezultate. Të tilla kontrole bëhen sa për bujë. Thuhet se lihen detyra në ndërmarrjet apo institucionet e kontrolluara, por, po të vësh të shikosh e të kontrollosh përsëri, me njerëz nga jashtë ndërmarrjes ose institucionit, do të shikosh se në to janë lënë vetëm detyra të përgjithshme dhe jo konkrete për kryerjen e të cilave duhet derdhur djersë e duhen bërë përpjekje me thonj e me dhëmbë. Kjo nuk bëhet jo se nuk njihet gjendja, por për arsye se ka liberalizëm në kërkesën e llogarisë nga drejtuesit e ndërmarrjes, nga komitetet ekzekutive apo edhe nga komitetet e Partisë, gjë që duhet të ndreqet patjetër.

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

# BILANC I TMERRSHIËM I NJË REGJIMI KU KA SUNDUAR PUSHITETI PERSONAL

Shënime

13 dhjetor 1978

Jemi në pragun e vitit 1979, kur do të mbushen plot 30 vjet qëkurse Kina u çlirua nga zgjedha e push-tuesve japonezë dhe nga sundimi feudo-borgjez i klikës së Çan Kai Shisë.

Kjo është një periudhë relativisht e shkurtër për të ndërtuar plotësisht shoqërinë socialiste, por nuk mund të thuhet se 30 vjet janë pak për ta transformuar deri në njëfarë shkalle shoqërinë e vjetër që ekzistonte në Kinë dhe për të ndërtuar të paktën bazat e socializmit.

Por, kur i hedhim një sy rrugës së zhvillimit të Kinës, që nga dita e çlirimit dhe deri tash, shohim se atje janë bërë përpertime shumë të vogla, ndonëse ka pasur mundësi kolosale, me të cilat një pushtet me të vërtetë proletar, po t'i shfrytëzonte si duhej, do të bënte mrekulli.

Kështu, në Bashkimin Sovjetik, pas fitores së Revolucionit Socialist të Tetorit nën udhëheqjen e Leninit dhe të Stalinit, kur u vendos pushteti i sovjetëve, push-

teti i proletariatit, Partia Bolshevike që zbatonte me konsekuencë mësimet e Marksit dhe të Leninit, mundi gjatë 30 vjetëve ta transformonte vendin në një fuqi të madhe socialiste, e theksoj, **socialiste**. Nën udhëheqjen e kësaj partie populli ndërtoi një ekonomi të fuqishme dhe zhvilloi veçanërisht industrinë e rëndë. Ky orientim ishte shumë i drejtë, sepse historia e zhvillimit të njerëzimit dhe ecja e një shteti proletar drejt socializmit tregojnë se duhet të mbështetesh, në radhë të parë, në ndërtimin e një industrie të fuqishme. Kjo që një domosdoshmëri për kushtet në të cilat ndodhej Bashkimi Sovjetik, që rrezikohej e kërcënohej vazhdimisht prej armiqve të jashtëm e të brendshëm.

Gjatë kësaj periudhe u zhvillua, po ashtu, një bujqësi e përparuar socialiste kolkoziane dhe arsimit e kultura u përhapën në masë. U formuan kuadro me arsim të lartë, të mesëm dhe punëtorë shumë të specializuar, që morën në duar teknologjinë e re dhe makineri moderne. Kështu që në një periudhë gati po kaq të gjatë sa edhe në Kinë, në Bashkimin Sovjetik u bënë transformime rrënjësore për përmirësimin e jetës së njerëzve dhe këto u kryen për arsye se atje u vendos pushteti i diktaturës së proletariatit, i cili udhëhiqej nga teoria e Marksit, e Engelsit, e Leninit dhe e Stalinit.

Çështja e kohës vërtet ka rëndësi, por më shumë rëndësi ka fakti se si e shfrytëzon këtë kohë, cilat janë ato ide që e detyrojnë kohën të ecë në favor të masave të gjera punonjëse dhe cilat janë ato që e keqpërdorjnë, ose e përdorin në dëm të masave. Po të marrim faktorin kohë, në të njëjtin interval, në Bashkimin Sovjetik dhe në Kinë janë arritur rezultate jo të

njëjta, shihen drejtime të kundërta në zhvillim. Ndërsa në të parin kishte një zhvillim progresist drejt ndërtimit të plotë të socializmit, në Kinë jo vetëm që nuk duket gjëkund të ndërtohet socializmi, por konstatohet ekzistenca e një regjimi të demokracisë borgjeze që ka numëruar në vend dhe rezultatet e zhvillimit në favor të popullit janë shumë të pakta.

Në vitin 1949, kur Kina u çlirua, atje shtrohej problemi i pushtetit, sepse lufta nacionalçlirimtare në këtë vend, ashtu si në çdo vend tjetër, u bë për të ndryshuar situatën e mëparshme, nga regressive në një situatë të re, progresive. Këtë shndërrim, këtë ndryshim progresiv, natyrisht, do ta bënin ato klasa që luftuan, e do të udhëhiqnin ai mendim, ajo politikë dhe ajo ideologji progresiste që udhëhoqën edhe luftën. Me fjalë të tjera, ata që marrin pushtetin në dorë, të udhëhequr nga partia e tyre, në aleancë me klasat mike, i vënë detyra vetes çfarë do të bëjnë pas fitores, në ç'rregë do të shkojnë, ç'qëllime duhet të arrijnë dhe kur duhet t'i arrijnë.

Ky është dhe duhet të jetë programi i fitimtarëve, po varet se cilët janë këta fitimtarë dhe nga ç'ideologji udhëhiqen.

Lufta nacionalçlirimtare në Kinë u udhëhoq nga Partia Komuniste e Kinës. Nga analizat që kemi bërë e vazhdojmë të bëjmë, ka dalë se në fakt ajo nuk ka qenë një parti e vërtetë marksiste-leniniste. Qoftë në politikë, qoftë në ideologji, qoftë në taktikën dhe në strategjinë e luftës, edhe në orientimet e saj për marrjen e pushtetit dhe vendosjen e diktaturës së proletariatit, ajo

nuk udhëhiqej nga ideologjia marksiste-leniniste, nuk ka qenë e frymëzuar nga kjo ideologji.

Me aq sa na kanë lejuar materialet, kemi arritur në konkluzionin se Partia Komuniste e Kinës nuk ka qenë komuniste. Në të ka pasur elementë që e donin komunizmin, e donin revolucionin, donin, gjithashtu, teorinë e Marksit dhe të Leninit, por atje që në fillim e vazhdimisht ka ekzistuar një kaos idesh, të cilat përplaseshin dhe nuk merrnin asnjëherë një formë të përcaktuar, notonin të gjitha në ujë të ndenjtur. Me këtë dua të them që në Partinë Komuniste të Kinës nuk ka ekzistuar një krah i fortë marksist-leninist, i cili, gjatë gjithë periudhës së luftës dhe të jetës së partisë, të mund të kristalizonte në parti një vijë të drejtë, të frymëzuar nga teoria shkencore e Marksit, e Engelsit, e Leninit dhe e Stalinit, dhe t'i bënte partitë e tjera të borgjezisë, që notonin tok me të në një lumë jo të kulluar, aleate të saj ose kundërshtarë. Rruga e parë do të ishte më e mirë, por pa u konfunduar partia komuniste me partitë e tjera, siç ndodhi me Partinë Komuniste të Kinës dhe siç po ndodh edhe aktualisht me të, sepse vija e saj nuk ka ndryshuar; të «njëqind lulet» predikoheshin dhe vazhdojnë të predikohen në të ashtuquajturën Parti Komuniste të Kinës.

Por e keqja nuk qëndron vetëm këtu. Këtu është burimi i së keqes, e cila krijoi pikëpamje të gabuara lidhur me luftën nacionalçlirimtare e me udhëheqjen e saj. Pikëpamja e kësaj partie për rolin e proletariatit ishte e gabuar. Kjo ishte më tepër një parti fshatarësh, që e konsideronte fshatarësinë e prapambetur kineze si udhëheqësen kryesore të revolucionit dhe që duhej t'i



udhëhiqte proletariatit dhe të gjitha masat e tjera në luftë.

Duke u bazuar në pikëpamje të tilla, kjo parti, gjatë gjithë periudhës së luftës e deri në fund, ruajti taktikat e një lufte partizane, megjithëse, si parti e një vendi të madh, me një popullsi të dendur, organizoi edhe njësi luftarake të mëdha. Por këto njësi ishin të ngjashme me ushtrinë e borgjezisë, me ushtrinë e Çan Kai Shisë, dhe udhëheqësit e armatave të ndryshme të ushtrisë nacionalçlirimtare nuk kishin ose kishin fare pak ndryshim nga gjeneralët e reparteve të mëdha të ushtrisë së Çan Kai Shisë.

Të gjithë këta udhëheqës kryesorë, me Maon në krye, kishin, natyrisht, ndjenjën e theksuar të çlirimit të vendit e të marrjes së pushtetit, por ideologjia e tyre nuk ishte ideologji e klasës punëtore. Ajo ishte ideologji fshatare. Këta mendonin si udhëheqës fshatarë, tek të cilët mbizotëronte dhe mbizotëroi tendenca e drejtimit personal, e pushtetit personal. Domethënë, atje ku vepronin armatat e mëdha, udhëheqësit e tyre ishin «zotër lufte». Dhe këta quheshin komunistë, gjoja lidheshin me partinë komuniste e drejtoheshin nga shtabi i Maos, por në praktikë, në fakt, ata drejtonin sipas kokës së tyre. Ndonëse e mbaruan luftën me fitore, kokën e kishin të mbushur me lakra, bile edhe këto lakra nuk ishin të sistemuara si duhej. Ata, gjatë gjithë periudhës së pasçlirimit, do të lëkundeshin sa nga njëra anë, në anën tjetër, dhe do të përpiqeshin si e si të tërhiqnin nga vetja grupe të ndryshme, pjesëtarët e të cilave i njihnin, se kishin udhëhequr luftën për interesat e tyre personale. Interesi i përgjithshëm i së ardh-

mes së vendit nuk ishte kristalizuar në një qëllim të vetëm, në një objektiv të vetëm, për arsye se partia që e udhëhoqi këtë luftë nuk ishte një parti në bazë të së cilës të qëndronte uniteti marksist-leninist, e as nuk udhëhoqej nga teoria e marksizëm-leninizmit, por ishte një parti, si me thënë borgjezo-kapitaliste përparimtare. Edhe format që iu dhanë asaj gjatë luftës dhe pas luftës, mbetën vetëm forma, kurse brendia vazhdoi të ishte kaotike, gjë që nxitej edhe më tepër nga propagandimi i lulëzimit të «njëqind luleve» dhe i konkurrimit të «njëqind shkollave».

Pra, orientimi dhe qëllimi kryesor i luftës e i revolucionit ishte marrja e pushtetit. Më 1949, kur Kina u çlirua, pushtetin e morën në dorë Mao Ce Duni dhe shokët e tij, që e udhëhoqën këtë luftë. Të gjithë këta, siç e theksova më lart, quheshin komunistë dhe vepronin nën maskën e komunizmit. Ata edhe mund që besonin, deri në njëfarë shkalle, në idetë e komunizmit, por ideologjia marksiste-leniniste nuk ishte kuptuar si duhej prej tyre dhe nuk u ishte rrënjësuar në zemër, që të konkretizohej në veprime të drejta. Tek ata gjatë gjithë kohës ka dominuar një filozofi e huaj për marksizëm-leninizmin: anët përparimtare të rrymave të ndryshme filozofike të vjetra kineze, të cilat u pleksën me disa pikëpamje të shtrembëruara të marksizëm-leninizmit dhe këto u zbatuan në rrëthanat e luftës e të pasluftës.

Kështu që Partia Komuniste e Kinës, me Mao Ce Dunin në krye, nuk mund të ishte kurrsesi një parti e tipit marksist-leninist dhe çështja e pushtetit dhe e rolit udhëheqës në jetën e vendit nuk mund të shtrohej

drejt prej tyre, pavarësisht se ky pushtet aktualisht ishte në duart e Maos me shokë dhe dukej sikur rolin udhëheqës e luante partia, që quhej parti komuniste. Pse ngjiste kjo? Për arsye se e gjithë lufta nacionalçlirimtare në Kinë u udhëhoq nga pikëpamje fshatare, sepse vetë Maoja dhe shokët e tij predikonin që fshatarësia kineze ishte më revolucionarja, prandaj ajo duhej ta kryente dhe ta udhëhiqte revolucionin, kurse klasa punëtore duhej të ishte aleate e fshatarësisë, meqë ishte e vogël dhe e paformuar. Fshatarësinë, sipas teorisë maoiste, e kishin formuar si klasë vuajtjet e mëdha të saj. (Sikur klasa punëtore nuk kishte vuajtur po aq, bile edhe më shumë!)

Çështja nuk shtrohet se kush ka vuajtur më shumë, por cila klasë është më përparimtare, klasa punëtore apo fshatarësia; kush është më e vendosur ta çojë revolucionin deri në fund, klasa punëtore apo fshatarësia. Pra, që këtej, del se kush duhej të udhëhiqte edhe luftën e se i kujt do të ishte pushteti pas lufte, i proletariatit apo i fshatarësisë. Këto probleme, që ishin kapitale, medoemos duheshin zgjidhur drejt. Por që të zgjidheshin drejt, më parë duhej të përcaktoheshin drejt, kurse një gjë e tillë jo vetëm nuk u bë, por ndodhi e kundërta: fshatarësia kineze vazhdoi dhe vazhdon të konsiderohet si udhëheqësja kryesore në revolucion. Pra, pushteti që u vendos në Kinë pas 1949-s nuk ishte pushteti i diktaturës së proletariatit, por një pushtet demokratiko-borgjez i udhëhequr nga një mentalitet dhe nga një ideologji fshatare e përparuar, nga një ideologji eklektike, siç e kemi përcaktuar filozofinë jo-marksiste të Mao Ce Dunit.

Çështja e revolucionit dhe e luftës së klasave edhe gjatë luftës, por sidomos pas luftës, dilte si një problem jashtëzakonisht i madh e i vështirë, veçanërisht në një vend të madh si Kina, ku akoma edhe pas çlirimit ekzistonin feudalizmi e forcat e shpartalluara të borgjezisë, që vazhdonin të kishin fuqi politike dhe ekonomike. Këta revolucionit nuk i shkatërroi dhe lufta e klasave për të likuiduar fuqinë politike dhe ekonomike të klasës feudo-borgjeze nuk u zhvillua. Kjo ndodhi sepse në krye të Partisë Komuniste të Kinës nuk ishte proletariati dhe pushteti nuk ishte i diktaturës së proletariatit. Të gjitha këto bënë që në Kinë të mos kalohej nga reformat demokratike borgjeze në platformën e ndërtimit të socializmit. Për këtë arsye Kina, që pas çlirimit e deri sot, noton në një kaos të madh politik, ideologjik dhe ekonomik. Ajo mbeti prapa në të gjitha drejtimit dhe fatkeqësia më e madhe për të ishte se u kthye 180 gradë drejt ndërtimit të një shteti borgjez kapitalist imperialist, kundër revolucionit në këtë vend dhe në botë. Këtu fajin më të madh e ka Mao Ce Duni, sepse ky, gjatë gjithë veprimtarisë së tij, u përpoq, si element i përparuar i fshatarësisë, të dominonte me pushtetin e tij personal në Kinë dhe ta udhëhiqte zhvillimin e vendit në një rrugë krejt të gabuar, ta çonte atë në rrugëkryq, të mos e lejonte rrymën progresiste të vazhdonte drejt përparimit e konsolidimit të pozitive revolucionare marksiste-leniniste.

Pavarësisht nga emrat dhe nga format që janë përdorur pas çlirimit, qoftë për pushtetin e republikën, qoftë për partinë, në Kinë, në realitet, nuk ka ekzistuar një program i qartë, i përcaktuar dhe i studiuar për

zhvillimin e vendit dhe as mund të ekzistonte një program i tillë. Vërtetë thuhej se revolucioni u krye, se në ballë qëndronte partia komuniste dhe se në Kinë u vendos demokracia e re, por në fakt, në këtë vend, ekzistonin në kuadrin e një «uniteti» dhe luftonin nën një flamur edhe borgjezia e madhe, edhe borgjezia e mesme, edhe fshatarësia, edhe klasa punëtorë, edhe borgjezia e vogël e qyteteve, pra të gjitha klasat e shtresat bashkë; të gjitha në një sofër dhe secila kërkonte të impononte vullnetin e qëllimet e veta për të ardhmen e Kinës.

Kuptohet, këto klasa ndesheshin me njëra-tjetrën, ndesheshin jo në një platformë për një kohezion dhe për ndarjen e shapit nga sheqeri, por vërtiteshin si atomet dhe përpiqeshin kush e kush të fitonte supremaci, të fitonte pushtet, të ruante avantazhe ose të krijonte avantazhe të reja dhe progresi i përgjithshëm i Kinës të konsistonte vetëm në një përmirësim të sipërfaqshëm të gjendjes moralo-politike dhe ekonomike të popullit. Kjo lejoi stanjacionin, gjë që krijoi moçalishte në ideologji, në politikë, në organizim dhe në zhvillimin e ekonomisë. Propaganda ishte e kurdisur në mënyrë të atillë që, pa ecur përpara, thuhej se po ecej përpara; pa pasur rezultate, thuhej se arriheshin rezultate të mëdha dhe, pa u udhëhequr nga një parti komuniste e vërtetë, thuhej se udhëhiqte një parti komuniste e vërtetë; trumbetohej se udhëhiqte klasa punëtore, por në realitet nuk ishte sunduese ideologjia e saj dhe nuk që kjo klasë që udhëhiqte, por ishin, në fakt, njerëz me mentalitet borgjez përparimtar ose feudal antipunëtor.

Natyrisht, në një pushtet me një ideologji të tillë,

iu vu disi rëndësi bujqësisë e fshatarësisë. Por brenda 30 vjetëve, pavarësisht nga forma gjoja e kolektivizimit, fshatarët e pasur u lejuan të posedonin toka, të shfrytëzonin krahun e punës në fshat e të nxirrnin fitime; fshatarësia e mesme u lejua të dominonte mbi fshatarësinë e varfër. Brenda 30 vjetëve u duk njëfarë ndryshimi për sa i përket gjendjes ekonomike të fshatarësisë, por, kur lexojmë materiale të autorëve që janë futur në thellësi, në brendinë e Kinës, dhe kanë parë gjendjen reale të fshatarësisë së këtij vendi, konstatojmë se ky ndryshim është shumë i vogël. Pra, ka pasur një lustër propagandistike dhe përmirësimi i jetës së fshatit ka qenë diçka efemere.

Për sa i përket industrisë, kësaj i është dhënë pak rëndësi. Gjatë këtyre 30 vjetëve industria në Kinë nuk ka përparuar. Është zhvilluar më tepër industria e vogël, artizanati. Kjo nuk do të thotë se atje nuk janë ndër-tuar një sërë kombinate, por për gjerësinë e Kinës dhe popullsinë e saj shumë të madhe kjo industri është minimale. Zhvillimi i paktë i industrisë ka bërë që Kina të mbetet shumë prapa në ekonomi. Të gjitha këto janë pasojë e politikës joproletare të partisë dhe të Mao Ce Dunit. Ky thoshte se industria udhëheq, por baza është bujqësia, kurse në realitet industria nuk udhëhiqte, por qëndronte në bisht dhe bujqësia nuk arrinte të bëhej me të vërtetë baza e industrisë.

Në Kinë, ashtu si edhe në vende të tjera, bëheshin plane të ndryshme ekonomike pesëvjeçare, përgatiteshin programe, hartoheshin edhe «hopi i madh» e ndërtimi i industrisë së rëndë, por në realitet Kina këtu pati dis-fata, të cilat u propaganduan si fitore. Mao Ce Duni

dhe udhëheqja kineze nuk bënë kurrë autokritikë për të treguar shkakun pse ngjanë këto disfata. Gabimet e një-pasnjëshme në këtë drejtim u bënë mbasi kishin një bazë shumë të favorshme për t'u zhvilluar dhe nuk mund të ndreqeshin duke ëndërruar ose duke imponuar mendimin e një personi, i cili kishte krijuar një autoritet dhe një famë në Kinë, siç ishte Mao Ce Duni, kurse të tjerët duhej t'i bindeshin atij.

Po bëheshin, pra, gabime të mëdha në politikë, në ideologji, në ekonomi dhe kurdoherë dilte se vetëm Mao Ce Duni kishte të drejtë e dënoheshin persona të tjerë, kurse gabimet vazhdonin të bëheshin, të mos njiheshin dhe të mos dënoheshin. Për shembull, u dënua fraksioni i Liu Shao Çisë, i cili ishte me të vërtetë një mbështetës i flaktë i borgjezisë fshatare dhe i borgjezisë së madhe e të mesme të qytetit, kurse kongresi, që vendosi këtë vijë të Liut, akoma nuk është dënuar. Ky kongres nuk u dënua kurrë nga Mao Ce Duni, ndryshe autoriteti i tij në sy të popullit kinez do të binte. Kështu, kongresi u quajt e vazhdon të quhet i drejtë dhe plotësisht i drejtë, bile Ten Hsiao Pini kërkon të rehabilitojë edhe Liu Shao Çinë dhe gjithë veprën e këtij.

Pra, kjo politikë krejtësisht e gabuar, krejtësisht antimarksiste, që ka zhvilluar Mao Ce Duni, e la Kinën në kaos dhe atje u zhvilluan një varg fraksionesh. Masat e ndryshme që janë marrë kundër tyre Mao Ce Duni i ka quajtur «luftëra të mëdha». Në fakt këto nuk ishin luftëra parimore për vendosjen e vijës së drejtë marksiste-leniniste, por luftëra për pushtet personal. Mao Ce Duni kurdoherë donte t'i shkante fjala e tij. Liu Shao Çia kërkonte të njëjtën gjë; po kështu Ten Hsiao

Pini, Pin De Huaja, Kao Gani e gjithë të tjerët me radhë, pra, të gjithë këta «mbretër», të mëdhenj e të vegjël, të Kinës donin t'u shkonte e tyrja. Dhe, që t'ia arrinin qëllimit, të tërë ngrinin lart flamurin e Mao Ce Dunit, flamur i cili ishte si thika me dy presa: Nga njëra anë ngrihej kulti i Maos dhe kudo forcoheshin pozitat e tij të gabuara, ide të gabuara, veprime të gabuara, dhe, nga ana tjetër, favorizoheshin deri në njëfarë mase personat e tjerë, si: Liu Shao Çia, Pin De Huaja e Ten Hsiao Pini, që fentonin organizimin e puçeve për marrjen e pushtetit. Disa prej këtyre ishin për rrëzimin e Mao Ce Dunit, të tjerë për mbajtjen e tij, për ta pasur si kukull në kolltuk, që vetëm të ëndërronte e të bënte llogje, duke treguar përralla e poezi të mbretërve, mbretëreshave e princërve e duke i interpretuar këto me një gjuhë filozofike, për t'i paraqitur gjoja si rrjedhim të zhvillimit historik materialist të Kinës.

Si u konkretizuan të gjitha këto? Në fushën politike, në përgjithësi, në botë Kina mori famën e një vendi socialist, Partia Komuniste e Kinës si një parti komuniste dhe Mao Ce Duni si marksist-leninist. Imperializmi amerikan e kapitalizmi botëror menduan se po ngrihej një fuqi tjetër e madhe komuniste, e cila, në aleancë me Bashkimin Sovjetik, do të bëhej një rrezik i tmerrshëm për ta. Prandaj në këtë situatë ata vepronin që rrezikun e ri, siç e konsideruan ata, ta eliminonin. Mao Ce Duni bëri lojën e aleancave. Kështu, pas çlirimit, politika e tij, që në sy të botës hiqej si marksiste-leniniste, dhe shteti i tij, si një shtet i diktaturës së proletariatit, u avitën nga Bashkimi Sovjetik për të qenë në një front me të. Kjo për njerëzit në botë



ishte e natyrshme e do të ishte me të vërtetë e natyrshme, në rast se Kina dhe Mao Ce Duni me partinë e tij do të ishin marksistë-leninistë.

Por, megjithëse u afrua me Bashkimin Sovjetik, Mao Ce Duni as përpara, as edhe kur mori fuqinë e derisa rronte Stalini, nuk kishte besim te Bashkimi Sovjetik, te Partia Bolshevike dhe te Stalini. Por këtë mosbesim ai nuk e shfaqte, për arsye se do të dëmtoheshin e ardhmja politike dhe ekonomike e Kinës e zhvillimi i saj progresist. Megalomania e shtetit të madh dhe ekzistenca e një gjendjeje të dobët nga pikëpamja politike, ekonomike e ushtarake në Kinë e detyronin Maon që, pa pasur besim te Stalini, të tregojë gjoja i afërt e i blindur ndaj tij, «si nxënësi i vogël përpara mësuesit».

Pra, Mao Ce Duni gjatë kësaj kohe nuk besonte në një aleancë me Bashkimin Sovjetik. Në sipërfaqe ai avitej drejt një aleance të tillë, por në mendje bluante, në radhë të parë, të zgjaste kohën që Kina të bëhej vetë një fuqi e madhe, që, në rast se lidhej me Bashkimin Sovjetik, të kishte pozita force të njëjta me të. Nga ana e Bashkimit Sovjetik, të udhëhequr nga Stalini, nuk mendohej kështu. Afrimin me Kinën Partia Bolshevike e shihte si çështje të unitetit ideologjik, politik dhe ekonomik për fitoren e revolucionit në botë dhe për zhdukjen e kapitalizmit botëror.

Pas vdekjes së Stalinit Bashkimi Sovjetik bëri kthesë në pikëpamjet politike dhe në lidhje me perspektivat e aleancave me Kinën.

Tradhtia e revizionistëve sovjetikë ndaj marksizëm-leninizmit dhe ardhja e hrushovianëve në fuqi

i gëzoi shumë Mao Ce Dunin dhe shokët e tij për dy arsye:

E para, se parashikonin që Bashkimi Sovjetik do të tërhiqej krejtësisht nga rruga e ndërtimit të socializmit, pra do ta ndalonte kursin që kishte nisur drejt ndërtimit të plotë të socializmit në bazë të teorisë shkencore të Marksit, të Engelsit, të Leninit e të Stalinit dhe do të dobësohej nga ana ekonomike, duke iu afruar kështu qëllimit të fshehtë të kinezëve që epërsia e Bashkimit Sovjetik ndaj Kinës si fuqi e madhe të zvogëlohej.

E dyta, kinezët shpresuan se në situata të tilla të dobësimit dhe të rforcimit të pozitive të tyre, hrushovianët do të kishin nevojë për mbështetjen e jashtme të maoistëve. Prandaj, duke u nisur nga kjo pikëpamje, ata, natyrisht, kërkuan ndihmë nga Bashkimi Sovjetik hrushovian, të cilin tash e konsideronin si aleat pak a shumë të afërt në ideologji, por prapë të largët nga potenciali ushtarak dhe ekonomik. Mungesat në këto drejtime maoistët u përpoqën t'i plotësonin me ndihmat e Bashkimit Sovjetik dhe të tregonin në dukje një afrim shumë më të madh, të shoqëruar edhe me kërkesa më të mëdha.

Edhe hrushovianët, ndaj Kinës, bënë lojën e tyre: e afruan atë, i dhanë ndihma ekonomike, i premtuan edhe armë konvencionale e, siç duket, edhe sekretin e bombës atomike. Kjo ishte një çështje kyç për fuqizimin e Kinës dhe për arritjen e barazisë së saj me Bashkimin Sovjetik hrushovian. Kështu, gjatë kësaj kohe shohim një dashuri hipokrite nga të dyja anët për njëri-tjetrin. Grupi i Liu Shao Çisë paraqitej grupi më i

afërt me hrushovianët, më në ujdi me të, për arsye se Liu ishte një menshevik, një kulak, një pseudosindikalist, që klasën punëtore e konsideronte si një klasë e cila duhej vetëm të punonte e të ishte nën thundër.

Gjatë kësaj kohe Mao Ce Duni shikonte se pushteti i tij personal rrezikohej nga grupimi i fuqishëm i Liu Shao Çisë, Ten Hsiao Pinit, Çu En Lait e të tjerëve dhe u frikësua nga një izolim politik, ushtarak dhe ekonomik. Në mendjen e tij filloi hartimi i një plani për likuidimin e kësaj situatë që po krijohej brenda në Kinë dhe në «aleancën» me Bashkimin Sovjetik. Çdo lidhje e nevojshme me Bashkimin Sovjetik duhej të bëhej vetëm nga Maoja, kurse të tjerët duhej t'i bindeshin atij.

Mirëpo çështjet nuk zhvilloheshin siç mendonte Mao Ce Duni. Hrushovianët vërtet kishin nevojë për mbështetjen e Kinës, për t'u lënë të kuptonin Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe botës kapitaliste se aleanca kino-sovjetike po bëhej një rrezik për ta, por, nga ana tjetër, ata u treguan më të shkathët në politikën e tyre tradhtarë të «bashkekzistencës paqësore» dhe të përparimit drejt një miqësie e bashkëpunimi më të afërt me imperializmin amerikan. Me fjalë të tjera, ata, pas ardhjes në fuqi, përcaktuan politikën e tyre të brendshme, por sidomos atë të jashtme.

Një gjë e tillë për Kinën krijoi njëfarë deziluzioni, sepse kjo mendonte që aleanca duhej të kufizohej vetëm midis saj dhe Bashkimit Sovjetik e të dy bashkë të vepronin mbi imperializmin amerikan dhe kapitalizmin botëror. Me fjalë të tjera, Kina dëshironte ta shfrytëzonte këtë afrim me Bashkimin Sovjetik për interesat

e saj, por nuk i doli llogaria. Gjithashtu asaj nuk i doli as llogaria tjetër: plotësimi i kërkesave për ndihmat e mëdha ekonomike nga ana e Bashkimit Sovjetik dhe sidomos për bombën atomike. Te kjo e fundit qëndronte synimi kryesor, por bombën Kina nuk e mori dot. Atëherë në kokën e Mao Ce Dunit lindi, ose, si me thënë, u ringjall, dhe u riorientua ideja e largimit të Kinës javash-javash nga Bashkimi Sovjetik.

Gjatë gjithë kësaj periudhe shohim që strategjia maoiste ndërroi drejtim: nga strategji për unitetin me Bashkimin Sovjetik u kthye për luftë në të dy krahët: edhe kundër Bashkimit Sovjetik, edhe kundër imperializmit amerikan. Natyrisht, u desh një proces i vazhdueshëm, derisa u arrit në këto pozita. Por, siç manovroi Mao Ce Duni, manovruan edhe sovjetikët për konsolidimin e pozitive brenda dhe për afrimin me imperializmin amerikan. Njëkohësisht ata mbështetnin në Kinë grupin e Liu Shao Çisë për të likuiduar veprimtarinë e Mao Ce Dunit, e cila nuk ishte marksiste-leniniste, por sovjetikët e kuptuan mirë se ç'qëllime kishin ajo: krijimin e një Kine të madhe socialimperialiste, sikurse synonte për vete edhe Bashkimi Sovjetik. Këtij nuk i interesonte që të kishte dy partnere kundër, prandaj punonte për t'i prerë hovin partneres së re (Kinës) që po manovronte të bëhej superfuqi. Kështu u zhvilluan një varg ngjarjesh dhe Mao Ce Duni një ditë u gjet i izoluar.

Izolimi i tij mund të themi se ishte i plotë. Ai s'kishte më fuqi as në parti, as në shtet, as në ushtri. Prandaj, duke e kthyer flamurin nga ajo anë, për të cilën shkrova më sipër, pra nga ana e autoritetit dhe e kultit

të tij të fryrë në një shkallë të lartë, Maoja filloi fushatën për likuidimin e grupit të Liu Shao Çisë. Më parë e filloi me Pin De Huanë, i cili ishte mik me Hrushovin dhe kishte kritikuar politikën e «hopit të madh» të Maos dhe mënyrën e ecjes përpara për forcimin e ekonomisë. Mao Ce Duni kishte për qëllim ta eliminonte këtë nga ushtria dhe në vend të tij të sillte një njeri të vetin të besuar. Përfundimisht, Pinin e zëvendësoi me Lin Biaon.

Kurdoherë në këto çështje bëhej politikë personale. Para së gjithash Maoja e dinte se duhej të kishte me vete ushtrinë, se partinë dhe pushtetin, gjoja të demokracisë së re që krijoi, vërtet nuk i kishte në dorë, por ai e dinte se as partia, as pushteti nuk mund të vendosnin ligjin në Kinë. Vetëm ushtria mund ta bënte një gjë të tillë. Prandaj Mao Ce Duni, pasi e likuidoi Pin De Huanë, filloi likuidimin, gjithashtu, edhe të Liu Shao Çisë, të Ten Hsiao Pinit, të Pen Çenit, mundet edhe të Çu En Lait. Për këtë pra, Maoja, në kushtet e izolimit të plotë të tij shpërtheu Revolucionin Kulturor. Siç e kam theksuar edhe herë të tjera, ky nuk ishte një revolucion. Në brendi ai ishte një puç ushtarak, kurse në formë ishte ngritja e rinisë studenteske për të shkatërruar Partinë Komuniste të Kinës, atë parti që s'ishte komuniste, por që ndodhej në duart e grupit të Liu Shao Çisë dhe drejtohej prej tij.

Gjatë Revolucionit Kulturor Kina u fut akoma më thellë në një kaos politik, ideologjik e kulturor dhe u dobësua akoma më shumë ekonomikisht e ushtarakisht. Nuk dihej më se kush e bënte ligjin. Të gjithë bënë ligje, sidomos «gardistët e kuq», të cilët u lëshuan nga

freri dhe sulmuan shtabet, sipas urdhrit të Maos. Kjo do të thoshte të likuidonin partinë. Ata hynë edhe në luftë me proletariatin, me fshatarët, bile edhe me ushtarët, duke krijuar një konfuzion dhe anarki, aspak në rrugën e një revolucionit proletar, por as edhe të një puçi të organizuar. Gjatë gjithë kësaj kohe mbizotërol strategjia e re: «luftë kundër Bashkimit Sovjetik dhe kundër imperializmit amerikan».

Përsëri Maoja pati *présence d'esprit*<sup>1</sup> që ruajti personin e Çu En Lait nga likuidimi, sepse ky ishte një nga pjesëtarët më kryesorë të grupit të Liu Shao Çisë dhe i qe besuar organizimi e drejtimi i ekonomisë. Në fakt, Çuja pak a shumë ishte figura kryesore si organizator i ekonomisë dhe i pushtetit, por në analizë të fundit del se ai nuk «shkëlqeu», sepse ekonomia e Kinës s'doli asnjëherë nga kaosi, nga varfëria dhe nga prapambetja. Për Maon, Çu En Lai ishte një person me shumë rëndësi, se në rrëmujën e madhe që u bë në atë kohë në Kinë, duhej ruajtur deri në njëfarë shkalle stabiliteti në organizimin e ekonomisë, në funksionimin e fabrikave, në zhvillimin e çalë të bujqësisë etj.

Kështu Çu En Lai dhe Maoja e likuiduan grupin e Liu Shao Çisë dhe të ashtuquajturën politikë të tij, të cilën nuk e kritikuan, por e aprovuan sikur ishte e Maos, dhe në fakt e këtij ishte. Ata e panë se Revolucionit Kulturor po shkonte larg objektivave që kërkonin të arrinin, pra panë se ai nuk i sillte Kinës asnjë përfitim në strategjinë bazë që kishte vendosur Mao Çe Duni me kokën e tij «gjeniale»: shndërrimin e Kinës

1. Frëngjisht — shkathhtësi mendiml.

në një fuqi të madhe imperialiste. Atëherë menduan se duhej qetësuar ky Revolucion Kulturor dhe duhej stabilizuar gjendja që të mund të realizohej taktika e re e mëvonshme e lënies mënjanë të strategjisë kundër Bashkimit Sovjetik, kundër imperializmit amerikan dhe kapitalizmit botëror, për të adoptuar një strategji të re: atë të luftës kundër Bashkimit Sovjetik dhe pro imperializmit amerikan e borgjezisë kapitaliste botërore.

Në këtë drejtim u manovrua gjatë gjithë Revolucionit Kulturor dhe Mao Ce Duni e Çu En Lai vendosën për kthesën e përshtatshme, domethënë që ta bënë Kinën një superfuqi, gjë që ka qenë ide e përhershme e tyre. Në kokën e Mao Ce Dunit e të Çu En Lait ziente mendimi se ishin larg realizimit të idesë së madhe të përjetshme për të dominuar botën dhe se politika e ndjekur deri në atë kohë ka qenë katastrofike, prandaj duheshin bërë sa më parë riparime në politikë. Dhe kështu e kthyen fytyrën gradualisht drejt Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe shteteve të tjera kapitaliste të botës. E hoqën nga rruga barrierën gjoja të pakapërcyeshme: «Ose me Tajvanin dhe kundër Kinës, ose me Kinën kundër Tajvanit». Tash u përdor taktika që mund të mbyllej njëri sy për lidhje diplomatike me shtete kapitaliste të zhvilluara, duke gjetur një formulë që këto të fundit të pritnin marrëdhëniet diplomatike me Tajvanin, gjë që e bënë shumë nga vendet kapitaliste të zhvilluara, të cilat lidhën marrëdhënie diplomatike me Kinën.

Kina filloi të zbatojë pjesën e parë të programit të saj: hapin drejt Perëndimit. Ajo u pranua në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, shkëmbeu ambasadorë

me shtete të ndryshme kapitaliste etj. Kështu filluan kontaktet e para, buzëqeshjet, njohjet, lajkat; natyrisht, të matura në fillim, por këto ishin, si me thënë, trokitje në derën e pallatit amerikan ose depërtim në livingrumet<sup>1</sup> e pallatit për t'u ngjitur në katin më të lartë, pra, për t'u lidhur me amerikanët.

Qëllimi kryesor i ndryshimit të strategjisë kineze ishte lidhja e Kinës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës nga e cila do të zgjidheshin të gjitha problemet e tjera. Mirëpo Shtetet e Bashkuara të Amerikës qëndronin të patundura në pozitat e tyre ndaj Tajvanit dhe, pa u siguruar mirë, ato nuk e lëshonin dhe nuk mund ta lëshojnë Tajvanin. Por interesi i tyre ishte që të dobësonin kundërshtarin e vet, Bashkimin Sovjetik, duke e tërhequr Kinën nga ana e tyre dhe të mos e linin atë që ta përdorte Kinën si një forcë «aleate» kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës, qoftë në një luftë të re botërore, qoftë për presionet që do t'i bënte gjatë gjithë zhvillimit të kontakteve.

Në Pekin u bë takimi i fshehtë me Kisingerin dhe u ujdisën llafet. Atje vajti, gjithashtu, presidenti Nikson, që u prit nga Mao Ce Duni me një dashamirësi të jashtëzakonshme. Ky ishte fillimi, por që premtonte se do t'i hapej porta një strategjie të re botërore ose, siç e përcaktoi Niksoni, që «do t'i sillte botës ekuilibrin dhe paqen». Në fakt Shtetet e Bashkuara të Amerikës kishin qëllimin që thashë, që Kinën ta bënin një neokoloni të tyre, sepse e dinin që ekonomia e këtij vendi ishte e dobët, përtokë; dinin etjen e Kinës për t'u bërë

---

1. Nga anglishtja — sallon.



fuqi e madhe; dinin, gjithashtu, që armiqësia e Kinës së Mao Ce Dunit ndaj Bashkimit Sovjetik ishte e papajtueshme, natyrisht, jo për çështje ideologjike, se në këtë fushë pikëpamjet në thelb ishin të njëjta, por për sa u përket pretendimeve kufitare të njërës kundër tjetrit. Pra, të gjitha këto përbënin ato arsye thelbësore që imperializmi amerikan ia nderi dorën Kinës për ta tërhequr pranë vetes dhe këtë dorë e shtrënguan fort me të dyja duart Mao Ce Duni dhe Çu En Lai. Kështu ne pamë që të ndryshonin politika dhe strategjia kineze.

Tash Shtetet e Bashkuara të Amerikës u bënë miksha e madhe e Kinës. Imperializmi amerikan, sipas propagandës kineze është dobësuar, është në rënie, nuk është më agresiv, kurse Bashkimi Sovjetik është një superfuqi imperialiste agresive e egër, që lufton për vendosjen e hegjemonisë botërore. Këto janë pozitat e përcaktuara aktualisht nga Kina dhe, për ta zhvilluar si duhet këtë politikë e këtë strategji, shohim një varg procesesh graduale. Kështu efektet e Revolucionit Kulturor dalngadalë filluan të zvogëloheshin dhe Mao Ce Duni nisi të luante politikën e përhershme të balancës brenda vendit. Pra, mbështeti elementët e rinj, të dalë nga ky «revolucion» grupin e «të katërve» siç e quajnë tashti Hua Kuo Feni e Ten Hsiao Pini, dhe, njëkohësisht, filloi të rehabilitonte disa elementë që i kishin likuiduar Revolucionin Kulturor dhe vetë Mao Ce Duni, midis tyre, më të shkathtin, më aktivin, Ten Hsiao Pinin, armikun e vendosur të Revolucionit Kulturor e të grupit të të pesëve. (Kështu i duhet thënë «katërshes», se ky në fakt ishte grupi i Mao Ce Dunit.)

Pra, shohim që Ten Hsiao Pini të rehabilitohet. Kjo

Ishte ideja e Maos dhe e Çu En Lait, të cilët, për të realizuar planin e afrimit me imperializmin amerikan e me kapitalizmin botëror dhe që për një kohë relativisht të shkurtër ta kthenin Kinën në një vend të madh kapitalist në botë, duhej të sillnin në fuqi njerëzit më të besuar të kësaj rruge, njerëzit më aktivë dhe armiq të elementëve që ngulnin këmbë në strategjinë kundër imperializmit amerikan.

Kështu Ten Hsiao Pini mori poste; ai u bë zëvendësi i Çu En Lait dhe, natyrisht, të dy së bashku punuan për forcimin e pozitive të tyre në ushtri. Për këtë qëllim ata kishin likuiduar që më parë Lin Biao. Ten Hsiao Pini u bë shef i shtabit të ushtrisë dhe Jeh Çien Jini udhëhiqte ushtrinë. Kështu ushtria tash quhej se gjoja ishte në duart e Maos, por në fakt që një vegël në duart e Çu En Lait, të Ten Hsiao Pinit dhe të Jeh Çien Jinit, kurse «katërshja», ose më mirë «pesëshja», kishte në dorë shtypin, radion, televizionin dhe asgjë tjetër. Pra, njëri grup vepronte konkretisht, tjetri grinte fjalë. Klani i Çu En Lait, e Ten Hsiao Pinit dhe e Jeh Çien Jinit vepronte intensivisht brenda në Kinë dhe në arenën ndërkombëtare për afrimin me borgjezinë kapitaliste të botës dhe me imperializmin amerikan.

Në Kinë ekzistonte një situatë e tillë ku dy grupe rivale përpiqeshin të merrnin fuqinë. Tash fuqinë, që po i ikte nga duart «katërshes» ose «pesëshes», kishin filluar ta merrnin Çu En Lai, Ten Hsiao Pini e të tjerë. Mao Ce Duni qëndronte edhe andej, edhe këtej, dhe nuk ishte cilësuar keq si «timonier i madh», pra «mbante timonin», por një timon që po e çonte Kinën në një oqean me dallgë, ku do të mbytej përgjithmonë.

Çu En Lai vdiq nga kanceri. Atëherë ishte momenti crucial: Do të vinte Ten Hsiao Pini në vendin e tij apo nuk do të vinte? Do të fitonte ky grup që ishte mëkëmbur apo grupi tjetër i «katërshes»? Dhe u bë ajo që u bë: «katërshja» u likuidua dhe fuqinë e mori Hua Kuo Fení. Në të vërtetë, në mënyrë subversive, e mori Ten Hsiao Pini me ushtrinë e tij dhe Jeh Çien Jini, të cilët vendosën ato që dimë.

Për sa u përket çështjeve të politikës, gjithçka u bë e qartë. Kina u lidh me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe filloi tratativa të hapëta, pa maska, pa dorashka me të gjitha vendet borgjeze e kapitaliste, në unitet me borgjezinë reaksionare perëndimore. Ajo filloi të marrë hua të mëdha nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nga Gjermania Perëndimore, nga Japonia, nga Franca, nga Anglia etj. Synimet e Kinës ishin që të merrte prej këtyre vendeve teknologji të përparuar, të ndërtonte një ushtri moderne, të realizonte orientimin që dha Çu En Lai sa ishte gjallë, sipas të cilit në fund të shekullit Kina duhej të arrinte nivelin e fuqive të mëdha botërore, domethënë të mos kishte më dy superfuqi në botë, por të bëheshin tri të tilla. Pas puçit kundër «katërshes» e ardhjes në fuqi të Hua Kuo Fenit, të Ten Hsiao Pinit dhe të Jeh Çien Jinit, ky plan filloi të vihej në zbatim dhe është në zhvillim të plotë.

Pra, aktualisht, shohim se janë krijuar tri pole në botë: poli amerikan, poli sovjetik dhe poli kinez. Dy polet, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Kina, përpiqen të dobësojnë polin tjetër, Bashkimin Sovjetik. Për këtë gjë, përveç ndihmave kolosale, huave të mëdha, kthimit të saj në një vend kapitalist të udhëhequr nga

një ideologji kapitaliste imperialiste, Kina adoptoi një-kohësisht edhe «teorinë e tri botëve». «Botën e tretë», ku përfshihen vendet që, në forma të ndryshme, sundohen pak a shumë nga dy superfuqitë, Kina e quan si forcën kryesore të lëvizjes drejt revolucionit dhe kjo forcë, sipas saj, duhet të ketë në udhëheqje Kinën. Këtë ajo nuk e thotë hapur, por e ka shprehur qartë derisa futi edhe veten në këtë «botë të tretë». Në këtë botë tri polesh Kina ideologjikisht vjen më e forcuar me teorinë pseudomarksiste të një aleance të ngushtë të të gjitha vendeve të pazhvilluara me imperializmin amerikan.

Qëllimi i Kinës është që të marrë ndihma, si nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ashtu edhe nga vendet e zhvilluara kapitaliste, dhe këto vende, veçanërisht ato të Evropës Perëndimore, domethënë «Evropën e Bashkuar» dhe Tregun e Përbashkët Evropian, t'i nxitë të fuqizohen, të bashkohen më ngushtë me imperializmin amerikan, tash miku i saj më i madh, sepse pa këtë nuk mund t'i bëhet ballë Bashkimit Sovjetik që gjoja kërcënon. Pra, hiqet sikur Bashkimi Sovjetik nuk ka tendenca lufte dhe hegjemonie kundër Kinës, por kundër Evropës Perëndimore. Prandaj Kina nxit bashkimin reaksionar të vendeve të Evropës Perëndimore, nxit NATO-n, fuqizimin e Tregut të Përbashkët Evropian, duke kërkuar prej tyre investime të mëdha. Marrjen e këtyre investimeve ajo e konsideron një ndihmë që u jep Kina këtyre vendeve, duke i lehtësuar nga barra e inflacionit dhe e krizës së madhe që i ka pllakosur.

Kjo aleancë, që gjoja duket si e dyfishtë, nuk është veçse një aleancë në mes Kinës dhe Shteteve të Bash-

kuara të Amerikës, kurse Evropa Perëndimore për Kinën është një potencial i dorës së dytë që duhet të bashkohet me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, natyrisht, edhe me Kinën, për t'i bërë ballë socialimperializmit sovjetik. Mirëpo një çështje e tillë mund të realizohet në qoftë se Kina gjen budallenj në Evropën Perëndimore që të luajnë qorrazi politikën e saj, domethënë edhe ta ndihmojnë Kinën, edhe të mbajnë mbi supet e tyre barrën e prangave dhe të zinxhirëve amerikanë, edhe të presin njëkohësisht marrëdhëniet ekonomike dhe politike të uljes së tensionit me Bashkimin Sovjetik. Por këtë gjë që kërkon Kina, nuk e ka «Evropa e Bashkuar», kjo dhelpër plakë. Edhe vetë Evropa përpigjet të bëhet një superfuqi, të shkëputet nga prangat amerikane, të bëhet një partner e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, pale e Kinës po e po, dhe si e tillë të mund të bëjë një politikë të vetën përballë Bashkimit Sovjetik, përballë Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe përballë Kinës. Ja, pra, ku i ka synimet «Bashkimi Evropian», Tregu i Përbashkët dhe NATO-ja.

Kina, për ta fuqizuar më mirë aleancën antisovjetike me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, natyrisht, i drejtoi sytë, në radhë të parë, nga Japonia. Aktualisht politika kino-japoneze ka hyrë në «rrugë të mbarë» për përgatitjen e luftës së madhe botërore. Partneri kryesor në zhvillimin e industrisë, të ekonomisë dhe të ushtrisë kineze është bërë Japonia, në radhë të dytë vijnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, pastaj Gjermania Perëndimore e kështu me radhë.

Përveç kësaj, Kina me Japoninë u lidh edhe me një traktat, që në realitet është një marrëveshje e fshehtë

ushtarake. Kjo u bë nën patronazhin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të cilave u leverdis një marrëveshje e tillë dhe do ta përdorin atë kundër rivalit të tyre në hegjemoni, Bashkimit Sovjetik, për dobësimin e këtij të fundit.

Kështu, duke bërë një përmbledhje, mund të themi se ardhja në fuqi e klikës reaksionare të Ten Hsiao Pinit dhe të Hua Kuo Fenit e shpejtoi ecjen e Kinës në rrugën e shndërrimit të saj në një fuqi të madhe imperialiste dhe në ndryshimin e aleancave ose në krijimin e aleancave të reja Kinë-Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Kinë-Japoni kundër Bashkimit Sovjetik. Për Kinën rëndësi ka që Evropa Perëndimore të bashkohet më ngushtë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, dhe e ashtuquajtura botë e tretë të jetë nën ndikimin e Kinës. Por edhe sikur «bota e tretë» të jetë nën ndikimin e imperialistëve të tjerë, kjo nuk prish punë për Kinën, mjafton t'i pritët rruga depërtimit të influencës sovjetike në këto vende.

Në rivalitet e në garë të shfrenuar me njëri-tjetrin punojnë amerikanët, kinezët, sovjetikët dhe qeveritë reaksionare kapitaliste të «Evropës së Bashkuar». Por të gjitha këto fuqi të errëta të reaksionit i bëjnë llogaritë sikur bota të jetë e ngrirë, ndërsa vetë këta, ashtu si në kohët e kaluara, para Luftës së Parë Botërore e para Luftës së Dytë Botërore, të jenë vetë zot e vetë shkop dhe të rregullojnë punët e popujve dhe të shteteve sipas qejfit e interesave të tyre. Ata në llogaritë dhe në veprimet që bëjnë e kanë zhdukur krejtësisht faktorin revolucion, faktorin luftë nacionalçlirimtare të popujve; kanë eliminuar kontradiktat në mes borgjezisë dhe pro-

letariatit, në mes shteteve të varfra e shteteve të pasura, në mes popujve të një vendi dhe klikave reaksionare që sundojnë mbi këta popuj dhe të gjitha këto i kanë reduktuar në një kontradiktë. Kështu, për kinezët e vetmja kontradiktë e sotme është ajo që ekziston në mes Kinës së lidhur me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me Evropën Perëndimore, me Japoninë e me të gjitha vendet e tjera kapitaliste të zhvilluara, nga njëra anë, dhe Bashkimit Sovjetik, nga ana tjetër.

Natyrisht, kjo skemë është jo vetëm krejtësisht reaksionare, por e gabuar dhe pa asnjë perspektivë. Bëta po zhvillohet, popujt po zgjohen dhe po ngrihen në luftë. Sot shohim të zhvillohen ngjarje që shkojnë deri në luftë të armatosur.

Të marrim Lindjen e Mesme, ku gjendja është mjaft e turbullt. Është e vërtetë se vendet arabe janë të ndara dhe imperializmi amerikan e socialimperializmi sovjetik po bëjnë përpjekje të mëdha që ta ruajnë këtë gjendje, por lëvizja zien dhe ajo gradualisht do të kthehet në cilësi. Ne shohim se në Iran ka dy muaj që populli proteston kundër regjimit dhe vritet nëpër rrugë, duke demonstruar kundër shahut. Regjimi i urryer i shahut, mikut të amerikanëve e të kinezëve, është në rrezik, pavarësisht se kush e mbështet. Fakt është se populli i mjeruar është ngritur kundër shtypjes kapitaliste të jashtme e të brendshme. Edhe në qoftë se kjo lëvizje nuk konkretizohet në arritjen e një republike demokratike përparimtare, prapëseprapë, siç e theksova më lart, gradualisht më vonë sasia do të kthehet në cilësi.

E njëjta gjë ndodh në vendet e Amerikës Latine e

në Afrikë, ku mund të themi, gjithashtu, se nuk ka qetësi, në popull ka urrejtje kundër shtypësve e shfrytëzuesve.

Pra, po të kurdisësh aleanca në mes tri-katër poleve apo pesë fuqive të mëdha (në qoftë se mund ta konsiderojmë, dhe duhet ta konsiderojmë, edhe Japoninë një fuqi të madhe në botë), çështjet nuk do të shkojnë si në vaj dhe nuk do të zgjidhen si i duan këto. Ekzistojnë në mes tyre kontradikta të thella, të cilat do të thellohen akoma më tepër. Popujt e këtyre vendeve, lufta çlirimtare e revolucionare dhe vetë ambiciet e njërës e të tjetrit vend për dominim dhe për hegjemoni, do t'i prishin planet e imperialistëve.

Ambiciet e Kinës për t'u bërë superfuqi nuk kufizohen vetëm në fuqizimin e brendshëm të saj. Ajo ka qëllime të largëta, të dominojë botën. Por aktualisht, tendenca e saj, e nxitur nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe nga shtetet evropiane, është që, mbasi të forcohet, të krijojë edhe ajo shtetet e bashkuara të Azisë ose komunitetin e bashkuar aziatik, ku të përmbledhë, natyrisht duke i zaptuar me luftë ose me diversion, Vietnamin, Korenë, Laosin, Kamboxhian, Tajlandën, Birmaninë dhe, më tej akoma, në qoftë se mund t'ia arrijë, të futet në një aleancë edhe me Indinë, siç bëri me Japoninë!

Kështu një Kinë e madhe, me një potencial të madh njerëzor, ekonomik dhe ushtarak, mund t'u bëjë ballë të dyja superfuqive, ose të tria superfuqive të tjera, duke futur edhe Evropën brenda, pra, të bëjë ligjin raca e verdhë mbi racën e bardhë dhe racën e zezë. Këto



pikësnyime kanë ekzistuar dhe ekzistojnë si tendenca politike në strategjinë socialimperialiste të Kinës.

Kina tok me Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të përpiqen që Indinë, Birmaninë, Afganistanin dhe Pakistanin t'i kenë zona të tyre të influencës. India është një shtet i madh, i fuqishëm, me një potencial të madh njerëzor, por edhe ekonomik. Ajo mund të jetë më e zhvilluar nga Kina, pavarësisht se atje polarizimi në mes të pasurve dhe të varfërve, në mes maharaxhëve dhe pariave është më i theksuar. Ka mundësi që, në një zhvillim të ri të ardhshëm dhe me mbështetjen e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të fuqive të tjera imperialiste, si dhe të bllokut kino-japonez, të bëhet edhe India një superfuqi dhe të mbrojë borgjezinë e Imperializmin nga socialimperializmi sovjetik. Me fjalë të tjera, ajo të bëhet një barrierë për të shpëtuar Lindjen e Mesme, e cila mund të kërcënohet nga socialimperializmi sovjetik.

Tash me ngjarjet që po ndodhin në Iran, shohim se sovjetikët po përpiqen të ringjallin hijen e traktatit të aleancës me këtë vend. Ata deklaruan: Në qoftë se ndokush prek Iranin me forca nga jashtë, atëherë Bashkimi Sovjetik do të ndërhyjë. Lindja e Mesme është një qendër lufte më e zjarhtë se çdo qendër tjetër, për arsye të kontradiktave të mëdha që ekzistojnë brendapërbrenda vetë shteteve arabe, shteteve arabe dhe Izraelit, shteteve arabe dhe imperializmit amerikan, shteteve arabe dhe Bashkimit Sovjetik, Bashkimit Sovjetik dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Bashkimit Sovjetik dhe Kinës.

Të gjitha këto kontradikta ekzistojnë për fushat e naftës të kësaj zone, pse kush ka energjinë, kush ka naftën, është më i fuqishëm; ai që e humbet këtë, dobësohet, por derisa e ka, do ta mbrojë me gjak dhe me luftë kundër atij që bën tentativa ta hedhë në dorë. Prandaj, në qoftë se sovjetikët rrezikojnë botën me një luftë të tretë, ka mundësi që më parë nga çdo gjë Lindja e Mesme të jetë objektivi kryesor, se atje është nafta dhe se rezistenca atje është më e dobët.

Forcat e mëdha sovjetike brenda një kohe të shkurtër mund të pushtojnë më shpejt Iranin, Gjirin Persik, Arabinë Saudite dhe të dalin në Mesdhe, sesa të sulmojnë Evropën Perëndimore, ku do të hasin në një rezistencë shumë më të madhe e shumë më të organizuar. Në qoftë se mund të shprehemi me shifra, në Evropë ata do të gjejnë një rezistencë njëqind herë më të madhe se ç'mund të gjejnë në Lindjen e Mesme.

Kjo, mendoj unë, me pak fjalë është një pasqyrë e shkurtër e situatës ndërkombëtare. Në rast se Kina e Mao Ce Dunit do të kishte ecur në rrugën revolucionare, në rrugën marksiste-leniniste, ajo mund të luante një rol të madh pozitiv në botë. Kjo rrugë nuk është ndjekur kurrë as nga Mao Ce Duni, as nga ithtarët e tij. Përkundrazi, ata kanë ecur në një rrugë borgjeze kapitaliste, gjë që u ka sjellë Kinës dhe botës shumë të këqija dhe rreziqe të mëdha për shpërthimin e një lufte të tretë botërore, këtë herë të një lufte atomike.

Gjithë Imperialistët janë një murtajë e madhe për njerëzimin. Qëllimi për të cilin u shkrua libri «Imperializmi dhe revolucioni» është të sqarohen këto situata,

t'u thuhet popujve ç'mendon Partia jonë, ç'rreziqe u turren, si duhen shikuar këto probleme dhe me ç'mjete duhen zgjidhur.

*Marrë nga libri:*

*Enver Hoxha, «Ditar për çështje ndërkombëtare» (botim i brendshëm), nr. 11, f. 492*

# **TYMI I BARDHË I ALEANCAVE NDËRIMPERIALISTE FSHEH RREZIQE TË MËDHA PËR NJERËZIMIN**

**Shënime**

**18 dhjetor 1978**

Më 16 tetor 1978 Kina e Hua Kuo Fenit dhe e Ten Hsiao Pinit, Kina revizioniste, tok me Shtetet e Bashkuara të Amerikës deklaruan se vendosën marrëdhënie diplomatike midis tyre. U realizua më në fund dëshira e zjarrtë e Mao Ce Dunit dhe e Çu En Lait për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike e miqësore të shumanshme me imperializmin më të egër të botës.

Natyrisht, për të arritur deri këtu u desh një kohë e gjatë, për arsye se duhej që Mao Ce Duni dhe Çu En Lai, në kohën e tyre, e më vonë Hua Kuo Feni e Ten Hsiao Pini të likuidonin të gjithë elementët që pengonin realizimin e kësaj dëshire të «timonierit të madh» Mao dhe të «kryetarit të nderuar» Çu.

Me pak fjalë, pas strategjisë së Maos, gjoja për të luftuar e për të demaskuar socialimperializmin sovjetik dhe imperializmin amerikan, u shpall Revolucioni Kulturor; u likuiduan shtabi i Liu Shao Çisë dhe gjithë partia me tërë levat e saj, u krijua një kaos i madh në

Kinë. Thonë se gjatë këtij kaosi u vranë 5 milionë veta, por kjo shifër nuk është e kontrolluar. Në këtë «revolucion» kryesori mbi kryesorët ishte vetë Mao Ce Duni. Grupi i ashtuquajtur i katërshes ishte mjete që përdori ai për ta propaganduar dhe për ta drejtuar Revolucionin Kulturor, me anën e të cilit likuidoi partinë, por jo organizmat shtetërorë. Këta të fundit dhe ushtria u ruajtën nga Mao Ce Duni dhe nga Çu En Lai për të mbështetur Revolucionin Kulturor derisa t'ua arrinin qëllimeve të tyre të caktuara. Pastaj ata morën masa që forcat e Revolucionit Kulturor, domethënë nxënësit e studentët e paorganizuar që vepronin në rrëmujë, të ktheheshin nga kishin ardhur dhe, si me thënë, të vendosej qetësia, pse në Kinë kurrë nuk ka pasur as qetësi, as stabilitet. Por çështja është se Revolucioni Kulturor nuk favorizonte bazën politike të strategjisë së re të Mao Ce Dunit dhe të Çu En Lait, idenë e tyre të miqësisë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me gjithë reaksionin botëror.

Prandaj gjatë fazës së riorcimit, «të stabilitetit» në Kinë, Çu En Lai ishte partizan i ruajtjes së organizmave shtetërorë ekzistues dhe jepte përshtypjen se këta organizma funksiononin me rendiment të kënaqshëm. Megjithëkëtë, nuk ishte vetëm çështja e mbajtjes në këmbë të organizimit të dobët të Kinës në fushën administrative, shtetërore dhe ekonomike, që e preokuponte atë. Çu En Lai me njerëzit e tij manovronte që frytë të Kinës të kthehej drejt një orientimi të ri, i cili do të shpallej më vonë. Ky ishte, si të thuash, objektivi i fshehtë i Çu En Lait. Për këtë ai kishte jo vetëm mbështetjen e Mao Ce Dunit, nën bajrakun e të cilit lufton-

te, por edhe mbështetjen e elementëve që udhëhoqën Revolucionin Kulturor, me të cilët bashkëjetoi gjatë gjithë Revolucionit Kulturor, që kur u fut në strofkën e tyre. Përjashtim bënte vetëm Çen Po Taja, i cili u konsiderua si i panevojshëm në Byronë Politike dhe iu nxorën një mijë e një «argumente» (të falsifikuara a të vërteta ishin, ne asgjë nuk mund të afirmojmë për këtë), që të mos bënte pjesë në udhëheqje. Por, në udhëheqjen e Revolucionit Kulturor, elementi më i rrezikshëm për planet e ardhshme të Mao Ce Dunit dhe të Çu En Lait ishte, siç duket, Lin Biaoja, i cili udhëhiqte ushtrinë kineze. Dihet se në Kinë ushtria ka qenë kurdoherë ajo që ka bërë ligjin. Gjatë kohës së luftës dhe pas luftës, ushtria, arma, ka dominuar mbi partinë. Gjatë Revolucionit Kulturor ushtria, të cilën e kishte në dorë Lin Biaoja, drejtpërdrejt ose tërthorazi, u bë mbështetja bazë e Mao Ce Dunit.

Gjatë kësaj kohe Lin Biaoja e ngriti në qiell në mënyrë skandaloze kultin e Mao Ce Dunit. Kjo propagandë për Maon aprovohej nga gjithë udhëheqja, pa përjashtim. Orkestrimin, që e drejtonte Lin Biaoja, e mbështeste «katërshja», e reklamnin dhe e aprovonin edhe Çu En Lai e shokët e tij, të cilët, në të vërtetë, nuk besonin asgjë nga të gjitha këto gjëra që thuheshin për Maon, por punonin në heshtje e në konspiracion për ta likuiduar një situatë të tillë nën flamurin e vetë Mao Ce Dunit.

Përpunimi i Mao Ce Dunit bëhej nga Çu En Lai dhe ishte shumë i lehtë, për arsye se pikëpamjet e tij, si për momentin e kthesës së madhe politike, të kthesës në aleanca, në ideologji, në politikë, në ekonomi

etj., puqeshin me ato të Mao Ce Dunit. Kjo shkaktol edhe likuidimin e Lin Biaos. Me fjalë të tjera, në ushtri dolën elementë që ishin të Maos dhe të Çusë, që Revolucionin Kulturor nuk e honepsnin.

Kjo ishte kryesorja, këtu do të mbështeteshin Mao Ce Duni, Çu En Lai, Ten Hsiao Pini e Hua Kuo Feni.

Natyrisht, zhdukja e Lin Biaos u paraqit si në një roman policesk, rokambolesk<sup>1</sup> dhe e pabesueshme në trajtat dhe në format me të cilat u shpall. Por, sidoqoftë, u likuidua pushteti i tij dhe u vendos një pushtet që favorizonte etapën e re që po përgatitej. Ishte e pamundur që kjo përgatitje të mos i binte në erë një pjese të udhëheqjes së partisë. (Me këtë nënkuptoj «katërshen».) Edhe kjo, domethënë «katërshja», vepronte në bashkëpunim me Mao Ce Dunin, i cili luante rolin e balancës midis dy klaneve. Ai kurdoherë ishte hezitues, i lëvizshëm, i paqëndrueshëm, i pavendosur dhe i tillë mbeti derisa vdiq. Pra, Mao Ce Duni «katërshes» i kishte lënë, si të thuash, dorë të lirë të manipulonte mjetet e agjitacionit e të propagandës, të shkruante artikuj mbarë e mbrapsht dhe të gjithë të mbështetur gjoja në maocedunidenë. Nga ana tjetër, edhe Çu En Lai me shokët e tij bënë punën e tyre. Të dy grupet bashkëjetonin në divergjenca dhe në disharmoni të plotë; të dy grupet përgatitnin puçin, pse puçist ka qenë Mao Ce Duni, puçistë ishin dhe dishepujt e tij, si grupi i «katërshes» ashtu edhe ai i Çu En Lait.

Kështu, për grupin e Çu En Lait vihej detyra që kurdoherë me Maon në krye ta likuidonte grupin rival,

---

1. Nga frëngjishtja — diçka jo e zakonshme, aventureske.

ta hiqte atë nga rruga e Maos dhe vetë të bëhej grupi i plotfuqishëm e pastaj të zbatonte planin dhe programin e përcaktuar me kohë që para çlirimit nga Mao Ce Duni dhe Çu En Lai. Këtë program e këtë plan sekret e zbuloi shtypi amerikan, i cili kohët e fundit shkroi se në vitin 1949 Çu En Lai i kishte dërguar një letër sekrete konsullit të përgjithshëm amerikan në Pekin, me anën e së cilës kërkonte që Shtetet e Bashkuara të Amerikës ta ndihmonin Kinën pas çlirimit, sepse as idetë e Mao Ce Dunit, as ato të tijat nuk synonin ndërtimin e socializmit në Kinë, por miqësinë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Te këta të fundit do të mbështetej Kina dhe jo te Bashkimi Sovjetik i Stalinit.

Maoja po plakej, prandaj i duhej ta shpejtonte procesin e vënies së Kinës në rrugën e realizimit të dëshirës së tij të zjarrtë. Momenti kishte arritur, ishte pjekur. Pas likuidimit të Lin Biaos, u zbulua se Çu En Lai dhe Mao Ce Duni kishin hyrë me kohë në tratativa të fshhta me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Këto tratativa, siç dihet, u zhvilluan në fillim midis Çu En Lait dhe Kisingerit. Pastaj zbriti në Pekin Niksoni, presidenti batakçi i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, i cili zhvilloi bisedime me Maon dhe me Çu En Lain, bisedime këto që përfunduan me komunikatën e Shangait. Ç'ndodhi tjetër në këto bisedime, nuk u mor vesh, veçse në shtypin kinez filloi njëfarë zbutjeje kundrejt Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Por zhvillimi i ngjarjeve tregoi se autorët e marrëveshjes midis Kinës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës kishin vendosur që të largohej nga skena, me dashje ose pa dashje, edhe e ashtuqajtura bandë e të katërve.



Me vullnet e me dashje, siç duket, «katërshja» nuk largohej nga pushteti. Elementët e saj nuk e propagandonin, siç dëshironin Mao Ce Duni dhe Çu En Lai, marrëveshjen kino-amerikane, e cila do të ishte me konsekuenca të rënda e të mëdha për vetë Kinën dhe për gjithë botën.

Por, natyrisht, gjatë kësaj kohe grupi i Çu En Lait u konsolidua dhe arriti të sillte në fuqi e t'i jepte poste të rëndësishme, deri atë të nënkryetarit të partisë, të zëvendëskryeministrit dhe të shefit të shtabit të përgjithshëm të ushtrisë, Ten Hsiao Pinit, «Hrushovit numër dy të Kinës», siç e ka cilësuar Mao Ce Duni, ose «kundërrevolucionarit monarkist», siç u vetëquajt ai në autokritikën që bëri përpara udhëheqjes së partisë gjatë Revolucionit Kulturor.

Në këtë mënyrë grupi i Çu En Lait po merrte në dorë gjithë pushtetin. Me fjalë të tjera, këtij grupi nuk i mbetej veçse të likuidonte politikisht dhe fizikisht, po të mundte, «katërshen», që kishte në dorë shtypin. Të gjithë organizmat e tjerë ishin në duart e grupit të Çu En Lait me Mao Ce Dunin në krye. Në Zyrën e Përgjithshme, që bënte ligjin në parti, ishte përgjegjës njeriu i Maos, që më vonë u bë i Hua Kuo Fenit e tash është zëvendësuar me elementin më besnik të këtij të fundit, pavarësisht se para Revolucionit Kulturor ishte akuzuar si agjent i thjeshtë i sovjetikëve. Edhe pse Maoja ishte kryetar i partisë, një nga zëvendëskryetarët e saj ishte Ten Hsiao Pini. Ai kishte në dorë njëkohësisht edhe ushtrinë e gjithçka tjetër. Kjo do të bënte dhe bëri që të shpejtohej procesi i likuidimit të «katërshes».

Në fillim të këtij procesi, Çu En Lai vdiq. Automatikisht atij duhej t'ia zinte vendin Ten Hsiao Pini si kryeministër. Kjo s'ndodhi. Mao Ce Duni caktoi Hua Kuo Fenin kryeministër. «Katërshja», në pamundësi të vinte njerëzit e vet në këtë post, e pranoi këtë zgjidhje, që u konsiderua sikur ishte rekomanduar nga vetë Mao Ce Duni, i cili, në fakt, siç po thonë tani, në atë kohë nuk ishte në vete. Nga e gjithë kjo një gjë është e njohur botërisht: Hua Kuo Feni, duke u bërë kryeministër, e likuidoi përsëri Ten Hsiao Pinin, e riuajtiti këtë revizionist pas ngjarjeve të prillit në sheshin Tien An Men, ku grupi i Ten Hsiao Pinit lëshoi njerëzit e vet për të demonstruar gjoja për përvjetorin e vdekjes së Çu En Lait. Këta demonstrues, siç dihet, u sulmuan e u goditën nga milicia popullore, e cila thuhej se ishte nën drejtimin e «katërshes» e të Hua Kuo Fenit.

Mirëpo intrigat e pallatit vazhduan dhe Mao Ce Duni gjatë kësaj kohe vdiq. Kështu, Hua Kuo Feni «me një të goditur» likuidoi njerëzit e «katërshes», i arrestoi ata, u bë kryetar i partisë e kryeministër dhe solli përsëri në fuqi, sepse iu imponua, Ten Hsiao Pinin si zëvendëskryeministër dhe si shef të shtabit të përgjithshëm. Hymë, pra, në një fazë të re të politikës kinëze, në të cilën komploti i djathtë reaksionar proamerikan i Çu En Lait e i Mao Ce Dunit po futej në fazën e konkretizimit të dëshirave të të dy të vdekurve dhe të vendimeve të hapëta dhe të fshehta që ishin marrë midis Mao Ce Dunit e Çu En Lait, nga njëra anë, dhe Niksonit e Kisingerit, nga ana tjetër.

Kina tash shpалosi planin e ri strategjik, hapjen e plotë drejt imperializmit amerikan, drejt fuqive të tjera

imperialiste dhe borgjezisë kapitaliste botërore. Ajo ndërtoi, gjithashtu, edhe teorinë e saj shoqëruese të këtij plani, si teorinë e «botës së tretë» dhe të luftës kundër socialimperializmit sovjetik, duke e cilësuar këtë të fundit armikun më kryesor të njerëzimit. Kina i bëri thirrje gjithë botës të bashkohej pa dallim klase, pikëpamjesh e orientimesh; ajo braktisi kryekëput teorinë marksiste-leniniste dhe adoptoi një politikë të re koniunkturale, antimarksiste.

Me Shtetet e Bashkuara të Amerikës lidhjet e Kinës kishin hyrë në rrugë të madhe. Nuk ishin vendosur as marrëdhënie diplomatike, as ishin shkëmbyer diplomatë dhe as ishte zgjidhur çështja e Tajvanit, por në Kinë kishin filluar të vinin grupe senatorësh, teknikësh, specialistësh, bankierësh e kreditorësh të ndryshëm amerikanë. Pra, nga të dyja anët allshveriset po shkonin në rrugë të mbarë dhe çdo gjë ecte me sukses, kurse me vendet e tjera kapitaliste Kina kishte arritur në një formulë *modus vivendi* për çështjen e Tajvanit dhe kishte vendosur prej kohësh marrëdhënie diplomatike. Tash, pas likuidimit të «katërshes» dhe marrjes së fuqisë në dorë, grupi i Hua-Tenit lëshoi kudo në botën kapitaliste emisarët e tij politikë, ekonomikë, ushtarakë të të gjitha armëve për të biseduar për kredi, për teknologji, për armatime të reja etj., etj. Kështu ngjau në radhë të parë me Japoninë, me Gjermaninë Perëndimore, me Francën, me Anglinë, me Tregun e Përbashkët Evropian, me një fjalë, me të gjitha shtetet kapitaliste.

Po ashtu udhëheqja antimarksiste kineze duhej të vendoste lidhje të plota me Jugosllavinë revizioniste dhe me Rumaninë gjithashtu revizioniste. Në zbatim të kë-

tij orientimi të ri ajo preu marrëdhëniet ekonomike me Shqipërinë, preu kreditë, tërhoqi specialistët pa i prerë marrëdhëniet diplomatike dhe, pas këtij veprimi të poshtër, u lidh më hapur me Jugosllavinë. Krahas kërkesave për kredi bankare dhe shtetërore, për teknologji të përparuar dhe për armatime, Kina vazhdonte të propagandonte në Evropë e kudo në botë «rrezikun iminent sovjetik», «luftën» që Bashkimi Sovjetik do të deklaronte në Evropë kundër Evropës etj. Për t'u bërë ballë këtyre «situatave e ngjarjeve» ajo predikonte «bashkimin e Evropës», armatimin e saj, forcimin e Tregut të Përbashkët Evropian dhe që kjo «Evropë e Bashkuar» të bëhej një mike e ngushtë e mikës së saj të ngushtë, Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Domethënë Kina predikonte vasalitetin e «Evropës së Bashkuar» ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Po ashtu Kina ndërmoi një ndërhyrje të pacipë në punët e brendshme të shteteve afrikane, të cilat i quante «botë e tretë» dhe, nën maskën e komunizmit, përpiqej të krijonte atje njëfarë influence politike, të hidhte bazat për veprimet e ardhshme ekonomike dhe ushtarake. Kjo veprimtari njëkohësisht kishte si objektiv të saj edhe pengimin e zhvillimit të tendencave ekspansioniste të socialimperializmit sovjetik, pra të ruante në Afrikë statukuonë, domethënë politikën neokolonialiste të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të Francës, të Anglisë dhe të racistëve të Afrikës së Jugut.

Ndërkohë brenda në Kinë vazhdonte lufta jo vetëm për demaskimin e «katërshes». Grupi i Ten Hsiao Pinit hyri në rivalitet me grupin e Hua Kuo Fenit dhe dukeshin qartë qëllimet e grupit të parë për të pasur

plotfuqishmëri brenda në vend. Me një fjalë, Teni dëshironte likuidimin e grupit të Huasë dhe të mbeturinave të «katërshes», të cilat, duke ndërruar këmishë, këtë herë në favorin e Hua Kuo Fenit, ekzistonin akoma në udhëheqjen e partisë e të shtetit. Pra, Hua Kuo Feni përpigëj «të trashëgonte» Maon, kurse Ten Hsiao Pini ishte partizani i revanshit të hakmarrjes kundër Revolucionit Kulturor, kundër atij që e organizoi dhe e udhëhoqi këtë revolucion, pra kundër Mao Ce Dunit. Kështu Ten Hsiao Pini e futi Kinën në një rrëmujë akoma më të madhe. Filluan kështu të dalin dacibao që atakonin edhe «katërshen», edhe Hua Kuo Fenin, edhe Maon dhe, herë tërthorazi e herë haptazi, ato mburrnin Ten Hsiao Pinin.

Dacibaot kërkonin rehabilitimin e të gjithë të dënuarve nga Revolucioni Kulturor, kërkonin që demonstrata e Tien An Menit të quhej një aksion revolucionar dhe jo kundërrevolucionar etj. Ato krijuan një situatë në favor të pushtetit të plotë të Ten Hsiao Pinit.

Natyrisht, të gjitha këto shkaktuan turbullira të mëdha, pse shumica e kuadrove u hodhën tej, ndërsa një pjesë tjetër e madhe kuadrosh të vjetër të reaksionit erdhën në fuqi dhe zunë postet që kishin më parë. Ata u bënë mbështetja kryesore e Ten Hsiao Pinit, gjë që e acaroi më tepër rivalitetin midis këtij dhe Huasë. Rruga që do të merrte ky rivalitet, nuk ishte e mirë as për Hua Kuo Fenin, as për Ten Hsiao Pinin. Një situatë e tillë çonte edhe në demonstrata, siç ndodhi para një jave në Shangai, për të cilat kam shkruar.

Prandaj të dy grupet u përpoqën jo të pajtohen, pasi midis tyre nuk do të ketë pajtim, por të gjejnë një

rrugë kompromisi, se për të tilla punë ata kanë lindur. Ky kompromis synonte ta qetësonte situatën brenda në Kinë, aq sa mund të qetësohet, dhe të krijonte besim tek aleatët e ardhshëm, që nga Japonia deri te Shtetet e Bashkuara të Amerikës, se në Kinë gjendja po stabilizohet dhe nuk ka rreziqe për investimet e tyre.

Në Jugosllavi e në Rumani pamë të shkonte Hua Kuo Fenl. Siç e kam thënë edhe herë të tjera, udhëtimi i tij në këto vende kishte për qëllim të ndizte urat kundër Bashkimit Sovjetik dhe të provokonte një luftë në Evropë. Këttj qëllimi ai nuk ia arriti. Pas kthimit të Huasë në Pekin, Ten Hsiao Pinl bëri hopin më të madh diplomatik konkret. Ai shkoi në Japoni për të marrë pjesë në ceremoninë e shkëmbimit të instrumenteve të ratifikimit të traktatit të miqësisë dhe të bashkëpunimit reciprok. Kjo ishte një fitore e madhe e reaksionit racist kino-japonez. U zhdukën të gjitha mosmarrëveshjet dhe Japonia gjeti në Kinë një treg të madh, shumë të favorshëm, ndërsa Kina gjeti te Japonia një mike shumë të afërt ideologjike dhe politike me një industri të madhe dhe të zhvilluar. Afaristët e mëdhenj, bankierët, bonzët japonezë u vërsulën në Kinë dhe shoqëritë e shtetit japonez i akorduan asaj me miliarda dollarë kredi.

Por aleanca kino-japoneze përmban në vetvete një rrezik të jashtëzakonshëm, rrezikun e një lufte të tretë botërore midis Kinës e Japonisë, nga njëra anë, dhe Bashkimit Sovjetik, nga ana tjetër. Si Kina, ashtu edhe Japonia, kanë pretendime territoriale ndaj Bashkimit Sovjetik, synojnë ta likuidojnë forcën politike, ideologjike, ushtarake e ekonomike të tij dhe ta futin atë në

strokën e vet, siç thonë ata, në Evropë, nën parullën «Azia aziatikëve», «Siberia aziatikëve», «Azia Qendrore e Bashkimit Sovjetik aziatikëve».

Prandaj ky traktat ka një rëndësi të jashtëzakonshme jo vetëm pse fuqizon Kinën me teknologji ushtarake dhe industriale moderne, por, njëkohësisht, i hap Japonisë një treg të madh për eksportim mallrash dhe një burim të madh lëndësh të para; e shpëton atë nga kriza dhe e ndihmon që ajo ta shtypë akoma më shumë klasën punëtore japoneze, e cila që tash vuan nga një shtypje e tmerrshme.

Pra, ideologjia antimarksiste e kinezëve doli aqik. Kina mori kredi të mëdha edhe nga vendet e tjera kapitaliste, aq sa gazeta franceze «Lë Mond» në njërin nga numrat e saj thotë se Franca po përliton jashtëzakonisht dhe, në qoftë se nuk gabohem, shuma e kredive që do t'i akordojë Kinës për teknologji moderne, arrin deri në 60 miliardë franga. Por gazeta bën pyetjen: A do të jetë Kina në gjendje t'i paguajë këto kredi kaq të mëdha? Etja e saj për armatime, për teknologji, për fabrika, për siderurgji është e madhe, — dhe përmend një afarist anglez, i cili kishte vajtur kohët e fundit në Kinë për të biseduar për dhënie kredish dhe kishte thënë se të gjitha këto kredi të mëdha Kina duhet t'i paguajë, por ato nuk lahen me lepuj të ngrirë e me rosa pekineze. Prandaj «Lë Mond» e këshillon qeverinë franceze që të jetë shumë e matur, se dhënia e ndihmës dhe e fitimeve që mund të nxjerrë Franca nga Kina, përveç karakterit politik që ka nga fakti se si do ta shikojë Bashkimi Sovjetik këtë ndihmë kaq të madhe që Perëndimi i jep Kinës, ka edhe karakter e pasoja ekonomike, pse një

vit i keq bujqësor në Kinë do të bëjë që ajo të mos jetë në gjendje t'i lajë borxhet që po merr nga shtetet kapitaliste.

Të gjithë e dimë se Kina aktualisht ka ndryshuar politikë, ka ndryshuar strategji dhe po lidhet ngushtë e po hyn në rrethin e kapitalizmit botëror. Kështu ajo po bëhet një vend i varur nga kapitali i huaj amerikan, japonez, nga ai i Evropës Perëndimore, natyrisht, duke u bërë atyre koncesione të rënda, duke krijuar shoqëri të përbashkëta, duke skllavëruar popullin kinez dhe duke humbur lirinë e sovranitetin e vet të vërtetë.

Është e qartë se Kina përgatitet për luftë dhe nxit luftën botërore; por, që të përgatitet për luftë, e thashë edhe më lart, ajo armatohet në ethe me mjetet më moderne dhe fuqizon prapavijat e saj ekonomike.

Kina përpiqet të shkojë në luftë me aleanca të reja, të cilat, siç po duket, synojnë në krijimin e unitetit kino-japonez dhe kino-amerikan, pra, në krijimin e një blloku të madh luftarak për mbrojtjen nga influenza sovjetike të Azisë Lindore, po e po, por edhe të të gjithë Paqësorit e të Azisë Juglindore. Fillimi i kësaj aleance synon konsolidimin e pozitave luftarako-ekonomike të Kinës, të Japonisë e të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në gjithë këtë pellg dhe pastaj ndarjen e tregjeve në mes tyre në gjithë Azinë. Kjo ndarje tregjesh do të thotë ndarje e zonave të influencës dhe në këtë ndarje të tria këto shtete të fuqishme imperialiste, në mos sot, nesër, do të ndeshen patjetër, pse oreksi i tyre është i madh. Kryesoret në këto aleanca, aktualisht, janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Këto kohët e fundit, në njëfarë konklavi vatika-



nesk në Pekin dhe në Uashington, për javë të tëra është punuar për të arritur në konkluzione të favorshme për një aleancë kino-amerikane të padeklaruar, por reale. Më në fund, nga ky konklav disa javësh, midis Ten Hsiao Pinit e përfaqësuesit të zyrës amerikane në Pekin, si edhe midis Karterit dhe përfaqësuesit të zyrës kineze në Uashington, nga oxhaku i selisë perandorake kineze dhe nga Shtëpia e Bardhë e Uashingtonit, doli tym i bardhë. Në Pekin dhe në Uashington në të njëjtën ditë e në të njëjtën orë, Hua Kuo Feni dhe Karteri shpallën se u lidhën marrëdhënie diplomatike midis dy shteteve dhe u vendos shkëmbimi i ambasadorëve.

Duket se për çështjen e Tajvanit Shtetet e Bashkuara të Amerikës i bënë lëshime Kinës. Ato do të cedonin, ashtu siç ceduan, duke njoftuar se me vendosjen e lidhjeve diplomatike me Kinën do t'i shkëputnin lidhjet diplomatike me Tajvanin. Unë kam thënë se, për të lidhur këto marrëdhënie diplomatike dhe për të vazhduar në rrugën e krijimit të një aleance, në mos të deklaruar, sekrete, çështja e Tajvanit nuk ka qenë një pengesë shumë serioze. Serioze kanë qenë sigurimet që Kina duhet t'u jepte Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Këta njohën se në Kinë ekziston një qeveri legale dhe se Tajvani është pjesë përbërëse e saj. Ky ishte lëshimi që bënë Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ky lëshim, natyrisht, ishte i nuancuar pse, pas Karterit, Vensi bëri disa «shpjegime» lidhur me Tajvanin, duke deklaruar se Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk do ta ndalojnë asnjëherë furnizimin e tajvanezëve me armë moderne, se do të ruajnë e do t'i zhvillojnë

marrëdhëniet tregtare, se në vend të ambasadës do të kenë një mision diplomatik të shkallës së zyrës së ndërlidhjes, siç ekzistonte deri tash në Kinën kontinentale dhe se do të ruajnë me Tajvanin marrëdhëniet kulturore dhe miqësore.

Me fjalë të tjera, çështja e Tajvanit na doli një fyçkë. Në sipërfaqe duket sikur Kina patl satisfaksion. Por ky satisfaksion, medoemos i ka kushtuar asaj shtrenjtë, pse në prapaskena ka marrë angazhime serioze në favor të zhvillimit të marrëdhënieve me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, u ka dhënë këtyre premtime për qëndrime joagresive ndaj Tajvanit, ndër-sa ky i fundit do të vazhdojë gjendjen e të qenit i pavarur ose do të bëjë osmozën në ato momente që do ta gjejë të përshtatshme klika e Çan Kai Shisë dhe e djalit të tij, kur Kina të jetë tërësisht në duart e Guomindanit dhe të reaksionit kinez. Me fjalë të tjera, kur diktatura kapitaliste të ketë gjetur stabilizim të plotë në Kinë, atëherë çështja e Tajvanit është e zgjidhur, për arsye se regjimi i Çan Kai Shisë e tajvanezët nuk kërkojnë tjetër gjë, përveçse zhdukjen e komunizmit dhe të socializmit dhe vendosjen e kapitalizmit në Kinë. Pra, tash që po vendoset kapitalizmi në këtë vend, diferenca në mes ishullit dhe Kinës kontinentale gradualisht do të zvogëlohet dhe dalngadalë tajvanezët do të marrin në dorë fuqi të mëdha brenda në kontinentin kinez.

Për sa i përket çështjes së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, këto nuk humbasin gjëkafshë përdërisa fituan në Kinën kontinentale, domethënë arritën të likuidonin atje mundësinë e zhvillimit të shoqë-

risë socialiste dhe të siguronin vendosjen e kapitalizmit, të siguronin, pra, mundësinë e penetrimit të influencës së tyre politike, ekonomike dhe ushtarake. Them edhe ushtarake, pse Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë me Japoninë një traktat ushtarak dhe, derisa kjo e fundit lidhi një traktat të miqësisë e të bashkëpunimit me Kinën, prapa krahëve, sigurisht, ka edhe klauzola ose nene të tjera që i lidhin me njëri-tjetrin. Vetë klauzolat e Traktatit Kino-Japonez thonë se që të dyja, Japonia dhe Kina, janë kundër hegjemonizmit të një shteti tjetër (kjo i referohet Bashkimit Sovjetik, pra janë kundër këtij).

Po ashtu Shtetet e Bashkuara me Kinën mund të kenë edhe marrëveshje sekrete ndërmjet tyre. Në qoftë se nuk kanë tash, mund ta bëjnë më vonë një gjë të tillë, kur të shohin se rreziku nga Bashkimi Sovjetik bëhet një kërcënim për to, dhe atëherë do të konsolidohet e do të deklarohet blloku kino-japono-amerikan.

Pra, u realizua ajo çka Niksoni tha publikisht përpara Çu En Lait në banketin zyrtar në Pekin, se Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të përpiqeshin të ndërtonin një urë aq të madhe, saqë të kapërcente Atlantikun nga San-Franciskoja në sheshin Tien An Men. Kjo urë tash u ngrit dhe Karteri ftoi Ten Hsiao Pinin të shkojë në Uashington nga fundi i janarit të vitit 1979. Ky e pranoi këtë «nder të madh» që i bëhet dhe me siguri vajtja e tij në Uashington do të bëjë një bujë të madhe, pse atje do të merren patjetër vendime të rëndësishme për zhvillimin e mëtejshëm të kësaj miqësie të përbindshme kino-amerikane, do të

nënshkruhen traktate e protokolle të hapëta dhe të fshehta.

Të gjitha këto gjëra përbëjnë një kërcënim të madh për paqen në botë dhe rritin synimet e imperia- listëve për rindarjen e botës. Është fakt se, aktualisht, Kina, me veprimet e saj në drejtim të Japonisë, të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të vendeve të tjera kapitaliste të zhvilluara, e ka dobësuar influ- encën e Bashkimit Sovjetik revizionist dhe mund të themi se ky është në rrugën e një izolimi, gjë që e de- tyron të jetë vigjilent dhe të përgatitet intensivisht për luftë në shumë drejtime: në drejtimin evropian, në atë aziatik, por edhe në drejtimin e Lindjes së Mesme. Këto përbëjnë tri fronte kryesore, nga të cilat një mëngjes, papritur, Bashkimit Sovjetik mund t'i vijë rreziku.

Si do ta përballojë ai këtë rrezik? Ky është një problem që duhet vëzhguar. Në ç'mënyrë Bashkimi So- vjetik do t'i vazhdojë aleancat luftarake kundër këtij rrethimi, këtë do ta shohim. Aktualisht konstatojmë se, duke u kristalizuar këto aleanca imperialiste, duke u përgatitur për një luftë të re grabitqare botërore, të gjitha palët po përpiqen që ta evitojnë hëpërhë një konflagracion botëror, derisa edhe njëri, edhe tjetri ta shohin se janë përgatitur si duhet.

Prandaj ekziston kjo periudhë kërcënuese dhe njëkohësisht false për bashkëpunim dhe ulje të ten- sionit. Imperializmi amerikan, që duket se është më i fortë, më i zhdërvjellët në aleanca dhe në ekspan- sionin e tij ekonomik, politik e ushtarak, përpiqet të mos i këputë urat me Bashkimin Sovjetik. Edhe ky, gjithashtu, në këtë situatë përpiqet që me Shtetet e

Bashkuara të Amerikës të arrijë disa rezultate gjoja për uljen e tensionit ose për marrëveshjet SALT-2, të marrë sa më shumë kredi prej tyre dhe nga vendet e tjera aleate të tyre, të zbutë deri diku veprimet e veta kundrejt NATO-s dhe të konsolidojë pozitat e tij ushtarake e politike në gjirin e Traktatit të Varshavës.

Sidoqoftë, këtë mund ta quajmë përsëri një fazë false të detantës, e cila u shërben përgatitjes dhe kristalizimit të mëtejshëm të aleancave e të përgatitjeve për luftë.

Unë mendoj se opinioni botëror e mbivlerëson Ten Hsiao Pinin me grupin e tij dhe ka arritur në përfundimin se ai do ta stabilizojë gjendjen në Kinë, do të bashkojë fraksionet, do të likuadojë kundërshtarët dhe do të ecë deri në njëfarë rruge bashkë me Hua Kuo Fenin, pastaj do ta likuadojë edhe këtë, edhe grupin e tij. Këtë përshtypje të lënë artikujt diplomatikë të gazetave të ndryshme të Evropës, si dhe komentet e agjencive të lajmeve. Po mendimi im është se situata në Kinë nuk është stabilizuar dhe Ten Hsiao Pini nuk është në gjendje ta stabilizojë atë.

Faktet tregojnë se në Kinë, edhe në kohën e Mao Ce Dunit, kur autoriteti i tij ishte i padiskutueshëm, bashkimi i devianistëve dhe uniteti i mendimit nuk ishin arritur kurrë, ata vetëm ishin tulatur. Zaten Mao Ce Duni nuk e lejonte bashkimin e grupeve dhe unitetin e mendimeve në vendin e tij. Ai e kishte parim «lulëzimin e njëqind luleve dhe konkurrimin e njëqind shkollave». Një pikëpamje e tillë filozofike dhe politike do të vazhdojë në Kinë dhe këto «shkolla», në të njëjtën kohë të fuqishme dhe të lëkundshme, në një koniunk-

turë të caktuar mund të bashkohen me Ten Hsiao Pinin, por në një koniunkturë tjetër mund ta braktisin atë dhe të mbështetin kundërshtarët e tij.

Unë jam i bindur se Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe diplomacia e lartë e të gjitha vendeve perëndimore, pavarësisht nga ç'thonë publikisht, e kanë parasysh faktin se Hua Kuo Feni është për vijën aktuale politike të Kinës, por me më shumë prurëncë, kurse Ten Hsiao Pini kërkon shpejtimin e realizimit të kësaj vije imperialiste. Tëni kërkon të realizojë me ngutje planin e Çu En Lait për ta bërë Kinën, medoemos dhe me çdo kusht, një superfuqi të barabartë me imperializmin amerikan dhe me socialimperializmin sovjetik.

Por, në arenën ndërkombëtare dhe në këtë pleksje luftërash për hegjemoni midis botës kapitaliste dhe asaj revizioniste, jo çdo gjë mund të shkojë sipas dëshirës së tri superfuqive. Duke lënë për një çast mënjanë rezistencën dhe luftën e madhe të popujve kundër rrezikut të luftës, kundër dominimit të botës nga këto tri superfuqi imperialiste, në vendet e ndryshme kapitalisto-revizioniste ka edhe tendenca centrifugale, edhe tendenca unifikimi. Për sa u përket tri superfuqive, ato po përpiqen si e si të ruajnë aleatët e vet dhe t'i shtojnë ata, duke ia rrëmbyer njërit ose tjetrit.

Vetë këta «aleatë» me kreun e bllokut të tyre kanë kontradikta të thella, të cilat përbëjnë një stad të dytë që pengon realizimin e qëllimit kryesor të të tre të mëdhenjve. Jo të tërë janë për luftën ndër imperialiste. Disa janë për ruajtjen e statukuosë, pra janë për detantën midis superfuqive, për forcimin e fuqive të tyre ekonomike dhe ushtarake. Brenda në këto aleanca, si në

atë të NATO-s, ashtu edhe në atë të Traktatit të Varshavës, si në Tregun e Përbashkët Evropian, ashtu edhe në KNER, ekzistojnë, pra, kontradikta të theksuara midis aleatëve. Këto kontradikta, duan apo nuk duan imperlallstët amerikanë ose socialimperialistët sovjetikë, duan apo nuk duan gjermanët e Perëndimit, anglezët, francezët, polakët, rumunët, gjermanët e Lindjes, çekoslovakët e bullgarët, po thellohen vazhdimisht. Pikërisht këto kontradikta i thellon tendenca e përgjithshme e dominimit të të mëdhenjve, e shfrytëzimit nga ana e tyre të potencialeve ekonomiko-politike të aleatëve më të dobët në favorin e qëllimeve strategjike të tyre.

Pra do të krijohen fërkime të panumërta e të papritura; do të lindin kundërshtime lokale të armatosura.

Tendenca e Kinës, e kësaj superfuqie që po ngrihet në aleancë me Japoninë dhe me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, është që, duke nënshtuar Vietnamin, Laosin, Kamboxhian, Tajlandën e mundësisht edhe Birmaninë, të zgjerojë influencën e saj ose të krijojë një bllok nën drejtimin e vet. Kjo dëshirë do të hasë në kundërshtimin e këtyre shteteve. Që tash ajo ka hasur në kundërshtimin e Vietnamit. Si pasojë, midis Kinës dhe Vietnamit po ngjasin incidente të përgjakshme. Po kështu midis Vietnamit dhe Kamboxhias po bëhet luftë, kurse Ten Hsiao Pini që brodhi në Tajlandë, në Birmani, në Filipine, në Malajzi e në Singapor, nuk gjeti predispozicionin që shpresonte. Kështu, Japonia nuk punon për Kinën, por për dominimin e saj; punon për zona influence për vete në vendet që përmenda më lart dhe në vende të tjera, si në Australi e më tutje akoma.

Përveç kësaj, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, pavarësisht nga miqësia që po krijohet midis Kinës dhe Japonisë, kanë planet e veta të mëdha strategjike, plane globale, planetare, ashtu siç i ka edhe Bashkimi Sovjetik.

Prandaj nuk është aq e lehtë as për Kinën, as për Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe as për Bashkimin Sovjetik që të mbajnë kurdoherë nën zgjedhën e tyre vende të tilla, si: Indinë, Pakistanin, Birmaninë apo Iranin. Ky grup vendesh ka në krye një borgjezi ende të fuqishme, me konceptet e veta dominuese, me një politikë koniunkturale të sajën për të përfituar sa më shumë sa nga njëri, aq edhe nga shteti tjetër imperialist, por që në të njëjtën kohë, veçanërisht në Indi, borgjezia në fuqi kujdeset që të mos angazhohet deri në grykë me njërin ose me tjetrën superfuqi. Influenca e Indisë, së afërmi e në një moment fuqizimi më të madh të potencialit të saj ekonomik e ushtarak, do të ndihet në gjithë këtë pellg dhe mund të arrijë deri në shtetet e Lindjes së Mesme.

Në vija të përgjithshme, mund të themi se, në situatat aktuale, tymi i bardhë i aleancave ndër imperialiste fsheh rreziqe të mëdha për njerëzimin, për paqen botërore. Tendenca është që këto aleanca të konsolidohen më tej në përgatitjet për shpërthimin e një lufte të madhe botërore. Por ekziston edhe tendenca centrifugale kundër këtyre aleancave dhe, mbi të gjitha, ekzistojnë rezistenca dhe revolta e popujve që kërkojnë çlirim nga zgjedha e kapitalit të brendshëm dhe e hegjemonisë së jashtme, si ajo amerikane, kineze, japoneze, sovjetike apo e ndonjë fuqie tjetër imperialiste.

Ne asistojmë, pra, në një fazë që mund ta quajmë



kruciale, prirja e së cilës është një luftë e tretë botërore. Kjo fazë fillon me konsolidim aleancash të reja për rindarjen e botës nëpërmjet luftërash lokale. Në të njëjtën kohë shohim edhe kundërshtime, bile të rrepta, nga masat e gjera të popujve që luftojnë kundër shtypësve.

Si konkluzion, viti 1978 vërtetoi pikëpamjet e drejta marksiste-leniniste të Partisë sonë të Punës se Kina e Mao Ce Dunit në realitet nuk ndërtonte socializmin; se Partia Komuniste e Kinës nuk ishte një parti marksiste-leniniste, se në Kinë mbretëronin kaosi dhe rrëmuja. Për të vendosur atje kapitalizmin, Hua Kuo Feni dhe Ten Hsiao Pini, në rivalitet e në grindje të heshtura dhe të hapëta me njëri-tjetrin, kanë hyrë në aleanca me kapitalizmin reaksionar botëror, me imperializmin amerikan, me atë japonez dhe të Evropës Perëndimore. Vija e tyre e përgjithshme është që Kina të bëhet një superfuqi imperialiste dhe të kundërshtojë social-imperializmin sovjetik. Udhëheqësit aktualë kinezë po bëhen luftënxitës, kundërrevolucionarë, pseudomarksistë dhe janë aktivë në të gjitha këto drejtime.

Partia jonë e demaskoi këtë vijë, i demaskoi këta njerëz, këto grupime, këtë parti dhe këtë pseudondërtim të socializmit dhe do të vazhdojë edhe paskëtaj të ndjekë me kujdesin më të madh zhvillimin e punës së tyre armiqësore ndaj njerëzimit dhe ndaj marksizëm-leninizimit.

*Marrë nga libri:*

*Enver Hoxha, «Ditar për çështje ndërkombëtare» (botim i brendshëm), nr. 11, f. 526*

# POPUJT DHE PROLETARIATI DUHET TË BËHEN TË VETËDIJSHËM PËR ÇKA PO NGJET NË BOTE

Shënime

21 dhjetor 1978

Siç kam thënë edhe më parë, lidhjet e Kinës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës duhet ta kenë bishtin pas, një bisht të fshehtë. Ne dimë se në komunikatën e Shangait, që u firmos nga Niksoni dhe nga Çu En Lai, thuhet se të dyja këto vende nuk do të luftojnë për hegjemoni. Kjo, natyrisht, nuk është e vërtetë, por një bluf, nga ana e Shteteve të Bashkuara po e po, por edhe nga ana e Kinës. Në atë kohë kinezët i zbukurorin imperialistët amerikanë me lule dhe propagandonin se gjoja ata qenë zbutur dhe s'ishin më agresivë. Më vonë u duk se edhe Kina aspironte për hegjemoni.

Me fjalë të tjera, u bënë përpjekje për të mbuluar diellin me shoshë. Në Traktatin Kino-Japoncz, siç dihet, çështja u përcaktua më tej. U theksua se të dy vendet janë kundër hegjemonizmit, gjë që do të thotë kundër socialimperializmit sovjetik, të cilin Kina e quan shtet imperialist hegjemon.

Pra, aleanca e përfunduar midis Pekinit dhe Tokios drejtohet kundër Bashkimit Sovjetik. Dimë, gjithashtu,

se edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë me Japoninë një marrëveshje «mbrojtjeje» a «paqësore», ose siç e thonë, të bashkëpunimit reciprok, e të tjera e të tjera epitete që u vihen këtyre lloj traktateve. Në fakt marrëveshja amerikano-japoneze është një mburojë e këtyre dy shteteve imperialiste e militariste kundër hegjemonisë së Bashkimit Sovjetik.

Pra, formohet kështu një rreth i mbyllur aleancash, bile edhe ushtarake, midis Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Japonisë dhe Kinës kundër Bashkimit Sovjetik. Këtë gjë fletushka «Pravda» e socialimperialistëve sovjetikë e cilësoi një «NATO të Paqësorit». Dhe në të vërtetë ajo është «NATO»-ja e Paqësorit. Këtu, në mos legalisht, *de facto*, do të bëjnë pjesë edhe Indonezia me Filipinet. Tendenca kino-japono-amerikane është që, përveç bllokut të NATO-s në Evropë, të krijohet edhe një bllok ushtarak kundër Bashkimit Sovjetik në Lindjen e Largme.

Këta e futin, pra, Bashkimin Sovjetik në mes dy fronteve ushtarake imperialisto-hegjemoniste. Sigurisht, Bashkimit Sovjetik i duhet ose të manovrojë ose të futet në një luftë planetare në të dy frontet. Kjo luftë imperialiste i nevojitet Bashkimit Sovjetik, por, që ta fitojë atë, ai duhet të likuideojë sa më parë njërin front për t'iu kthyer pastaj frontit më të rrezikshëm për të. Por aktualisht shohim se Bashkimi Sovjetik, megjithëse tregohet i shqetësuar për çka po ngjet në skakierën e madhe botërore diplomatike midis Shteteve të Bashkuara, NATO-s, Japonisë dhe Kinës kundër tij, në të vërtetë nuk është edhe aq i shqetësuar.

Pse nuk është aq i shqetësuar? Për arsye, mendoj

unë, se e di që Kina në gjendjen që është sot, po u fut në një aventurë me Bashkimin Sovjetik, do të pësojë disfatën më të madhe. Kinës i duhet kohë ta ngrejë nivelin e ushtrisë së saj në atë të një ushtrie moderne që të jetë në gjendje të përballojë ushtrinë e revizionistëve sovjetikë. Kësaj ushtrie i nevojitet të ketë edhe prapavija të qeta e të forta, që aktualisht nuk i ka. Për të realizuar një gjendje të tillë duhet një kohë e gjatë, të paktën 10-15 vjet. Bashkimi Sovjetik gjatë këtyre 10-15 vjetëve, mendoj unë, do të manovrojë për të krijuar në botë sferat e tij të influencës, për të krijuar aleancat e veta e njëkohësisht për të krijuar situata të tilla që aleanca midis Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Kinës të mos forcohet, por të dobësohet.

Duhet të kemi parasysh se flota e Paqësorit e Bashkimit Sovjetik është një flotë detaro-luftarake e fuqishme. Ajo ka baza në Vietnam: në Hajfong e në Sajgon. Në këtë mënyrë ajo bëhet një forcë e rrezikshme edhe për flotën amerikane e për atë japoneze, sepse Kina, aktualisht, nuk ka një flotë të atillë që të jetë në gjendje ta përballojë flotën sovjetike, ndërsa flotat e dy shteteve aleate të Kinës mund të maten me flotën sovjetike, por ndeshja do të jetë e rreptë. Sidoqoftë, nga bazat e Vietnamit flota sovjetike është në gjendje ta godasë Kinën, përveç goditjeve që mund t'i bëjë nga kufiri tjetër i madh në Siberi, në Mongoli dhe në Sinkiang.

Me Traktatin Sovjeto-Vietnamez Laosi ndodhet në sferën sovjetike; Kamboxhia, në rast rreziku, likuidohet përnjëherë, edhe Tajlanda po ashtu. Kështu që rrethimi i Kinës nga ana e Bashkimit Sovjetik nga veriu,

nga lindja dhe nga jugu është i realizueshëm. Dhe në e dimë se Shtetet e Bashkuara të Amerikës asnjëherë nuk do të hyjnë në zjarr për t'ia nxjerrë gështenjat Kinës, por do të orvaten ta vënë këtë në zjarr për t'ua nxjerrë gështenjat Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Edhe në rast të një konflikti midis Kinës e Japonisë nga njëra anë dhe Bashkimit Sovjetik nga ana tjetër, Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të luajnë rolin e spektatorit dhe të ndihmësit, sa të jetë e mundur më *discret*<sup>1</sup> të Kinës, për ta nxitur këtë kundër Bashkimit Sovjetik, në mos për ta thyer, për ta dobësuar.

Por ne shohim se Bashkimi Sovjetik manovron me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ai tregohet sikur marrëveshja kino-amerikane nuk ia dëmton interesat. Kjo është në dukje, sepse në fakt, interesat e tij dëmtohen. Prandaj Bashkimi Sovjetik, duke thënë se marrëveshja ose lidhja e marrëdhënieve diplomatike me Kinën është një gjë e natyrshme, kërkon që Shtetet e Bashkuara të Amerikës të mbajnë qëndrime botërore një çikë më të përcaktuara. Por kurdoherë të mos harrojmë se Shtetet e Bashkuara të Amerikës, duke e njohur Kinën, i bënë asaj një lëshim në lidhje me çështjen e Tajvanit dhe alcatët e tyre panë se për interesat e vet të mëdhenj Shtetet e Bashkuara të Amerikës mund ta braktisin aleatin e tyre, të madh ose të vogël, siç bënë me Tajvanin, megjithëse duhet thënë që në të vërtetë Tajvanin ato nuk e kanë braktisur dhe vetë Kina nuk dëshiron që ta braktisin, por ta ndihmojnë.

Tajvani dhe Kina ecin në një rrugë, në rrugën pro-

---

1. Frëngjisht — i matur, i rezervuar.

amerikane. Kina po borgjezohet; atje po vendoset kapitalizmi, që i ngjan kapitalizmit të Tajvanit. Natyrisht, kur piqen dy xhandarë, ç'muhabete mund të bëjnë? Patjetër që muhabete xhandarësh. Kur piqen dy kapitalistë, çfarë mund të bëjnë? Sigurisht, muhabete dhe marrëveshje kapitalistësh. Kështu që osmoza midis Tajvanit dhe Kinës do të bëhet, në mos sot, nesër, kur në kontinent, domethënë në Kinë, të jenë bërë transformime rrënjësore lidhur me vendosjen e kapitalizmit.

Nga ana tjetër, Tregu i Përbashkët Evropian ose Evropa Perëndimore, shtetet që formojnë këtë «Evropë të Bashkuar», kanë tendencë që të bëjnë një politikë të balancës midis Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik. Aktualisht ky treg nuk rrezikohet drejtpërdrejt nga Bashkimi Sovjetik. Vetë Bashkimi Sovjetik do ta evitojë një gjë të tillë gjatë kësaj periudhe 10-15-vjeçare, kur Kina do të bëjë sforcë të mëdha për t'u armatosur dhe për të ndërëuar një ekonomi ushtarake. Por në të njëjtën kohë do të bëjë orvatje të shumta që ta shfrytëzojë në favorin e tij situatën e turbullt dhe të pastabllë të Kinës.

Duhet të mendojmë se stabilizimi i situatës së brendshme në Kinë do të jetë mjaft i vështirë. E para, për arsye ekonomike, pse Kina po zhvillohet drejt një ekonomie kapitaliste ushtarake dhe kjo nuk do ta përmirësojë gjendjen ekonomike dhe as atë politike të vendit. Pastaj në Kinë, siç e dimë, gjatë gjithë periudhave është zhvilluar një kapitalizëm me shumë fytyra, kaotik, me maska të ndryshme, me maska të çala dhe me një ideologji të bastarduar, gjë që ka lejuar «të lulëzojnë njëqind lule dhe të konkurrojnë njëqind

shkolla». Pra, këto «njëqind shkolla» gjatë kësaj periudhë tranzitore do të vazhdojnë të konkurrojnë dhe të hyjnë midis tyre në konflikte politike, ekonomike dhe për pushtet, pse çështja e pushtetit në Kinë nuk është vendosur. Klika të ndryshme, si ajo e Ten Hsiao Pinit dhe e Hua Kuo Fenit, aspirojnë ta shtien atë në dorë. Por, përveç këtyre, atje rrojnë edhe elementët e shëndoshë marksistë-leninistë, të cilët do ta shohin edhe vijën antimarksiste të Maos, edhe vijën reaksionare kapitaliste të këtyre që janë aktualisht në fuqi dhe, në një kaos të tillë, edhe këta do të përpiqen të konsolidojnë pozitën e tyre në revolucion. Ata do të shohin njëkohësisht edhe gjendjen shumë të rrezikshme në të cilën e kanë futur Kinën e tyre klika aktuale e Hua Kuo Fenit dhe e Ten Hsiao Pinit, domethënë në hallkat dhe në zinxhirët e imperializmit amerikan, të Japonisë militariste dhe të kapitalizmit, botëror, në një konflagracion të mundshëm edhe me një imperializëm tjetër të madh e të rrezikshëm, siç është Bashkimi Sovjetik. Me fjalë të tjera, në Kinë, në mes të «njëqind shkollave», mund të jetë edhe shkolla marksiste-leniniste, e cila, në rrugë të drejtë mund të fitojë terren dhe mund të kristalizohet një gjendje e shëndoshë, e cila me kohë të marrë përpjesëtime të gjera.

E gjithë kjo situatë do të bëjë që të përfitojnë amerikanët dhe reaksioni i brendshëm kinez, por edhe Bashkimin Sovjetik do ta çojë në kërkim alcancash aktuale, që do të ndiqet me transformime në alcanca më konkrete imperialiste e socialimperialiste. Në këtë mënyrë do të shtohen kontradiktat midis të gjitha

këtyre shteteve që vijnë rrotull në vorbullën e planetit për të vendosur hegjemoninë e vet.

Pikërisht në këto situata klasa punëtore, e udhëhequr nga partitë e vërteta marksiste-leniniste, duhet të luajë një rol vendimtar. Është momenti i revolucioneve proletare, është periudha e kalbëzimit të imperia- lizmit, i cili është dobësuar nga të katër anët dhe goditet, gjithashtu, ku më shumë e ku më pak, nga të katër anët, nga forca e proletariatit, nga forca e popuj- ve që e gërryen dhe e dobëson. Kjo gërryerje e ky dobë- sim do të vijnë duke u shtuar dhe do të vërtetohet teza e Leninist se epoka aktuale është epoka e revolucioneve proletare.

Natyrisht, këto revolucione proletare nuk do të bëhen me një të rënë të trumbelës, por në bazë të situa- tave që do të krijohen, në bazë të rrethanave të çdo vendi në veçanti, dhe në botë, në përgjithësi. Vetëm se proletariati dhe popujt duhet të bëhen të vetëdij- shëm për çka po ngjet; t'i kuptojnë mirë situatat e gjendjen politike, dhe të edukohen që brenda këtyre situatave në zhvillim të marrin rrugën e ndërgjegj- shme për çlirimin e tyre. Me fjalë të tjera, të përga- titen për revolucionin.

Natyrisht, përgatitja për revolucion, nuk është diçka e lehtë, por një luftë e vazhdueshme me zigzage, me disfata e me fitore.

*Marrë nga libri:*

*Enver Hoxha, «Ditar për çë- shtje ndërkombëtare» (Botim i brendshëm), nr. 11, f. 545*



# RRETH NGJARJEVE NË SHESHIN TIEN AN MEN

## Shënime

26 dhjetor 1978

Sikurse bën të ditur agjencia HSINHUA, më 21 dhjetor gazeta «Zhenminzhibao» botoi një artikull me titull «Rroftë populli!», të shkruar nga një komentator që ishte «ftuar» në zyrat e redaksisë së gazetës.

Ky është fillimi i gënjeshtërs, pse komentatori «i ftuar» që shkruan një artikull të tillë, me siguri është një nga udhëheqësit kryesorë, në mos përfaqëson një grup udhëheqësish. Artikulli kërkon «të vërtetojë» ngjarjet historike, të cilat përpiqet «t'i vërë» në vendin e duhur dhe t'u japë rëndësinë që «meritojnë». Këtu çështja është për ngjarjet e prillit 1976 në sheshin Tien An Men. Sipas këtij artikulli, «zbulimi i së vërtetës rreth ngjarjeve të sheshit Tien An Men është një provë e ligjit të pakundërshtueshëm se e vërteta nuk mund të fshihet kurrë».

Pra, e vërteta në këtë rast është se *l'éméute*<sup>1</sup> e Tien An Menit ditën e dëshmorëve dhe ditën e përvjetorit të vdekjes së Çu En Lait, qenka, siç thotë artikuli-

---

1. Frëngjisht — trazira.

lli, një «veprim i madh masiv revolucionar që hodhi shkëlqimin e tij në gjithë Kinën» dhe se kjo ngjarje është «burim krenarie për kombin kinez, një ngjarje heroike në historinë e socializmit dhe një monument i pavdekshëm në historinë e popullit kinez»; bile «ajo do të mbetet në histori së bashku me poemat emocionante revolucionare që u përhapën në të gjithë vendin».

Rrëmuja e Tien An Menit ishte një «luftë për jetë a për vdekje» për Kinën dhe, sipas këtij myteberi, fitoi jeta, pse u zhvilluan ngjarje revolucionare, të cilave tashti u është vënë titulli «Lëvizja e 5 prillit». Kjo «nuk ishte diçka e rastit», na thotë komentatori që nga zyrat e «Zhenminzhibaos», por ishte një «iniciativë e madhe e ndërmarrë nga miliona revolucionarë». Pra këtu, si të thuash, nuk paska gisht Ten Hsiao Pini.

Në të vërtetë ngjarjet e Tien An Menit me siguri të plotë ishin organizuar nga klika e Ten Hsiao Pinit. Demonstruesit shkuan në Tien An Men në heshtje, pse ishte dita e dëshmorëve dhe, në qoftë se ata rezistuan, kjo i përngjiste rezistencës gandiste, domethënë ishte pasive. Kjo rezistencë pasive e këtyre mijëra vetave dhe jo milionave, siç thotë komentatori, do të kalonte në heshtje nëse elementët që ishin në fuqi në atë kohë, Hua Kuo Feni, Van Hun Veni e të tjerë do të kishin ruajtur gjakftohtësinë.

Pra, si ata që ishin në fuqi, si ata që e organizuan këtë trazirë, kishin qëllime puçiste dhe ky mund të quhet vetëm veprim puçist e asgjë tjetër. Kur quhet «trazirë» një marshim i heshtur i 10, 20 apo 100 mijë vetave në Tien An Men, ç'mund të quhen lëvizjet e

masave popullore në Iran, që prej tre muajsh me radhë, ditë për ditë, po dalin nëpër rrugë, përleshën me ushtrinë e shahinshahut, gjakosen, arrestohen dhe vriten?

Kina këto përleshje të përgjakshme të popullit iranian, në të gjitha qytetet dhe jo vetëm në Teheran, as që i përmend fare. Përkundrazi, ajo merr në mbrojtje shahun dhe veprimet e përgjakshme të ushtrisë dhe të SAVAK-ut të shahut. Pra, për revolucionin në Kinë ka dy kuptime: trazira quhet revolucion, ndërsa revolucion kundër shahinshahut, këtij mbreti feudal, quhet «mungesë rregulli e disipline». Njerëzit që sundojnë sot në Kinë nuk kanë asnjë fije gjykim marksist.

Që t'i japin kësaj ngjarjeje ngjyrën e fillimit të një revolucioni tjetër të madh, që është quajtur revolucion i «katër modernizimeve», natyrisht, këta renegatë të marksizëm-leninizmit teorizojnë, duke thënë se «lëvizjet e mëdha politike i kanë rrënjët në jetën ekonomike dhe politike të shoqërisë dhe kërkesat shoqërore janë shkaqet e tyre». Me këtë zotërinjtë kinezë duan të vërtetojnë se prapa rrëmujës që u krijua në sheshin Tien An Men, nuk është dora e Ten Hsiao Pinjt dhe e bandës së tij, por qenkej «vullneti i shprehur i popullit».

Këta udhëheqës revizionistë e kapitalistë thonë se kaloi ajo kohë kur në Kinë revolucionin shpërthente, «pse ashtu donin disa agjitorë». Revolucionin, bëjnë demagogji ata, e shpërthen shoqëria. Dhe, për ta ilustruar këtë, ata bëjnë përpjekje që thënie të Marksit e të Engelsit t'i shkëputin nga konteksti, t'i cungojnë e t'ua përshtatin arbitrarisht puçit dhe intrigave të një bande renegatësh antimarksistë që kërkojnë të konsolidojnë pushtetin e tyre të dalë nga puçi ushtarak. Sipas tyre

likuidimi i «katërshes», likuidimi i Lin Biaos, që akuzohen se ia kanë sjellë të gjitha këto fatkeqësi Kinës, qenkan bërë me vullnetin e popullit dhe jo «me një të goditur», ashtu siç e paraqesin Hua Kuo Feni dhe Ten Hsiao Pini. Këta njerëz u likuiduan pikërisht me një të goditur dhe s'është aspak e vërtetë se ata i rrëzoi populli që u ngrit. Përkundrazi, deri në njëfarë shkalle, nga ana e jashtme, një gjëje të tillë mund t'i përshtatet Revolucioni Kulturor, gjatë të cilit Maoja u bëri thirrje miliona studentëve e nxënësve, të cilët u ngritën dhe sulmuan shtabet, sulmuan partinë dhe e likuiduan.

Edhe Revolucioni Kulturor ishte një aksion i ngritur përsëri nga agjitorët, prapa të cilëve, në fakt, qëndronte Maoja, por në rrugë jo të drejtë, pse atakoheshin partia dhe proletariati. Në pamje të jashtme ky edhe mund të quhej një «revolucion», por jo puçi i Hua Kuo Fenit dhe as lëvizja e Tien An Menit.

Mua më duket se grupi i «të katërve», siç e theksojnë edhe këta që janë sot në fuqi, e cilësoi veprimin masiv në sheshin Tien An Men si një incident politik kundërrevolucionar. Ky ka qenë një gjykim i drejtë, më serioz dhe ka një bazë. Por vetëm me këtë kuptim që u dha «katërshja» këtyre ngjarjeve, Ten Hsiao Pini dhe banda e tij nuk habiten. «Në qoftë se ata, — thotë banda e Ten Hsiao Pinit, — nuk do ta kishin zakon të shtrembëronin historinë në këtë mënyrë, ata nuk do të ishin bërë objekt i sulmeve të kësaj lëvizjeje dhe nuk do të ishin sjellë në mënyrë gjakatare, duke mashtruar popullin dhe duke shkaktuar gjakderdhje».

Nuk mungojnë të bëhen edhe disa përjashtime të heshtura, pse në krye të organizimit të shtypjes së për-

gjakshme të këtij incidenti që thonë ata, ka qenë edhe vetë Hua Kuo Feni, tash kryetar i partisë, i cili tok me shokët e vet të atëhershëm, «të katërshes», duke vepruar nën flamurin e direktivat e Maos dhe duke u bazuar në shkrimet e tij, nxori milicinë. Edhe aktualisht çdo gjë bëhet duke u bazuar në shkrimet e Maos.

Pra, «Zhenminzhibaoja» thotë se «thelbi i ngjarjeve të sheshit Tien An Men ishte vajtimi për kryetarin e Këshillit të Shtetit, Çu En Lain dhe kundërshtimi ndaj bandës së të katërve». Kjo do të thotë se sheshi Tien An Men, sipas Ten Hsiao Pinit dhe Hua Kuo Fenit, u kthye në murin e lotëve të Jerusalemit, ku në ditën e të vdekurve njerëzit venë e murmuritin lutje për Mesinë, rrëfihen për fatkeqësitë që u kanë ndodhur dhe kërkojnë shërimin e plagëve shpirtërore nga forca hyjnore e perëndisë. Edhe ngjarjet e sheshit Tien An Men i përngjajnë «revolucionit gandist», «revolucionit të heshtur».

Ky artikull vë në dukje se populli 800 milionësh kinez gjatë Revolucionit Kulturor kishte fituar eksperiencë të madhe për të bërë revolucion. Mirëpo autori harron që këtë Revolucion Kulturor, të udhëhequr nga Mao Ce Duni, e bënë nxënës e studentë, të cilët marshonin drejt Pekinit dhe qendrave të qyteteve të tjera të Kinës duke hedhur slogane për shkatërrimin e grupit revizionist të Liu Shao Çisë dhe të Ten Hsiao Pinit, për të likuiduar partinë, për të likuiduar të gjitha organizatat e masave.

Kjo ngjarje e heshtur në sheshin Tien An Men, thuhet në artikullin e «Zhenminzhibaos» përfaqësonte vullnetin e madh revolucionar të popullit. Njerëzit shkonin atje për të nderuar «birin e madh» të Kinës që për-

faqësonte «të gjitha të mirat» e popullit kinez, që nga cilësitë e karakterit, të vullnetit, të qetësisë, të besnikërisë, të guximit etj., etj. Artikullshkruesi nuk harron të vërë në dukje që Çu En Lai, kur u sëmur rëndë, thirri pranë tij Ten Hsiao Pinin dhe e ngarkoi atë me punë në Komitetin Qendror, që bashkë me njerëzit e tij «të zbatonin vijën revolucionare» të shokut Mao Ce Dun, pavarësisht se ky e kishte quajtur Ten Hsiao Pinin revizionist dhe e kishte dënuar, së bashku me grupin e tij, të zbatonin «mësimet e Maos» e të studionin teorinë marksiste-leniniste, rekomandim, të cilin vetë Mao Ce Duni s'e ka bërë kurrë; «të sigurojë stabilitet dhe unitet», që ai, gjithashtu, s'e ka bërë kurrë vetë dhe «të çojnë përpara ekonominë kombëtare», gjë që nuk e kanë zbatuar as Maoja, as Çu En Lai. Ky i fundit, tok me Li Hsien Nicnin, kanë qenë artizanët kryesorë të ekonomisë në Kinë. Maoja ka mbretëruar si diktator; ai bënte siç mendonte vetë. Nga një politikë e tillë Kina mbeti pas dhe fajin nuk e ka «katërshja», por Mao Ce Duni, Çu En Lai dhe pasuesit e tyre.

Pra, grupi i ri i Hua Kuo Fenit dhe ai i Ten Hsiao Pinit duhet t'i gjejnë një arsye, një ilaç, një gënjeshtër kësaj fatkeqësie të madhe që i ndodhi Kinës dhe, për këtë, e gjetën «kokën e turkut»: Lin Biaon dhe «katërshen». Unë nuk them se këta të fundit kanë qenë njerëz të mirë, por, në radhë të parë, s'ka qenë i mirë vetë Mao Ce Duni, pse të gjithë këta punonin nën drejtimin e Maos dhe ishte ky që goditi edhe Kao Ganin, edhe Pin De Huanë, edhe Pen Çnin, edhe Ten Hsiao Pinin, edhe Liu Shao Çinë, dhe të gjithë ata që sot po rehabilitohen.

Po a tha ndonjë fjalë Ten Hsiao Pini kur bëri pagnegjirikun e Pin De Huasë me rastin e rehabilitimit të tij? Ai e ngriti atë në qiell, por nuk tha asnjë fjalë përse ky, Pin De Huaja, u dënua dhe u hoq. Vetëm në të kaluar e sipër tha se ishte dënuar e hequr nga intrigat e Lin Biaos. Po përse nga intrigat e Lin Biaos? Atë e hodhi tej Mao Ce Duni në mënyrë jomarksiste e mund të themi, në mënyrë brutale, duke ushtruar pushtetin e tij të pakufishëm personal. Sot interesat e Huasë e të Tenit kërkojnë që ata të mos i përmendin këto gjëra dhe të gjitha fajet e Çu En Lait e të Mao Ce Dunit t'ua hedhin vetëm «katërshes» dhe Lin Biaos, të cilët nuk ishin më të mirë se këta, por ishin të një stofi, të një stofi të vjetër, të ngrënë nga minjtë.

Kinezët nuk harrojnë të thonë se gjatë Revolucionit Kulturor ka pasur edhe njerëz të mirë që nuk i dinin qëllimet e këqija të «bandës së të katërve», që u mashtruan, dhe kështu, sipas tyre, u krijua «një rrymë e kundërt në revolucionin e madh proletar», i cili, thonë këta, ishte në rregull, po «i shkaktoi vuajtje popullit kinez», pse, kuptohet, goditi bandën reaksionare kapitaliste të Liu Shao Çisë e të Ten Hsiao Pinit me shokë.

Populli, thonë këta myteberë, vuajti shumë gjatë Revolucionit Kulturor. Natyrisht, populli kinez vuajti dhe nuk rronte në parajsë, por fajin nuk e kishte vetëm «katërshja». Fajin kryesor e kishin Mao Ce Duni me vjën e tij antimarksiste dhe gjithë partia, e cila udhëhiqej nga kjo vjër që nuk e bëri kurrë popullin të ecte në rrugën e vërtetë të socializmit dhe të rregullonte pak a shumë më mirë dhe progresivisht të ardhmen e tij.

Artikulli i «Zhenminzhibaos», natyrisht, nuk mun-

gon të vërë në dukje se të gjithë ata që u akuzuan si armiq të klasës punëtore, si autoritete reaksionare etj., u persekutuan. Pra, gjithë veprimtaria gjatë Revolucionit Kulturor ishte vepër e «katërshes». Ajo, në kohën e saj, persekutoi popullin, «mijëra njerëz akuzoheshin, arrestoheshin, burgoseshin e torturoheshin pa të drejtë».

Vihet re i njëjti stil që përdori Hrushovi kundër Stalinit. Vepra e Hrushovit, pra, nuk shkoi dëm. Tash ajo nga revizionistët është ngritur në parim. Në Kinë, si një «arsye» e shëndoshë kundër grupit të «të katërve», përdoret akuza se ishte ajo që i sollti fatkeqësinë popullit kinez, ndërsa tash, «për të mirën e tij», erdhi në fuqi banda e Ten Hsiao Pinit, «e njeriut të vitit», siç e quajti shtypi amerikan, dhe ky do ta çojë Kinën në socializëm! Si do ta çojë? Natyrisht, thonë renegatët kinezë, «në rrugën e Marksit, Engelsit, Leninit, Stalinit dhe të Mao Ce Dunit». Këtë të fundit ata nuk e harrojnë, sido që të gjithë janë kundër tij dhe s'bëjnë keq që janë kundër, pse Mao Ce Duni kurrë nuk ka qenë marksist dhe nuk mund të vihet kurrë krahas katër klasikëve. Mund të themi se Mao Ce Duni nuk ishte kaq reaksionar, siç janë këta të sotmit. Ai ishte një demokrat borgjez revolucionar që nuk zbatonte parimet e marksizmit dhe gjithçka që ngjau nuk shkoi në rrugën e ndërtimit të socializmit.

Me një tiradë të madhe, propagandisti i zellshëm i «Zhenminzhibaos», duke përdorur fraza dhe slogane marksiste që shërbejnë për të fshehur synimet revizioniste e kapitaliste, na përshkruan qëllimin e revolucionit socialist. Ai përdor fraza të tilla si: «në vendet



socialiste popujt janë zot»; «demokracia socialiste është demokracia më e gjerë dhe nuk mund të gjendet në asnjë vend borgjez»; «socializmi mund të arrihet vetëm kur ekziston udhëheqja e proletariatit (që në Kinë nuk ka ekzistuar kurrë) dhe pararoja e saj» (që edhe kjo në Kinë nuk ka ekzistuar kurrë, por ka ekzistuar dhe vazhdon të ekzistojë pushteti personal). Në fakt, në Kinë ka një parti që quhet komuniste, por që nuk është aspak komuniste.

Në artikull «katërshja» akuzohet se mbante lidhje me borgjezinë brenda në parti. **Ekzistenca e borgjezisë brenda në Partinë Komuniste të Kinës është një e vërtetë e madhe.** Në fakt borgjezia brenda partisë ishte pjellë e Mao Ce Dunit, së cilës ai vetë me teorinë e tij të «dy vijave» e «të lulëzimit të njëqind luleve» dhe «të konkurrimit të njëqind shkollave», i kishte krijuar mundësi të vegjetonte dhe të drejtonte në parti. Kur kjo bëhej e rrezikshme për personin dhe për pushtetin e tij personal Maoja e likuidonte dhe jo me dorën e tij, por me të atyre që komandonte, që i bindeshin e që i gënjente. Në mes tyre kanë qenë edhe «katërshja», edhe Çu En Lai, por kanë qenë edhe miliona njerëz të tjerë që ndiqnin vijën e Mao Ce Dunit, sepse mendonin që kjo ishte një vijë marksiste-leniniste.

Në artikull thuhet edhe një *enormitet* i madh, se «socializmi bazohet në gjithë eksperiencën e kulturës kapitaliste». Pra, për Ten Hsiao Pinin kultura kapitaliste është çdo gjë, prandaj kjo duhet të inkuadrohet edhe në socializëm. Artikulli nuk bën asnjë dallim në kulturën kapitaliste, bile rrënjët e realizmit socialist i gjen pikërisht në këtë kulturë, pra në mentalitetin, në

qëllimet e kapitalit e të kapitalistit, sepse dihet që kultura kapitaliste i shërben një rendi tjetër krejt të ndryshëm nga ai socialist. Në kulturën kapitaliste, natyrisht, ka disa gjëra përparimtare, që duhet medoemos t'i shikojmë me sy kritik, dhe kultura socialiste t'i adaptojë, në qoftë se janë për të adaptuar, por në asnjë mënyrë nuk mund të merret gjithçka prej saj e ashtu siç është. Kurse demagogët, për të cilët e kam fjalën, nga zelli i madh që u ka hipur, harrojnë të fshehin ndjenjat e veta kapitaliste dhe padashur zbulojnë të vërtetën, duke nxjerrë «xhevahire» të tilla në shkrimet e tyre.

Vetë Ten Hsiao Pini ka pohuar dikur se ka qenë një ruajallst, një njeri që mbronte feudalizmin, kurse tash është kthyer dhe akuzon «katërshen» se të gjitha këto të këqija, siç janë akuzat e padrejta kundër njerëzve të pafajshëm, implikimi në fajësi jo vetëm i viktimave, por edhe i të afërmeve të tyre, i fëmijëve dhe i të njohurve të tyre etj., etj., bien erë feudalizëm.

Artikulli i «Zhenminzhibaos» pretendon se në kohën e «katërshes» punëtorët, fshatarët, ushtarët, intelektualët, që ishin të shtypur, menduan përgjigjen që duhej të jepnin, «me anë të një procesi të thellë krahasimi». «Ata, — sipas artikullit, — kuptuan se vija e «bandës» ishte feudalizëm me maskë socialiste, kuptuan se «katërshja» mbante lart flamurin e kuq, duke pretenduar se ishte e majtë dhe revolucionare, ndërsa në fakt ishte shtypëso e popullit». Autorët e artikullit harrojnë se ata nuk kuptuan asgjë dhe as nuk e morën mundimin ta kundërshtonin «katërshen» dhe ta denonconin atë si një klikë feudalësh, me Mao Ce Dunin në krye, perandorin e tyre.

Pastaj «Zhenminzhibaoja» dhe komentatori i saj «i ftuar» vënë pyetjen: «Ç'do të ndodhë në Kinë? A do të ecë Kina triumfalisht drejt qëllimit të katër modernizimeve të parashtruar nga Partia Komuniste e Kinës dhe udhëheqësi i saj, shoku Mao Ce Dun (megjithëse ai s'i ka përcaktuar asnjëherë «katër modernizimet»), apo do të lejohet banda e të katërve të shkatërrojë çështjen e revolucionit dhe ta kthejë Kinën socialiste në një humnerë gjysmëfeudale dhe gjysmëkoloniale?». Dhe japin përgjigjen se, sigurisht, Kina do të ecë drejt një revolucioni tjetër të madh, revolucionit të «katër modernizimeve». Sipas tyre, i tërë populli kinez e ka kuptuar tradhtinë e «katërshes» dhe «rrugën e drejtë marksiste-leniniste» të udhëheqjes aktuale. Ja ç'thonë: «Ky ishte problemi që shqetësonte të 800 milionë banorët e Kinës. Pa dyshim, Partia dhe populli ynë nuk do ta lejonin kurrë një regres të tillë. Nuk mund të kishte përgjigje tjetër ndaj bandës kundërrevolucionare të të katërve, përveçse revolucionit fitimtar në shkallë kombëtare. Ky ishte përfundimi në të cilin arriti populli në këto kushte të vështira».

Ç'frazë bombastike dhe të gënjeshtërt!

Në artikull, thuhet se populli kinez do që më parë të fitojë revolucionin, socializmin në Kinë dhe pastaj revolucionin i madh botëror dhe ai do të kontribuojë për këtë. Në realitet as grupi i «të katërve», as Mao Ce Duni, as udhëheqja aktuale nuk kanë menduar e nuk mendojnë as për revolucionin në Kinë, pale për revolucionin botëror!

Artikulli kthehet përsëri te ngjarja e sheshit Tien An Men dhe e quan atë «gur vendimtar në histori» dhe

jo vetëm në historinë e Kinës, por gjatë festivalit të Cingmingut, më 1976, ai «u bë edhe një herë qendër e vëmendjes botërore». Pra del se Tien An Meni na qenka qendra e vëmendjes botërore, kërthiza e botës dhe Kina «Perandoria e mesit», perandoria në mes të perandorisë amerikane dhe asaj sovjetike. Me këtë përcaktim, «duke hedhur parulla revolucionare e duke kënduar Internacionalen në sheshin Tien An Men, populli i Pekinit, si dhe gjithë populli kinez», as më pak e as më shumë, «shprehën kërkesat dhe dëshirat e tyre, vullnetin dhe forcën e tyre si krijues të historisë, të cilët nuk mund t'i ndalte askush».

Ky «komentator» i «Zhenminzhibaos» thotë se «veprimtaria e bandës së të katërve gjatë një dekade ka krijuar dy kategori njerëzish në jetën politike të Kinës. Nga njëra anë qëndron një grup njerëzish që janë turpi i kombit, anëtarë të fraksionit kundërrivolucionar të bandës, dhe, nga ana tjetër, qëndrojnë revolucionarët, njerëzit e mirë», Ten Hsiao Pini dhe banda e tij, ose më mirë «lëvizja e madhe revolucionare masive, e cila ishte shprehje e aspiratave të partisë, të ushtrisë e të popullit, të mençurisë së popullit, të talentit të tij» etj., etj. (Këtë popull as nuk e peshojnë fare këta njerëz dhe ata që humbën davanë.)

«Banda e të katërve, — thotë artikulli, — kishte punuar me mjaft marifet sa që kishte uzurpuar poste drejtuese në parti dhe në shtet, pra edhe në Komitetin Qendror të Partisë të kryesuar nga shoku Mao Ce Dun». Kjo do të thotë se Mao Ce Duni ishte një leckë që s'peshonte fare, që hiqej prej hunde nga kush të vinte në fuqi. Kur lshin në fuqi njerëzit e «katërshes», e tërhiqnin

ata nga hunda, kur ishte Liu Shao Çia, e tërhiqte ai, por kurdoherë «Mao Ce Duni ishte frymëzuesi i madh i të gjitha luftërave të mira për socializmin». Këto janë absurditete, janë kontradikta që nuk hahen.

Por, thotë artikullshkruesi, «populli nuk u kushtoi vëmendje urdhrave të bandës, veproi kundër udhëzimeve të saj për çdo gjë». Kjo s'është e vërtetë. Populli iu bind që ç'ke me të grupit të «të katërve» ose të të pestëve, me Mao Ce Dunin në krye, ose të të gjashtëve, edhe me Lin Biaon në mes. «Autokratët fashistë që mendonin se pushteti është gjithçka, nuk kishin çfarë të bënin», thotë zëdhënësi i revizionistëve kinezë. «Ata nuk pranuan të lejonin popullin të vajtonte për kryetarin e Këshillit të Shtetit», por lejuan që «katërshja» për 10-15 vjet me radhë të sundonte në Kinë.

Shiko ç'barazime po bëjnë: Armiku, thonë ata, dhe dinë të përdorin fraza, «hyri si krimbi në zemër të partisë dhe të shtetit» dhe «lufta nën diktaturën e proletariatit u bë shumë e komplikuar». Por në fakt ajo nuk u bë «shumë e komplikuar», ose aspak e komplikuar, për arsye se në Kinë nuk ekzistonte diktatura e proletariatit, por një diktaturë personale, një diktaturë borgjeze kapitaliste, ku kishte njëqind rryma që luftonin midis tyre për të marrë pushtetin. Pra, krimbi kishte hyrë me kohë brenda në parti dhe në pushtet.

«Në veprimin e masave revolucionare në sheshin Tien An Men, thotë ky myteber, revolucionarët e vjetër proletarë (domethënë të gjithë kundërrevolucionarët që u rehabilituan), e treguan veten të denjë për besimin e madh që ka për ta populli dhe meriton të mbahet parasysh se një grup punëtorësh të rinj qëndruan

në pararojë të luftës revolucionare, dhe ishin pararoja më e guximshme dhe më e vendosur». Në fakt, këta krerë të reaksionit, këta «revolucionarë të vjetër», as që u ndodhën fare në radhët e para të asaj demonstrate të heshtur në sheshin Tien An Men, as nuk lëshuan ndonjë lot për Çu En Lain. Vetë Ten Hsiao Pini ishte fshehur si një mi dhe, në vend që të dilte të luftonte edhe ai, u jepte urdhra njerëzve të tij si të vepronin. Kështu skenari rregullohet: «Banda e të katërve e gjeti veten të rrethuar nga i gjithë kombi dhe përdori dhunën kundërrevolucionare në shtypjen brutale të masave të paarmatosura»; dhe në këtë mënyrë ajo u çarmatos me një të goditur të zotit Hua Kuo Fen.

Pra, për këta renegatë lëvizja masive, gjoja revolucionare, në sheshin Tien An Men «hapi një faqe të re në histori, fillimin e periudhës së re të zhvillimit të revolucionit socialist dhe të ndërtimit socialist në Kinë». Pra, çka ishte bërë përpara, nuk ishte as fillimi, as mbarimi i revolucionit socialist. Këtë e pohojnë edhe vetë, natyrisht, për të ngritur kauzën e tyre. Por kauza e tyre është po aq e krimbur, sa dhe kauza e Mao Ce Dunit.

Dhe përsëri, për të mbështetur tezën e tyre të «katër modernizimeve», autorët e artikullit thonë se duhen lënë mënjanë politika dhe ideologjia. Për këtë më parë kanë folur Ten Hsiao Pini e të tjerë. Bile çështjen e vënë në gojë të Mao Ce Dunit, i cili, thonë ata, «i ka bërë thirrje herë pas here partisë ta kalojë theksin e saj nga lufta e stuhishme klasore e periudhës revolucionare, në prodhim e ndërtim dhe të dallojë e të zgjidhë drejt dy tipat e kontradiktave të ndryshme, për sa i përket natyrës së tyre, me qëllim që të bashkojë popullin e të

gjitha kombësive të vendit për një betejë të re, betejën kundër natyrës, për zhvillimin e ekonomisë dhe të kulturës sonë, për të ndihmuar gjithë kombin që ta kalojë këtë periudhë kalimtare relativisht lehtë, për të konsoliduar sistemin tonë të ri dhe për të ndërtuar shtetin tonë të ri».

Kjo është porosia e Maos, të cilën që nga Çu En Lai, Ten Hsiao Pini, Liu Shao Çia, Pin De Huaja, Lin Biaoja e deri te këta që kanë ardhur në fuqi nuk e kanë vënë kurrë në zbatim, por tash që filloi kjo «periudhë e re e zhvillimit të socializmit», do ta zbatojnë.

Me këtë ata nxjerrin konkluzionin se «për arsye të ndryshme, ky ndryshim historik nga konsiderimi i lëvizjes politike si detyra qendrore në konsiderimin e zgjerimit të prodhimit si detyra qendrore, nuk është vënë me të vërtetë në jetë që prej më se 20 vjetësh. Ne kemi pësuar humbje të rënda për shkak të kësaj. Nuk u prek rëndë vetëm shpejtimi i zhvillimit të ekonomisë kombëtare dhe përmirësimi i nivelit të jetesës së popullit, por dhe konsolidimi i diktaturës së proletariatit dhe përmirësimi i sistemit politik në ekonominë socialiste. Kjo u ndie shumë në popull».

Ky është një konkluzion kritik, që këta njerëz i bëjnë vijës së Mao Ce Dunit. Kjo, në fakt, është e vërtetë, sepse vija e Maos lëkundej nga njëri drejtim në tjetrin, nga drejtimi politik në atë ekonomik dhe nuk përqendrohej as te politika, as tek ekonomia, nuk i vinte ato në raport të drejtë me njëri-n tjetrin, nuk vihej partia në drejtim, në udhëheqje. Këta që janë sot në fuqi në Kinë pretendojnë se do ta rregullojnë situatën. Por po këta njerëz, kur kanë qënë edhe më parë

në fuqi, vepruan ashtu siç ka vepruar edhe Maoja. Të gjithë ata udhëhiqeshin nga pikëpamjet e Mao Ce Dunit dhe ky i likuidoi se nuk u bindeshin si duhej direktivave të tij. Këta donin që Kina të shkonte më me revan në rrugën kapitaliste, gjë që e ka thënë haptazi Liu Shao Çia në Kongresin e 8-të të Partisë Komuniste të Kinës. Edhe më vonë, e derisa vdiq, Mao Ce Duni e ka aprovuar këtë vijë, që i ka shkaktuar fatkeqësi të mëdha popullit kinez.

Por, siç thuhet sot, doli shpëtimtari Çu En Lai, i cili foli në kongres dhe në Asamblenë Kombëtare për «katër modernizimet», që do ta kthenin Kinën në fund të shekullit tonë në një fuqi të madhe. «Tashti, — thotë artikullshkruesi, — që kemi shpërrur bandën e të katërve (por kjo «bandë e të katërve» është 600 milionë, se po të ishte puna për 4 veta, çdo gjë do të ishte rregulluar me kohë dhe përfundimisht), burimet e popullit dhe të vendit tonë do të jenë në gjendje të arrijnë me shpejtësi këtë ndryshim të madh historik (që ka caktuar Çu En Lai) dhe populli ynë do të tregojë zotësinë e tij për këtë zhvillim, se është ai që e bën historinë dhe se kjo histori do të jetë e gjerë, më e pasur, më e guximshme, dhe më e freskët, më e ndërgegjeshme dhe në mënyrë më të planifikuar e më sistematike».

Me fjalë të tjera, «ju kinezë, — thonë ata, — kini besim tek ekipi i ri që ka ardhur dhe sundon në Kinë. Ne jemi besnikë të Marksit, të Engelsit, të Leninit, të Stalinit e të Mao Ce Dunit. Shoku Mao Ce Dun, — theksojnë, — i qëndronte besnik vijës «nga masat e për masat». Ai bënte një punë të mirë për përgjithësimin e përvojës së masave në luftë dhe brumoste në partinë



tonë traditën dhe stilin e bukur të punës, domethënë respektimin, besimin dhe mbështetjen në masat».

Kur ishte i tillë ky Mao Ce Dun dhe të gjithë punonin nën flamurin e tij, kur ka thënë kaq fjalë të bukura, përse nuk u realizuan këto? Përse u dënuan grupi i Kao Ganit, i Pin De Huasë, i Liu Shao Çisë, e të tjera e të tjera si këto? Kësaj është zor t'i japin një përgjigje njerëzit që ecin sot në Kinë në rrugën kapitaliste dhe që duan të fshihen nga populli, duke ruajtur deri diku autoritetin e Mao Ce Dunit, sepse u shërben për ta hedhur në gjiriz flamurin e tij dhe për të ngritur flamurin e tyre të zi, derisa Kina të bëhet një fuqi e madhe kapitaliste, me një diktaturë fashiste në krye.

Autori i artikullit të «Zhenminzhibaos» shkruan se Mao Ce Duni ka thënë: «Kinës i mungojnë shumë gjëra, por gjëja kryesore janë pavarësia dhe demokracia». Pra, tash këto vendit të tyre po ia sigurojnë zotërit e rinj me alcancën që bënë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me Japoninë dhe me gjithë reaksionin kapitalist botëror, nga po marrin kredi të panumërta me të cilat gjoja ndërtojnë socializmin. Kështu forcojnë «pavarësinë» dhe «demokracinë» që ka predikuar Mao Ce Duni. Tash në Kinë është ngritur edhe «muri i demokracisë», ku vlojnë dacibaot, të cilat janë karta të shkruara dhe të diktuar nga klikat. Kur vjen një klikë në fuqi, dacibaot janë në favorin e kësaj dhe kundër tjetrës, kurse kur rrëzohet ajo e vjen një e re, është kjo e fundit që vë dacibaot e kështu me radhë.

Pra «muri i demokracisë» nuk është i demokracisë, por është muri i klikave, njerëzit e të cilave shkru-

ajnë mbarë e prapë për të diskredituar ata që dëshirojnë të diskreditojnë. Prandaj për çështjen e pavarësisë e të demokracisë s'është bërë asgjë në kohën e Maos, asgjë nuk po bëhet aktualisht dhe asgjë nuk do të bëhet edhe më vonë. Përkundrazi, çështja e pavarësisë dhe e demokracisë në Kinë do të shkojë poshtë e më poshtë.

Mbeturinat e feudalizmit e të kapitalizmit burokratik nuk janë zhdukur në Kinë. Këtë nuk mund ta fshehtë udhëheqja aktuale kineze. Ten Hsiao Pini dhe Hua Kuo Feni e shohin veten që janë si mbi gjemba, që nuk i kanë konsoliduar akoma pozitat e tyre, dhe thonë se «këto të këqija është vështirë që të mposhten nga lufta spontane e masave. Duhet të bashkohet udhëheqja e partisë dhe të mbrohet nga shteti». Pra, këta dishepuj të Maos, që kurdoherë kanë dashur dhe duan «të lulëzojnë njëqind lulet» e «të konkurrojnë njëqind shkollat», tash flasin për bashkim në udhëheqje të partisë, bile ky bashkim duhet të mbrohet nga shteti, me fjalë të tjera partia duhet të jetë nën drejtimin e ushtrisë dhe të bëjë ashtu siç urdhëron ushtria.

Autori i artikullit dhe personat që qëndrojnë pas tij thonë: «Nga ana tjetër, populli, nën ndikimin e llojeve të ndryshme të ideologjisë joproletare, është i prirë për anarki dhe ultrademokraci, në qoftë se ai do të shkëputet nga udhëheqja e bashkuar e partisë dhe centralizmi demokratik». Me fjalë të tjera këta parashikojnë rreziqe të mëdha që u turren. Kështu njerëzit që paraqesin rrezik të vërtetë për ta, e që në mos sot, nesër, do të ngrihen si një forcë e madhe për t'i shkatërruar. akuzohen që përpara si elementë të prirë nga anarkizmi e nga ultrademokracia. Atyre u thuhet në formë kër-

cënimi që, në qoftë se shkëputen nga «udhëheqja e bashkuar e partisë dhe nga centralizmi demokratik», do t'i sjellin Kinës fatkeqësi të mëdha, prandaj paralajmërohen: «Kini mendjen, mos lëvizni, tregojuni të bindur ndaj urdhrave dhe vendimeve që japim ne, klika në fuqi, sepse duhet të na mbështetni, ndryshe, ne do të mbrohemi me armët e shtetit. Në rast se në Kinë paraqiten lëvizje progresiste e revolucionare, këto, ne njerëzit në fuqi, i quajmë që tash anarki dhe ultrademokraci.»

Pra, udhëheqja është kundër ultrademokracisë dhe, si pasojë, «muri i demokracisë» është muri i klikës së Ten Hsiao Pinit. Për të lavdëruar këtë mund të vihen kurdoherë dacibao, por nuk lejohet të vihen dacibao kundër bandës së tij dhe pro Mao Ce Dunit ose «katërshes». Kjo jo, sepse quhet «anarki»!

Si konkluzion, ky myteber, që shkruan në «Zhenminzhibao», thotë se «ngjarja e Tien An Menit është një formë e luftës», «është forma e luftës për kryerjen deri në fund të revolucionit socialist», domethënë për kryerjen e revolucionit «socialist» me puç ushtarak, për «parandalimin e rivendosjes së sundimit kundërrevolucionar», që duhet kuptuar të sundimit revolucionar. Ai nuk mungon të thotë se «rishikimi i vendimit i bën njerëzit ta ndiejnë se partia jonë gjithmonë qëndron në anën e tyre dhe e ka udhëhequr me vendosmëri popullin në luftën e tij për demokracinë e plotë». Atëherë vihet pyetja: Kur ka qëndruar në anën e tyre, përse janë bërë gjithë këto gjëra? Përse atëherë nuk ka ekzistuar demokracia e plotë? Por këtyre pyetjeve nuk mund t'u përgjigjet dot banda e Ten Hsiao Pinit dhe ajo e Hua Kuo Fenit.

Autori ose autorët e artikullit në fjalë duan të thonë se dacibaot që vihen nëpër mure tregojnë se «është populli që shqetësohet për çështjet e partisë dhe të shtetit», për të ardhmen. Prandaj, thonë ata, «ne duhet të kemi besim në nivelin e lartë të ndërgjegjes dhe të gjykimit politik të masave dhe besojmë se ato nuk do të lejojnë kurrë që elementët e këqij të kryejnë turbullirra». Po ç'kanë bërë këto masa në «10 luftërat» e zhvilluara deri tashti? Kur e kanë treguar ato këtë zotësi e këtë vullnet të pathyeshëm? Pse i kanë pranuar këto masa njerëzit që kanë dashur të luajnë me fatin e popullit, që nga Mao Ce Duni dhe të gjithë adeptët e tjerë të tij? Këtyre pyetjeve është e zorshme t'u përgjigjen bandat në fuqi në Kinë. Atyre u përgjigjet si duhet Partia e Punës e Shqipërisë, duke i analizuar çështjet në dritën e marksizëm-leninizmit.

*Marrë nga libri:*

*Enver Hoxha, «Ditar për çështje ndërkombëtare» (botim i brendshëm), nr. 11, f. 560*

## PLENUMI I 3-TË I KOMITETIT QENDROR TË 11-TË TË PKK

Shënime

28 dhjetor 1978

Më 23 dhjetor agjencia HSINHUA transmetoi komunikatën e Plenumit të 3-të të KQ të 11-të të Partisë Komuniste të Kinës.

Ky plenum është vazhdim i serisë së masave që janë marrë për konsolidimin e pushtetit të grupit djathtist-imperialist të Hua Kuo Fenit.

Ashtu si edhe Kongresi i 11-të, plenumi i 3-të u mbledh pasi imperializmi amerikan çeli dritën e gjelbër për Kinën. Kjo, si dhe mendimi se këto transformime që po bëhen në Kinë e kanë burimin në ujdinë kino-amerikane, mund të duken të çuditshme. Por faktet historike vërtetojnë që përpara se Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe shtetet e tjera kapitaliste të vinin në ujdë, në aleanca e në alishverishe të mëdha me Kinën, duhej që në këtë vend të bëheshin transformime rrënjësore nga e djathta, ndryshe këto ngjarje nuk do të ndodhnin. Në Kinë do të vazhdonte zhvillimi i situatave në po atë formë kaotike që kishte filluar qysh nga krijimi i Republikës Popullore, që kur ishte gjallë Mao Ce Duni, bile edhe më përpara, gjatë luftës nacionalçlirimtare.

Kjo nuk do të thotë se me ndryshimin e situatave pas dënimit të Liu Shao Çisë dhe pas vdekjes së Mao Ce Dunit në Kinë u vendos stabiliteti politik, ideologjik e organizativ. Në asnjë mënyrë jo. Atje, deri në një revolucion proletar të vërtetë, ekzistojnë dhe do të vazhdojnë të ekzistojnë kaosi, indisiplinimi, sabotimi dhe lufta për pushtet në mes fraksioneve të ndryshme.

Situata aktuale është rrjedhim i politikës së Çu En Lait, të cilën e aprovonte Mao Ce Duni qëkurse ishte gjallë, domethënë që nga koha kur të dy ata morën kontakte të fshehta me presidentin Nikson të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Kjo praktikë vazhdoi edhe pas vdekjes së tyre.

Pas marrjes së fuqisë nga Hua Kuo Feni dhe nga Ten Hsiao Pini, Kina nuk mund të lëkundej sa andej-këndej si në kohën e Maos. Ajo do të zbatonte strategjinë që kishin vendosur Mao Ce Duni dhe Çu En Lai, domethënë miqësi me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, e cila kishte filluar të realizohej me takimin që Mao Ce Duni dhe Çu En Lai bënë në Pekin me presidentin Nikson. Kjo miqësi dhe kjo vijë ishin hedhur në Kartën, komunikatën e Shangait, e cila përbënte pikën kulminante të strategjisë së re, miqësinë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, hapjen drejt Perëndimit, dhe shtypjen e çfarëdo lëvizjeje që do ta kundërshtonte këtë strategji. Prandaj gjatë gjithë kësaj kohe, deri në Plenumin e 3-të të KQ të 11-të, u zhvillua një luftë e rreptë, që kishte për qëllim të ruheshin pozitat e grupeve të ndryshme në udhëheqje.

Mirëpo gjatë gjithë kësaj periudhe njëvjeçare, në qoftë se nuk gabohem, në udhëheqjen e partisë u zhvi-

lluan luftimë të brendshme. Kontradiktat në radhët e saj ishin të mëdha. Ten Hsiao Pini dhe grupi i tij përpqeshin të merrnin plotësisht fuqinë në dorë, kurse Hua Kuo Feni nuk e lëshonte këtë. Në të njëjtën kohë, jashtë bëheshin përpjekje për ta paraqitur çështjen se në Kinë ngjiste një revolucion i ri, i përkohshëm, që konsistonte në demaskimin e «katërshes» dhe të Lin Biaos që tashmë qenë rrëzuar.

Në fakt, në Kinë, midis fraksioneve rivale të ndryshme, në udhëheqje dhe jashtë saj, vazhdonte një luftë e ashpër. Kjo luftë pengonte stabilizimin brenda vendit dhe dëmtonte besimin e imperialistëve dhe të kapitalistëve të huaj, të cilëve iu hapën portat e Kinës dhe u kërkoheshin kredi dhe investime të mëdha. Prandaj imperializmi amerikan, kandidati kryesor në këtë miqësi, me siguri kërkoi nga udhëheqja kineze që të vendoste në vend stabilitetin, sepse pa stabilitet nuk do të mund t'i jepte Kinës ndihmat ekonomike, patentat dhe nuk do të mund ta armatoste ushtrinë kineze. Mungesa e stabilitetit nuk do të lejonte të përfundohej as aleanca midis Kinës dhe Japonisë dhe, më vonë, as zbatimi i Kartës së Shangait, domethënë përfundimi i një aleance sekrete midis Kinës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Ndërkohë imperialistët amerikanë studionin se cilat ishin forcat që predominonin dhe mund ta stabilizonin situatën në Kinë. Ata zgjodhën Ten Hsiao Pinin, mikun e mikut të tyre të vjetër, Çu En Lait, dhe i dhanë mbështetje të hapët. Sigurisht, amerikanët influencuan edhe te grupi i Hua Kuo Fenit që ky t'i bënte lëshime, në mos të dukshme, indirekte, grupit të Ten Hsiao Pinit.

Stabiliteti në Kinë duhej të vendosej me një kom-

promis në udhëheqje. Dhe kompromisi u arrit në mbledhjen e Plenumit të 3-të të Komitetit Qendror të 11-të të Partisë Komuniste Kineze.

Ku qëndron ky kompromis? Faktikisht **Ten Hsiao Pini** e ka fuqinë në dorë; ai ka në dorë ushtrinë, ekonominë dhe partinë. Për ta pasur partinë në dorë, qoftë edhe formalisht, u arrit në kompromis që ish-kryetari i Bashkisë, **Vu Teh**, ish-komandanti i Pekinit **Çen Hsi Lien** dhe ndonjë partizan tjetër i **Hua Kuo Fenit** të qëndronin në **Byronë Politike**, ndërsa **Ten Hsiao Pini** solli në këtë organ të lartë një numër të madh prej 5 ose 6 vetash, të gjithë njerëz të tij, që nga **Ten Jin Çao**, që është e veja e **Çu En Lait**, dhe deri tek ish-shefi i Zyrës së Përgjithshme në kohën e **Liu Shao Çisë**, të cilin **Mao Ce Duni** e akuzoi se ishte agjent i hrushovianëve.

Tash në **Byronë Politike**, edhe nga ana formale, **Ten Hsiao Pini** ka fuqinë në dorë, ka shumicën. Do të mбетet apo jo **Hua Kuo Feni** në postet që ka aktualisht, ky është një problem që do ta tregojë koha. Çështja është se gjatë kësaj periudhe **Ten Hsiao Pini** rehabilitoi të gjithë të njohurit, miqtë dhe bashkëluftëtarët e tij të persekutuar nga **Mao Ce Duni** dhe nga **Revolucioni Kulturor**, nga **Lin Biaoja** dhe nga «katërshja», që «i kanë shkaktuar Kinës të gjitha të këqijat», siç thonë ata. Pra, ky plenum afirmoi rehabilitimin e plotë të të gjithë elementëve borgjezë, kapitalistë e reaksionarë, të cilët ishin shkarkuar ose diskredituar nga **Revolucioni Kulturor**. Të gjithë këta, pavarësisht nga mosha e kaluar, zunë postet e veta të mëparshme. Ky rehabilitim do të thotë rehabilitim i të gjithë aparatit të vjetër të kohës së **Liu Shao Çisë** e të **Ten Hsiao Pinit**. Në plenum nuk



u shpall akoma rehabilitimi i Pen Çenit dhe i ndonjë tjetri, kurse Pin De Huaja u rehabilitua plotësisht e me triumf.

Çështja tjetër që u vendos në këtë plenum është se aktualisht gati mori fund lufta për demaskimin e «katërshes». Kjo do të thotë që mori fund lufta për demaskimin e Maos, të maoizmit dhe të gjithë adeptëve të tij. Në të vërtetë ajo mori fund vetëm në sipërfaqe, sepse lufta vazhdon dhe do të vazhdojë gjatë gjithë jetës, mbase ata që besojnë te Mao Ce Duni dhe në politikën e tij gjoja marksiste, janë shumë dhe, në mos sot, nesër, do të ngrihen të marrin revanshin kundër këtyre që aktualisht u morën fuqinë nga duart. Këtë çështje, pra, konfirmoi plenumi i 3-të dhe kjo synon që t'i japë të kuptojë popullit kinez se gjoja mbaruan persekutimet nga grupi në fuqi kundër kundërshtarëve të tij dhe, nga ana tjetër, për t'i thënë botës se në Kinë gjendja u stabilizua, u vendos qetësia dhe pushteti është konsoliduar. Me këtë ata duan t'i thonë, gjithashtu, popullit kinez dhe Perëndimit se çdo gjë: stili, metoda, politika, uniteti në udhëheqje, fraksionet etj., etj. në Kinë kanë ndryshuar, se gjendja në vend është stabilizuar. Në bazë të cilave norma është stabilizuar? Plenumi thotë në bazë të normave marksiste-leniniste (!). Kjo nuk është aspak e vërtetë. Përkundrazi, gjendja ka ardhur në normat kapitalisto-revizioniste, por këto norma nuk kanë hedhur akoma rrënjët që dëshirojnë Ten Hsiao Pini dhe imperializmi amerikan. Ky i fundit shpreson se dora e fortë e Ten Hsiao Pinit dhe e grupit të tij do ta stabilizojë këtë situatë, në mos brenda vitit, brenda 5-6 vjetëve, duke mënjanuar ndonjë turbullirë të re.

Pra, Plenumi i 3-të i Komitetit Qendror të 11-të të PKK sipas tyre u karakterizua gjoja nga një unitet i plotë në parti dhe në udhëheqje, gjë që është një gënjeshtër e madhe, pse atje ekziston një rivalitet i ashpër në mes grupit të Hua Kuo Fenit dhe atij të Ten Hsiao Pinit.

Në këtë plenum çështja e demokracisë është ngritur si një normë me rëndësi të madhe. Thuhet se të gjithë kanë të drejtë të flasin, të kritikojnë cilindo qoftë; muret e dacibaove quhen «muret e demokracisë» etj. Veçse në Kinë, sipas këtij plenumi, dhe kjo është shkruar në tri komunikatat e botuara, duhet të mbretërojnë tri «jo-të», të cilat konsistojnë në atë që «asnjeri nuk duhet të sulmohet për gabimet e tij», «kurrkujt nuk duhet t'i vihen epitete» dhe «nuk duhet të përdoret shkopi i madh». Pas gjithë kësaj, thonë se në Kinë është vendosur diktatura e proletariatit (!). E bukur diktaturë e proletariatit! Diktaturë kapitaliste me ngjyra liberale. Ku është parë që në një shtet që quhet socialist, ku udhëheq një parti gjoja marksiste-leniniste, ku ekziston gjoja diktatura e proletariatit, të lejohet një liberalizëm kaq i madh? Kush janë këta që ia predikojnë këto tri «jo» popullit dhe së ashtuquajturës Parti Komuniste të Kinës? Janë ata që likuiduan me një të goditur antidemokratike «katërshen» e Lin Biaon, ata që po bëjnë kërdrinë aktualisht në Kinë e që po burgosin nga të katër anët, ata që kanë diskredituar në një mënyrë aq skandaloze Çian Çinin dhe të tjerë.

Çështja tjetër që konfirmoi ky plenum është se Ki-na do të ndjekë rrugën e «katër modernizimeve», të cilat në të vërtetë duan të thonë ndërtim i kapitalizmit në Ki-

në. Me ndihmën e kujt? Këtë kinezët nuk e thonë. Nuk zënë aspak në gojë litarin në shtëpinë e të varurit, pse Kina është varur te Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe te kapitalizmi botëror. Nuk përmendet aspak se Kina po futet deri në grykë në borxhe te kapitalizmi ndërkombëtar, por pretendohet që ajo gjoja do të zhvillohet me forcat e veta. Premtimet janë të bujshme: me forcat e veta dhe, duke ndjekur Ten Hsiao Pinin, Kina do të bëhet një shtet i fuqishëm socialist, të mos harrojmë, një shtet i një demokracie të vërtetë, të mos harrojmë, një popull që do të përparojë, do të lulëzojë dhe jeta e tij do të bëhet e begatshme! Të gjitha këto premtime, grupi kapitalisto-revizionist i Ten Hsiao Pinin ia bën popullit kinez, i cili, pikërisht kur po mbahej ky plenum dhe kur rreth tij ishin grumbulluar të gjithë miqtë dhe dashamirësit e Tenit, në Shangai e gjetkë demonstronte dhe kërkonte të dinte nëse do të marrin apo nuk do të marrin fund mjerimi i tij, mungesa e lirisë, e ushqimeve, e shtëpive. Njerëzit në Shangai thërritnin: «Rroftë revolucionin!». Pra, populli kërkon revolucion, kurse udhëheqja kërkon kundërrevolucion, qetësi, bindje, «disiplinë», «rregull», pse nga to e nga ndihma amerikane dhe ajo e kapitalizmit botëror, që me kamata të rënda vërshojnë në Kinë, gjoja do t'i vijë mirëqenia popullit kinez!

Plenumi i 3-të i Komitetit Qendror të 11-të, sipas komunikatës së botuar, trajtoi edhe probleme të politikës së jashtme dhe arriti në përfundimin se «politika e jashtme e partisë dhe e qeverisë ka qenë e drejtë dhe e suksesshme». Ky plenum, pretendon udhëheqja kineze, është historik, pse «zgjidhi një numër problemesh

të rëndësishme që i kishte lënë historia, si dhe çështjen e kontributit dhe të gabimeve të disa udhëheqësve të rëndësishëm». Kush ishin këta udhëheqës të rëndësishëm? Sigurisht, Mao Ce Duni. Por grupi i Ten Hsiao Pinit nuk guxon akoma ta përmendë me emër, sido që në «murin e demokracisë» kanë dalë edhe kritika kundër Maos. Nuk janë njerëz të thjeshtë ata që i bëjnë këto kritika, por është pikërisht aparati propagandistik i Ten Hsiao Pinit, i cili ka për qëllim demaskimin e plotë të Maos dhe ngritjen e kultit të Tenit.

Kështu ndodhi në Bashkimin Sovjetik me çështjen e Hrushovit, kështu po ndodh atje edhe me çështjen e Brezhnjevrit.

Plenumi i 3-të vendosi të forcojë «demokracinë» në jetën e partisë dhe në jetën politike të shtetit kinez, duke krijuar një komision qendror për kontrollin e disiplinës. Detyra kryesore e këtij komisioni është që të vazhdojë rehabilitimin e plotë të reaksionit dhe likuidimin e çdo kundërshtari aktual. Në krye të këtij komisioni u vunë të gjithë ata elementë të rrëzuar nga Revolucioni Kulturor dhe miq të Ten Hsiao Pinit.

Sipas komunikatës, në këtë plenum u arrit një gjë «e bukur»: «Gjatë dy mbledhjeve pjesëmarrësit shprehën lirisht mendimin e tyre, duke u bazuar në marksizëm-leninizëm-maoceudunidenë dhe folën lirisht». Kup-tohet pse folën lirisht, sepse mbronin veten, mbronin pushtetin e tyre të reaksionit, të kapitalizmit. Komunikata thekson se «mbledhjet që u bënë, çuan me të vërtetë në një situatë politike, e cila karakterizohej si nga centralizmi, ashtu edhe nga demokracia, si nga disiplina, ashtu edhe nga liria, si nga uniteti i vullnetit, ashtu dhe

nga liria personale e të menduarit dhe nga gjallëria, ashtu siç mësonte shoku Mao Ce Dun».

Mao Ce Duni të gjitha këto parime i kishte hedhur tej. Ai kërkonte të bëhej vetëm çfarë donte vetë. Por atyre që janë sot në fuqi u duhet të thonë se veprojnë «ashtu siç mësonte shoku Mao Ce Dun», pse dinë edhe këta ta përdorin demagogjinë dhe të bëjnë të kundërtën e asaj që thonë. Si për çudi, kjo komunikatë thotë se brenda 10 muajve që erdhi në fuqi Ten Hsiao Pini, «janë arritur fitore të mëdha në revolucionin e rëndësishëm politik kombëtar për demaskimin dhe dënimin e Lin Biaos dhe të bandës së të katërve». Gjithashtu, sipas tyre «është rimëkëmbur dhe është forcuar më tej ekonomia kombëtare». Çfarë ekonomie kombëtare është forcuar? Në Kinë nuk po realizohet asgjë, atje ekziston uri, planet në industri dhe në bujqësi nuk realizohen, blihen drithëra buke me sasi kolosale nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës e gjetkë. Dhe të mos harrojmë se këtë ekonomi kombëtare e kanë drejtuar në kohën e tyre Çu En Lai, Li Hsien Nieni, Li Çiani dhe Ten Hsiao Pini, kur erdhi në fuqi. Të gjithë këta nuk mundën ose nuk ditën, s'ishin të zotët ta çonin ekonominë në rrugën që t'i jepte të paktën njëfarë kënaqësie relative popullit kinez.

Por mbi të gjitha, sipas komunikatës, plenumi theksoi se «Kina ka arritur suksese të reja të rëndësishme në krijimin e një fronti të bashkuar ndërkombëtar kundër hegjemonizmit dhe në zhvillimin e marrëdhënieve miqësore me të gjitha vendet e botës».

Është e qartë se Kina u rreshtua përfundimisht me shtetet kapitaliste dhe se ajo është e lidhur në miqësi me klikat reaksionare të këtyre shteteve. Politika ak-

tuale kineze nuk ka të bëjë me miqësinë midis popullit kinez dhe popujve të botës, por është politikë e miqësisë midis klikës udhëheqëse kineze dhe klikave që sundojnë në «botën e parë», në «botën e dytë» dhe në «botën e tretë», siç i quan teoria kineze e «tri botëve».

Revizionistët kinezë shkojnë edhe më tej. Në komunikatën e plenumit ata thonë se «gjatë viteve të para pas themelimit të Republikës Popullore dhe sidomos mbasi transformimi socialist përfundoi në vija të përgjithshme, shoku Mao Ce Dun herë pas here e udhëzonte partinë që ta përqendronte punën në ekonomi dhe në revolucionin teknik. Nën udhëheqjen e shokut Mao Ce Dun dhe të shokut Çu En Lai partia jonë bëri shumë për ndërtimin socialist dhe korri fitore të rëndësishme».

Këtu, le që ka kontradikta të mëdha, se nuk u korri fitore të rëndësishme, por është gënjeshtër të thuhet se mbaroi ndërtimi i socializmit në Kinë, siç pretendon kjo komunikatë. Atje as ka filluar ndërtimi i socializmit, pale të ketë mbaruar. Përkundrazi, tash në Kinë ka filluar ndërtimi i hapët i kapitalizmit.

Po përse ngjanë këto dështime të mëdha? Edhe kësaj çështjeje ia kanë gjetur ilaçin. Ky ilaç sipas klikës Hua-Ten është tradhtia e Lin Biaos dhe e «katërshes». Por komunikata e plenumit, megjithëse është kategorike, përsëri lë shteg për të justifikuar disfatat e ardhshme, duke theksuar se spastrimi i njerëzve të «katërshes» dhe të Lin Biaos nuk ka marrë fund. Ai, pra, duhet të vazhdojë, pavarësisht se në fillim thuhet që «lëvizja dhe kritika kundër Lin Biaos dhe bandës së të katërve përfundoi në përgjithësi». Por, në fakt, kundërshtimet ndaj këtyre uzurpatorëve të pushtetit dhe

varmihësve të mirëqenies së popullit do të vazhdojnë edhe më vonë.

Tashti, lironë udhëheqësit kinezë, «është koha e përshatshme të merret vendim për përfundimin e lëvizjes masive kombëtare për demaskimin e kritikën e Lin Biaos dhe bandës së të katërve, prandaj theksi të kalohet në punën e partisë dhe vëmendja e popullit t'i kushtohet modernizimit socialist».

Ky është një diktat që i imponohet Kinës nga fuqitë imperialiste e veçanërisht nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Imperializmi amerikan gjykon që, në rast se do të vazhdojë një veprimtari e një gjendje e tillë e Ten Hsiao Pinit, në Kinë do të ngjasin turbullira të mëdha. Partizanët e Mao Ce Dunit nuk do të shtypen kollaj dhe Ten Hsiao Pini do të krijojë pengesa që do t'i vënë në rrezik aleancat e Kinës me Amerikën, me Japoninë dhe me të gjithë partnerët e ndihmësit e tjerë të kapitalizmit botëror.

Prandaj në plenumin e 3-të ata e theksojnë këtë dhe e pohojnë se partia duhet të ketë mbështetjen e sigurimit dhe të ushtrisë, si partia e Titos, që pushteti ta ndihmojë partinë në konsolidimin e saj. Me fjalë të tjera, atje predikohet «uniteti» në parti nën diktaturën e kapitalit, nën diktaturën ushtarake.

E vetmja rrugëdalje për revizionistët modernë kinezë është që në Kinë të vërshojnë kapitalet e huaja. Ky vërshim ka filluar tashmë; rrjedhimet e tij do t'i shohim më vonë. Atje do të bëhet bujë për «ndërtime të mëdha», por këto ndërtime do të bëhen në favorin e kapitalizmit kinez, të shoqërive të mëdha aksionare, të bankave të huaja e të shoqërive shumëkombëshe. Po-

pullit kinez do t'i jepen thërrime të vogla, sa për ta gënjyer. Se kur do të zhgënjehet ky popull, kjo varet nga një punë e madhe politike revolucionare, marksiste-leniniste, që duhet të bëjë një udhëheqje e dalë nga populli, e mbështetur në traditat luftarake të popullit kinez. Por duhet të ketë njerëz dhe një parti të vërtetë, që t'i drejtojë në rrugë të drejtë këto tradita luftarake, të cilat nuk mund të nënvleftësohen.

Në plenum revizionistët kinezë folën edhe për një organizim «të ri» të ekonomisë. Ja ç'thuhet atje: «Plenumi theksoi se një nga të metat serioze në strukturën e drejtimit ekonomik të vendit është superpërqendrimi i autoritetit, prandaj është e nevojshme që ai të kalohet nga udhëheqja qendrore në organet e niveleve më të ulëta, në mënyrë që autoritetet lokale dhe ndërmarrjet industriale e bujqësore të kenë më shumë të drejta vendimi në drejtim, duke u udhëhequr nga një planifikim i unifikuar shtetëror».

Kjo është politikë eklektike, që thotë se edhe duhet të shpërndahet drejtimi ekonomik dhe të unifikohet planifikimi shtetëror. Me fjalë të tjera, teorinë revizioniste të vetadministrimit këta si teori e maskojnë, por në praktikë e zbatojnë. Agjencia HSINHUA njofton se rreth Pekinit u formuan një varg qendrash agroindustriale, në të cilat u bashkuan 15 a 20 komuna. I gjithë ky organizim është bërë nën shembullin jugosllav të komplekseve agroindustriale që janë ngritur rreth Beogradit. Tash kinezët flasin haptazi se do të adaptojnë metodat e vetadministrimit jugosllav, por ata nuk do të mjaftohen vetëm me to. Për administrimin e industrisë ekzistuese dhe për atë që po ndërtojnë, do të adaptojnë edhe



një sërë metodash të tjera kapitaliste, sipas vendeve që bëjnë investime në Kinë dhe sipas nevojave dhe ujdive me shoqëritë e përbashkëta.

Në Plenumin e 3-të të Komitetit Qendror të 11-të udhëheqësit revizionistë kinezë thanë shumë «gjëra të bukura» e «xhevahire të çmueshme»! Ja ç'thonë ata në një vend: «Është e nevojshme që, nën udhëheqjen e centralizuar të partisë, të zgjidhet me vetëdije problemi i dallimit midis partisë, qeverisë dhe ndërmarrjeve dhe t'u jepet fund zëvendësimit të qeverisë me partinë dhe zëvendësimit të administratës së ndërmarrjes me atë të qeverisë; të bëhet një ndarje e detyruar midis niveleve të ndryshme, tipave të punës dhe individëve; të rriten përgjegjësia dhe autoriteti i organeve administruese dhe i personelit drejtues; të pakësohen numri i mbledhjeve dhe shkresat, me qëllim që të rritet efikasiteti i punës; të kryhet me vetëdije kontrolli, të jepen shpërblime dhe dënime; të ngarkohen dhe të shkarkohen njerëzit nga përgjegjësitë».

Gjithë ky orientim është një program i koklavitur, i errët, i paprincipitë, eklektik, revizionist, kapitalist dhe aspak marksist-leninist. Për çdo drejtim, për çdo paragraf të komunikatës, mund të shkruhen libra të tërë që të komentojnë dhe të vërtetojnë se vija aktuale e Kinës, e vendosur nga ky plenum, përfaqëson pikërisht atë që kemi thënë vazhdimisht, se Kina po ecën në rrugën kapitaliste dhe është një vend revizionist socialimperialist.

*Marrë nga libri:*

*Enver Hoxha, «Ditar për çështje ndërkombëtare» (botim i brendshëm), nr. 11, f. 590*

## KINA DHE JAPONIA

### Shënime

29 dhjetor 1978

Kina dhe Japonia janë dy vende të mëdha: njëra ka shtrirje të gjerë territoriale e popullsi shumë të madhe në numër, kurse tjetra, Japonia, është një vend me hapësirë shumë më të vogël nga ajo e Kinës, por me një popullsi të madhe, duke e krahasuar me raportin popullsi-territor në Kinë.

Të dy këto shtete fqinje gjatë historisë së tyre kanë pasur në shëkuq edhe momente miqësie, por edhe momente luftërash e përpjekjesh për hegjemoni mbi njëra-tjetrën. Megjithatë, si Kina, edhe Japonia kanë pasur karakteristika të përbashkëta, sidomos në fushën e kulturës. Në Japoni, gjatë shekujve të kaluar, kultura kineze ka ushtruar një influencë të madhe. Atje ka hyrë dhe është pranuar hieroglifi kinez. Natyrisht, gjuha japoneze ndryshon nga ajo kineze, por, duke lexuar hieroglifet, kinezi mund ta kuptojë japonishten dhe anasjelltas, japonezët gjuhën kineze.

Duke studiuar historinë shekullore të këtyre dy vendeve, shohim se edhe në kohët tona, në shekullin e 19-të, në fillim të shekullit të 20-të e më vonë, Kina perando-

rake është sulmuar nga Japonia. Po ashtu Kina e Sun Jat Senit dhe e Çan Kai Shisë është okupuar nga Japonia, e cila ka gjetur tek ajo terren për ekspansion jetik. Më parë Japonia zaptoi Mançurlinë, iu afrua Pekinit, pushtoi gjithë juglindjen e Kinës dhe gjatë Luftës së Dytë Botërore kaloi në Nankin, në Kanton e në ishujt Hajnan.

Ne i njohim ambiciet dhe veprimet e Japonisë militariste edhe ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës, kur ajo kishte pushtuar gjithë Azinë Juglindore, që nga Indokina, Singapori, Malaja e Australia, sulmoi flotën amerikane në Pirl-Harbor dhe pastaj, më vonë, u detyrua të tërhiqej me disfatë, deri në shkatërrimin e plotë të saj.

Japonia ka qenë një objekt sulmi nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Nuk harrohen fjalët e Teodor Rusveltit, të presidentit të vjetër amerikan, që tha në ato kohë se kundër Japonisë duhej përdorur shkopi i madh, sepse Shtetet e Bashkuara të Amerikës shikonin tek ajo një rivale shumë serioze me ekspansionin e vet imperialist në Paqësor dhe në Azinë e Largme.

Japonia, nga ana e saj, nën drejtimin e militaristëve dhe të Mikados<sup>1</sup>, iu vu me të gjitha mjetet e mënyrat forcimit të pushtetit të vet, krijimit të një ushtrie të fortë, të një marine luftarake nga më të fuqishmet në botë dhe vendosjes brenda ishujve të Japonisë të një diktature të tmerrshme militariste. Kjo diktaturë e egër u forcua edhe më tepër pas likuidimit të flotës cariste në gjirin e Tiencinit dhe Japonia, natyrisht, e hodhi vësh-

---

1. Perandorit.

trimin te Bashkimi Sovjetik i konsoliduar pas Revolucionit Socialist të Tetorit. Në kohën kur kishte sulmuar Kinën, ajo bëri edhe një orvatje drejt Mongolisë, por atje hëngri një grusht të rëndë. Ushtria e Kuqe, nën udhëheqjen e Stalinit, e detyroi Japoninë militariste të ishte prudente në drejtim të Bashkimit Sovjetik, për arsye se kishte përpara një fuqi të madhe ushtarake. Si pasojë, megjithëse ambiciet e saj drejt Vladivostokut, Siberisë dhe Koresë ishin shumë të mëdha, Japonia u zmbrops.

Kështu që në Luftën e Dytë Botërore Japonia nuk luftoi në të dy krahët dhe nuk e sulmoi Bashkimin Sovjetik. Ky e kuptoi këtë moment historik, i hoqi trupat nga Siberia e i çoi në Frontin e Perëndimit kundër hitlerianëve. Ky veprim shërbeu si një faktor me rëndësi për thyerjen e makinës ushtarake naziste gjermane. Pas sulmit vendimtar amerikano-sovjetik Japonia u thye dhe nënshkroi Traktatin e Paqes me fuqitë perëndimore, natyrisht me kushte jo të favorshme për të. Megjithatë, struktura e ushtrisë japoneze qëndroi e paprekur, Mikadoja qëndroi në krye dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës u përpoqën dhe ia arritën qëllimit që gjatë gjithë periudhës së pasluftës ta mbanin nën kontrollin e tyre Japoninë. Ato e fuqizuan atë si ushtarakisht, edhe ekonomikisht në mënyrë kolosale, aq sa Japonia ka arritur aktualisht të bëhet një superfuqi e superindustrializuar.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore dihet se Kina e Çan Kai Shisë dhe e Mao Ce Dunit, në fillim në unitet e pastaj në përçarje, luftoi kundër japonezëve dhe në fund fitoi ushtria e Mao Ce Dunit, e cila e çliroi vendin nga pushtimi japonez. Kështu, midis dy vendeve u vendos e u zhvillua një armiqësi e tillë, që dukej sikur s'do të

kishte asnjë perspektivë pajtimi. Mirëpo më vonë, e sidomos aktualisht, pamë dhe po shohim më qartë se nuk ndodhi ashtu. Në vitin 1972 Kina lidhi marrëdhënie diplomatike me Japoninë dhe kjo mund të quhet si një faqe e re që hapet në historinë e marrëdhënieve midis dy vendeve, gjë që më vonë do të ketë konskuenca të mëdha. Hapja diplomatike e Kinës me Japoninë, pas vitit 1972, duket qartë që ka qëllime antisovjetike.

Pra, Kina konkurroi me Bashkimin Sovjetik se kush do ta tërhiqte pas vetes Japoninë dhe fitoi, kurse Bashkimi Sovjetik nuk mundi dot të lidhej ngushtë me Japoninë kundër Kinës, e cila kishte marrë pozita të theksuara antihrushoviane, që dihet se ishin jo për çështje ideologjike, por për sundim botëror.

Sipas statistikave që janë bërë, agjencitë e lajmeve njoftojnë se që nga viti 1972 deri më 1978 numri i vizitorëve tregtarë japonezë që kanë vajtur në Kinë, është rritur nga 8 mijë në 30 mijë dhe numri i misioneve kinëze në Japoni vjen kurdoherë duke u rritur. Pra, jemi duke vënë re një zhvillim dhe një perspektivë zhvillimi të madh, që synon afrimin e mëtejshëm të Kinës me Japoninë. Siç duket, tenxherja ka gjetur kapakun. Kina është prapa, shumë prapa ekonomikisht dhe e pazhvilluar, por ka popullsinë më të madhe në botë. Atje jetojnë rreth 900 milionë banorë. Ajo akoma është e paeksploruar dhe nuk njihet ekzaktësisht pasuria e madhe e burimeve energjetike të saj. Flitet se Kina ka 600 miliardë tonë qymyr, 50 miliardë tonë naftë, 60 miliardë metra kub gaz dhe shumë minerale të tjera të vlefshme. Ajo prodhon tungsten, është e dyta në botë për anti-

monin, e treta për kallajin dhe amiantin, e pesta për hekurin e kështu me radhë.

Në njoftimet që japin agjencitë e lajmeve, thuhet se nga shifrat e prodhimit, që njihen e që janë publikuar prej statistikave zyrtare, del se në vitin 1978 Kina prodhon 500 milionë tonë qymyr, 150 miliardë kilovat-orë energji elektrike, 28 milionë tonë çelique, 125 milionë tonë naftë, 310 milionë tonë drithëra etj.

Kjo është pasuria e Kinës, një pasuri kolosale, siç shikohet, por që duhet të vihet në shfrytëzim që të zhvillohet.

Shteti fqinj i saj, Japonia, ka një dinamizëm të çuditshëm dhe një potencial ekonomik industrial të pasmbullt. Atje jetojnë 115 milionë banorë, që janë grumbulluar të tërë në një sipërfaqe prej 360 mijë kilometrash katrorë. Japonia të gjitha lëndët e para i sjell nga jashtë dhe te Kina ajo gjeti partneren e saj të përshtatshme për t'i blerë këto lëndë të para, që i duhen për industrinë e vet dhe për të eksportuar atje makineri, teknologji të re, armatime etj. Japonia, siç shënova më lart, mund të konsiderohet si vend i superprodhimit të madh dhe i industrializimit të madh; atje ka shoqëri shumëkombëshe me baza japoneze që janë nga më të rëndësishmet në botë, si: «Micui», «Micubishi», «Sumidomo», «Jasuba», «Nipon Stil» etj.

Kështu që të dy këto vende, Japonia dhe Kina, do të plotësojnë njëra-tjetrën. Japonia do t'i shesë Kinës teknologji moderne, armatime e makineri për ta fuqizuar atë, do të eksportojë atje materiale të industrializuara të cilësisë së lartë dhe do të marrë nga Kina lëndën e parë. Avazi i aleancës së fundit të këtij viti, që u nën-

shkrua në mes Kinës dhe Japonisë, do të dëgjohet më pas. Kjo aleancë me rëndësi të madhe do ta forcojë edhe Kinën, por edhe Japoninë, e cila do të bëhet një fuqi imperialiste jashtëzakonisht e madhe dhe e rëndësishme, që do të tronditë jo vetëm Azinë, jo vetëm Bashkimin Sovjetik, por edhe imperializmin amerikan, e bile gjithë botën.

Tash marrëdhëniet midis Japonisë dhe Kinës janë zgjeruar shumë dhe portet kineze i kanë hapur të dy kanatet për japonezët. Kur Ten Hsiao Pini shkoi në Japoni, gjatë vizitës në një kombinat të prodhimit të automobilave (atje ka shumë kompani të tilla), tha: «Tash po e kuptoj ç'do të thotë çupë e bukur dhe çupë e përçmuar. Këtu, në Japoni, një punëtor ndërton 90 makina në vit, kurse në Kinë nuk arrin të ndërtojë një makinë».

Në tërë këtë ndërmarrje të madhe Kina kapitaliste, Kina imperialiste e Ten Hsiao Pinit, synon të zhvillohet në atë drejtim që është zhvilluar Japonia dhe me ndihmën e veçantë të saj.

Kina përpara fliste se nuk do të merrte kredi, tash kreditë që po merr ajo kanë hyrë në histori. Kredi Kina merr edhe nga bankat, edhe nga shtetet, edhe nga shoqëritë shumëkombëshe, edhe nga Hong-Kongu, edhe nga Japonia, edhe nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, edhe nga Evropa Perëndimore; ajo e ka nderur dorën nga të katër anët.

Potenciali ekonomik i Japonisë është kolosal. Për këtë arsye Kina zgjodhi si partner kryesor në çështjet ekonomike Japoninë dhe i hapi dyert e tregut të saj krejtësisht për këtë shtet që ka një zhvillim me përmasa aq të mëdha, saqë tremb Perëndimin dhe amerikanët. Shi-

het qartë se monedha japoneze është nga më të fortat, bile dollari amerikan që vlerësohej 360 jenë japonezë më 1971 ose 300 më 1976, më 1978 ka zbritur në 200 jenë. Ja sa është zhvleftësuar dollari amerikan dhe sa është ngritur vlera e jenit japonez. Kuptohet se ky është rezultat i tregtisë së madhe që zhvillon Japonia me shumicën dërrmuese të prodhimeve që nxjerr.

Shkëmbimet e Kinës me Japoninë po shtohen vazhdimisht; sipas statistikave, nga 2 miliardë e 200 milionë dollarë që arrinte shuma e tyre në vitin 1974, u rrit në 4 miliardë e 100 milionë dollarë më 1976, në 5 miliardë e 100 milionë në 1977 dhe në vitin 1978 arriti afërsisht në 7 miliardë dollarë, siç thonë disa agjenci, dhe kjo patjetër është e argumentuar. Pra, për Japoninë është krijuar një situatë shumë e favorshme në shkëmbimet tregtare; atje ka një përparim të madh teknologjik, ka përqindje më të vogël të të papunëve dhe një monedhë me një forcë jashtëzakonisht të zhvilluar.

Kina ka vendosur marrëdhënie të ngushta me Japoninë dhe merr prej saj kredi e teknologji moderne, me qëllim që edhe ajo në fund të shekullit të bëhet një fuqi e madhe. Por, mund të merret me mend se ç'fuqi ekonomike do të bëhet Japonia gjatë kësaj kohe. Ajo do të superzhvillohet në atë mënyrë, që do të çuditë botën.

Prandaj jam i mendimit se jo vetëm sovjetikët, por edhe amerikanët i shqetëson një zhvillim, një «alcancë», dhe një bashkim i tillë kino-japonez. Megjithatë imperialistët amerikanë aktualisht janë të fuqishëm dhe manovrojnë që një bashkim i tillë të mos ketë mundësi të zhvillohet në disfavor të tyre, prapëseprapë ata do ta shikojnë me vigjilencë të madhe këtë zhvillim.



Orientimi kryesor aktual, sipas mendimit tim, është konsolidimi i kësaj aleance dhe zhvillimi me ritme të shpejta i Kinës, njëkohësisht forcimi në mënyrë monstruoze i fuqisë ekonomike, ushtarake, i modernizimit e i teknologjisë së Japonisë. Të dy këto shtete, si dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Sovjetik, natyrisht, do të ndeshen në konflikt për hegjemoni. Aleanca e Kinës me Japoninë mund të pasohet edhe nga një aleancë tjetër, aleanca kino-amerikane. Nuk dihet ç'do të nxjerrë udhëtimi i Ten Hsiao Pinit në Uashington, që është njoftuar se do të bëhet nga muaji janar i vitit 1979; nuk është çudi që vajtja e tij të konkludojë me një aleancë bashkëpunimi dhe miqësie. Kështu që Shtetet e Bashkuara të Amerikës lidhen me Japoninë dhe me Kinën me një aleancë, e cila bëhet, siç thoshte gjithë frikë «Pravda» për të kualifikuar aleancën në mes Kinës dhe Japonisë nën tutelën amerikane, se po «krijohet NATO-ja e Paqësorit».

Kjo, sigurisht, krijohet që tendencat e Kinës e të Japonisë për ekspansion t'u kundërvihen atyre të Bashkimit Sovjetik për ta dobësuar e për ta mundur këtë superfuqi. Mirëpo si do të zhvillohet ky ekspansion? Do të jetë një marshim i kësaj superfuqie të re ose i dy superfuqive në aleancë, duke pasur në krah edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës drejt Siberisë, drejt Bashkimit Sovjetik apo një marshim drejt rrugës së vjetër të pushtimit japonez, domethënë në Azinë Juglindore, të cilën ta bëjnë një domen të tyre që nga Indokina, Koreja dhe deri në Detin e Kuq, për të mbrojtur Lindjen e Mesme? Ekspansioni kino-japonez mund të orientohet pa humbje të mëdha në këtë pellg dhe nëpërmjet disa

luftërave të pjesshme ose diversioniste mund të jetë më i lehtë. Por interesat e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në këtë drejtim cenohen. Cenohen gjithashtu edhe interesat e Bashkimit Sovjetik, se edhe ky kërkon ta evitojë luftën në drejtimin e tij dhe t'i angazhojë luftimet jashtë territorit të vet, domethënë në Afrikë, në Gadishullin Arabik, në Pakistan, në Indi e po të këtë mundësi, edhe në Indokinë.

Pra, ekspansioni kino-japonez, si rezultat i kësaj aleance ushtarake të ethshme, është një rrezik i madh, që do të shkaktojë një konflagracion, në mos botëror, të pjesshëm, duke kapur Lindjen e Largme, Azinë Juglindore, ishujt e Paqësorit etj. Por një luftë e tillë nuk mund të imagjinohet pa implikimin e të gjitha shteteve imperialiste që janë futur në këtë krizë të madhe dhe që kërkojnë me çdo mënyrë të dalin prej saj, domethënë të mundin kundërshtarët e tyre dhe vetë të rindajnë botën.

Në këto situata kaq të turbullta për imperializmin, socialimperializmin dhe borgjezinë e madhe kapitaliste, një rëndësi të dorës së parë marrin sqarimi i popujve dhe ngritja e tyre në luftë; krijimi, forcimi e organizimi i partive marksiste-leniniste, revolucionare që duhet të udhëheqin revolucionin dhe luftën nacionalçlirimtare kundër shtypësve kapitalistë. Prandaj duhet ngritur lart emri i popullit trim iranian, i cili ka 3 muaj e më shumë që ditë e natë po lufton dhe vritet nëpër rrugët e Teheranit, Ispahanit, Tabrizit, «qyteteve të shenjta», duke demonstruar kundër shahut, kundër regjimit mesjetar dhe katil. Me dhjetëra mijë demonstrues në Marshad e gjetkë, çdo ditë, gjatë tërë kohës,

bile edhe kur është vendosur shtetrrëthimi, po përleshën me ushtrinë. Zemërimi i popullit iranian ka ardhur duke u rritur dhe ka arritur kulmin. Gjithë Irani është mbërthyer nga grevat e këto nuk janë greva të zakonshme, por të përgjakshme, ku vriten qindra e qindra veta dhe pas çdo të vrari ngrihen në këmbë me dhjetëra mijë të tjerë që kërkojnë rrëzimin e shahut.

Imperializmi amerikan ndodhet në vështirësi. Dytri herë Karteri ka folur haptazi për mbrojtjen e shahut; po kështu edhe krerët revizionistë sovjetikë, të cilët janë shprehur se, po të ndërhyhet në Iran, atëherë edhe Bashkimi Sovjetik do të marrë masa. Tash po dëgjojmë se dy acroplanmbajtëse amerikane, «Libërejshën» dhe një tjetër, u nisën nga Japonia për në Gjirin Persik, gjoja për të mbrojtur dhe për të tërhequr qytetarët amerikanë, që janë rreth 40 mijë veta.

Brenda në Iran ekzistojnë trupa të CIA-s e trupa të Izraelit, të cilat mbrojnë pallatin e shahut, si dhe trupa të zgjedhura terroriste, por, megjithëkëtë, asgjë s'e pengon popullin të hidhet mbi to. S'ka rëndësi çështja se kush e udhëheq dhe e ngre popullin iranian në kryengritje për rrëzimin e regjimit mesjetar, barbar dhe të shitur tek imperializmi, të shahut të Persisë. Fli-tet se e udhëheqin sheikët e sektit mysliman shiit; thuhet se e drejton nga Parisi njëfarë Ajatollah Khomeini ose Fronti Kombëtar, në qoftë se nuk gabohem, i cili vepron aktualisht në Iran.

Nga zhvillimi i demonstratave të mëdha në qytetet e Iranit, ku shohim çdo natë në televizor grushtet e popullit të mbledhura fort e të ngritura lart, themi se s'ka dyshim që kjo kryengritje është pozitive, pavarësisht se

mund të jenë imamët që e nxitin. Edhe Stalini ka folur për imamët, për hanët e Afganistanit, dhe i ka mbrojtur ata. Ata hanër ishin, por Stalini ka folur mirë për ta, se luftuan me forcat angleze në grykat e maleve dhe i bënë hi; nga disa mijëra anglezë që ishin futur atje, vetëm 3 veta dolën gjallë nga Afganistani.

Kryesorja është se në Iran populli udhëhiqet nga ndjenja e urrejtjes kundër shahut. Ai është hedhur në këto demonstrata se nuk i duron dot mjerimin, varfërinë, padrejtësitë, shtypjen dhe korrupsionin. Populli i Iranit është ngritur edhe kundër imperializmit amerikan që grabit pasuritë kolosale të burimeve të naftës iraniane, duke i lënë të zotët e këtyre pasurive në uri, në sëmundje, në injorancë. Kjo gjendje e shtyn popullin iranian të luftojë. Sidoqoftë, hoxhatolislamët apo Ajatollah Khomeini e të tjerë janë elementë të borgjezisë së madhe kapitaliste e feudale me tendenca fetare. Kjo duhet konsideruar pozitive, si një fitore kundër shahut dhe do të lërë gjurmë të thella në popullin iranian. Por atje nuk janë vetëm imamët e hoxhatolislamët që udhëheqin, sepse ekzistojnë edhe elementë të tjerë, njerëz të partisë «Tudeh», prosovjetikë mund të themi, elementë pro Musadekut, socialdemokratit të vjetër. Atje ka gjithashtu, edhe marksistë-leninistë të partisë «Tufan». Kjo është një parti e re, por aktualisht ka një terren të përshtatshëm për luftë, për të ngritur lart ndërgjegjen e popullit, për t'i treguar atij rrugën e drejtë, për ta bërë të ndërgjegjshëm për forcën e tij të pamposhtur, forcë e cila nuk mund të përmbahet as nga ushtria e shahut, as nga SAVAK-u, sigurimi i shtetit të tij, as nga luftanijet amerikane dhe as nga CIA. Pra, populli duhet të

sqarohet dhe kjo pakënaqësi e madhe e tij të vihet në shërbim të revolucionit, të luftës nacionalçlirimtare, të jetë të paktën një parapërgatitje e luftërave të ardhshme e revolucionit të ardhshëm.

Lufta e Iranit do të ketë influencë të madhe në të gjitha Emiratet e Gjirit Persik, në Arabinë Saudite e në vendet e tjera, si në Siri e gjetkë, me një fjalë, në të gjithë Lindjen e Mesme, ku intrigat amerikane e sovjetike, tash edhe kineze, po bëjnë kërdrinë për të ruajtur statukuonë, domethënë shfrytëzimin dhe shtypjen e popujve.

Në gjithë këtë pellg ka një situatë të favorshme revolucionare. Viti 1979 e gjen revolucionin në ngjitime, kurse imperializmin, socialimperializmin dhe kapitalizmin botëror të mbërthyer në një krizë të madhe, nga e cila është e zorshme të dalin. Klikat e tyre, ngaqë nuk mund të gjejnë dot mënyra drejtimi, mbytin revoltat e popujve me gjak, por revolucioni nuk mund të mbytet. Ai fiton terren, ai marshon kurdoherë përpara.

*Marrë nga libri:*

*Enver Hoxha, «Ditar për çështje ndërkombëtare» (botim i brendshëm), nr. 11, f. 602*

## **PËR GJENDJEN NDËRKOMBËTARE GJATË VITIT 1978**

**Shënime**

**31 dhjetor 1978**

Nesër fillon viti i ri. Sot është dita e fundit e vitit 1978, pra mund të bëjmë një përmbledhje të gjendjes së strategjisë botërore të imperializmit në përgjithësi dhe të superfuqive në veçanti.

Imperializmi amerikan dhe socialimperializmi sovjetik, dy fuqi të mëdha bërthamore, vazhdojnë armatimin e tyre. Pavarësisht nga disa marrëveshje që kanë nënshkruar dhe nga disa projekte SALT që nuk po realizohen, fakt është se të dyja këto superfuqi përpiqen të konsolidojnë pozitat e tyre botërore dhe t'i dalin përpara rrezikut të një lufte bërthamore. Natyrisht, këtë luftë, qoftë Bashkimi Sovjetik, qofshin Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nuk e duan, por thellimi i krizës do ta krijojë një situatë të tillë. Në fillim lufta mund të jetë e zakonshme dhe më pas të kthehet në bërthamore.

Prandaj Bashkimi Sovjetik, përveç shtimit të armatimeve, nëpërmjet Traktatit të Varshavës dhe KNER-it,

përpiqet të konsolidojë «aleancat» me vendet e «demokracisë popullore». Këto vende, në fakt, janë të pushituara nga Bashkimi Sovjetik dhe prej tij konsiderohen si një *glacis* midis tij dhe Evropës Perëndimore. Sot Bashkimi Sovjetik është një vend revizionist, social-imperialist. Atje nuk veprojnë ligjet e një shteti socialist. Pavarësisht nga fjalët që thonë, në Bashkimin Sovjetik sot dominojnë rusët, «rusët e bardhë». Pra në këtë vend nuk ekziston më dhe nuk mund të ekzistojë ai konsolidim i Bashkimit Sovjetik leninist-stalinian, nuk mund të ekzistojë ai unitet dhe ajo kompaktësi përpara një lufte të re botërore, siç ishin në luftën kundër hitlerianëve. Të gjitha republikat e Bashkimit Sovjetik nuk janë të qeta, bile, në kohë krize, mund që të mos shkojnë në unitet në luftë kundër një pushtuesi të mundshëm. Është revizionizmi ai që e shkaktoi këtë mundësi përçarjeje. Kjo është njëra anë.

Ana tjetër është se Bashkimi Sovjetik sot ndodhet përballë shumë rreziqeve, por sidomos përballë dy fronteve: frontit të Evropës Perëndimore, NATO-s, në unitet dhe në aleancë luftarake dhe ekonomike me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, dhe në Lindje përballë frontit kino-japonez, ku prapa tij profilohen përsëri Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Kështu që Bashkimi Sovjetik sot ndodhet në mes dy zjarresh, sidomos në Azi. Tash Kina po armatohet me shpejtësi të madhe, duke synuar të sulmojë Bashkimin Sovjetik, kuptohet, në qoftë se do të vazhdojë kjo situatë, se ne mund të asistojmë edhe në një kthesë të politikës kineze ndaj Bashkimit Sovjetik, pra, në krijimin e një situatë kur çështjet nuk do të paraqiten si sot.

Por nënshkrimi i Traktatit Kino-Japonez dhe afrimi kaq i ngushtë i Kinës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me vendet e Tregut të Përbashkët Evropian dhe me kapitalin botëror e bën më iminente rrezikshmërinë e luftës kundër Bashkimit Sovjetik në frontin aziatik. Prandaj këllij i duhet ta shpartallojë këtë front tani, kur ky akoma nuk është konsoliduar dhe nuk është bërë i rrezikshëm për shpërthimin e një lufte frontale. Për këtë Bashkimi Sovjetik mund të përfitojë nga gjendja e dobët aktuale e Kinës dhe nga pamundësia e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe e vendeve të Evropës Perëndimore që të bëjnë ligjin kudo. Ai ka filluar të grumbullojë rreth vetes së tij një numër shtetesh të lidhura me të në një formë ose në një tjetër, me qëllim që të mund të zgjerojë dominimin e tij edhe në vende të tjera, ashtu siç dëshirojnë e veprojnë edhe rivalët e tij.

Ne konstatojmë se Bashkimi Sovjetik përpiqet të futet në Afrikë, në Lindjen e Mesme, në Afganistan, në Pakistan, mundësisht dhe në Indi. Gjithashtu, aktualisht, ne vëmë re se lidhjet e tij me Vietnamin dhe me Laosin po forcohen. Kjo përbën një *glacis* tjetër sovjetik, por edhe pikë sulmi eventual kundër Kinës nga juglindja e Azisë së Largme.

Në kontinentin afrikan, pavarësisht nga fjalët që thuhet, po të studiohet imtësisht situata, del se qofshin Shtetet e Bashkuara të Amerikës, qoftë Bashkimi Sovjetik, qofshin edhe shtetet e «Evropës së Bashkuar» nuk janë në gjendje të investojnë aq sa duhet. Në Afrikë, në përgjithësi, «Evropës së Bashkuar» i duhet,



sipas statistikave, të investojë të paktën 15 miliardë dollarë në vit, kurse ajo nuk mund të investojë veçse 3 miliardë. Në këtë kontinent më shumë investon Franca. e cila bën një politikë më të afërt me Afrikën e zezë. Kjo vjen për shkak të lidhjeve të saj të vjetra koloniale me këto vende, të cilat propagandohen gjoja si lidhje kulturore, shoqërore, ekonomike etj. Dhe Franca ka tendencë që të influencojë në Tregun e Përbashkët Evropian dhe së toku të krijojnë bllokun eurafrikan, meqë Afrika, jo vetëm për ta, është një kontinent me shumë rëndësi, me popullsi të paktë dhe me lëndë të para në sasi të pallogaritshme. Në përgjithësi Afrika është pak e shfrytëzuar, por megjithatë Afrika Jugore furnizon Evropën me shumë materiale, bile me materiale të rëndësishme strategjike.

Por çështja qëndron në atë që shkalla e investimeve aktuale të «Evropës së Bashkuar» është shumë e paktë, prandaj tendenca e shteteve që e përbëjnë këtë është të krijojnë lidhje me Afrikën e Veriut dhe atë të Jugut dhe të mos lejojnë Bashkimin Sovjetik, por edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës të hedhin kthe-trat e tyre në kontinentin afrikan. Një gjë e tillë bëhet shkak për lindjen e një konkurrence në mes dy superfuqive dhe shteteve të «Evropës së Bashkuar» të marra së toku dhe veç e veç.

Për sa u përket investimeve të Bashkimit Sovjetik në Afrikë, këto janë minimale, por tash së fundi ky ka filluar të futet atje, kërkon baza detare, por ka ndërhyrë edhe ushtarakisht, si në Angola, tok me kubanezët, në Etiopi dhe në Eritre, në Somali, në Aden e

gjetkë. Pra Bashkimi Sovjetik vepron në dy drejtime: të krijojë *glacis*-in sovjetik dhe të përçajë unitetin luftarak që përgatitet dhe zhvillohet në të dy krahët e tij. Një gjë të tillë Bashkimi Sovjetik do ta bëjë edhe në Evropë, edhe në Azinë e Vogël. Dhe në fakt e ka filluar këtë punë, megjithëse ka pasur dhe disfata. Megjithatë, për të një rëndësi të madhe strategjike, aktualisht, merr Mesdheu, sepse nëpërmjet tij pengon NATO-n, mund të rrezikojë ushtrinë e këtij pakti në një konflikt me të, dhe njëkohësisht i pret rrugën «Evropës së Bashkuar» për një bashkim të mundshëm eur-afrikan.

Kështu që Bashkimi Sovjetik, nga ana e vet, duke u infiltruar me shumë mënyra, qoftë me investime (por këto, siç e vura në dukje, janë të pakta), qoftë me propagandë dhe me diversion, përpiqet që Sirinë, Irakun dhe Afganistanin t'i ketë të vetët. Çështja është që dhe këto të mos jenë të rrezikshme për të, por aleate të tij në një luftë kundër Lindjes, domethënë në një luftë kundër treshes, Kinë, Japoni, Shtete të Bashkuara të Amerikës, ose në gjithë këtë pellg të mund të krijojë, duke kapërcyer Gjirin Persik, duke kaluar në Pakistan e në Indi, një *glacis* të madh, me qëllim që të dobësojë rrethimin e vet.

Kurse Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nga ana e tyre, përpiqen të financojnë dhe të armatosin Kinën për ta pasur atë kurdoherë si një faktor të rrezikshëm kundër Bashkimit Sovjetik që do të përpiqet të paktën të mbrojë perandorinë e vet, Siberinë, Mongolinë dhe Azinë Qendrore, ose «të përballojë» një sulmues, kuptohet, të fuqizuar me një potencial të madh ushtarak

dhe ekonomik, që ka përkrah edhe Japoninë militariste të superindustrializuar dhe të armatosur deri në dhëmbë.

Gjithashtu, Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të përpiqen që në konfliktet me Bashkimin Sovjetik të ruajnë Oqeanin Indian, t'i kenë Indinë dhe Birmaninë me vete dhe ta pengojnë infiltrimin e Bashkimit Sovjetik qoftë në Oqeani, qoftë nga toka në gjithë këtë rrip që të çon drejt Gjirit Persik dhe Azisë Qendrore.

Pra, aktualisht gjendja paraqitet e tillë: përgatitjet për luftë po bëhen në ethe; shtetet imperialiste, në radhë të parë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimi Sovjetik dhe Kina vazhdojnë të armatosen. Midis tyre ka kontradikta, të cilat thellohen dhe, për të mos arritur në një luftë bërthamore të përgjithshme, nxitin luftëra lokale. Bashkimi Sovjetik përpiqet të arrijë një detantë me Tregun e Përbashkët Evropian dhe me NATO-n, përpiqet, gjithashtu, t'i zbutë kontradiktat me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, bën një politikë përçarjen e fronteve. Po ashtu Evropa, për të cilën Bashkimi Sovjetik përbën një rrezik të madh, nuk do që të digjet. Ajo është e gatshme të vërë të tjerët, sidomos frontin e lindjes kino-japonez, që të përleshet me Bashkimin Sovjetik dhe të nxjerrë për të gështenjat nga zjarri. Prandaj shohim që investimet dhe shkëmbimet tregtare në mes Tregut të Përbashkët Evropian dhe Bashkimit Sovjetik nuk pengohen, ato zhvillohen jo vetëm me Bashkimin Sovjetik, por edhe me aleatët e tij, me satelitët e Lindjes, pjesëtarë të Traktatit të Varshavës.

Kurse në Afrikë situata është akoma e papërcak-

tuar, për arsye se në shtetet afrikane, që janë «të lira» dhe «të pavarura», sundojnë klika të borgjezisë së madhe, sundojnë bajraktarë dhe feudalë të mëdhenj të lidhur, natyrisht, me ata që u japin më shumë. Dhe këta, në radhë të parë, janë anglezët, francezët, gjermanoperëndimorët, amerikanët pastaj të tjerët, kurse Kina s'u jep gjë fare. Pra, ajo i ka këmbët e shkurtra atje. Asaj i duhet shumë kohë që të futet në Afrikë. Në këtë pellg Kina luan rolin e pllakës së gramafonit për të gjithë. Ajo mbështet Shtetet e Bashkuara të Amerikës, mbështet «Evropën e Bashkuar» dhe u lutet këtyre që ta ndihmojnë atë me çfarë të mundin, ndërsa Bashkimit Sovjetik të mos i japin kredi, që të dobësohet. Bile kinezët këtë e kanë deklaruar.

Prandaj, situata aktuale, në pragun e Vitit të Ri 1979, më duket se është e mbushur me plot rreziqe, është e turbullt, por njëkohësisht edhe revolucionare, se politika e të mëdhenjve imperialisto-revizionistë nuk është e pranueshme nga popujt, këta mbahen me forcë nën zgjedhën dhe nën diktatin e tyre. Popujt i kuptojnë intrigat, manovrat, strategjinë dhe taktikat e tyre dhe nuk rrinë me duar lidhur. Lëvizjet çlirimtare popullore po ngrihen, po shpërthejnë hapur, por ende janë të dobëta. Këto shpërthime mund të jenë momentale, mund të jenë të shkurtra, por prapë janë shpërthime, të cilat i shërbejnë dobësimit të fuqive të mëdha dhe pengojnë shpërthimin e një lufte të re botërore.

Në këtë drejtim ne duhet të punojmë, të luftojmë, të zgjerojmë sa të jetë e mundur kontaktet me masat e gjera të popujve të botës. Duke u lidhur ngushtë me partitë marksiste-leniniste, me njerëzit përparim-

tarë dhe nëpërmjet tyre drejtpërdrejt me ta, ne t'u japim këtyre popujve mendimin e Shqipërisë socialiste dhe të Partisë së Punës të Shqipërisë.

*Botuar për herë të parë në  
librin: Enver Hoxha, «Superfuqitë»,  
f. 474*

*Botohet sipas librit:  
Enver Hoxha, «Superfuqitë»,  
f. 474*

## DISFATA TË KINËS REVIZIONISTE

Shënime

7 janar 1979

Siç kam shkruar edhe më parë, çështja vietnameze është një çështje e krijuar nga Kina, e cila në programin e saj, të një fuqie të madhe, donte ta kishite Vietnamin nën drejtimin e saj politiko-ideologjik, ashtu siç kishte në planin e vet që edhe Shqipëria të ishte nën drejtimin politiko-ideologjik të Kinës, me qëllim që të zbatonte direktivat e saj për të krijuar një aleancë me Jugosllavinë titiste, dhe me Rumaninë revizioniste, kundër Bashkimit Sovjetik, dhe kështu të krijonte një plasdarm për qëllimet e veta në Evropë. Kësaj ajo nuk ia arriti.

Me Vietnamin Kina i ka filluar mosmarrëveshjet që në kohën e luftës. Plani politik i Mao Ce Dunit dhe i Çu En Lait për afrimin me Shtetet e Bashkuara të Amerikës synonte shpëlimin e imperializmit amerikan nga një disfatë e plotë në Vietnam. Për këtë ndërhyrja e Kinës në çështjet vietnameze, në çështjet e luftës së saj, ka qenë e madhe dhe presionet që janë bërë kanë pasur karakter politik, ekonomik dhe ushtarak nëpërmjet furnizimit me armë e me ushqime.

Ne dimë, dhe kështu është, se nga Kina i janë dhënë Vietnamit edhe armë e ushqime, por janë dhënë, ashtu siç na janë dhënë edhe neve kreditë, me një mijë bela. Kur Mao Ce Duni dhe Çu En Lai vendosën të afroreshin me Niksonin, domethënë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, mosmarrëveshjet në mes Pekinit dhe Hanoit u shtuan. Kina kërkonte t'i impononte Vietnamit vullnetin e vet. Vietnami ka kundërshtuar dhe ky kundërshtim është parë në praktikën diplomatike. Udhëheqësit vietnamezë disa herë kanë thënë se nuk i lejojnë asnjë shteti të përzihet në çështjen e Vietnamit. Ata hynë vetë në bisedime me amerikanët, por kjo ishte tjetër çështje dhe ne e kemi dhënë mendimin tonë për këtë. Tash qëndrojmë në marrëdhëniet kino-vietnameze.

Natyrisht, gjatë luftës vietnamezët kanë pasur edhe ndihmën e sovjetikëve. Ne e dimë se ndihma e tyre, këtë e kemi thënë dhe besojmë se kështu është, ka qenë shumë e paktë! Por në udhëheqjen vietnameze tendencat pro revizionistëve sovjetikë kanë qenë më të theksuara. Për shkak të frikës nga Kina, udhëheqja vietnameze, te veprimet e Mao Ce Dunit dhe të Çu En Lait ka parë një politikë djallëzore, të cilën ka kërkuar ta kundërbalancojë me një politikë më të afruar me revizionistët sovjetikë, por brenda disa caqeve e disa kushteve, pse Bashkimi Sovjetik nuk ishte as në gjendje, as nuk donte që të futej për Vietnamin në armiqësi ose në luftë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ai fliste, propagandonte, por nga krahu tjetër merrej vesh, bënte allishverishe të mëdha me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Prandaj Vietnami, pavarë-

sisht se në fund filloi bisedimet, i mundi, si me thënë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, por u gjend në vështirësi nga të dyja anët. Natyrisht, pas çlirimit udhëheqjes së Vietnamit iu shkaktuan vështirësi të mëdha, politike dhe ekonomike. Çështja kryesore ishte ajo e bashkimit të të dyja pjesëve të Vietnamit. Kjo u arrit, por gjendja në fillim ende nuk ishte e stabilizuar, pse në Vietnamin e Jugut ka qenë regjimi i Thieut, ishte ushtria amerikane prej gjysmë milioni njerëzish, ekzistonin korrupsioni, tregu i zi, spiunët, agjentët, sabotatorët e çdo gjë tjetër e keqe. Të gjitha këtyre u duhej vënë fre. Natyrisht, ky fre do të mund t'u vihej kur të forcoheshin disi pozitat e pasluftës në Vietnam e, në radhë të parë, pozitat politiko-ideologjike dhe pastaj ato ekonomike.

Vietnami, i dalë nga një luftë kaq e gjatë, ekonomikisht ishte dhe është akoma në gjendje të vajtueshme, kështu që me siguri ka kërkuar ndihma edhe nga Kina, edhe nga Bashkimi Sovjetik. Të dy këto shtete superimperialiste menduan se erdhi koha që secili për interesat e llogaritë e veta të bënte presion mbi këtë vend. Natyrisht presioni më i madh ishte nga ana e Kinës, pse ishte më afër. Përveç kësaj, brenda në Vietnam kishte miliona kinezë.

Reformat që qeveria vietnameze zbatoi ndaj një pjese të emigrantëve kinezë, të cilët përfaqësonin tregun e zi dhe ishin majmuri në kurrizin e popullit vietnamez, qeveria kineze i përdori për të ngritur një fushatë të madhe antivietnameze dhe i konsideroi si persekutim i madh i kinezëve dhe kështu filluan incidentet kufitare.



Udhëheqja kineze i nxiti kinezët që banonin në Vietnam të ngrinin krye, të sabotonin, të kërkonin me leje e pa leje të iknin nga Vietnam me grupe të mëdha. Kështu që situata u komplikua. Kjo situatë, mendoj unë, është vepër djallëzore e kinezëve. Tok me këtë, nga ana e kinezëve u krijua incidenti i madh kufitar midis Kamboxhias dhe Vietnamit.

Në mes Kamboxhias dhe Vietnamit ka pasur mosmarrëveshje kufitare. Njëri dhe tjetri kishin pretendime të lëna nga kolonializmi i vjetër francez. Këto mosmarrëveshje në mes këtyre dy shteteve, duhej të zgjidheshin në mënyrë paqësore e vëllazërore, por kjo nuk ngjau dhe për këtë ka shumë arsye.

Për sa i përket Kamboxhias, ajo luftoi kundër amerikanëve dhe u çlirua. Lufta e kamboxhianëve u ndihmua nga lufta e vietnamezëve. Ky është fakt dhe kush e mohon këtë, gabon. Natyrisht, edhe kamboxhianët u dhanë lehtësi vietnamezëve në luftën e tyre. Rruga «Ho Shi Min», që i furnizonte forcat e Vietnamit të Jugut nga Veriu, kalonte nëpër xhungla në tokën kamboxhiane. Populli kamboxhian i juglindjes ushtrinë e çlirimit të Vietnamit e ndihmonte me oriz. Por duhet thënë edhe se në Kamboxhia erdhi në fuqi një grup udhëheqësish që quheshin komunistë dhe ne mendonim se ishin të tillë. Por në fakt ata ishin njerëzit e kinezëve dhe mendonin më keq se kinezët, vepruan më keq se kinezët jo vetëm në lidhje me vietnamezët, por edhe në lidhje me popullin e tyre.

Kamboxhia u quajt një vend socialist. Në krye të këtij vendi «socialist» thuhej se ishte në fuqi një parti «komuniste», e cila udhëhiqej nga dy persona kryesorë,

njëfarë Pol Poti dhe Jeng Sari. Ishte në këtë udhëheqje edhe Kieu Samfani. Por kryesorët ishin dy të parët.

Pol Potin as e njohëm ndonjëherë dhe as ia kishim dëgjuar emrin. Ai mbahej i fshehtë, kurse Jeng Sarin e takuam personalisht disa herë dhe përshtypja jonë për të nuk ishte e mirë. Ai nuk ishte marksist. Shumë qëndrime të tij ishin jo vetëm të cekëta, por edhe të gabuara. Megjithatë, për luftën e popullit të Kamboxhias në radhë të parë dhe për komunistët e Kamboxhias ne ruanim një mendim të mirë. Për këtë ne niseshim nga parimi se eksperiencia fitohet, nuk lind askush me eksperiencë të përsosur. Përshtypje të mirë na bëri Kieu Samfani. Ai ishte komandant i përgjithshëm i ushtrisë, njeri i thjeshtë, i matur, i hapët, i çiltër. Por pastaj konstatuam se për të nuk kishin konsideratë të madhe dy personat kryesorë.

Njeriu më në zë i Kamboxhias, për fat të keq të revolucionit të socializmit në këtë vend, ishte një princ, Sihanuku. Ai ishte politikan dhe e mbrojti deri në fund atdheun e tij, Kamboxhian, kundër imperializmit amerikan dhe qëndroi i patundur ndaj tij. Nuk e dëgjuam të fliste keq për komunistët, sido që komunistët ai nuk i donte. Kurdoherë që patëm kontakt me të, ai na thoshte se «Unë do t'i lë ata të vendosin vetë regjimin komunist në Kamboxhia». Në fakt kështu bëri, ose e detyruan të bënte kështu. Sihanukun, siç tha në intervistën e fundit që mbajti në Pekin tash që iku nga Kamboxhia, gati e kishin burgosur, domethënë e mbanin në arrest shtëpie dhe nuk e kanë as të bënte telegram ngushëllimi për vdekjen e Mao Ce Dunit.

Por ç'ishte vepra e klikës së Pol Potit dhe e Jeng:

Sarit që mbështetej nga Mao Ce Duni, nga Çu En Lal dhe nga e gjithë udhëheqja aktuale edhe e mëparshme e Kinës? Këta ishin dy fashistë. Ata bënë kërdrinë kur hynë në Pnom-Pen. Thuhet se vranë me qindra mijë njerëz, për të mos thënë më shumë, zbrazën të gjitha qytetet, të cilat mbetën krejt bosh, gjoja që banorët e tyre të venin në fshat, në orizoret, të nxirrnin bukën. Ky ishte një persekutim në masë, që nuk e ka bërë asnjë diktator fashist. Këtë e bënë të ashtuquajturit komunistë të Kamboxhias, Pol Poti e Jeng Sari me shokët e tyre. Në Pnom-Pen nuk kishte veçse ushtarë. Ambasadat e huaja rronin të rrethuara, mezi u jepnin njëfarë ushqimi, nuk u jepnin asnjë aspirinë. Merre me mend se ç'sjellje mbanin pastaj me popullin e tyre.

Kjo ishte e dënueshme, e padurueshme nga ana jonë dhe tash së fundi ne u detyruam që ta tërheqim ambasadorin. Lamë vetëm dy veta sa për ta mbajtur ambasadën hapur. Ndërkohë filloi konflikti në kufi, bam-bum, çak-bamb, gjoja për territore: ti ma shkele, unë s'ta shkela. Komunikatat ishin të bujshme, sikur bëhej një luftë e madhe. Gjoja 10 mijë veta vritnin në ditë kamboxhianët, vietnamezët gjoja digjnin fshatra të tëra, dhe të gjitha këto veprime të kamboxhianëve bëheshin në koordinim me kinezët, në kohën që nga ana tjetër këta të fundit vepronin vetë me emigracionin e tyre në Vietnam.

Pra dukej qartë që këta elementë antipopullorë, fashistë në Kamboxhia ishin miq dhe mbështeteshin nga Kina, e cila bënte çdo përpjekje që ta nënshtonte Kamboxhian, më vonë të nënshtonte Laosin, të nënshtonte sidomos Vietnamin, nën pretekstin se Vietnam mbështetej nga sovjetikët, dhe këndej të kalonte në nënshtri-

min e të gjitha vendeve të ASEAN-it. Kjo ishte vija politike antivietnameze e kinezëve.

Në këto situata të vështira brenda, të shkaktuara nga lufta, nga emigracioni kinez dhe nga presionet kineze në kufi, të shkaktuara nga klika e Pol Potit dhe e Jeng Sarit me luftime në kufi, Vietnami u detyrua të nënshkruajë traktatin e miqësisë me Bashkimin Sovjetik që t'i kundërvihet Traktatit Kino-Japonez.

Ne e dënuam këtë qëndrim të Vietnamit, pse nuk ishte i drejtë. Dënuam gjithashtu edhe qëndrimin e Vietnamit për hyrjen e tij në KNER. Por, sipas logjikës vietnameze dhe asaj kapitalisto-imperialiste-revizioniste, Vietnami do ta bënte një gjë të tillë, sepse Kina mund të sulmonte Vietnamin dhe derisa Vietnami u lidh me Bashkimin Sovjetik, sulmi kinez cvitohej. Në fakt, Kinës, po të ndërmarrë një aventurë të madhe dhe të sulmojë Vietnamin, do t'i kushtojë shtrenjtë dhe do të pengohet në rrugën e saj të «katër modernizimeve», pse Bashkimi Sovjetik nuk do të rrijë i qetë nga veriu.

Kështu që edhe në këtë çështje udhëheqja kineze pësoi disfatë të madhe. Humbi Vietnamin, humbi Kamboxhian, humbi miqësinë me Shqipërinë, humbi edhe gjithë atë «nam» që kishte fituar dhe në vend të tyre litoi urrejtjen.

Tashti të vijmë përsëri në çështjen vietnameze dhe t'i shohim çështjet më mirë. A duhej të arrinin vietnamezët në këtë shkallë? Po ta gjykojmë se klika e Pol Potit dhe e Jeng Sarit është shtyrë nga kinezët, dhe kështu është, vietnamezët duhej t'i jepnin fund kësaj situatë dhe ata i dhanë fund duke ndërhyrë, pavarësisht se nuk e thonë. Ata kanë ndërhyrë fuqimisht në Kam-

boxhia dhe për këtë ne jemi të bindur. Për këtë qëllim ata krijuan Frontin e Bashkuar të Çlirimit Kombëtar. Ky Front mund të krijohej dhe u krijua shumë lehtë, për arsye të pakënaqësisë së madhe që kishte shkaktuar në masë banda e Pol Potit dhe e Jeng Sarit në Vietnam. Kështu që një ofensivë e rrufeshme e divizioneve vietnameze, nën flamurin e Frontit të Bashkuar të Çlirimit Kombëtar, e likuidoi qeverinë e Pol Potit, pushtoi Pnom-Penin dhe gjithë Kamboxhian. Kina mbeti me gisht në gojë. Sihanuku, gjoja i dërguar nga qeveria e Pol Potit, shkoi në Pekin dhe prej andej në Kombet e Bashkuara.

Në Pekin princi u prit nga udhëheqja e re kineze me të përqafuara e të shtrënguara të duarve. Me të mbërritur këtu, Sihanuku mbajti, për gazetarët e huaj në Pekin, një konferencë shtypi prej 6 orësh. Ai tha: «Unë luftoj për popullin dhe për atdheun tim, Vietnami na ka sulmuar dhe unë do ta sulmoj atë në Kombet e Bashkuara, do të kërkoj që kjo Organizatë të ndërhyjë që ushtritë vietnameze të tërhiqen nga atdheu im dhe Vietnami të përjashtohet nga Kombet e Bashkuara si invador». Shtoi se «Mua më dërgoi qeveria e Pol Potit, megjithatë po jua them se nuk jam dakord me këtë qeveri».

E pyetën Sihanukun a ka vrarë njerëz qeveria e Pol Potit?

Tha se kjo çështje është e tmerrshme dhe filloi të qarët.

«Unë nuk di gjë, sepse isha i burgosur në shtëpinë time dhe dëshiroj të them se nuk jam dakord me qeverinë e Pol Potit.»

«Ku është Pol Poti?» e pyetën. «Nuk e di, por është mirë. Ata thonë, — shtoi princi, — se do të luftojnë me guerilje brenda dhe se Kina do t'i ndihmojë jo duke sulmuar kufijtë e Vietnamit, por se si, ky është një sekret që nuk e di». Vazhdoi duke thënë se çdo gjë varet nga populli i Kamboxhias.

«Në rast se ky popull është i kënaqur me Frontin e Bashkuar Kombëtar të Çlirimit, që u krijua dhe vietnamezët largohen, atëherë është shumë mirë. Por unë më në Kamboxhia nuk shkoj, do të kërkoj strehim, — tha Sihanuku, — ose në Kinë, ose në Francë. Në Kombet e Bashkuara unë e kam për detyrë të mbroj atdheun tim dhe të vete të flas për të bërë të njohur pikëpamjen time për atdheun tim dhe atje do të sulmoj vietnamezët».

Kaq tha princi. Çfarë të thoshte më shumë? Ai doli më i zgjuari, më i fituari, më i respektuari.

Këtë çorbë e gatuan Mao Ce Duni, Çu En Lai, Pol Poti, Jeng Sari. Në këto kushte dhe rrethana udhëheqja vietnameze nuk bëri përpjekje të merreshin vesh me njëri-tjetrin dhe të rezervohej deri diku në lidhjet e saj me Bashkimin Sovjetik; këto lidhje i shfrytëzon me paturpësinë më të madhe Kina e Ten Hsiao Pinit, e cila është kthyer në një vend kapitalist dhe ka lidhur aleancë të ngushtë me imperialistët.

Vietnami ka deklaruar se nuk është për krijimin e Indokinës si përpara, por për miqësinë ndërmjet vendeve të Indokinës: Kamboxhia, Laos, Vietnam, duke ruajtur pavarësinë, lirinë dhe sovranitetin secili prej këtyre shteteve. Aktualisht, por dhe më vonë nga vietnamezët do të punojnë që këto tri shtete të kenë një politikë të përbashkët në interes të sovranitetit, lirisë e pavarësisë

së secilit, dhe të treve së bashku. Sigurisht këto shtete do ta kundërshtojnë çdo politikë agresive dhe kërcënuese që mund t'u vijë nga Kina. Ata do të luftojnë, gjithashtu, që Kina të mos arrijë të hedhë ganxhat e veta edhe në Tajlandë. Edhe në këtë vend, ku politika e tyre do të jetë e njëjlojtë, këto tri shtete do të luftojnë që edhe Tajlanda të mbajë anën e tyre. Kjo i prish planet kineze dhe ndihmon planin sovjetik. Si do të veprojnë këto dy superfuqi, do ta shohim. Por nuk duhen mbajtur në konsideracion vetëm dy suferfuqitë. Duhet mbajtur parasysh edhe vullneti i popujve dhe i qeverive të këtyre vendeve, se mendoj që vietnamezët kanë personalitetin e tyre. Ata kanë luftuar vite e vite me radhë për lirinë, pavarësinë dhe sovranitetin e vet. Tash vietnamezët janë lidhur me sovjetikët, por kam mendimin se nuk do të katandisen si bullgarët, si çekoslovakët, gjithashtu as kinezëve nuk do t'u përulen. Miqësinë me Bashkimin Sovjetik vietnamezët mendoj se do ta kufizojnë deri atje ku e duan interesat e tyre. Më tej ata nuk do të lejojnë, për arsye se kanë vuajtur dhe kanë luftuar shumë për këtë liri dhe për këtë pavarësi. Ky është mendimi im. Koha do të tregojë nëse e kam drejt apo gabim.

Ne do të dëshironim që Vietnami, Kamboxhia dhe Laosi të jenë shtete të lira, të pavarura, të qëndrojnë kundër imperializmit amerikan, kundër imperializmit sovjetik, kundër imperializmit kinez, kundër kapitalizmit botëror dhe me forcat e veta, e në unitet midis tyre, të ndërtojnë vendet e veta, të ndërtojnë fuqinë mbrojtëse të vendeve të tyre, të ndërtojnë socializmin në bazë

të teorisë së Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit. Kjo është dëshira jonë. Për çdo qëndrim tjetër që do të mbajnë, ne nuk do ta mbyllim gojën.

*Marrë nga libri:*

*Enver Hoxha, «Ditar për çështje ndërkombëtare» (botim i brendshëm), nr. 12, f. 11*



# LAVDI POPULLIT IRANIANI

Shënime

14 janar 1979

Populli i Persisë<sup>1</sup> është një popull me tradita të lashta përparimtare, me kulturë të madhe, me një filozofi të gjerë idealiste. Nga gjiri i tij kanë dalë shkrimtarë, poetë, filozofë e shkencëtarë që kanë habitur botën. Veprat e tyre edhe sot janë me autoritet në thesarin e madh kulturor botëror.

Historia e popullit persian dhe e njerëzve të shquar të dalë nga gjiri i tij, është një nga pjesët më të lavdishme të historisë botërore. Shumë nga këta njerëz të mëdhenj, filozofë, poetë, si: Sadiu, Firdusiu, Omar Khajami e të tjerë, e të tjerë, kanë qenë njerëz të thjeshtë të popullit dhe shkrimet e tyre e kanë burimin te populli, pa varësisht se përkraheshin nga shahët e perandorive të ndryshme. Tradita e kësaj diturie, e kësaj shkence, ka kaluar brez pas brezi.

Në kohët moderne Irani u bë pre e imperializmit, si-domos e imperializmit anglez, i cili ishte i pari që zbuloi

---

1. Në vitin 1935 shahu Reza Pahlevi e ndryshoi emrin e Persisë në Iran.

vajgurin në këtë vend, nga mori prej shahëve e princërve të Persisë koncesione të mëdha për «Anglo-Persian Oil Kompani» dhe këto i mori për 5 grosh. Më vonë, kur e pa që dolën thesare të mëdha, Admiraliati i flotës angleze e mori këtë pasuri nën drejtimin e vet, pse pa këtë Anglia nuk mund të kishte një flotë që të dominonte oqeanet dhe nuk mund të zhvillonte një industri të përparuar në metropolin e vet.

Prandaj «Anglo-Persian Oil Kompani» i zgjeroi shumë në favor të vet territoret e shfrytëzimit të naftës rreth Abadanit në Gjirin Persik e më tej dhe e mbushi vendin me puse prej nga thithte «floririn e zi» dhe ndërtoi atje rafineri të mëdha. Që këtej, me vaporë të ndërtuar posaçërisht për këtë qëllim, me cisterna, transportonte në metropole e gjetkë naftën, të cilën, këtë herë, e shiste me flori të verdhë. E gjithë kjo i shërbente strategjisë së imperializmit në synimin për të dominuar botën.

Më vonë, në nxjerrjen, në përpunimin dhe në transportimin e naftës çdo gjë u perfeksionua, me qëllim që fitimet të ishin sa më të mëdha për kolonizatorët dhe mjerimi i popullit iranian të shtohej sa më tepër.

Në Iran lëvonin thërrimet që binin nga sofrat e madhe e Perandorisë Angleze dhe këto thërrime i ndanin në mes tyre shahët, të cilët u jepnin diçka edhe princërve të tjerë në krahina të ndryshme të Persisë, që ishin plot me fusha naftëmbajtëse. Përfaqësuesit e dinastisë së Haxharëve dhe pas tyre ajo e Pahlevëve u bënë pasanikët më të mëdhenj të Persisë e jo vetëm të kësaj, por edhe të botës, sepse Persia arriti të zinte vendin e dytë në glob për nxjerrjen e naftës.

Atje, siç e dimë, kanë ndodhur turbullira e konflikte popullore, të cilat e kanë pasur burimin edhe në rezistencën e popullit kundër shahut dhe shahinave, që bënin një jetë përrallore, por edhe kundër imperializmit anglez që shfrytëzonte pa mëshirë popullin, i cili s'kishte bukë të hantë, s'kishte këpucë në këmbë e s'kishte rroba në trup, në qytete, por sidomos në fshatra.

Të mos flasim për shumë nga këto, po për konfliktin në mes partisë «Tudch» të bashkuar me borgjezinë latifondiste demokrate të Musadekut, nga njëra anë, dhe Perandorisë Angleze të përfaqësuar nga koncesioni i madh i petrolit anglez, nga ana tjetër. Si rezultat i këtij konflikti dhe i kësaj kryengritjeje, Musadeku, në fillim të vitit 1951, futi në dorë pushtetin. Qeveria e krijuar prej tij shtetëzoi naftën, kështu që Perandoria Angleze dhe perandoritë e tjera që merrnin naftë nga Persia rrezikoheshin të mbeteshin me gisht në gojë, pse pjesa më e madhe dërrmuese e të ardhurave të naftës do t'i shkonte popullit iranian, me fjalë të tjera, situata do të ndryshohej përsëri në disfavor të shahut Pahlevi. Fitortja e kryengritjes së forcave që përfaqësonte Musadekun dhe të partisë «Tudch», parti e cila kishte një frymëzim, si me thënë, komunist, e detyroi shahun të largohej me shpejtësi me avion për në Romë, por ndërhyri CIA, e cila, në bashkëpunim me gjeneralët e shahut dhe me demagogji, mashtroi llumin e Teheranit dhe e nxori atë në rrugë gjoja për të mbrojtur Musadekun, por, në fakt, rrethoi pallatin ku gjendeshin anëtarët e qeverisë, të cilët i arrestoi bashkë me Musadekun, shpartalloi pa mëshirë partinë «Tudch», vrau e burgosi anëtarët e saj dhe e mbyti në gjak këtë kryengritje demo-

kratike të popullit. Qendra e kësaj revolte, e cila nuk pati një zhvillim të madh në të gjithë Iranin, ishte Teherani.

Me ndërhyrjen e amerikanëve, natyrisht, pjesa e luanit në vajguri iu dha Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të cilat luajtën rolin vendimtar për shtypjen e kryengritjes popullore. Pjesa tjetër më e vogël i mbeti Anglisë dhe, në radhë të tretë, çka mbetej, e kjo që mbetej ishte përsëri shumë, se aq e madhe që pasuria e naftës, iu dha shahut Muhamed Reza Pahlevi. Kështu, ky u bë një monark i fuqishëm, një megaloman i madh, një perandor që e nxirrte origjinën e tij nga lashtësia e largët që nga koha e asirianëve. Bile edhe 2 500-vjetorin e themelimit të shtetit të parë persian e festoi në shkretëtirë, ku ngriti tenda të mëndafshta dhe thirri të gjithë kryetarët e qeverive të botës, që nga Titoja deri te kinnezët, të cilët shkuan dhe bënë aheng, duke e ngritur në qiell famën e shahut të Iranit, të këtij njeriu barbar, feudal mesjetar, që thithte gjakun e popullit iranian, i cili vuante në mjerimin më të madh në varfëri, në injorancë.

Shahu u bë vale i Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Këto ishin padroni që sundonte, që thithte pjesën më të madhe të vajgurit dhe bënte ligjin në Iran. Të ardhurat që merrte, shahu i investonte jashtë vendit në emrin e tij e të familjes. Ai investonte në shoqëritë e mëdha të çelikut në Gjermani, në Shtetet e Bashkuara e gjetkë, blinte rrugë të tëra plot me pallate dhe me hotele në vendet kryesore të botës, depozitonte flori e gurë të çmuar në bankat e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të Evropës, për t'i pasur si pasuri të tij

vetjake për kohë të këqija. Brenda në vend ai kishte krijuar SAVAK-un, një armë mizore, që vriste e priste cilindo që kundërshtonte, ose që thoshte qoftë edhe një fjalë kundër këtij gjakpirësi.

Këtë herë jo vetëm nafta, por tërë vendi si territor, politikisht dhe ushtarakisht, ishte shitur tek amerikanët. Shahu, për t'u mbrojtur nga populli, kishte blerë nga Shtetet e Bashkuara një sasi të madhe armatimesh nga më modernet që kanë shitur këto jashtë, kishte krijuar një ushtri prej qindra mijë vetash, me të gjitha llojet e armëve, me avionë, me tanke, me mitraloza, me raketa nga më modernet, kishte ndërtuar shumë aerodrome. Të gjitha këto bëheshin për të mbrojtur pasuritë e amerikanëve në Iran dhe pasuritë e shahut, si dhe për ta mbajtur popullin në mjerim.

Natyrisht, një gjendje e tillë nuk mund të vazhdon-te tërë jetën, megjithëse ndihma materiale ushtarake e politike shahut i vinin nga të katër anët e botës. Përveç të tjerëve, edhe perandoria e re kineze i hodhi trëndafila shahut. Vetë Hua Kuo Feni shkoi në Iran<sup>1</sup> dhe me përziermësinë më të madhe bisedoi për një miqësi «të madhe e të shëndoshë» me shahun e Persisë dhe i uroi jetë të gjatë këtij furnizuesi të fuqishëm me naftë të miqve të mëdhenj, Kinës, Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe kapitalizmit botëror.

Hua Kuo Feni u nda si miku më i mirë i shahut të Iranit, por duhet thënë se këto lidhje të Kinës me perandorin e Pahlevëve ishin vendosur edhe para ardhjes në fuqi të Hua Kuo Fenit dhe të Ten Hsiao Pinit. Mao Ce

---

1. Më 29 gusht 1978.

Duni dhe Çu En Lai ishin bërë miq të ngushtë me shahun e Iranit, ku udhëheqës kryesorë kinczë, si Li Hsien Nieni e të tjerë venin e vinin sa herë të donin. Edhe në Pekin pritej me madhështi motra e shahut, një nga pasaniket më të mëdha të Iranit, këshilltare e vëllait të saj në planet për robërimin dhe për shtypjen e popujve dhe një intrigante me nam. Kjo ishte princesha Ashraf, që pritej me nderime të mëdha nga Mao Ce Duni dhe nga Çu En Lai.

Megjithëse forcat e reaksionit, të imperializmit, të revizionizmit, të kapitalizmit botëror vepronin së bashku, nuk mundën ta shtypnin popullin heroik të Iranit. Ndjenja e lirisë dhe e pavarësisë po ziente tek ai si një vullkan i madh, mëria po shtohet, urrejtja dhe zemërimi po rriteshin gjithnjë e më tepër, derisa më në fund populli shpërtheu. Ka tre muaj që gjithë populli i Iranit, proletariati iranian, gjithë punëtorët e naftës u ngritën në revolta të hapëta. Me mijëra, me qindra mijë njerëz, ditë e natë mbushnin rrugët e të gjitha qyteteve të Iranit duke bërë titur: «Vdekje shahut! Poshtë shahu! Jashtë shahu! Jashtë imperializmi amerikan!». Të shtënat e mitralozave, të urdhëruara nga shahu, gjëmonin nëpër rrugë ku vriteshin me qindra njerëz të popullit e megjithatë, përsëri me qindra mijë të tjerë dilnin të nesërmen me trupat e të vrarëve në krahë, me grushtet përplotë, duke protestuar pa pushim. As ushtria, as tanket, asgjë nuk e trembi këtë popull heroik.

Ishte krijuar një gjendje e tillë revoltuese në popullin iranian sa nuk mund të kishte as tank amerikan, as tank kinez, as tank sovjetik, as tank anglez që të ndalonin shpërthimin e tij dhe sulmin kundër perandorisë

mesjetare barbare, shfrytëzuese, skllavëruese të shahut Muhamed Reza Pahlevi, shërbëtor i imperializmit dhe i kapitalizmit botëror.

Kjo tregon se kushtet objektive në Iran ishin pjekur. Një kryengritje e tillë e popullit me një forcë kaq të madhe, sigurisht udhëhiqej nga një moment subjektiv. Kush ishte ky moment subjektiv? Duan të thonë se ishte ndjenja e islamizmit, ishte Ajatollah Khomeini, i cili banon në Paris dhe që andej u jep udhëzime të revoltuarve. Fakt është, dhe duhet njohur, se ky person dhe sekti i tij shiit aktualisht luajnë një rol, si faktor subjektiv, në revoltën e popullit iranian, por në asnjë mënyrë nuk janë vetëm ky dhe sekti i tij forca vendimtare. Në udhëheqje të këtij revolucioni, mund të themi me tipare demokratiko-borgjeze, antiimperialist në Iran, parulla e të cilit është «Vdekje shahut!», është edhe borgjezia përparimtare, fetare dhe afetare, si dhe komunistë e patriotë të vërtetë iranianë. Me muaj të tërë, ditë e natë, pa frikë e me një guxim shembullor, si një «*rouleau compresseur*», kryengritësit çajnë barrikadat e armikut pa u trembur aspak nga plumbat e ushtrisë së shahut, pa u trembur nga vdekja. Froni i Pahlevisë është lëkundur dhe nga dita në ditë pritet të bjerë. Shahu i Iranit në mos sot, nesër me siguri do të qërohet prej andej. Ai ka deklaruar se do të largohet për një kohë gjoja për pushime, por, në fakt, do të largohet për të mos u kthyer më. Shahu po ikën me lezet, por s'ka punë lezeti këtu. Janë forca, rezistenca, kryengritja e popullit që e detyrojnë atë ose të vritet, ose të kapet i gjallë nga populli, ose të marrë avionin e të shkojë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Zaten atje i ka dërguar të gjithë njerëzit

e familjes, kurse ai vetë po qëndron një çikë më vonë, derisa të krijojë njëfarë *modus vivendi*, një qeveri gjoja që të pranohet dhe një regjencë, domethënë të quhet sikur shahu nuk ka dhënë dorëheqjen e që më vonë biri i tij të ketë pretendime për fronin dhe për këtë qëllim ai ka caktuar një person, të cilin e ka mohuar partia e vet, partia e Ajatollah Khomeinit.

Kryesorja është se revolta e madhe e popullit heroik iranian kundër imperializmit botëror, kundër shahut, kundër armëve të panumërta e moderne, kundër asaj kuçedre që dukej e pamposhtur, fitoi. Populli, ndonëse i paarmatosur, me forcën e madhe të vullnetit të tij, që e manifestonte çdo ditë përballë forcave të armatosura të shahut, tregoi se është i pamposhtur, gjë që i tronditi Shtetet e Bashkuara dhe detyroi të largohen nga Irani me dhjetëra mijë specialistë të huaj. Aeroplanmbajtëse të Shteteve të Bashkuara të Amerikës janë afruar në ujërat e Iranit, por pa shpresë. Kështu kësaj radhe CIA e humbi davanë në Iran, nuk fitoi dot si në kryengritjen e Musadekut, sepse këtë herë kryengritja ka marrë përpjesëtime të mëdha. Nafta e Iranit nuk kullon më në sulinat e cisternave angleze, amerikane etj., etj.

Kjo tregon se ç'forcë e madhe është populli. Populli iranian rrëzoi perandorinë dhe e detyroi të dështojë forcën e madhe ushtarake e politike të imperializmit amerikan, të imperializmit botëror. Ky është një fakt me shumë rëndësi. . .

Të gjitha ato që ndodhën në Iran, janë shembull i forcës së popullit dhe tregojnë se faktorët objektivë e subjektivë të revolucionit janë krijuar. Vetëm duhet kuptuar që në këto ngjarje faktori subjektiv nuk është



vetëm dhe thjesht Partia Komuniste marksiste-leniniste e Iranit, pse atje ka të tjera forca progresiste demokratike, borgjeze, antifeudale, antiimperialiste që veprojnë. Që këtej Partia Komuniste marksiste-leniniste e Iranit duhet të nxjerrë mësimë dhe të futet brenda në popull, të jetë në ballë të situatës, të krijojë lidhjet me popullin, me proletariatin, t'i tregojë ç'fitore të madhe korri ai dhe të dijë të ndërtojë aleancat me ata elementë, me ato shtresa demokratike, që morën pjesë aktive në kryengritje dhe tok me ato të shkojë përpara nga etapa në etapë.

Popujt, partitë marksiste-leniniste dhe elementët përparimtarë duhet të nxjerrin konkluzione të drejta nga kryengritja e Iranit. Imperializmi amerikan dhe kryesisht ai sovjetik, që janë në rivalitet për zona influence, zakonisht akuzojnë njëri-tjetrin për organizim kryengritjesh e revoltash në ato vende, popujt e të cilave luftojnë për çlirimin e tyre kombëtar e shoqëror. Këtë e bëjnë me qëllim që t'i denigrojnë këto kryengritje e revolta, t'ua ulin vlerën e vërtetë e t'i sabotojnë më lehtë. Kjo taktikë po zbatohet prej tyre edhe për revoltën e madhe të popullit iranian kundër shahut e imperializmit. Kjo nuk është e vërtetë. Ata, po, kanë gisht në këtë revoltë, por në një drejtim tjetër dhe konkretisht: imperializmi amerikan kërkon të ruajë privilegjet që ka pasur në Iran dhe bëri e bën çmos që t'i ruajë këto privilegje. Imperializmi sovjetik përpiqet të përfitojë nga rasti për të siguruar privilegje për vete. Për këtë qëllim Karteri foli dy-tri herë në mbështetje të shahut të Iranit, po ashtu nuk mbeti pas as

Bashkimi Sovjetik, duke deklaruar se nuk do të lejonte ndërhyrjen e shteteve të tjera në Iran.

Fakt është se në Iran imperializmi amerikan pësoi një disfatë politike, ushtarake dhe ekonomike, u godit aleanca e tij me shahun. Por a i lau duart imperializmi amerikan nga Irani? Është gabim të mendohet e të thuhet se i ka larë krejtësisht duart. Jo, ai do të përdorë taktika të reja, taktika në forma e në mënyra gjoja demokratike, do të përpiqet të hyjë në marrëveshje, në ujdi, natyrisht më pak të favorshme sesa në kohën e shahut, me atë pushtet demokratiko-borgjez që do të vendoset në Iran pas largimit të shahut.

Edhe imperializmi sovjetik ka në Iran elementët e tij, me të cilët vepron për interesat e vet në kundërshtim me ata të imperializmit amerikan. Imperializmi sovjetik nuk ka luftuar shumë kundër shahut, përkundrazi e ka përkëdhelur atë. Bashkimi Sovjetik në Iran ka influencë në kurdët, azerbajxhanasit, por edhe në partinë «Tudeh», të cilën e përdor dhe do ta përdorë për qëllimet e tij. Ai do ta ushtrojë influencën e vet edhe pas krijimit të një qeverie tjetër demokratike, borgjeze, siç predikoi se do të vendoset Ajatollah Khomeini në intervistën që dha në Paris.

Është deklaruar se, pas rënies ose heqjes së shahut dhe me shpalljen e republikës, sipas fjalës së Ajatollah Khomeinit, do të bëhen disa reforma për popullin: do të likuidohet SAVAK-u, e tmerrshmja polici e shahut, që shtypte popullin, ose do të likuidohet ushtria e madhe iraniane, do të nxirren disa njerëz në gjyq, gjë që s'ka dyshim, dhe do të konfiskohet pasuria e disa njerëzve që

kanë abuzuar më tepër e që çështja e tyre është bërë skandaloze.

Aktualisht konstatojmë se shahu, para se të ikë, siç po njoftojnë agjencitë e lajmeve, ka krijuar këshillin e regjencës, ku bën pjesë kryeministri, shefi i shtabit të përgjithshëm e të tjerë. Ky kryeministër, Shapur Baf-tjari, është njeriu i shahut, pra i amerikanëve. A do të mundë ai ta marrë fuqinë, ose të bëjë një grusht shteti? Këtë do ta shohim, por aktualisht atë e mohojnë dhe nuk e pranojnë as masat e popullit, as Ajatollah Khomeini në Paris, i cili ka deklaruar se do të formojë një qeveri të tijën, që do të qëndrojë e paanshme, as me Bashkimin Sovjetik, as me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Nga sa po duket dy superfuqitë imperialiste po bëjnë pazarllëqe në kurriz të popullit iranian, në kurriz të gjakut që u derdh, ndonëse, siç duket, Ajatollah Khomeinit akoma nuk ia kanë marrë krahët as amerikanët, as sovjetikët. Në qoftë se amerikanët arrijnë t'ua marrin krahët Khomeinit dhe pasuesve të tij, atëherë patjetër në Iran do të ngjasë gjakderdhje dhe kryengritja e popullit do të shtypet. Ç'do të bëjnë sovjetikët, këtë do ta shohim. Këta mbase do të përpiqen t'i gjejnë anën Ajatollah Khomeinit, duke bërë që ky të krijojë një qeveri që të shikojë edhe interesat e Bashkimit Sovjetik, ashtu si edhe interesat e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Kjo do të jetë një rrugë e mesme, dhe të shohim nëse do të arrihet kjo rrugë. Sidoqoftë, do të vazhdohet të luhet në kurriz të popullit, pse regjimi demokratik që do të vendoset pas ikjes së shahut, do të jetë një regjim si të gjitha regjimet e tjera të pellgut të naftës, të pellgut të Lindjes së Mesme.

Do të luhen shumë intriga që ky revolucion të mos bëjë reforma të thella. Në këtë vend strategjik me rëndësi të madhe do të duhet akoma një kohë e gjatë që populli të bëhet edhe më i ndërgjegjshëm për forcën e tij të madhe që ka dhe kjo ndërgjegje duhet të krijohet nga një parti marksiste-leniniste e vërtetë. Aktualisht kjo parti pothuajse nuk ekziston, ose është një forcë shumë e vogël, influenca e së cilës akoma nuk ndihet, ose ndihet shumë pak. Influenca sovjetike mund që të ndihet nëpërmjet qeverisë që do të vendoset në këtë vend, por kjo do të ndihet patjetër për interesat e Bashkimit Sovjetik imperialist dhe gjoja në format e një demokracie për popullin. Bashkimi Sovjetik do të futë këmbët në Gjirin Persik, ashtu siç përpiqet t'i futë edhe në Irak.

Prandaj në këtë zonë kaq të rëndësishme për tërë botën, si nga ana ekonomike, ashtu edhe strategjike, do të luhen taktika dhe strategji të shumta, të cilat duhet t'i vëzhgojmë, pse kanë rëndësi të madhe, kanë rëndësi për të ardhmen e botës, në kuptimin që ky rajon mund të jetë shkëndija e një lufte botërore, por mund të jetë njëkohësisht edhe shkëndija e revolucioneve zinxhir, revolucione demokratiko-borgjeze, që mund të kalojnë në revolucione të vërteta...

Lindja e Mesme është në zjarr e në flakë. Irani tash është në pararojë, kurse vendet e tjera të kësaj zone gjenden në rrëmujë, në intriga të panumërta. Popujt e këtyre vendeve janë të topitur, janë nën zgjedhën e kapitalistëve vendës të lidhur me kapitalistë të ndryshëm të huaj. Një gjë i lidh këto vende me njëri-tjetrin: lufta gjoja kundër Izraelit, kurse lidhjet e tjera janë të

dukshme me njërin ose me tjetrin imperializëm, të cilët veprojnë shumë më lehtë sesa veprojnë aktualisht në Iran.

Në ditët e sotme këtu populli është në lëvizje dhe është bërë një forcë e madhe. Por si dhe ku, në ç'drejtime do të kanalizohet, konkretisht çfarë do të dalë nga kjo lëvizje e madhe popullore, këtë do ta shohim. Pozitiv është fakti që për herë të dytë në Iran populli po ngrihet kundër monarkisë, kundër feudalizmit në një luftë antiimperialiste dhe për një demokraci borgjeze popullore progresiste.

*Botohet sipas librit:  
Enver Hoxha, «Shënime për  
Lindjen e Mesme», f. 187*

# **MBI ÇËSHTJEN E PARTISË KOMUNISTE TË ITALISË (MARKSISTE-LENINISTE)**

**Shënime**

**19 janar 1979**

Agjencitë e shtypit italian vënë në dukje se një anëtar i Byrosë Politike të Partisë Komuniste të Italisë (marksiste-leniniste), mbajti një konferencë shtypi, ku asistonin 100 korrespondentë të gazetave e të agjencive të lajmeve. Gjithashtu ishin ftuar në këtë konferencë dhe atashetë e shtypit të të gjitha ambasadave, edhe yni, me përjashtim të atashetut të zyrës së shtypit kinez.

Ky person, i cili është djali i një anëtari të komitetit qendror të partisë revizioniste italiane, do të jetë drejtori i gazetës së re teorike me emrin «Otobre», që do të nxjerrë Partia Komuniste e Italisë (marksiste-leniniste).

Siç e kam shënuar, udhëheqës të kësaj partie kanë thënë se do të botonin një gazetë teorike, vetëm kaq, por se si do ta kishte emrin, se ç'tirazh e ç'formë do të kishte, nuk është thënë gjë. Me fjalë të tjera, botimi i kësaj gazete doli si papandehur dhe u bë me bujë të madhe nga ana e tyre. Në konferencën e shtypit u tha se në këtë gazetë do të lejohen të shkruajnë edhe ata që nuk janë dakord me partinë revizioniste italiane.

Para kësaj konference një udhëheqës i kësaj partie kishte vajtur dhe i kishte thënë një shokut tonë që këtë gazetë do ta nxjerrim me iniciativën e «këshillave të punëtorëve» (që gjoja janë nën drejtimin e kësaj partie), se ata paguajnë për nxjerrjen e kësaj gazete dhe vinin në dispozicion shtypshkronjën.

Për sa i përket shtypshkronjës, shokët e Partisë Komuniste të Italisë (marksiste-leniniste) kanë kërkuar ndihma në të holla, por një nga korrespondentët e gazetave borgjeze italiane, që bën një artikull për këtë gazetë, thotë se shtypshkronja ku do të shtypet kjo gazetë qenka pronë e një tregtari të madh, i cili ia kishte falur dhëndrit të tij me shpresë që këtij t'i vinte mendja në vend. Pra për këtë shtypshkronjë ka diçka që nuk është shumë ortodokse, si me thënë.

Përveç të tjerave, dëgjojmë se në kongresin e ardhshëm të partisë revizioniste italiane do të ketë shisione dhe elementët që do të bëjnë pjesë në to do të bashkohen me partinë marksiste-leniniste të Italisë dhe ka nga ata, që janë edhe persona të njohur, që do të shkëputen nga partia e Berlinguerit dhe do të shkruajnë në gazetën «Otobre». Gjithashtu një nga drejtuesit e kësaj partie kishte thënë se neve (italianëve) na vihet si detyrë të punojmë edhe me udhëheqjen e partisë revizioniste sovjetike, por edhe me marinarët sovjetikë, të cilët kanë kontakte me njerëzit tanë nëpër porte dhe simpatizojnë Stalinin.

Në këtë çështje ka disa të panjohura që janë të dyshimta. E para e punës, kjo parti kërkonte ndihmë nga ne për ta bërë të përditshme gazetën «Nuova unita». Ne i thamë se nuk kemi mundësi, pra organi «Nuova

Unita» nuk po del i përditshëm, ai mbetet i përjavshëm dhe dihet që kjo është gazeta kryesore, kurse në konferencën e shtypit u tha se gazeta e re «Otobre» do të ketë 12 faqe, afërsisht sa gazeta jonë «Drita» dhe do të shtypet çdo ditë me tirazh 35 mijë kopje. Bëhet pyetja: ku i gjetën këto të holla shokët e Partisë Komuniste të Italisë (marksiste-leniniste) për të nxjerrë një organ të tillë teorik me një tirazh kaq të madh, me kaq fletë, kur ata kërkuan nga ne subvencion që ta bënin «Nuova unita»—në të përditshme? Kjo është një pyetje.

Pyetja e dytë të lind për çka thonë ata në lidhje me marinarët sovjetikë. Ne s'kemi asnjë dyshim se ka marinarë sovjetikë që e duan Stalinin, e që, natyrisht, nuk flasin, por një ose dy nga këta marrin kontakt me shokë marksistë-leninistë. Kjo është e drejtë, por duhet të mos harrojmë se Partia jonë është shumë më e vjetër nga Partia Komuniste e Italisë (marksiste-leniniste) e megjithatë s'ka ardhur asnjë marinar sovjetik që të kërkojë kontakt me ne e të thotë që unë jam kundër regjimit, kurse tek italianët paskan vajtur! Kjo na çudit pak. Pastaj një nga këta anëtarë të Partisë Komuniste të Italisë (marksiste-leniniste), më duket se është ky që bëri konferencën e shtypit, ka thënë se «ne do të kemi një korrespondent tonin në Moskë». Gjithashtu ka thënë që ata konstatojnë se aktualisht Bashkimi Sovjetik është dobësuar, kurse imperializmi i Shteteve të Bashkuara është bërë më i fortë. Ai paska thënë, gjithashtu, se Brezhnjevi është një nga ata persona në Bashkimin Sovjetik që mund të bëjë një kthesë.

Të gjitha këto thënie, natyrisht, janë të pakontrolluara dhe të mohueshme, por sidoqoftë në këtë mes



ka disa gjëra të errëta. Cilat janë këto? Është ajo që thashë më parë, ku gjenden të hollat për të shtypur këtë gazetë, sepse «këshillat e punëtorëve» italianë nuk kanë mundësi të japin një ndihmë të tillë për ta nxjerrë gazetën. Këto të holla vijnë nga dikush dhe, pra, cili është ky «dikush», kjo duhet parë.

Udhëheqësit e kësaj partie hiqen miq dhe dashamirë ndaj nesh e në unitet me pikëpamjet e Partisë sonë të Punës. Kjo kështu ka qenë, kështu është edhe tash.

Ata janë shprehur, dhe tash po e theksojnë, se me gazetën e tyre e sidomos me gazetën e re që do të dalë, do të shkaktojnë shisione, përçarje në partinë revizioniste italiane dhe do të heqin nga radhët e saj njerëz, të cilëve do t'u japin mundësinë të shkruajnë në gazetën «Otobre». Të tillë njerëz do të ketë edhe nga baza, por edhe nga udhëheqja e partisë revizioniste italiane. Kjo deri diku është e rregullt, domethënë fakti që Partia Komuniste e Italisë (marksiste-leniniste) duhet të përpiqet edhe në bazë, por edhe në udhëheqje që ta përçajë partinë revizioniste të Italisë dhe t'i tërheqë elementët pozitivë të bazës rreth vetes në luftë kundër imperializmit italian, borgjezisë kapitaliste italiane, partive të borgjezisë dhe partisë revizioniste. Pra kjo është e drejtë, por këtu duhet pasur kujdes, se në këtë mes mund të ketë ndonjë manovër nga ana e borgjezisë italiane. Ka mundësi që në Partinë Komuniste të Italisë (marksiste-leniniste) të kenë hyrë njerëz të tillë, të cilët, të maskuar nën petkun e komunistëve, bëjnë punën e policisë italiane. Cila është puna e kësaj policie, e demokristianëve dhe e të gjitha partive të

tjera të borgjezisë italiane? Të shpartallojnë ose të dobësojnë partinë revizioniste italiane, dhe ka mundësi që një nga këto mjete në duart e tyre të jetë edhe Partia Komuniste e Italisë (marksiste-leniniste).

Në qoftë se supozojmë një gjë të tillë kjo tentativë është vetvetiu e maskuar dhe nuk zbulohet lehtë, për arsye se është një nga detyrat e partisë marksiste-leniniste që të luftojë kundër revizionizmit. Domethënë një gjë e tillë i intereson kapitalit italian dhe mundet që në partinë revizioniste të krijohen shisione. Unë mendoj se këto shisione të partisë revizioniste, sidomos në udhëheqje, nuk mund të jenë kurrë në favor të marksizëm-leninizmit, sepse udhëheqësit e kësaj partie janë të gjithë të komprometuar, janë antimarksistë; në bazë mund të gjejmë elementë të shëndoshë, por në krye zor se gjejmë. Këta që po përpiqen të krijojnë shisione në kongresin e ardhshëm të partisë revizioniste do të jenë sigurisht si ata elementët që ngritën krye në Partinë Komuniste (revizioniste) të Francës kundër Marshesë dhe që filluan të shkruanin në gazetën «Lé Mond» dhe në gazetatat e tjera të borgjezisë, veçse këtu, në Itali, për këtë qëllim po financohet një gazetë e re me emrin «Otobre», së cilës po i japin bujë të madhe në emër të Partisë Komuniste të Italisë (marksiste-leniniste). Në këtë gazetë shfaqin mendimin e tyre këta shisionistë, që, në fakt, janë revizionistë, por që fshihen nën petkun e antiberlingueristëve.

Por nuk është e thënë që këta shisionistë të partisë revizioniste italiane të bashkohen vetëm me Partinë Komuniste të Italisë (marksiste-leniniste) për ta likuiduar këtë, se mund të ketë edhe nga ata që të bashko-

hen me grupe të tjera të majta, të ashtuquajtura ekstra-parlamentare, që të bëjnë punën e policisë italiane dhe të hiqen si të majtë. Terroristët dhe të gjitha grupimet që ekzistojnë në Itali e që një pjesë është pro Kinës, një pjesë përbëhet nga «brigadat e kuqe» e shumë emërtime të tjera, të cilat gjoja luftojnë kundër pushtetit në Itali, por që në të vërtetë lufta e tyre drejtohet kundër komunizmit, policia italiane i përdor për të krijuar pasiguri në popull, urrejtje kundër të gjitha organizatave me emrin «brigadat e kuqe», «Fronte unità proletaria» etj., etj., të cilat hiqen si komuniste e kundër pushtetit të borgjezisë. Në fakt të gjitha këto grupime janë nën drejtimin e borgjezisë italiane.

Këtu është rreziku që shokët italianë ka mundësi të mos e kuptojnë dhe mendojnë se është një gjë e mirë e mundohen ta shfrytëzojnë. Pra ekziston mundësia që të përdoren këta shokë ose që disa njerëz të depërtojnë e të bëjnë punën e policisë italiane në këtë parti.

Një gjë që neve na ka rënë në sy është se kjo parti është shumë pretencioze dhe harxhon mjaft të holla, duke dërguar delegatë në të gjithë Evropën për të marrë kontakt me partitë e tjera. Ka mundësi që t'i jetë caktuar edhe një rol tjetër kësaj partie, nëpërmjet ndonjërit nga udhëheqësit e saj, që e ha këtë, të shpartallojë forcën marksiste-leniniste që po ngrihet dhe sidomos, duke menduar se Partia Komuniste e Italisë (marksiste-leniniste) është mike e Partisë së Punës të Shqipërisë, të infiltrohet edhe në Partinë e Punës të Shqipërisë, por edhe në qoftë se nuk do të mund të infiltrohet, se s'ua hedh dot shqiptarëve, të paktën të bëjë një punë sabo-

tuese në radhët e partive të tjera komuniste të Evropës. Tash kjo është një mundësi.

A mund të jetë kjo vegël e sovjetikëve? Mundet që sovjetikët të kenë gisht edhe në Partinë Komuniste të Italisë dhe kanë interes që nëpërmjet saj t'u bëjnë presion partive revizioniste të Evropës Perëndimore ose eurokomuniste që të mos mbajnë qëndrime antisovjetike. Edhe kjo është një mundësi tjetër.

Kjo gjë lidhet vetëm me atë çështje që duket parimore, për të cilën udhëheqësit e kësaj partie thanë se «duhet të punojmë edhe me partitë e tjera revizioniste, edhe me atë sovjetike, pse edhe në partinë sovjetike ekzistojnë elementë kundërshtarë dhe që e duan Stalinin». Kjo në parim, që duhet të punojnë, është e drejtë, por na çudit çështja tjetër që situatat ndërkombëtare kjo parti i gjykon se janë të disfavorshme për Bashkimin Sovjetik dhe këtej mund të dilet me konkluzionin që Bashkimi Sovjetik duhet të forcohet, të kundërbalancojë gjoja peshën e imperializmit italian, prandaj lufta që duhet të bëjë kjo parti, në ndihmë të Bashkimit Sovjetik, është që të godasë eurokomunistët që nuk i binden Moskës. Edhe kjo është një gjë që mund të shikohet, por e vërteta është se Bashkimi Sovjetik, me gjithë kontradiktat që ka me partitë revizioniste të Evropës Perëndimore, prapëseprapë mund ta gjejë fjalën me to më mirë sesa me Andreotin e me Zhiskar d'Estënin. Me këta Bashkimi Sovjetik, gjithashtu, do të jetë në miqësi, por ai do njëkohësisht që revizionistët të futen në qeverinë e Andreotit e të Zhiskar d'Estënit, të Kallaganit etj., dhe atje të mund të punojnë, ashtu si të munden, për interesat e tij, sepse të tërë një ngjyrë kanë këta,

pra për të dobësuar rezistencën e borgjezisë evropiane përballë socialimperializmit sovjetik. Ky është qëllimi kryesor i sovjetikëve, por nuk ekskludohet që edhe bishtrat, domethënë grupimet e ndryshme, deri edhe «brigadat e kuqe» Bashkimi Sovjetik t'i përdorë për qëllimet e veta, pra të ketë gisht ashtu siç ka edhe në kroatët, edhe në shqiptarët e arratisur jashtë që veprojnë kundër nesh. Bashkimi Sovjetik revizionist po i luan të tëra kartat.

Me një fjalë ne sot për sot akoma nuk mund të themi ndonjë gjë të rëndë për Partinë Komuniste të Italisë (marksiste-leniniste) dhe për udhëheqjen e saj, por vetëm shohim disa shfaqje që na krijojnë pikëpyetje<sup>1</sup>. Do të shohim se si do të zhvillohet situata. Ne duhet të mbajmë lidhje me ta dhe të përpiqemi t'u shpjegojmë qëndrimet tona, po ashtu t'u themi atyre të jenë vigjilentë, se partinë e tyre nuk e kanë të fortë e të kalitur dhe nuk duhet të shkojnë nga mendimi se në partinë e tyre, deri edhe në udhëheqje, policia italiane nuk bën përpjekje e nuk ka mundur të futë njerëzit e vet. Armiku ka arritur të veprojë edhe brenda radhëve të Partisë sonë, bile deri në udhëheqje të saj, që është një parti e vjetër, një parti e fortë, një parti që e zbaton me besnikëri marksizëm-leninizmin dhe që është parti në fuqi.

Prandaj mund të ekzistojë mundësia që këta të jenë thyer. Të gjithë ose një pjesë e personave me rëndësi në udhëheqje mund të jenë thyer nga «brigadat e kuqe» dhe nga grupimet e tjera terroriste, që u kanë impo-

1. Shih në këtë vëllim, f. 282.

nuar të ndjekin një rrugë të tillë. Këtë rrugë deri tashti e maskojnë me vijën e tyre që në vija të përgjithshme nuk ke ç'i thua. Që ata duhet ta përçajjnë partinë revizioniste, e theksova se është e drejtë, që bazën duhet ta afrojnë, edhe kjo është e rregullt, por të jenë të kujdesshëm në futjen e këtyre elementëve në partinë marksiste-leniniste. Njerëz nga udhëheqja e partisë revizioniste duhet të shkëputin, por do të jetë një gabim i madh po t'i futin këta brenda në partinë e tyre. Edhe ajo që gazetën «Otobre», të cilën e konsiderojnë gjoja si një gazetë teorike të partisë ku mund të shkruajnë këta disidentë antimarksistë të vjetër, është përsëri një gabim dhe një gjë që na lë të dyshojmë.

Do të shohim ç'vijë do të ndiqet nga shtypi i partisë marksiste-leniniste, që nga «Nuova unita», «Otobre» dhe ç'do të na thonë neve për problemet ndërkombëtare. Çfarë mendimesh do të shprehin ata për eventet, si zhvillohen e qysh zhvillohen. Ne do t'u themi mendimet tona dhe do të shohim nëpërmjet pikëpamjeve të tyre nëse luhet ndonjë manovër këtu apo kemi të bëjmë me njerëz megalomanë, me fanfaronë, me nai-vë, të cilët mund të bien fare kollaj në kurthe, me njerëz të frikshëm, që janë thyer dhe që kanë nevojë për të holla për të jetuar në një mënyrë ose në një mënyrë tjetër.

*Marrë nga libri:*

*Enver Hoxha, «Ditar për çështje ndërkombëtare» (botim i brendshëm), nr. 12, f. 45*

## MBLEDHJET E BYROSË POLITIKE TË JENË TË GJALLA, ME DEBATE

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

25 janar 1979

Në projektplanin e çështjeve, mund t'i marrim në analizë në Byronë Politike, siç u diskutua edhe këtu, të tria ato probleme. Atëherë meqë kemi edhe aktivitete të tjera e lëmë kështu, të mos bëjmë tri mbledhje, por dy, një në janar, këtë që do të bëjmë tani, dhe një tjetër në vjeshtë. Problemin tjetër që është menduar për ta shqyrtuar në një mbledhje plenumi në muajin qershor, mendoj ta lëmë për një mbledhje të Byrosë Politike.

Unë kam një vërejtje të përgjithshme, për të cilën në qoftë se pranohet, të vendosim sot këtu. E kam fjalën për materialet që i vijnë Byrosë Politike. Mendimi im është që, meqenëse disa prej nesh anëtarëve të Byrosë nuk janë të rinj, pra dhe mosha po bën punën e

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua edhe rreth projektplanit të çështjeve që do të shqyrtonin Byroja Politike dhe Sekretariatit i Komitetit Qendror, gjatë vitit 1979.

vet, vitet po kalojnë njëri pas tjetrit, në Byro të paraqiten kryesisht projektvendime, materiale të shkurtra me gjërat më kryesore dhe të hiqen hyrjet e mbylljet e gjata. Të evitohet raportet, relacionet me shumë «ujë». Megjithëse kemi vënë një kufi për këto materiale që ato të mos jenë më shumë se 5 faqe, prapëseprapë edhe këtë nuk e respektojnë, po nga 15 faqe material na paraqesin. Sado që të më thuhet mua të mos e lexoj këtë apo atë material, unë do t'i lexoj materialet që paraqiten, pavarësisht se janë të gjata. Kurse në rastet kur më jepet një faqe me disa mendime kryesore e me shifra, atëherë e kam më të lehtë punën. Dhe një material i tillë i shkurtër është plotësisht i mjaftueshëm, sepse për mua nuk janë të huaja problemet që trajtohen.

Kur problemet trajtohen shkurt, në mënyrë koncize në raport si dhe me gojë nga ata që e kanë përgatitur atë, atëherë në mbledhje çdo gjë del e qartë, shohitet mirë dhe vihen pikat mbi i. Kështu mund të nxirren edhe detyra të studiuara e vendime të pjekura. Kurse po të jetë raporti i gjatë, problemet mbulohen nga frazat dhe të ftuarit nuk thonë gjë, sepse justifikohen me atë që «çdo gjë është thënë në raport». Por kështu çështjet nuk qartësohen e nuk përcaktohen ato masa që duhen për të ocour drejt realizimit e tejkalimit të detyrave. Një raport të tërë të jep iks apo ypsilon kuadër, kur i bëhet vërejtje për moszbatimin e detyrave dhe të nxjerr njëkohësisht një varg vështirësish e justifikimesh. Në këtë raport ai nuk bën asnjë propozim konkret që udhëheqja pastaj ta kthejë në vendim, por në të gjitha ato 5 faqe raport vetëm thotë që Partia duhet të bëjë kështu e ashtu. Po pse i thotë këto? Përse



nuk e bën ai alje ku militon Partinë të veprjës? Përse i kemi gjithë ata kuadro që punojnë në organet e Partisë? Ai i bashkimeve profesionale, për shembull, ose i komitetit të Partisë thotë duhet të bëjë kështu Partia, duhet të bëjë ashtu që të ketë disiplinë të fortë në punë etj., etj. Mirë, dakord themi që të bëjë Partia. Po kush është Partia? Ne komunistët jemi, prandaj të gjithë t'i futemi punës për të vënë në lëvizje njerëzit dhe të mos mbetemi vetëm në fraza.

E dyta, një pjesë prej nesh, jemi anëtarë të Byrosë Politike me një stazh të gjatë dhe gjatë kësaj periudhe kemi luftuar dhe punuar si punonjës partie prandaj dhe nuk kemi nevojë t'i bëjmë agjitacion e propagandë njëri-tjetrit as të flasim me perifrastime. Po të veprhet në këtë mënyrë i mësojmë keq edhe shokët që vijnë nga baza të na thonë më shumë fraza sesa të na raportojnë shkurt, me pak fjalë, por saktë e qartë se si i kanë realizuar detyrat, planin, ose, në qoftë se nuk i kanë realizuar, të shpjegojnë pse, të tregojnë shkaqet e mosrealizimit. Pra e kam fjalën që të jemi sa më konkretë e të rrahim mendimet me njëri-tjetrin. Kjo do të bëjë që mbledhjet e Byrosë Politike të jenë të gjalla, me debate. Dhe debatet, mendoj unë, do të jenë shumë më të frytshme kur mbledhjes i paraqiten projektvendime, rreth të cilave të diskutohet gjerësisht. E them këtë sepse ndodh që materialet që vijnë në Byrosë Politike nuk shoqërohen me propozime konkrete e me projektvendimet përkatëse. Por a do t'i mësojmë këta shokët këtu në aparatën e Komitetit Qendror që të punojnë me një stil e me një metodë efektive për udhëheqjen? Duhet mësojmë t'i mësojmë e t'ua kërkojmë një gjë të tillë,

sepse ky stil dhe kjo metodë pune që praktikohet, nuk janë të frytshme.

Kur paraqiten projektvendime dhe diskutohet për to, atëherë edhe personat përgjegjës të ftuar në mbledhje, qoftë ministri, sekretari i Partisë, apo kryetari i komitetit ekzekutiv, do të raportojnë me gojë, por edhe do t'u përgjigjen pyetjeve, do të shpjegojnë e do të argumentojnë vendimin. Edhe këtyre shokëve ne duhet t'u kërkojmë që të na raportojnë këtu si duhet, shkurt dhe konkretisht, sepse në qoftë se na raportojnë ashtu siç përgatitin ato raportet që na dërgojnë atëherë nuk kemi përmirësuar gjë.

Kështu, për shembull, kur të vijë të raportojë për qymyret drejtori i një miniere, zëvendësministri ose ministri i Industrisë dhe i Minerave, ai duhet të jetë menduar mirë më parë që të thotë këto e këto, pa fraza, të thotë që gjendja e qymyreve është në këtë apo në atë situatë, për këto e këto arsye, dhe të propozojnë se ç'masa partie ose shtetërore duhen marrë. Mbi këtë bazë reflektohet dhe projektvendimi, pastaj i bëhet ndryshimi përkatës. Në këtë mënyrë, pas debatit dhe siç përfundon çështja, më duket mua, i arrihet më mirë qëllimit dhe ne i mësojmë njerëzit të ecin me një stil tjetër pune që, pa dyshim, siç e theksova, është edhe më i frytshëm.

Jam dakord me mendimin që u tha këtu që të vihet një faqe relacion me projektvendimin veçse të bëhet kujdes që nga një faqe relacioni të mos vejë 5-6 faqe. E theksoj këtë, sepse e kemi një eksperiencë të tillë.

Qeveria ka një praktikë pune më të drejtëpërdrejtë me vendime, urdhëresa etj., prandaj në mbledhjet e saj

u referohen këtyre, pyetet e kontrollohet dhe kërkohet llogari.

Edhe ne këtu në Byro, kam mendimin që për këto që diskutojmë të merren vendime dhe konkluzionet që dalin nga këto diskutime të dërgohen menjëherë dhe rregullisht në bazë. Nuk mjafton që të dërgohen vetëm protokollat, buletinet me fjalën time. Por ta bëjmë rregull që nga protokollat e mbledhjeve të nxirren konkluzione që të kthehen në vendime të Byrosë Politike. Se vendimi është vendim, i detyrueshëm për t'u zbatuar. Dhe kështu kemi vepruar ne. Nga konkluzionet e Byrosë Politike kanë dalë edhe vendimet. Dhe kur merret një vendim ai duhet meoemos të zbatohet.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH,  
që gjendet në AQP*

# ZBATIMI I VIJËS SË PARTISË DHE I LIGJSHMËRISË KËRKON RRAIJE MENDIMESH DHE RRUGËZGJIDHJE TË DREJTA

*Diskutim në mbledhjen e Presidiumit  
të Kuvendit Popullor të RPSSH<sup>1</sup>*

27 janar 1979

Me leje, shoku Haxhi [Lleshi], dëshiroj të them edhe unë disa fjalë. Meqenëse është hera e parë që po mbledhet Presidiumi i ri i Legjislaturës së 9-të, nga ana e Komitetit Qendror ju sjell përshëndetjet revolucionare dhe urimet më të mira për kryerjen me sukses të detyrave. Siç e dimë, Komiteti Qendror dhe Partia e vlerësojnë lart Presidiumin e Kuvendit Popullor, si një nga organet më kryesore të pushtetit tonë pas Kuvendit Popullor, që, në periudhën ndërmjet sesioneve, duke i qëndruar besnik vijës së Partisë dhe Kushtetutës sonë, mbron ligjshmërinë socialiste. Komiteti Qendror na rekomandon të jemi kurdoherë besnikë të vijës së Partisë dhe ne kemi qenë, jemi e do të jemi deri në fund të

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit «Mbi politikën e faljes së dënimeve gjatë viteve 1976-1977».

tillë; ai kërkon të jemi vigjilentë për ruajtjen e pastërtisë së vijës së Partisë nëpërmjet zbatimit të ligjeve, të punojmë që të jenë gjithnjë të drejta këto ligje, të cilat i miratojmë këtu si dekrete, pastaj i paraqiten Kuvendit Popullor për t'u miratuar si ligje.

Si kurdoherë, Partia na mëson, që, duke marrë parasysh edhe detyrat e këtij organi të lartë, të jemi parimorë e të drejtë në mendime dhe t'u kushtojmë vëmendje të veçantë çështjeve kapitale që kanë rëndësi vendimtare për shtetin tonë të diktaturës së proletariatit. Të mos merremi me gjëra të vogla, se këto nuk janë për Kuvendin Popullor. Natyrisht, normat e Partisë, për ne, si dhe për të gjithë komunistët e të gjitha forumet, që nga Komiteti Qendror e deri në bazë, në të tërë organizmat e pushtetit, duhet të zbatohen në frymë të drejtë partie, marksiste-leniniste, shoqërore. Fjalën e kam gjithnjë për probleme të rëndësishme, për të cilat të zhvillohen debate parimore. Kurdoherë ka qenë e qartë që secili nga ne ka të drejtë të thotë mendimin e vet, dhe këtu në Presidium kushdo nga ne ka kompetenca, të cilat duhet të respektohen. Ky është një respekt i vetëdijshëm që rrjedh nga fryma revolucionare e Partisë sonë dhe nga mësimet jetëdhënëse të marksizëm-leninizmit. Ne jemi nga ata njerëz që nuk abuzojmë kurrë me funksionet që na cakton Partia dhe kompetencat duhet t'i zbatojmë që të gjithë, sepse e kemi për detyrë. Shoku Haxhi Lleshi, në të gjitha sesionet, na ka drejtuar e na ka ndihmuar si kryetar i Presidiumit. Partia është e bindur se ai do të vazhdojë të drejtojë edhe më mirë akoma e me konsekuencë, po edhe ne, si anëtarë të këtij organi, do të bashkojmë veprimtarinë dhe ndihmën to-

në, në mënyrë që punët të shkojnë drejt, të shkojnë kurdoherë mirë.

Këto gjëra dihen prej nesh, megjithatë me këtë rast desha t'i theksoja edhe një herë. Çështja është të bëjmë të gjitha përpjekjet që në këtë organ të lartë këto cilësi të ekzistojnë gjithnjë dhe të vërtetohen në jetë ato që thashë më parë për zbatimin e vijës së Partisë nëpërmjet zbatimit të ligjshmërisë. Vija e Partisë, zbatimi i saj, jo vetëm këtu, por edhe në çdo forum partie ose pushteti, nuk durojnë as burokratizëm, as familjaritet, por kërkojnë shprehje mendimesh, diskutimesh dhe gjetje të rrugës më të drejtë për zberthimin dhe zgjidhjen e atij ose të këtij problemi.

Ne kemi të drejta dhe kompetenca të shumta: mund të thërresim në raport dhe të kontrollojmë Këshillin e Ministrave dhe çdo organ tjetër të administratës shtetërore, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme etj. Në qoftë se anëtarët e Presidiumit nuk janë të bindur për një çështje, të diskutojmë, të rrahim mendime që të sqarohen gjërat. Mund të duket sikur këtu s'ka fare çështje për të cilat të shfaqen mendime të kundërta. Kjo vjen për arsye të unitetit të mendimit e të veprimit që ekziston në radhët tona, por, në të vërtetë, probleme ka. Ato, kur është e nevojshme, mund t'i shtrojmë edhe në Byronë Politike, ku u jepet një zgjidhje më e drejtë, në bazë të diskutimeve.

Për të mos u zgjatur, edhe një herë, në emër të Komitetit Qendror ju sjell përshëndetjet e tij dhe ju uroj punë të mbarë.

Unë do të propozoja, besoj se edhe ju do të jeni dakord, të ngarkojmë shokun kryetar të Presidiumit t'i

çojë shokut Myslim Peza urimet tona më të mira, për të qenë kurdoherë me shëndet të mirë e me jetë të gjatë. Ne e kuptojmë dhe e ndiejmë mungesën e tij, por kur ai ta shikojë të mundshme që të vijë këtu, për ne do të jetë një gëzim i madh. Dakord atëherë, të vejë shoku Haxhi.

Tash lidhur me pikën e parë të rendit të ditës. Unë jam dakord me raportin, dhe i gjej me vend proporcionet e faljeve të ndryshme të dënimeve sipas fajeve. Besoj se nuk e kemi gabim, por e kemi drejt. Proporcionet e faljeve nga propozimet që vijnë, pavarësisht se ne këtu i diskutojmë, në përgjithësi ruajnë frymën e vërtetë e të drejtë të ligjshmërisë e të vijës së Partisë sonë. Ato bëhen duke mbajtur parasysh edhe situatën e brendshme politike të vendit tonë, edhe pozitën e Shqipërisë në kuadrin e situatës ndërkombëtare. Gjithashtu, unë jam dakord edhe me të gjitha vërejtjet që bënë shokët.

Kisha vetëm disa pyetje, përgjigjet e të cilave do të shërbejnë për të më informuar. Shoku Aranit Çela<sup>1</sup>, në qoftë se ka mundësi, të na shpjegojë më hollësisht disa gjëra. Për shembull, një person që dënohet dhe mendon se dënimi i tij nuk është i ligjshëm, ku ankohet në shkallë të dytë? Ankesa vjen drejtpërdrejt në Gjykatën e Lartë apo në këshillin gjyqësor pranë gjykatës së rrethit?

*Pasi iu dha përgjigje këtyre pyetjeve, shoku Enver Hoxha vazhdoi:*

---

1. Kryetar i Gjykatës së Lartë të RPSSH.

Pra, gjykata të shkallës së dytë janë këshillat gjyqësorë të gjykatave të rretheve dhe Gjykata e Lartë. Këshilli gjyqësor në gjykatën e rrethit, përveç gjyqtarëve që ka dhënë vendimin në shkallë të parë, përbëhet nga tre gjyqtarë të rrethit. Pra, në gjykimin e shkallës së dytë marrin pjesë gjykatësit e rrethit, kurse në rrethet e vogla mund të bëjnë pjesë në këshill edhe një ose dy gjyqtarë nga rrethet e tjera. Në realitet vendimet e shkallës së dytë duhet të jenë të formës së prerë, por të kihet kujdes se mos gjykatësit bien në pozita subjektive dhe ia prishin njëri-tjetrit vendimet, se, sigurisht, nuk kanë të lërë një kuptim aq të lartë ideologjik. Për hakmarrje, njëri mund t'ia prishë vendimin një tjetri që ia ka prishur atij më përpara, ose bëhen dy veta bashkë e i prishin vendimet një kolegu të tyre që ua ka prishur vendimet që këta kanë pasë marrë më parë etj.

Unë gjithashtu dëshiroj të di: vendimet e këshillit gjyqësor të gjykatës së rrethit marrin formë të prerë apo ankesat i përplasen edhe Gjykatës së Lartë? Derisa ne krijuam gjykatën e shkallës së dytë, këtë e bëmë që të mos rëndoheni ju të Gjykatës së Lartë, ndryshe nuk do të ishte nevoja ta bënim një gjë të tillë! Unë di gjithashtu që Gjykata e Lartë, kur e sheh të nevojshme, një çështje mund ta tërheqë atë dhe ta gjykojë vetë. Ankimet që bëhen kundër vendimeve të formës së prerë i shqyrton kryetari i Gjykatës së Lartë me aparatën e tij.

Po a është i mjaftueshëm ky forum i shkallës së dytë, që kemi krijuar në rrethe apo mos duhet që të



gjendet një formë tjetër, ta zëmë që në këshillin gjyqësor të shtojmë edhe dy ose tre ndihmësgjyqtarë me qëllim që ata të kenë debate më shumë e të mos ekzistojë ai influencim profesional, siç mund të ndodhë në një forum ku bëjnë pjesë vetëm gjykatësit e rrethit? Këshillin gjyqësor të rrethit ne e kemi, gjithashtu kemi edhe gjykatën e shkallës së parë, trupi gjykues i së cilës formohet nga një gjyqtar dhe dy ndihmësgjyqtarë, që zgjidhen nga populli.

Ne jemi larguar shumë nga juria e gjykatës borgjeze. Por a mos duhet të lehtësohet më shumë Gjykata e Lartë? E dyta, ankimet që i vijnë Gjykatës së Lartë si verifikohen? Unë, Sekretari i Parë i Komitetit Qendror letrat që më vijnë nga populli ia dërgoj zyrës së letrave, e cila aktivizon këshilltarë, instruktorë e të tjerë për të verifikuar çështjet, për të zgjidhur problemet. Ti, shoku Aranit, si vepron me sektorin e ligjshmërisë? Si i drejtoni ju zyrat e ndihmës juridike? Me sa dimë, nuk ekziston më ai organizim me frymën e avokaturës së vjetër që ka ekzistuar më përpara. Inspektorët që ka Gjykata e Lartë a janë të mjaftueshëm?

Unë e ngre çështjen e përsosjes së punës së këshillit gjyqësor, sepse shohim që në përgjithësi, prishen relativisht shumë vendime. Ne e konstatojmë një gjë të tillë. Prishja e vendimeve të gjykatave ka disa shkaqe, siç janë: dobësitë në hetime, dobësitë në gjykim nga gjykata e shkallës së parë ose e shkallës së dytë në rrethe etj., prandaj, duke pasur parasysh këto, duhen gjetur, pa shtuar organikat, forma më të përshtatshme që të evitohet sa më tepër dhënia e vendi-

meve të padrejta<sup>1</sup>. Kërkesat dhe ankesat është e zorshme të evitohen, se çdonjëri ka të drejtë t'ju shkruajë juve, të na shkruajë neve, t'i shkruajë kujt të dojë për diçka që kujton se ka të drejtë.

Kompetencat e gjykimeve të gjykatave të shkallës së dytë herë pas here mund t'i rishikoni. Këtë duhet ta bëni për arsye se gjyqtarët e shkallës së dytë janë më kompetentë e më me eksperiencë. Kështu, brenda një kohe, për shembull, brenda vitit ose brenda dy vjetëve, ju të Gjykatës së Lartë mund të arrini në konkluzionin se duhet të lehtësoheni nga disa çështje, duke ua ngarkuar ato këtyre gjykatave, me qëllim që ju të përqendroheni më mirë në problemet më me rëndësi.

Nga ana tjetër, të mbahet parasysh edhe karakteri popullor i gjyqeve tona, prandaj duhen gjetur njerëz kompetentë, që populli të krijojë besim te gjyqtarët që zgjedh vetë, domethënë të jetë i bindur se ata janë njerëz që gjykojnë drejt, që i shikojnë mirë të gjitha rrethanat. Është një gjë e mirë që te ne nuk ka njëanshmëri e padrejtësi flagrante në gjykime.

Ju keni një punë me rëndësi të madhe e të vështirë. Edhe zyra e rekurseve të ligjshmërisë, në qoftë se nuk gabohem, merr një rëndësi të madhe, për arsye se ka kontakt me të gjithë ata që gjykojnë dhe që kërkojnë të drejtën. Ai që punon aty duhet t'i futet prob-

---

1. Këto të meta e defekte në punën e këshillave gjyqësorë, që përmend këtu shoku Enver Hoxha, nxorën kokë dhe u vunë re në praktikë. Prandaj në zbatim të porosisë që të gjenden forma më të përshtatshme, u pa e arsyeshme që këshillat gjyqësorë të rretheve të suprimohen dhe në vend të tyre u krijuan gjykatat e zonave, si gjykata të shkallës së dytë.

lemit, të marrë e të shqyrtojë me radhë të gjitha dosjet dhe pastaj do ta përpykë kokën te kryetari i gjykatës ose te zëvendësit e tij. Sa rëndësi merr për ne, për anën gjyqësore, një organizëm i tillë, i cili e bind atë që ka bërë kërkesë nëse ka apo s'ka të drejtë, për këtë arsye e për këtë arsye! Prandaj e ngre unë këtë çështje. Këtu nuk e kam fjalën që duhet shtuar organika, por më duket se del problemi i gjetjes së formave e të mënyrave më të efektshme për këtë qëllim. Kur bëjmë konferenca e mbledhje me kuadrot e Partisë e të pushtetit, vërtet dëgjojnë ata që njerëzit bëjnë letra-ankesa, por disave u ngulen në kokë, kurse disave u hyjnë nga njëri vesh e u dalin nga tjetri. Ndërsa kur vjen në gjykatë a në prokurori konkretisht personi që ankohet, ndryshon puna. Nëpunësi aty ia shpjegon hollësisht çështjet këtij personi, e ky është një shpjegim efikas. Njeriu i gjykuar arrin të bindet dhe të mos e përsëritë më fajin, të mos bëhet recidivist. Kurse nëpër mbledhje, siç thashë në mjaft raste, flitet në përgjithësi, pa ia vënë gishtin plagës ose pa kritikë të adresuar. Prandaj, më duket që disa propozime mund edhe të shikohen.

Po, ju, shoku prokuror i përgjithshëm, i keni të mjaftueshme kompetencat apo kërkon kompetenca të tjera? Në qoftë se kërkon, në ç'drejtim i kërkon, që të kemi një dijeni?

Ju, të prokurorisë, si mbrojtës të ligjshmërisë socialiste, i merrni në analizë prishjet e vendimeve gjyqësore dhe a dilni ju me konkluzione që këto vendime janë prishur për këto e për këto arsye? Dhe, në fakt, duhet të dilni me konkluzione. Edhe nga numri

i kthimit të dosjeve hetuesisë për plotësim hetimesh apo nga pafajësitë që jep gjykata të nxirret një konkluzion për punën e hetuesisë a punon mirë ajo apo duhet forcuar puna e saj. Në këtë drejtim ju duhet të arrini edhe në disa përfundime e përgjithësime që të mund të na thoni me siguri nëse është bërë mirë riorganizimi i hetuesisë nga Komiteti Qendror. Sig po e dëgjoj unë, tani që hetuesinë e ka Ministria e Punëve të Brendshme ju thoni se nuk keni ndonjë kërkesë lidhur me këtë çështje. Por mua më ka ardhur ndonjë e tillë në vesh, prandaj pyes. Po meqë jeni në këtë mbledhje e sqarojmë më mirë çështjen, këtu në Presidium.

Ju i përmendët këtu edhe kompetencat e prokurorit dhe thatë që prokuroria ka vetëm kontrollin e zbatimit të ligjshmërisë, kurse tani kërkohet që t'i hiqet asaj e drejta që të marrë vendim për fillimin e çështjes penale kur konstaton edhe shkelje që përbëjnë vepra penale. Unë mendoj se prokurorisë i lihen mjaft kompetenca që të ushtrojë funksionin e kontrollit të ligjshmërisë mbi veprimtarinë e organeve të hetimit dhe të gjykimit. Është e drejtë, për shembull, që disa veprime të bëhen patjetër me sanksionimin e prokurorit. Edhe kontrolli i banesës, që është çështje delikate dhe me rëndësi të madhe, mendoj se duhet të bëhet me sanksion të prokurorit. Pa aprovuar prokurori, nuk mund të bëhet kontrolli i banesës as nga kryetari i koshillit, se ky mund të bëjë edhe lëshime, mund të ketë lidhje farefisnie ose krushqie me personin etj. Edhe prokurori mund të ketë lidhje të tilla, por ky është njeri i ligjshmërisë, nuk është një aktivist i lagjes, prandaj duhet të mbikëqyrë e të veprojmë medocmos.

Nga sa shoh këtu, Prokuroria nuk ka ndonjë ankesë për vendimin e Byrosë Politike mbi ndarjen e hetuesisë nga prokuroria<sup>1</sup>, dhe ky vendim konsiderohet i drejtë. Por shqetësimi që shfaqet këtu se prokurorisë po i kufizohen kompetencat dhe se kështu kontrolli i prokurorisë mbi hetuesinë nuk do të bëhet si duhet, nuk qëndron. Në qoftë se ka prishje të vendimeve, duhet parë mirë, se ka një sërë faktorësh që shkaktojnë dobësi në punën e hetuesisë. Ato mund të vijnë edhe nga hetimet e njëanshme, nga mungesa e provave, nga që fajtori, zakonisht, kërkon të dredhojë etj. Por prokurorisë i lihen kompetencat e nevojshme për të vënë në vend zbatimin e ligjshmërisë.

Edhe një gjë parimore kisha për të thënë, shoku Aranit. Më duket se nuk është e rekomandueshme që gjatë zhvillimit të proceseve gjyqësore të ngrihet dikush nga salla e gjyqit e të thotë: «Me leje shoku gjykatës, unë kam për të thënë këtë ose atë gjë». Mendoj se nuk duhet lejuar kjo, pasi ka rrezik që gjyqtarët të influencohen. Është parimisht e gabuar dhe nuk është aspak demokratike që t'u bëhen vërejtje gjyqtarëve në sallë. Gjyqtarët dhe ndihmësgjyqtarët i ka zgjedhur vetë populli. Shteti ka krijuar organet e hetuesisë, të

---

1. Më 21 dhjetor 1973 me vendim të Byrosë Politike hetuesia u nda nga prokuroria dhe iu dha në varësi Organeve të Punëve të Brendshme. Po ky vendim u sabotua nga armiqtë Kadri Hazbiu dhe Feçor Shehu, të cilët e shndërruan hetuesinë në shtojcë të sektorit operativ dhe dëmtuan rëndë politikën e Partisë në zbatimin e ligjshmërisë. Për këtë në qershor të vitit 1983 hetuesia u nda nga Organet e Punëve të Brendshme për të vepruar si organ më vete, i pavarur.

cilat bëjnë hetimet. Për të mbështetur ose për të rrëzuar akuzën ka edhe dëshmitarë, të cilët thërriten në gjyq. Në sallë ka edhe njerëz që asistojnë gjatë gjykimit. Por ama, këta njerëz, domethënë dëgjuesit, nuk kanë të drejtë të ndërhyjnë gjatë gjykimit të çështjes, ndryshe kalohet në anarki. Kemi gjykatën popullore me gjykatës të popullit, me dëshmitarë që janë caktuar nga ata që gjykohen dhe nga hetuesia, që të arrihet në përfundime të drejta. Duhet të kuptojmë se po u vep-rua ndryshe, do t'u afrohem formave të jurisë së gjyqit borgjez, i cili cakton atje njerëz që nga këpucari e deri te profesori, shtatë-tetë veta dhe bëhen hetimet, flet prokurori për seancën, bën pyetjet prokurori, mbli-dhen në gjyq ata të jurisë që të shprehen nëse është fajtor ose jo ai që gjykohet, duke u përgjigjur me një «po» ose «jo». Ne nuk mund ta kthejmë auditorin në një gjyq të dytë edhe për arsye subjektive. Në sallën e gjyqit do të vijnë njerëz që janë të interesuar të dënohet ose të mos dënohet ai që gjykohet. Por ne duhet të bëjmë që t'u pritët rruga presioneve dhe kërcëni-meve. Edhe mua më vjen ndonjë letër ku shkruhet: «Në qoftë se, shoku Enver, nuk jepni urdhër të pushkatohet ky person, i cili është dënuar me 17 vjet burg, unë do të marr koburen dhe do të vete ta vras!». Në një rast të tillë nuk mund të veprohet ndryshe, veçse të merren masa kundër letërshkruesit. Prandaj, po të pranohet që auditori të thotë «Me leje...», atëherë gjyqi nuk do të jetë objektiv. Pse i shkon njërit në mend diçka ose pse tjetri ka një mendim e pastaj mund të ndërhyhet? Unë mendoj se nuk mund të bëhet një gjë e tillë. Ka vend se ku mund të flasin njerëzit, janë mble-

dhjet e Frontit, ku ata po të duan flasin, ose në mbledhjet e kolektivit. Kurse në gjyq, gjykohet një vepër penale, dhe është trupi gjykues ai që gjykon, që drejton e zhvillon procesin gjyqësor që bën dhe edukimin e atij që gjykohet dhe që merr vendimin përkatës. Prandaj nuk mund të lejohet një formë e tillë, gjoja demokratike, si ajo për të cilën fola më lart, ku gjatë gjyqit të ngrihen nga salla e të flasin edhe ata që janë të interesuar të dënohet personi, edhe ata që nuk duan që ai të dënohet. Ky nuk do të ishte gjyq. Pra nuk është e përshtatshme një «demokraci» e tillë, për një vend ku gjyqi është i popullit, e gjyqtarët zgjidhen nga vetë populli. Kurse gjetkë gjyqtarët emërohen dhe, për të dhënë përshtypjen që vendimi gjoja është popullor, zgjedhin jurinë. Atje, një kasap i caktuar në juri hiqet sikur gjoja nuk është influencuar! Po ai që më parë ka marrë edhe para bile! Prandaj këtu duhet të kemi kujdes.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Presi-  
diumit të Kuvendit Popullor  
të RPSSH, që gjendet në AQP*

## DEKORIMI — STIMUL I LARTË QË NXIT DHE FRYMËZON PËR ARRITJE TË REJA

*Diskutim në mbledhjen e Presidiumit  
të Kuvendit Popullor të RPSSH<sup>1</sup>*

27 janar 1979

Te ne është bërë traditë që sipas meritave jepen medalje ose urdhra, bile edhe titulli «Hero i Popullit».

Haxhiu [Lleshi] ka të drejtë, kur thotë se nuk është serioze që dikush që ka marrë më përpara një dekoratë më të lartë, t'i jepet një tjetër më e ulët se ajo, pasi duket sikur personi ka shkuar mbrapa. Se, për shembull, në rast se i jepet dikujt tani një urdhër i klasit të dytë, një gjë e tillë nuk shkon fare, derisa para kësaj dekorate ai ka marrë një tjetër më të lartë. Njerëzit tanë ecin dhe duhet të ecin edhe më përpara. Pra, përse të jepet ajo dekoratë që duhej të ishte dhënë para asaj që ka marrë?!

Janë gjëra formale këto që bëhen nganjëherë, por që duhen parë me kujdes. Mbi ç'bazë propozohet t'i

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua edhe rreth propozimeve të paraqitura për dekorime të punonjësve.



jepet tjetrit një medalje, kur më përpara atij i është dhënë urdhër? Në rast se kemi dekoruar, për shembull, një person me Urdhrin e Heroit të Punës Socialiste për punë të shkëlqyer që ka bërë, më vonë ai mund të marrë një urdhër tjetër goftë edhe më të vogël, për shembull, atë të Trimërisë, për një akt trimërie që ka kryer. Në këtë rast kjo është e logjikshme. Urdhri vërtet është më i ulët, por ai i jepet punonjësit, sepse në rastin konkret ndryshon karakteri i veprimtarisë së kryer dhe dekorata i përgjigjet kësaj.

Për shembull një Heroi të Punës Socialiste, që mund të jetë tornitor te Piloja [Peristeri]<sup>1</sup>, dhe që është shquar për një gjest trimërie, si fjala vjen, për mbrojtjen e pronës socialiste nga zjarri, po, në këtë rast i jepet Urdhri i Trimërisë, paçka se ka titullin e lartë të Heroit.

Pra, e kam fjalën që para se të bëhen propozime për dhënie dekorate ose urdhri, këto gjëra duhen studiuar mirë e të mos bëhen formale.

Lidhur me dekorimet kisha edhe një vërejtje, si domos për shokët e ushtrisë. Shoh se ushtarëve nuk u jepen dekorata. Dekorohen vetëm oficerët dhe kryesisht oficerët e lartë. Kjo nuk duhet të ecë më kësh-tu. Dekorata është një stimul për veprim dhe për punë. Ushtari është baza e ushtrisë sonë. Ai rropatet në shi, në borë, zbaton taktikën luftarake, kryen punime fortifikuese e bën plot shërbime të tjera që ju i dini. Kam asistuar në disa mbledhje të organizuara të ushtrisë e

---

1. Në atë kohë drejtor i kombinatit të auto(tractorëve «Enver Hoxha» në Tiranë.

më ka tërhequr vëmendjen një gjë e tillë. Shokët e Luftës Nacionalçlirimtare i kanë dekoratat e luftës. Ato i kanë merituar, bile edhe pas luftës i meritojnë, sepse punojnë e militojnë me devotshmëri. Por ama edhe ushtarët që dallohen në kryerjen e shërbimit ushtarak, që, siç thashë, bëjnë gjithë këto punime fortifikuese e meritojnë të dekorohen. Ky është një stimul moral që i nxit dhe i frymëzon ata, ua shton më tepër forcat dhe vullnetin, u mpreh më tepër vigjilencën. Kështu, kur ushtari i dekoruar mbaron shërbimin ushtarak e kthehet në shtëpi e në punë, do t'i thonë: «Ku e ke marrë ti këtë dekoratë?». «E kam marrë në ushtri», do t'u përgjigjet ai. Të tjerët pra do të shohin se ky çenka dalluar në ushtri, se ushtria e ka vlerësuar. Populli ynë që e vlerëson ushtrinë, krenohet kur shikon që bijtë e tij, ushtarët e thjeshtë, janë nderuar për shërbim shembullor me dekorata të ndryshme. Njerëzit tanë janë të thjeshtë, nuk i vënë dekoratat që të duken, por në një ditë feste duhet t'i vënë.

Edhe për ata që ndjekin shkollat ushtarake duhet parë ky problem, si nxënësit e shkollës «Skënderbej», studentët e Shkollës së Bashkuar, të Akademisë Ushtarake. Bile, edhe për rezervistët, për ata që dallohen në stërvitje e në përgatitjen luftarake, përse të mos jepen dekorata? Në qoftë se duhet ndonjë dekoratë e veçantë për ta, ta shikojmë këtë çështje e të krijojmë edhe dekoratat përkatëse.

Pra, unë e shtroj këtë problem që shokët e ushtrisë, por edhe ne si Presidium, ta shikojmë këtë çështje.

Gjithashtu, dua të theksoj se dekorata ka vlerë

kur jepet në kohë. Prandaj ajo duhet të jepet në kohën e duhur. Për shembull, në një repart xhënier ku kryhen punime fortifikuese, komandanti, komisari, që rrinë e punojnë tok me ushtarët, kur shohin se dy, tre, pesë prej tyre shkëlqejnë në punë, atëherë, nuk duhet të presin, por të bëjnë menjëherë propozimet për dekorimin e tyre. Dhe ka shumë vlerë jo vetëm për të dekoruarit, por edhe për të tjerët, kur pikërisht aty në frontin e punës, në vendin e ngritjes së objektit, të zhvillohet ceremonia e dorëzimit të dekoratave ushtarëve. Të shikoni pastaj se si do të rritet edhe më shumë vrulli e mobilizimi i të gjithë ushtarëve e kuadrove në punë. Po kështu siç veprohet shpeshherë, që njerëzve nuk u çmohen puna, meritat, dhe nuk kujtohet njeri për t'i nderuar me dekorata e stimuj të tjerë, kjo nuk i nxit ata për punë. Aq më keq është në ato raste kur edhe për dekorimet bëhen haçëre. Prandaj edhe në këtë çështje duhet të veprohet në kohë. Kur konstatohet që dikush nga ushtarët punon mirë, atëherë, kur edhe qëndrimet e figura e tij morale është e mirë, nuk duhet pritur, por menjëherë të bëhet propozimi e të dekorohet. Përse dekorojmë traktoristin, tornitorin apo kuadrot, e të mos dekorojmë ushtarin e minatorin që rrezikojnë jetën e tyre kur vënë minat? Prandaj, shikojeni këtë çështje ju të ushtrisë.

*Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga procesverballi i mbledhjes së Presidiumit të Kuvendit Popullor të RPSSH, që gjendet në AQP*

# METODA DHE STILI TË JENË TË ZHIDËRVJELLËT, TË ÇOJNË PUNËN PËRPARA

*Diskutim në Plenumin e 6-të të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

29 janar 1979

*Duke e marrë fjalën në fillim të punimeve të Plenumit, shoku Enver Hoxha tha:*

Për zhvillimin e punimeve të Plenumit, në qoftë se jeni dakord, mendoj të ndjekim një procedurë tjetër, pak më ndryshe nga herët e tjera. Shokët sekretarë të parë të komiteteve të Partisë apo kryetarë të komiteteve ekzekutive të atyre rretheve që kritikohen në këtë raport të Byrosë Politike për mosrealizimet serioze, akoma nuk i kanë dhënë emrat për diskutim. Ata mund të flasin edhe më vonë, por mua më duket se nuk është e drejtë që ata të flasin në fund. Komiteti Qendror kërkon nga shokët që të japin llogari më shumë, të flasin më përpara për mosrealizimet. Gjer tani kanë dhë-

---

1. Në këtë Plenum, që i zhvilloi punimet më 29-30 janar 1979, u diskutua rreth raportit të Byrosë Politike të KQ të PPSH «Mbi plotësimin e planit të vitit 1978 e të tre vjetëve të pesëvjeçarit të gjashtë të marrë së bashku dhe masat për realizimin e detyrave të vitit 1979».

në emrin shokë të tjerë. Unë mendoj që këtë radhë, ta prishim këtë «demokraci» dhe të flasim përpara shokët që kritikohen.

Në raport u kritikua Lushnja për mosrealizime të planit me peshë të madhe. Po kështu kritikohen edhe rrethet e Dibrës e të Krujës. Propozoj që nga këto rrethe mund të flasim edhe sekretari i parë edhe kryetari i komitetit ekzekutiv, po qe se janë të dy këtu. E them këtë pse mundet që sekretari i parë të jetë përgatitur për të folur për të gjitha problemet nga një çikë dhe të ketë thurur fraza.

Komiteti Qendror do të dijë, fjala vjen, nga Korça, pse nuk e realizoi ky rreth pataten, por gjatë raportimit nuk ka nevojë të na bëhen fraza. Lushnja të na raportojë shkaqet pse nuk u realizua gruri. Në qoftë se veprimet në këtë mënyrë, atëherë mendoj se do të dalim këtu, në Komitetin Qendror, me një ide të qartë se ku qëndrojnë dobësitë politike, organizative, teknike, dobësi në bazë dhe lart dhe do të bëhet një analizë më e mirë. Në qoftë se bëjmë raporte të gjata për të gjitha problemet, mendimi im është që nuk dalin në pah të metat. Duhet medoemos të dalim me konkluzione për ato çështje për të cilat janë vërtetuar të meta. Natyrisht, ka dhe shumë gjëra të mira, prandaj të mos jemi pesimistë. Ne nuk jemi që të mos i përmendim të mirat, edhe këto do t'i përmendim, por më tepër duhet të qëndrojmë e të thellohem në shkaqet e mosrealizimeve. Me një fjalë, të diskutojmë në cilat drejtime dhe përse organizimin nuk e keni mirë, përse e keni neglizhuar këtë ose atë punë etj. Për ato probleme ku shohim organizim të dobët ne duhet të diskutojmë doemos, pran-

daj unë propozoj që të procedojmë konkretisht duke u futur drejt e në temë, pa slogane. Të mos bëjmë raportim për raportim, sa për të thënë se kemi bërë këtë e kemi ndjekur atë. Pse e them këtë? Për arsye se ai që është sekretar partie ose kryetar i komitetit ekzekutiv në një rreth, ka një eksperiencë të madhe, shumë shokë kanë një eksperiencë 20-vjeçare. Ata i njohin problemet, i njohin njerëzit, tokat, fushat, fabrikën, njohin dobësitë, bile nuk kanë nevojë as për të folur duke lexuar në letër. Se letra ka një frazeologji të grumbulluar dhe të shkruar për t'i thënë gjërat të menduara gjatë që më përpara. Nuk u duhen as Komitetit Qendror, as komiteteve të rretheve, as organizatave-bazë raportime stereotipe, me fraza. Ta dëbojmë atë metodë të huaj frazash nga diskutimet tona dhe t'i biem problemit drejt e në kokë. Ta shikojmë problemin në aspektin objektiv dhe subjektiv dhe të lidhur me personat që punojnë, se po nuk e lidhëm punën me njeriun, do të endemi në errësirë.

Të kemi parasysh që kritikën të bëjmë konstruktive në mes shokësh. Ne nuk duam t'i vrasim shokët, po për të kritikuar ata që punojnë dobët dhe për t'i lavdëruar ata që punojnë mirë është absolutisht e nevojshme.

Nuk mjafton të thuhet se «më vret ndërgjegjja». Ne e kuptojmë se komunistin e vret ndërgjegjja për mosrealizimet dhe kjo është e natyrshme; por çështja është që Partia, për shembull, në Peshkopi duhet të bëjë një punë politike e ideologjike të madhe e të jashtëzakonshme. Puna e Partisë, që nga rrethi deri në bazë, duhet të jetë e puthitur mirë politikisht dhe ideologjikisht, në varësi nga karakteristikat e vendit. Kur e

përsërisim shpesh që «ndërtimi i socializmit dhe zbatimi i marksizëm-leninizmit duhet të bëhet në kushtet e vendit», kjo duhet parë jo vetëm në shkallë kombëtare, por edhe në shkallë rrethi, bile edhe në shkallë krahi- ne, fshati dhe familjeje. Edhe në një familje me tre ve- ta, ndryshe nga dy të tjerët, i treti mund të mos jetë përparimtar. Ky njeri jopërparimtar dëmton. Këto çështje të Partisë, të shoqëruara me masa organizative e shtetërore duhet të studiohen thellë e të zbatohen me konsekuencë nga njerëz kompetentë.

Në Lezhë, për shembull, puna e Partisë nuk është e kënaqshme. Çështja e bujqësisë është kapitale. Atje janë harxhuar shuma kolosale për të përmirësuar to- kën, për të ujitur, për ta tharë. Gjithë këto sakrifica që ka bërë populli shqiptar duhet t'ë mos shkojnë kot, por të shërbejnë si një faktor vendimtar dhe stimulues për të rritur ndërgjegjen e kooperativistëve të Lezhës. Në këtë rreth ka mbeturina, që duhet të studiohen histori- kisht dhe politikisht.

Puna na mëson. Në fillim unë thashë t'u bëjmë py- etje shokëve që diskutojnë, kurse tani, siç shikohet, mund të bëjmë edhe vërejtje. Dua të shtoj edhe një gjë tjetër. Ata shokë të ministrive që u zunë në gojë këtu, se nuk realizojnë mallra me rëndësi për ekspor- tin, le të përgjigjen pse nuk e bëjnë këtë gjë. Disa prej këtyre shokëve, puna e të cilëve zë një peshë në çësht- jen e eksportit, pasi t'u bëhen pyetje dhe vërejtje, të ngrihen e të flasin, pavarësisht se mund të kenë disku- tuar. Disa kanë ardhur të përgatitur me shkrim, disa kanë ardhur me duar në xhepa. «Më pyetni, t'ju përgji- gjem» më tha një shok këtu. Mirëpo ne këtu nuk jemi

në hetuesi. Ne jemi në Plenumin e Komitetit Qendror të Partisë. Këtu shtrojmë çështjet që na ka ngarkuar Partia, ashtu siç janë, dhe presim pyetje, vërejtje dhe kritika nga shokët. Ne u bëjmë kritika jo vetëm shokëve të bazës, por edhe drejtuesve të Partisë në qendër.

Unë konstatoj se shumë pak ose aspak vërejtje po bëhen për punën e udhëheqjes. Këtë problem nuk e ngre formalisht, por që ta kuptojmë drejt. Në bazë ka të meta, por ka edhe suksese të mëdha. Ka gjëra të mira udhëheqja, por ka edhe të meta. Këtu në mbledhjen e Plenumit të Komitetit Qendror të Partisë t'i ndryshojmë stilin dhe metodën e punës.

*Botuar për herë të parë në librin: Enver Hoxha, «Për Partinë» (Përmbledhje veprash), vëll. 3, f. 434*

*Botohet sipas librit: Enver Hoxha, «Për Partinë» (Përmbledhje veprash), vëll. 3, f. 434*



# **NË LUFTË PËR REALIZIMIN E PLANIT TË FORCOJME KONTROLLIN E ZBATIMIT TË DETYRAVE**

*Konkluzione në Plenumin e 6-të të KQ të PPSH*

30 janar 1979

Në këtë mbledhje të Plenumit folën tetëmbëdhjetë veta, por, sipas mendimit tim, nga mënyra që praktikoi Plenumi për zhvillimin e punimeve të tij, me ndërhyrjet dhe plotësimet që bënë shokët, në të vërtetë këtu u bënë rreth dyzet diskutime. Kjo metodë pune, për t'u larguar nga frazeologjia boshe në diskutimet tona dhe për trajtimin konkret, shkurt e qartë të problemeve që na shqetësojnë më tepër, mund të na shërbejë edhe në të ardhmen.

Si shokë të zgjedhur në Komitetin Qendror të Partisë e kemi për detyrë që kritikën, sugjerimet dhe vërejtjet që i bëhen punës sonë t'i kemi kurdoherë parasysh, t'i studiojmë me gjakftohtësi, t'i realizojmë pa vonesë dhe t'i përvishemi punës për të kryer plotësisht detyrat. Tre vjet lufte e pune të pesëvjeçarit kaluan, shembuj pozitivë e arritje të mira ka në çdo drejtim të ekonomisë e në çdo rreth. Na kanë mbetur akoma ve-

tëm dy vjet për mbylljen e planit pesëvjeçar dhe nevojat ekonomike e politike të vendit tonë kërkojnë që, gjatë këtyre dy vjetëve, të bëjmë një sforcë të madhe. Nga realizimet e planit në këta dy vjet do të varet shumë edhe fizionomia e planit të ardhshëm pesëvjeçar. Prandaj për të dalë me sukses duhet t'i vëmë gjoksin punës, t'i lëmë mënjanë justifikimet e kota për mosrealizimet dhe të heqim dorë nga kërkesat pa vend për plotësimin nga të tjerët të atyre nevojave që mund t'i plotësojmë vetë, në radhë të parë, brendapërbrenda ndërmarrjes, uzinës, fabrikës apo kooperativës. Vetëm kur të jemi shumë të shtrënguar dhe pasi të kemi bërë vetë të gjitha përpjekjet e mundshme për plotësimin e detyrës mund të drejtohem për ndihmë në komitet apo në ministri, sipas rastit.

Nga raporti që mbajti shoku Hysni, nga diskutimet që u bënë këtu dhe nga eksperiencia e punës së Partisë del se, duke filluar nga baza, rrethi e deri në qendër, nuk u është qëndruar kurdoherë në krye detyrave, ka munguar kërkesa e shëndoshë e llogarisë, nuk është punuar kudo me një ndjenjë përgjegjësie të madhe, nuk është luftuar sa duhet indiferentizmi, nuk janë luftuar në shkallën e duhur mbeturinat e psikologjisë së pronës private. Të gjitha këto tregojnë se nuk është arritur akoma në përmasat e duhura kuptimi politik i rëndësisë së madhe që paraqet gjendja e Shqipërisë në botën e sotme. Bota është në zhvillim, por zhvillimi aktual i saj është kërcënues për lirinë, pavarësinë dhe sovranitetin e popujve.

Raporti i Byrosë Politike para këtij Plenumi sintetizon punën e kryer nga organet dhe organizatat e Par-

tisë, nga organet e pushtetit dhe nga ato të ekonomisë. Këtë raport mos ta kuptojmë si mohim të sukseseve që janë arritur. Ky është një raport pune, që i bëhet udhëheqjes kryesore të Partisë jo për të mohuar sukseset, djersën, vendosmërinë, trimërinë dhe vetëmohimin e shumicës dërrmuese të komunistëve, të kuadrove, të punëtorëve e të kooperativistëve, por që të tërheqë vëmendjen e shokëve për t'i dhënë më tepër rëndësi analizës së dobësive, të metave e gabimeve të ndreqshme që vihen re në punën e Partisë dhe të organeve shtetërore dhe ekonomike për sa i përket plotësimit të planit të vitit 1978 dhe të tre vjetëve të marrë së bashku, si dhe për të caktuar masat për realizimin e detyrave të vitit 1979.

Treguesit e realizimit të planit janë të lidhur ngushtë me njëri-tjetrin, ata përbëjnë hallkat e një zinxhiri, i cili është i fortë në qoftë se i ka të forta të gjitha hallkat e tij. Në qoftë se njëra hallkë dobësohet, domos do të dobësohet edhe tjetra që lidhet me të, prandaj secili duhet të kuptojë se nga neglizhenca e tij pengohen edhe të tjerët. Kjo neglizhencë është me pasoja shumë të rënda, sepse e fut ekonominë në rrugën e shpërpjesëtimeve e të zhbalancimeve dhe sjell një varg dukurish të tjera negative.

Këtu dua të sqaroj mirë edhe një çështje. Kur themi Partia udhëheq ekonominë, kemi kurdoherë parasysh që anëtarët e saj, që punojnë në sektorët ekonomikë, në prodhim e në drejtim, luftojnë dhe punojnë kudo për zbatimin e politikës ekonomike të Partisë. Përkërisht për të siguruar këtë udhëheqje punojnë në prodhim 80 për qind e komunistëve. Edhe në drejtim të

organeve e sektorëve të ekonomisë punojnë një shumicë e madhe komunistësh. Për sa kohë që Partia udhëheq ekonominë, edhe përgjegjësia për mosrealizimet, ta themi shqip, bie mbi Partinë dhe kur themi mbi Partinë, do të thotë se bie edhe mbi shokun ministër, edhe mbi shokun sekretar të Partisë, edhe mbi drejtorin në ministri apo në ndërmarrje, dhe deri tek anëtari i thjeshtë i Partisë. Prandaj kjo përgjegjësi është edhe kolegjiale, por edhe individuale.

Mua më duket se Partia dhe organet shtetërore i kanë përcaktuar drejt metodën dhe stilin e punës. Nga kjo anë nuk ka gabime, por megjithëkëtë ato duhen parë në lëvizje e ndryshim drejt përmirësimit të vazhdueshëm. Për përsosjen e metodës e të stilit në punë nuk duhet pritur që të diktohen gjithnjë urdhra nga lart, por secili, duke pasur parasysh direktivat e drejta të Komitetit Qendror, vendimet e drejta të Byrosë Politike e të Qeverisë, ligjet në fuqi, të përpiqet të gjejë mënyrat, format e stilin revolucionar, që janë më të përshtatshëm, që japin më shumë rezultate në fushën e zbatimit praktik. Ajo që rekomandohet është çështja që metoda dhe stili të jenë të zhdërvjellët, ta çojnë punën përpara, të forcojnë organizimin.

Edhe referatet e leksionet e përgatitura nga Partia, që të kenë bukë, duhet të puqen me problemin që preokupon shtetin dhe ekonominë pikërisht në atë sektor ku këto mbahen. Në qoftë se materiali është i përgjithshëm dhe nuk lidhet me punën, pak mund të flitet për dōbinë e tij. Një punë e tillë *ex cathedra*, siç thotë latini, nuk zë vend. Referate e leksione të kësaj natyre as të

ngrohin, as të ftohin, llafet që thuhet në to hyjnë nga njëri vesh e dalin nga tjetri.

Me këtë çështje lidhet edhe problemi se kush e shikon dhe e udhëheq tërë punën për realizimin e planit, kush mund t'u japë detyrave të planit rrugëzgjdhje më të drejtë, më të arsyeshme dhe më dinamike. Është organizata e Partisë, është organi ekonomik shtetëror, janë drejtori i ndërmarrjes dhe kryeinxhinieri, kryetari i kooperativës dhe kryeagronomi e të tjerë, janë komiteti i Partisë dhe komiteti ekzekutiv i këshillit popullor të rrethit dhe aparatet e tyre, janë vetë klasa punëtore, fshatarësia kooperativiste. Janë pra gjithë këto forca të mëdha që, po t'i vëmë në lëvizje si duhet, po t'u hapim horizonte dhe t'u përkrahim iniciativat, siç u fol këtu, jo vetëm dobësitë që vërehen do të zhduken por edhe detyrat do të plotësohen, e të jemi të bindur se do të tejkalohen.

Mosrealizimet e kanë burimin në faktin se akoma nuk ka në të gjithë punonjësit një ndërgjegje të lartë revolucionare dhe një kuptim serioz të problemit që shtrohet për plotësimin e detyrave të planit. Në këtë drejtim ndërgjegjja nuk ka arritur në atë shkallë që kërkon Partia. Kjo gjendje bëhet e rrezikshme, sidomos, kur drejtuesit e ndërmarrjeve ose të kooperativave nuk kuptojnë thellë përgjegjësitë e tyre. Nxitja e ndjenjës së përgjegjësisë te çdo punonjës dhe drejtues për mënyrën se si duhet ta kuptojë dhe si ta kryejë ai detyrën, si duhet ta zbërthejë atë etj., ka shumë rëndësi. Partia nuk duhet dhe nuk mund t'u japë receta njerëzve për mënyrën e kapërcimit të çdo vështirësie që del, por duhet të punojë me ta që të vrasin mendjen

dhe të mos i zërë gjumi pa plotësuar detyrat. Partia duhet t'i ndihmojë ata që ta bëjnë këtë gjë, pse vetëm atëherë do të kemi suksese të mëdha.

Ne, udhëheqja e Partisë, sido që jemi të bindur se gabime parimore për sa u përket orientimeve të politikës ekonomike të Partisë nuk kemi, prapë për plotësimin e detyrave të planit nuk jemi pa gabime. Në këtë drejtim kemi edhe ne përgjegjësitë tona kolektive, por edhe individuale. Ne, shokë, e kuptojmë se barra e zbatimit të direktivave që jepen, e zbërthimit dhe e konkretizimit të tyre, me pak fjalë, e dhënies së rezultateve të prekshme të këtyre direktivave, i bie sidomos bazës. Udhëheqja ka rolin e saj të rëndësishëm, se nuk është e lehtë të organizosh e të drejtosh punët, por baza ka shumë shqetësime për zgjidhjen e të cilave udhëheqja duhet të jetë pranë. Në këtë kuptim mund të flitet që ajo të bëhet një me bazën, të shqetësohet e të gëzohet bashkë me të.

Nuk ka ndonjë rast që komunisti dhe kuadri t'u jetë drejtuar masave për kapërcimin e vështirësive dhe të mos ketë korrur suksese. Shkëputja nga masat punonjëse e vë kuadrin para vështirësive të mëdha, përkundrazi lidhja me masat, qarja e halleve bashkë me to, modestia proletare e ndihmojnë atë të dalë faqebardhë. Drejtorit të një kombinati, për shembull, nuk duhet t'i rritet mendja nga besimi që i ka dhënë Partia se kështu ai do të shkëputet nga masat e do të dështojë. Asnjë kuadri, qoftë ky edhe funksionar i lartë, të mos i rritet mendja, pse zotësia e tij nuk mund të barazohet kurrë me zotësinë e Partisë dhe të masave.

Në raport theksohet qartë se realizimi i të gjitha

detyrave të planit shtetëror duke u mbështetur në forcat tona, çarja e rrethimit dhe e bllokadës imperialisto-revizioniste kanë rëndësi kombëtare dhe ndërkombëtare. Këtë çështje duhet ta mbajnë mirë parasysh punonjësit në bazë, në rrethe e gjer në ministritë. Veçanërisht nuk duhet ta harrojnë punonjësit e bujqësisë, të cilët gjatë tre vjetëve (1976-1978) nuk e plotësuan planin e prodhimit për drithërat e bukës, pambukun, lulediellin, panxharsheqerin, ullirin, mishin, qumështin etj. Mosplotësimi i planeve në bujqësi i ka krijuar probleme të mëdha ekonomisë. Kjo gjendje ka ndikuar negativisht në plotësimin e nevojave të popullit për disa prodhime bujqësore e blegtorale, ka vënë në vështirësi industrinë e lehtë e ushqimore për lëndë të para, ka penguar plotësimin e kontingjenteve të caktuara për eksport etj. Ligjet ekonomike të socializmit janë të hekurta. Ashtu siç janë të hekurta ligjet për revolucionin, janë dhe për kundërrevolucionin. Këtë ne duhet ta kuptojmë edhe teorikisht, edhe praktikisht.

Detyrat e planit nuk janë realizuar edhe në nxjerrjen e naftës bruto dhe në nxjerrjen e gazit kryesisht nga vendburimet e reja. Ky mosrealizim është një pengesë për ecjen përpara të ekonomisë sonë. Këtë gjë duhet ta kuptojnë thellë tërë punonjësit e sektorit të naftës.

Ju, shokë, të tërë i keni ndjekur shtypin dhe emisionet televizive, ku, veç të tjerave, keni mësuar edhe për luftën e madhe të popullit në Iran, që është një ndër vendet më të pasura në naftë. Atje ka shpërthyer revolucioni demokratiko-borgjez, që drejtohet kundër marrëdhënieve feudale e monarkisë, kundër fashizmit

dhe imperializmit, kundër shfrytëzuesve të naftës. Pavarësisht se atë revolucion e udhëheqin fetarët e jo komunistët, karakteri i tij është progresist. Lufta e popullit të Iranit për të përmbysur regjimin e shahut, për të mbrojtur naftën nga grabitësit dhe për të përmirësuar jetën e tij, ka tronditur botën. Çështja e naftës, pra, është me rëndësi të jashtëzakonshme.

Ne, shokët e udhëheqjes, natyrisht, nuk e njohim problemin e nxjerrjes së naftës gjer në hollësitë teknike konkrete, por dimë diçka për origjinën e shtresave naftëmbajtëse, që janë shfrytëzuar gjatë gjithë kësaj kohe. Kjo kohë e gjatë shfrytëzimi është e mjaftueshme për të provuar praninë e naftës në nëntokën tonë. Ne njohim pellgun kryesor naftëmbajtës të Shqipërisë. Prej dekadash nafta nxirret nga një pellg, por ky fakt nuk përjashton ekzistencën e naftës edhe gjetkë, prandaj për zbulimin e vendburimeve të reja të naftës e të gazit, ashtu siç ka porositur me kohë Partia, duhet të ecet nga e njohura në të panjohurën. Ne kemi dijeni gjithashtu për epokat e ndryshme të formimit të tokës gjatë të cilave janë vërtetuar përmbysje që specialistët i quajnë thyerje tektonike. Gjeologët duhet t'i njohin mirë këto thyerje, sepse tektonika është pjesë e gjeologjisë.

Si shokët edhe unë di dhe besoj se në pellgun e njohur nuk ka disa fusha të veçuara naftëmbajtëse, por ka, si të themi, një fushë të madhe me shtresa të ndryshme, që janë shkaktuar nga fenomenet e përmbysjeve të epokave gjeologjike dhe nga fenomenet që shkakton prania e naftës dhe e gazit. Këto fenomene, si dhe të tjera, të cilat nuk është rasti të analizohen



këtu, të marra në tërësinë e tyre, na bëjnë të jemi të bindur se vendi ynë është naftëmbajtës. Për këto arsye udhëheqja e Partisë ka qenë në gjendje t'i kapë ato devijime e gabime që i kushtojnë shtrenjtë ekonomisë sonë socialiste.

Udhëheqja nuk ka qenë dakord me «teknikën» dhe me «teorizimet» shterpe të disa specialistëve të naftës. Ajo nuk mund të jetë dakord me ata gjeologë ose drejtues të sektorit të naftës që «teorizojnë» për të justifikuar vend e pa vend avaritë e shumta, mungesën e një studimi të aplikueshëm dhe neglizhencën në diskutimin objektiv rreth këtyre studimeve.

Interesat e ekonomisë popullore nuk mund të lejojnë që për një kohë të gjatë të mos njihet kapaciteti i një fushe të re naftëmbajtëse. Nuk mund të pritet derisa të bëhet konturimi kur t'i vijë për mbarë njërit ose tjetrit, nuk mund të pritët që të vendoset të shpohet apo të mos shpohet, të shkohet apo të mos shkohet gjer në fund të pusit, sipas dëshirave të njërit apo të tjetrit. Me rregullat teknike jemi dakord, por nuk pajtohemi me gabimet dhe me shkeljet e theksuara të këtyre rregullave në një kohë kur nafta, aktualisht, është një nga lëndët më deficitare dhe jetike për ekonominë tonë dhe për atë botërore. Deficitet në nxjerrjen e naftës e të gazit nuk mund të kapërcehen me njëfarë autokritike shkel e shko. Prandaj shokët specialistë të punojnë e të japin të dhëna, me qëllim që Partia të dijë ç'naftë ka nëntoka jonë. Si do ta dijë këtë Partia kur ka raste që hezitohet në përcaktimin e thyerjeve të tokës, herë duke thënë se «jemi në krye», herë «jemi në mes»? Dhe këto hezitime shfaqen në një kohë

kur në dy puse, në një distancë prej një kilometër nga njëri-tjetri, duket që ka naftë.

Ju, shokë specialistë e drejtues të naftës, keni kaq kohë që ngurroni të shponi pusin e dytë, megjithëse edhe ju, edhe ne jemi të bindur që nafta ekziston. Ne kemi një sasi sondash të nevojshme për shpime, por në vend që me këto sonda, për të cilat na kanë thënë se rrinë edhe pa punë, të fillohet shpimi brenda fushës që ka perspektivë shumë të madhe, shpeshherë bëhen muhabetë pa bërëqet!

Natyrisht ekzistenca e fushës me perspektivë na gëzon pa masë, por sido që të jetë, ne duhet të dimë konturimet. Mund të na thuhet se «për këto konturime, shoku Enver, nevojitet kjo e ajo». Dhe unë do t'u them shokëve se ato vërtet duhen, por po të organizohet puna dhe një pjese të mirë të gjeologëve e të inxhinierëve të shpimit t'u caktohet detyra që t'i japin Partisë të dhëna se kjo fushë ka kaq milionë tonë naftë, që gazi fillon për shembull nga Bishti i Pallës dhe del deri në Vlorë etj., ata do të mobilizohen më fort e më mirë dhe nuk do të ndodhë më që, pasi shpohet një pus, na jepet sihariqi që u zbulua naftë dhe pastaj pusi mbyllet ose digjet!

Ne nuk e dimë akoma sa duhet sasinë e rezervave, pasi nuk kemi ordinatorë supermodernë në dispozicion, por ne duhet t'i bëjmë llogaritë me këto mjete që kemi. Po të kishim nga këta ordinatorë, do t'i bënim parashikimet në një kohë më të shkurtër, por meqë mjete të tilla tani për tani s'kemi, le t'i bëjmë llogaritë për një kohë pak më të gjatë, pa avari, pa neglizhenca dhe jo me disiplinë të dobët.

Në sektorin e naftës, siç dihet, ka ekzistuar puna e theksuar armiqësore e sabotimit. Mbeturinat e metodës e të stilit të punës së sabotuesve në ekonomi shfaqen edhe tashti në disa drejtime: në «teorizime» kur nuk duhet teorizuar, në mbivlerësimin e aftësive teknike e shkencore, duke përcmuar mendimet e punëtorëve me përvojë, për të cilët thuhet se nuk kuptojnë nga fusha e specialitete të naftës, në ekzistencën e frikës dhe, për rrjedhim, nuk veprohet nga disa specialistë, duke menduar se po të gabojnë mund të konsiderohen sabotues! Nga këto drejtime duhet parë mungesa e përgjegjësisë, mungesa e përcaktimeve të sakta të pikave dhe moszbatimi i urdhrave të bazuar për nxjerrjen e naftës.

Të mos mendohet se këto dobësi të punës, ne shokët e udhëheqjes nuk i njohim. Ne këto i njohim dhe do të kërkojmë llogari bile edhe për ato çështje, njohja e të cilave konsiderohet «sferë e specializuar».

Si mund të pranojë Partia të dëgjojë kur thuhet se naftëtarët dhe metalurgët nuk kanë disiplinë?! Në qoftë se ata vërtet nuk kanë disiplinë dhe nuk e kuptojnë gjendjen, atëherë ku po shkojmë, po gënjejnë veten? Ne, more shokë, veten nuk e gënjejnë dhe e dimë që e vërteta nuk është kështu.

Të gjitha këto detyra që po realizohen provojnë të kundërtën, që klasa jonë punëtore dhe fshatarësia kooperativiste kanë disiplinë, kanë ndërgjegje, trimëri dhe punojnë me vetëmohim për ndërtimin e socializmit. Mua më duket se për mosplotësimin e detyrave duhet «larë koka», pra duhen spastruar pikëpamjet e mendi-

met e shokëve drejtues të sektorëve ekonomikë në rrethet e deri në qendër.

Raporti i Byrosë Politike, të gjitha diskutimet që u bënë në këtë mbledhje të Plenumit të 6-të të Komitetit Qendror të Partisë si dhe eksperiencia jonë e mirë, bashkë me dobësitë, duhet të na shërbejnë për realizimin e detyrave për vitin 1979. Gjatë kësaj periudhe kohe t'i përvishemi punës seriozisht dhe të mos na rrëmbejë euforia pa baza. Euforia te njerëzit tanë, sipas mendimit tim, është shfaqur në dy lloje: njëra ka qenë euforia e bazuar dhe tjetra euforia e pabazuar. Eufori e bazuar është ajo që rrjedh nga fakti se vendi ynë, Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë, Partia e Punës e Shqipërisë mbajnë lart me dinjitet flamurin e marksizëm-leninizmit, të pavarësisë, të sovranitetit proletar dhe qëndrojnë kurdoherë përkrah popujve që luftojnë për t'u çliruar. Njerëzit shikojnë te Shqipëria dhe kërkojnë të dinë ç'e shkakton këtë forcë të madhe të këtij vendi të vogël, që, i rrethuar, u bën ballë me trimëri armiqve të rrezikshëm? Ne e dimë ku qëndron «sekreti» ynë, të cilin nuk e fshehim, por e deklarojmë botërisht: forca dhe guximi ynë qëndrojnë tek ideologjia marksiste-leniniste që na frymëzon, te Partia e Punës që na udhëheq, te shteti i diktaturës së proletariatit, te prona socialiste mbi mjetet e prodhimit, tek uniteti i popullit rreth Partisë, te guximi që na lëvrin në damarë dhe që rrjedh si trashëgim nga të parët tanë. Nuk i duron populli shqiptar shtypjen dhe skllavërinë. Në luftën pa kompromis kundër armiqve populli ynë bëhet shembull edhe për të tjerët. Ky qëndrim i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe i Partisë

së Punës të Shqipërisë ka marrë dhenë, prandaj Partia dhe shteti ynë nderohen nga popujt, proletarët dhe komunistët e vërtetë në mbarë botën. Ja përse njerëzit tanë kanë të drejtë të gëzohen dhe të jenë në eufori. Kjo eufori ka baza.

Euforia për të cilën po flas duhet të shërbejë jo vetëm që të shtohet akoma më tepër rrezatimi i fuqisë politike dhe ideologjike të Partisë dhe të shtetit tonë në popujt e botës, por edhe që të ndërtohet me sukses socializmi, të realizohen planet për zhvillimin ekonomik e kulturor të vendit dhe të forcohet mbrojtja.

Euforia, kur detyrat nuk plotësohen, është e pabazuar dhe e dëmshme. Pse është e dëmshme? Sepse të bën të kënaqesh kur nuk duhet të jesh i kënaqur. Përse të ekzistojë kjo vetëkënaqësi pa baza, kur po flasim ditë dhe natë që jemi të rrethuar nga armiqtë dhe jemi në vështirësi ekonomike, për të cilat duhet të mobilizohemi të gjithë për të vënë në vend dëmet që na kanë sjellë revizionistët kinezë? Plotësimi i detyrave të tre vjetëve të planit pesëvjeçar paraqet mungesa të ndjeshme në prodhime të rëndësishme, të cilat në këto situata kaq të rënda ndërkombëtare bëhen jetike për vendin tonë. Kur flasim për situata të rënda ndërkombëtare, për rrethim të dyfishtë imperialisto-revizionist, këto nuk duhen kuptuar si slogane, si formula të thata pa kuptim. Përkundrazi, kur flasim për rrezikshmërinë e revizionizmit sovjetik, të revizionizmit kinez, të revizionizmit titist, të imperializmit amerikan duhet ta kuptojmë çështjen me tërë seriozitetin që kërkohet dhe të ndjekim zhvillimet politike botërore, për-

gatitjet e të gjitha këtyre fuqive reaksionare për luftëra të pjesshme dhe të përgjithshme.

Në horizontin botëror po duket një aleancë tjetër e tmerrshme e lidhur midis superfuqive. Sot ose nesër kjo aleancë mund të çojë në luftë të përgjithshme, së cilës do të na duhet t'i bëjmë ballë vetëm. Ne jemi një popull, një Parti dhe një shtet që nuk mund të presim ndihmë nga asnjë shtet tjetër. Asnjë shtet nuk do të na mbrojë, por ne do të kemi përkrah popujt e botës dhe kjo përkrahje na mbush me krenari e na shton forcat. Është detyra jonë që, duke ruajtur modestinë, me shembullin tonë të frymëzojmë popujt e tjerë, që ata ta pengojnë shpërthimin e luftës, që ata të demaskojnë armiqtë e tyre, të cilët janë edhe armiqtë tanë dhe, në qoftë se në një luftë të pjesshme rrezikohet Shqipëria, ata të ngrihen në këmbë për mbrojtjen e saj.

Por që t'u bëjmë ballë rreziqeve, duhet të ndërtojmë një ekonomi socialiste të fortë. Forcën ekonomike e çon përpara Partia nëpërmjet zhvillimit të forcave prodhuese dhe përsosjes së marrëdhënieve socialiste në prodhim, nëpërmjet forcimit të unitetit dhe rritjes së pjekurisë së njerëzve, forcimit të aleancës midis klasës punëtore dhe fshatarësisë kooperativiste, ruajtjes së pronës socialiste mbi mjetet e prodhimit dhe zhvillimit të luftës klasore në thellësi, kundër të metave e dobësive për kapërcimin e vështirësive.

Po nuk forcuam ekonominë, po nuk realizuam planet, situata jonë mund të dobësohet. Mosrealizimi i planeve, me rezervat që kemi, mund të përballohet edhe për disa vjet, por jo për shumë kohë. Mirëpo, në qoftë se planet nuk realizohen, ligjet ekonomike objektive të

socializmit bëjnë punën e tyre. Ato as nuk mund të krijohen, as nuk mund të hiqen sipas qejfit. Kush nuk mban mirë parasysh kërkesat e tyre hyn në qorrsokak, ndërsa po të punohet në praktikë në përputhje me kërkesat e këtyre ligjeve arrihen në mënyrë të paevitueshme suksese në ecjen përpara. Se u jemi përmbajtur fort kërkesave të ligjeve ekonomike të socializmit, prandaj edhe kemi një ekonomi të stabilizuar e dinamike. Mirëpo kjo gjendje nuk mund të qëndrojë dhe nuk qëndron vetvetiu kështu. Ligji i kërkesës dhe ofertës, për shembull, vepron dhe bën punën e vet, pavarësisht nga ndërgjegjja dhe vullneti ynë. U tha këtu se fshatarët janë të kënaqur dhe kjo gjë ne na gëzon, por nga ky fakt ne nuk duhet të mos mbajmë parasysh e të pengohemi për të zbatuar kërkesat e këtij ligji. Po nuk u prodhua grurë, krijohen pakënaqësi, se njerëzit duan të hanë. Po nuk u prodhuan dhe nuk u tregtuan, sidomos në fshat, materiale ndërtimi në sasinë e nevojshme, natyrisht që fshatarët nuk kanë me se të ndërtojnë shtëpi banimi etj. Popullata do të shtohet vazhdimisht në qytet e në fshat, çifte të reja do të marthohen e do të krijojnë familje më vete, por ato duan banca, pra, duhen prodhuar më shumë materiale ndërtimi që të ndërtohen shtëpi. Po kështu qëndron çështja edhe për mjaft mallra e produkte të tjera industriale ose bujqësore. Prandaj na duhet të realizojmë planet, të ruajmë stabilitetin ekonomik dhe të ngremë më lart nivelin e ekonomisë.

Detyrat që na dalin do t'i kryejmë vetë me forcat tona. Ky zotim kërkon përpjekje të mëdha, shumë djersë dhe besim në vetvete. Parimi ynë për t'u mbështetur

në forcat tona nuk i pranon disa mendime që ekzistojnë, sidomos te drejtuesit e disa ndërmarrjeve ekonomike. Sipas këtyre drejtuesve s'ka nevojë të bëhen përpjekje të mëdha për të siguruar prodhimin e këtij ose të atij sendi, se atë mund ta importojmë dhe, në vend që të vrasin mendjen për të shfrytëzuar forcat e mëdha dhe kushtet e përshtatshme që kanë, ngulin këmbë që objekti të cilin ata kërkojnë, t'u vijë sa më parë nga importi! Të gjitha këto pretendime këta drejtues i bëjnë në një kohë kur as ata, as ndërmarrjet e tjera nuk e kanë realizuar planin as në sasi, as në cilësi, as në asortiment. Ata ankohen përse nuk u vijnë mallrat e importit, megjithëse sendet e prodhuara prej tyre nuk janë të përshtatshme për eksport. Në këtë mënyrë këta shokë nuk e kuptojnë si duhet rëndësinë e madhe dhe seriozitetin me të cilin duhet kuptuar problemi i tregtisë së jashtme në situatat që kalojmë, por edhe për të ardhmen.

Shokët që e morën fjalën thanë me të drejtë se nuk mund të blesh pa shitur, se më parë duhet të shesësh e pastaj të blesh. Situata jashtë është e atillë që në qoftë se mallin nuk e ke ashtu siç e kërkon blerësi, ky ose do të ta blejë me një çmim të lirë, ose nuk ta blen fare, duke të dëmtuar jo vetëm ekonomikisht, por edhe politikisht. Predispozicioni i kapitalistit që del në treg është i tillë që ai të fitojë për vete e të dëmtojë kundërshtarët, sidomos ne që punojmë për të shembur themelet e kapitalizmit, që bëjmë thirrje për revolucion. Ata që ne kërkojmë t'i rrëzojmë me revolucion, përpiqen të na gërryejnë nga brenda ose duke na futur agjentë, ose duke na sabotuar në tregtinë e jashtme, në realizimin e importit e të eksportit.



Një çështje tjetër shumë të rëndësishme kemi atë të krijimit të rezervave për kohë të veçantë, shokë. Një luftë e kemi bërë dhe kemi dalë fitimtarë. Por gjersa ekziston imperializmi, ekziston edhe rreziku i një lufte tjetër, e cila do të jetë më e ashpër se e para, dhe që do të zhvillohet në kushte krejt të tjera. Para 35 vjetësh armiku, për shumë arsye, nuk i digjte dot të tëra fushat e mbjella me grurë, kurse tashti, me mjetet që disponohen, ai është në gjendje t'i përvëlojë të tëra. Prandaj, në qoftë se ne nuk mendojmë qysh tani për të siguruar grurin, misrin e shumë gjëra të tjera, nuk kemi menduar mirë për veten tonë, për fëmijët tanë.

A mund t'i realizojmë detyrat e vitit 1979? Mund t'i realizojmë plotësisht. Për këtë janë të gjitha mundësitë. Mund të flasim për vështirësitë që na u krijuan në ato vepra që na i lanë në mes revizionistët kinezë, por edhe ato do t'i realizojmë me forcat tona.

Të kuptohemi drejt, shoku Hajredin Çeliku<sup>1</sup>, se edhe detyrat në kombinatin «Çeliku i Partisë», do t'i realizojmë vetëm me forcat tona, pa ndihmën e specialistëve të huaj. Në atë kombinat ka inxhinierë me një eksperiencë shumë të madhe. Ne kemi njerëz të shquar jo vetëm në specialitetet e inxhinierisë, por edhe në fusha e specialitete të tjera të shkencave të natyrës dhe të shkencave shoqërore. Për shkencëtarët tanë të disa fushave të dijes kanë respekt edhe shkencëtarë të huaj.

Herë pas here, kur kam kohë, lexoj libra të auto-

---

1. Në atë kohë drejtor i kombinatit metalurgjik «Çeliku i Partisë» Elbasan.

rëve të huaj në frëngjisht. Lexova, për shembull, diçka për arkeologjinë, ku përmenden me emra edhe arkeologë tanët, për të cilët thuhet se kanë zbuluar këtë ose atë monument të kulturës së lashtë. Edhe në shkencat teknike ne kemi njerëz të shquar. Mund t'ju përmend rastin e një specialisti, i cili ka bërë kalkulime të ndërlikuara shkencore në një fushë dhe tani ka shkuar për specializim në Paris. Ndryshe nga ajo formë që ishte pranuar prej shkencëtarëve francezë, specialisti ynë gjeti një mënyrë tjetër demonstrimi. Ata i përpunuan në makinat llogaritëse elektronike kalkulimet e bëra dhe u habitën kur panë se doli një rezultat pozitiv, që nuk e kishin parashikuar. Të huajt, të entuziazmuar i thanë shkencëtarit tonë: ti me këtë punim shkencor mund të paraqitesh për gradën e doktorit. Ky rast tregon se ne kemi kuadro të aftë në çdo fushë të aktivitetit ekonomik, politik, shkencor e kulturor tek të cilët duhet të kemi shumë besim.

Ne nuk jemi ksenofobë ndaj kulturës së huaj. Përkundrazi, për shkencën dhe kulturën përparimtare jemi shumë të interesuar për t'i vënë në shërbim të atdheut. Për sa i përket teknikës, në qoftë se njerëzit tanë nuk ia dalin dot ndonjë çështjeje, atëherë gjejmë mënyrat e marrjes së eksperiencës nga jashtë, duke dërguar specialistët tanë atje, duke sjellë këtu literaturë të huaj etj. Ndërtimin e socializmit duke u mbështetur në forcat e veta Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë e ka sanksionuar në Kushtetutë. Këtë parim të përgjithshëm kushtetues duhet ta kuptojmë thellë, sidomos në këto momente kur të gjithë jemi të bindur në drejtësinë e çështjes sonë, por në të njëjtën ko-

hë duhet të mos harrojmë se asnjë shtet i huaj nuk do të na ndihmojë.

Para dy-tri javësh gazeta «Borba» e Beogradit shkruante një artikull për marrëdhëniet me Shqipërinë. Në esencë përmbajtja e artikullit, e shprehur me një gjuhë diplomatike, që ne dhe të tjerët ua njohim me kohë, ishte kjo: udhëheqësit shqiptarë kanë thënë se duan të përmirësojnë marrëdhëniet me fqinjët. Dakord jemi edhe ne, thuhet në artikull, që t'i përmirësojmë marrëdhëniet, por me kusht që të lihet mënjanë lufta ideologjike, të mos kritikohen më vetadministrimi jugosllav dhe Titoja. Mirëpo kështu si thonë ata nuk jemi ne dakord. Ne kemi kërkuar nga jugosllavët që të lidhemi me hekurudhë nëpërmjet Shkodrës për të çuar mallrat më shpejt e më lirë në Evropën Qendrore dhe u kemi shtruar çështjen e tharjes e të sistemimit të fushës së Shkodrës, nga e cila përfitojmë ne dhe ata, prandaj kemi propozuar që për këtë punë të investojmë të dyja palët. Sido që ne nuk heqim dorë nga lufta ideopolitike kundër revizionistëve jugosllavë dhe sistemit të tyre vetadministrues, ata megjithatë do t'i pranojnë propozimet tona, sepse mendojnë ta shfrytëzojnë hekurudhën në një mënyrë tjetër, por ne, që u njohim dhëmbë e dhëmballë, i kemi parashikuar djallëzitë e tyre.

Ju, të gjithë jeni në dijeni që shokët tanë të Ministrisë së Tregtisë së Jashtme kanë vajtur në vende të ndryshme për lidhje marrëdhëniesh e kontratash dhe atje janë pritur shumë mirë.

Kërkesave tona për shitblerje mallrash mjaft prej tyre u janë përgjigjur me shprehje të tilla, si: «Do të

shikojmë», «Ne duam të kemi marrëdhënie me ju», duam ashtu e duam kështu etj. Ministri i Tregtisë së Jashtme të Italisë erdhi këtu i shoqëruar me 20 veta nga pas. Pasnesër do të vijë ndonjë tjetër me specialistët e tij. Kështu kanë ardhur e do të vijnë edhe të tjerë. Po çfarë mendojnë ata për ne? Disa thonë vërtet shqiptarët kanë shpallur se po ndërtojnë ekonominë duke u mbështetur në këmbët e tyre, por a do të jenë në gjendje të ecin kështu kur nuk marrin kredi për të blerë e për të tërhequr mallrat e kontraktuara? Ata i shohin vështirësitë tona, prandaj manovrojnë për të përfituar sa më shumë, për t'i blerë bitumin e mallrat tona me çmim të lirë.

Një gazetë italiane shkruante se e Keqja për Shqipërinë është se ajo nuk merr kredi, se po të merrte kredi, mallrat e kontraktuara do t'i shlyente me kreditë e huaja. Natyrisht, ai që ka shkruar në këtë gazetë nuk e ka hallin të vështirësitë tona, por kërkon të na nxitë që ne të pranojmë kredi dhe kështu të na hidhet laku në fyt, siç ka ndodhur para Çlirimit. Mirëpo ne nuk biem në këto kurthe, se e dimë që pranimi i kredive nga shtetet kapitaliste, borgjeze e revizioniste, lidhet me dhënien e koncensioneve, me krijimin në vendin tonë të shoqërive dhe institucioneve të tjera ekonomike financiare të huaja ose të përbashkëta, gjë që shpie në humbjen e lirisë, pavarësisë dhe sovranitetit tonë.

Duke vlerësuar drejt situatat dhe duke jetuar me to, duhet që çdo ndërmarrje të mos mendojë vetëm për veten e saj, por për ekonominë tonë në tërësi dhe të përpiqet të realizojë me përpikëri detyrat e planit, duke qenë e bindur që në qoftë se nuk i realizon këto, bëhet

pengesë për socializmin. Të mos mendohet se neglizhencat në kryerjen e detyrës mund të mbulohen me një autokritikë, ose duke ua hedhur fajin të tjerëve. Shfaqjeve të tilla t'u pritet rruga një herë e mirë. Kështu duhen kuptuar këto çështje. Mirëpo në praktikë vërehet se shpeshherë nuk ka koordinim të mirë në planifikim dhe nuk zbatohen kontratat e lidhura. Zbatimi i detyrave të planit dhe respektimi i kontratave është një çështje komplekse që lidhet me shumë nyja. Duhet të kesh çelikut, që të prodhosh artikuj, pjesë ndërrimi, makineri etj. për industrinë. Edhe prodhimi i çelikut në asnjë mënyrë nuk është i shkëputur nga prodhimi i grurit e i misrit. Duhet ta shesim tepricën e grurit ose të misrit që të blejmë qymyrin koks dhe sende të tjera të nevojshme për ekonominë. Por shitja e mallrave, siç thashë, nuk mund të realizohet në qoftë se ato janë të cilësisë së dobët. Duhani mund të shitet, por vetëm në ato forma, në atë harman, me ato erëra që i pëlqejnë të huajit. Kur kemi pirë duhan dhe kemi konstatuar që çdo kuti e ndërronte harmanin, ne kemi thënë: «Ky është kromë, me të të grin kolla». I huaji nuk t'i pranon prodhimet me cilësi të dobët. Kur isha i ri, në Francë kam pirë «Goluaz», kështu quheshin cigaret më të përhapura. Edhe sot përdoret akoma «Goluazi». Por ashtu siç prodhoheshin dyzet e ca vjet përpara, prodhohen edhe sot këto cigare, nuk i kanë ndryshuar, erën e kanë njësoj, kartën njësoj dhe ngjyra e zezë e duhanit ka mbetur njësoj. Ka të tjera mallra që i përmirësojnë vazhdimisht dhe i bëjnë më tërheqëse. Mund të prodhosh sa të duash por s'ka shumë dobi prodhimi kur nuk plotësohen kërkesat e konsumatorëve.

Parimi i mbështetjes në forcat e veta i zbatuar në ekonomi, do të thotë, në radhë të parë, prodhimi në vend i sa më shumë mallrave që nevojiten. Vetëm ato që vërtet nuk mund të prodhohen me forcat tona, duhet t'i importojmë dhe t'i kërkojmë me kohë, duke pasur mirë parasysh faktin se që t'i importojmë këto, më parë duhet të realizojmë eksportin në sasi dhe në cilësi.

Në luftën për realizimin e planit dikasteret duhet të jenë të lidhur ngushtë me njëri-tjetrin. Ato duhet të forcojnë kontrollin e zbatimit të detyrave nga ndërmarrjet e tyre vartëse dhe të vënë para përgjegjësisë komitetet ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve. Lidhjet në mes dikastereve dhe në mes tyre e bazës duhet të jenë të forta, prandaj të gjenden mënyrat si duhen vendosur e si duhen ruajtur këto lidhje. Këtu u tha se Porti i Durrësit po mbushet me mallra, për shkak se nuk po evadohen për eksport. Përse nuk është menduar që të ketë depo për ruajtjen e mallrave edhe gjatë, e jo vetëm në Durrës? Sepse, sipas mendimit tim, çështja nuk është parë në një sfond të gjerë kombëtar, por në prizmin sektorial, dikasterial.

Plani i vitit 1978 është realizuar më mirë se ai i vitit 1977. Nuk ka diskutim se plani i vitit 1979 do të realizohet më mirë se ai i vitit 1978. Kjo mbledhje e Plenumit, jam i bindur se do të ketë efekt të madh organizues e mobilizues në punën e komunistëve dhe të masave. Kur hartuam planin pesëvjeçar, ju kujtohet të gjithëve me sa entuziazëm e pritën këtë aksion masat punëtore e fshatare dhe gjithë punonjësit e tjerë, si lu përveshën punës me zell për të hartuar dhe për të rea-

lizuar planin, duke u bazuar në mesataren e përparuar. Kjo ka qenë një nxitje reale, gjë që u praktikua në shumë kooperativa, megjithatë plani në bujqësi nuk u realizua. Mosrealizimi ka shkaqe të ndryshme. Nuk po flas këtu për ato atmosferike, por për ato shkaqe që i quajmë subjektive, siç janë shkalla e mobilizimit të organeve dhe organizatave të Partisë, të organeve shtetërore dhe ekonomike, si dhe të çdo komunisti e punonjësi në veçanti. U zotuar që gjatë vitit 1978 të plotësonim edhe deficitet e dy viteve të mëparshme. Natyrisht, plani vjetor u realizua më mirë, por deficitet nuk u plotësuan.

Kur u përcaktuan masat për realizimin e planit të vitit 1979 u lanë zbuluar këto deficite dhe nuk u vunë detyra që të mbulohen të paktën një pjesë e tyre. Si u harruan këto mungesa serioze në plotësimin e planit pesëvjeçar? Detyrat e planit, të aprovuara nga Kongresi i 7-të i Partisë, nuk janë vënë për vite të veçanta, por janë si pesëvjeçar, prandaj edhe lufta jonë duhet të ketë pikërisht këtë synim. A mund ta quajmë këtë një harresë? Ç'është kjo rënie vullneti?! Kjo do të thotë se nuk janë kuptuar drejt situatat, prandaj nuk janë arritur plotësisht detyrat që rrjedhin prej tyre.

Këto probleme dhe sidomos dy apo tre prej tyre që janë kryesore si, bie fjala, prodhimet bujqësore e sidomos drithërat e bukës, nafta dhe tregtia e jashtme, duhet t'i kuptojmë dhe t'i vlerësojmë me gjithë seriozitetin e tyre. Ne po shohim që jashtë tregojnë interesim për Shqipërinë. Natyrisht, ky interesim nga të huajt tregohet jo se na duan, por për interesat e tyre lidhur me vendin tonë. Këta interesa janë edhe për çështje

politike, edhe për çështje ekonomike. Ka shtete që kanë nevojë për disa nga prodhimet tona. Në qoftë se për tonuk kanë nevojë aktualisht, nesër, kur kriza të krijojë një situatë tjetër të re, nevojat e tyre do të shtohen dhe në qoftë se për një ton krom, i huaji paguante 70 dollarë, do të jenë të detyruar të na e blejë me 80, 90 dhe me 100 dollarë. Lakmive kapitaliste të të huajve ne u tregojmë bërrylin, por nevojat e tyre për zhvillimin e tregtisë duhet t'i vëzhgojmë.

Duhet të mos harrojmë se armiku i jashtëm na saboton në tregun botëror, por ai përpiqet edhe të na futet e të na ngjitet në fillim si «mik» që të përgatitë terrenin për të realizuar synimet e tij ndaj vendit tonë. Ne nuk gënjehemi nga lajkat e dhelpres. Jemi gati të bëjmë tregti me vendet e tjera, por mbi bazën e barazisë, të respektimit të sovranitetit, të mosndërhyrjes dhe të dobisë reciproke. Jashtë këtyre parimeve cilitdo ia vëmë kufirin tek thana.

Fola pak gjatë për këtë çështje, por ju, shokë, e kuptoni sa shumë rëndësi ka problemi që analizojmë. Mendoj që secili prej nesh është i qartë dhe i bindur për kërkesat e Partisë dhe nevojat e atdheut, prandaj është në gjendje të bëjë një punë politike, ideologjike dhe teknike me rendiment të madh, jo vetëm personalisht si drejtues, por edhe për mobilizimin e vartësve nga qendra në bazë, për t'i dhënë një impuls të madh punës. Ky të jetë një impuls me veprim të vazhdueshëm dhe të konkretizohet me plotësimin e detyrave, me rritjen e rendimentit, me uljen e kostos, me rritjen e akumulimit të brendshëm socialist etj.

Njerëzit tanë po bëjnë heroizma të mëdha, por ka



edhe nga ata që e heqin këmbën zvarrë. Të parët t'i inkurajojmë, të dytët t'i shkundim. Ata, të cilëve u rritet mendja, t'i edukojmë që të jenë të thjeshtë e t'i futen punës për interesin e madh të shtetit, të Partisë dhe të socializmit.

Ju uroj shumë suksese! T'i përvishemi punës të gjithë, se po u mobilizuar të tërë, do ta realizojmë dhe do ta tejkalojmë në një shkallë të kënaqshme planin e vitit 1979, që është viti i katërt i pesëvjeçarit të gjashtë, viti i 35-vjetorit të Çlirimit të Atdheut dhe i fitores së revolucionit popullor, i jubileut të 100-vjetorit të lindjes së Josif Visarionoviç Stalinit, nxënësit besnik të Leninit, udhëheqësit të lavdishëm të proletariatit botëror.

Përpara, t'i vëmë gjokset punës për interesat e lartë të Partisë dhe të popullit!

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

**PËR NJË LIDHJE MË TË MIRË E SHKRIRJE  
ORGANIKE TË PROBLEMEVE NË MATERIALIN  
PËR PARTITË REVIZIONISTE EUROKOMUNISTE**

*Bisedë me shokun Ramiz Alia*

**31 janar 1979**

**SHOKU ENVER HOXHA:** Duke reflektuar rreth materialit për partitë revizioniste eurokomuniste, kam menduar si ta zhvilloj atë më gjerë dhe si të realizohen më mirë lidhja e problemeve, shkrirja organike e tyre. Siç të tha edhe Nexhmija, çështja kryesore, që edhe ti vetë e ke pasur parasysh, është që ky libër ose broshurë, sido që të dalë, të mos jetë dublim i librit «Imperializmi dhe revolucioni». Dublim nuk është nevoja dhe nuk duhet të bëjmë.

**SHOKU RAMIZ ALIA:** Ashtu është, kjo s'ka pse të bëhet.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Nëpërmjet këtij materiali, synoj të përgatitim diçka që të shërbejë si një plotësim i mëtejshëm konkret i librit «Imperializmi dhe revolucioni». Mendimet që kishim i thamë në atë libër, por më duket se mjaft ide dhe probleme nuk janë ezauruar aty, se ka akoma të tjera që kërkojnë

zbërthim, pasi kemi të bëjmë me një fushë të gjerë çështjesh e problemesh, për të cilat ne kemi dhe do të vazhdojmë të shprehim mendimet tona.

*SHOKU RAMIZ ALIA:* Ashtu është.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Numri i problemeve, siç e ke parë, në këtë studim vjen duke u zgjeruar, sepse këtu analizohen periudha të tëra, të ndryshme. Natyrisht, këto janë periudha të njohura, edhe teorikisht, edhe politikisht. Dhe dihet që nga ana jonë nuk ka asnjë analizë e trajtim çështjesh që të mos jetë e bazuar në marksizëm-leninizmin dhe në zhvillimin konkret të ngjarjeve historike, që vërtetojnë tezat tona marksiste-leniniste. Këtë e theksoj se po të themi që në këtë libër do t'u shmangemi përsëritjeve të tezave tona kryesore, jo vetëm që do të bënim gabim, por as nuk duhet menduar një gjë e tillë. Çështja është që libri të mos ketë përsëritje në formën dhe në mënyrën e shtruarjes së këtyre problemeve, me një fjalë në kombinimin e tyre.

Ne kemi biseduar tok shumë herë për çështjen që në propagandën tonë, sa të jetë e mundur, t'u largohemi formave shkollareske të të shkruarit, sidomos të asaj që kemi trashëguar nga sovjetikët.

*SHOKU RAMIZ ALIA:* Po, po, ashtu është.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Konstatojmë se mjaft studiues e publicistë tanët përdorin akoma frazeologji të rëndë e jotërheqëse, një mënyrë standard e të zakonshme të shkruarit, që është bërë shprehi dhe prej së cilës disa nuk shkëputen kollaj. Ne jemi përpjekur që disa materiale tonat teoriko-politike t'i bëjmë më

interesante, domethënë që këto të ngjallin te lexuesi interesim dhe aplikacion në leximin e tekstit.

Lidhur me këto, unë kam parasysh që nuk duhet ekskluduar fakti që vepra ose broshura, që po shkruaj, të mos mbajë ngjyrën e një libri me karakter edukativ, por, përveç kësaj, ajo të jetë e atillë që të ngjallë interes te lexuesit, t'u hapë këtyre horizont dhe t'i nxitë ata t'u punojë mendja për të gjetur rrugët e drejta, të nxiten ata që të gjejnë e të lexojnë materiale plothësuese dhe të kuptojnë se ky libër është vërtet një material i rëndësishëm teoriko-politik. Por, kuptohet, ai nuk ka dhe në asnjë mënyrë nuk mund të ketë të gjitha njohuritë e shumta shkencore që përmbajnë marksizëm-leninizmi dhe tërë zhvillimi teoriko-shkencor botëror. Unë këtu kam trajtuar, duke zgjedhur vetëm disa momente, nga të cilat janë nxjerrë pikat kardinale për të ilustruar një, dy, apo pesë çështje. Një kjo.

Prandaj unë u kushtoj kujdes të veçantë edhe përpjekjeve për të gjetur formën e përshtatshme të këtij libri. Dhe forma më e mirë, më duket mua, duhet të jetë që nocionet teorike që duam të ngulitim në kokën e njerëzve, gjë që ne e mësojmë te Lenini dhe te Marksi, në të gjitha veprat e klasikëve tanë të mëdhenj, t'i lidhim me kohën, me ngjarjet, me periudhat e tyre, me rrymat filozofike të kundërta apo të afërta, me rrymat me gabime, me devijime ose me lëshime, ashtu sikurse na mësojnë ata. Klasikët, duke e pasur të qartë se ku donin të dilnin, i kanë trajtuar e përpunuar mendimet dhe orientimet e tyre në lidhje të ngushtë me jetën. Ata kanë vepruar kështu për të treguar zhvillimin dialektik të kësaj jete, përplasjen e ideve të ndryshme me

njëra-tjetrën dhe pastaj të nxirrnin konkluzionet, duke ndjekur një rrugë të tillë që një pikëpamje të gabuar të shprehur nga dikush, e kritikojnë, e hedhin atë poshtë dhe mbështetin një mendim progresist, por duke thënë se ky nuk mund të qëndrojë deri këtu, por duhet zhvilluar më tej etj., etj.

**SHOKU RAMIZ ALIA:** Po, po, duhet të shkojë më tej.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Një metodë e tillë punë duhet të praktikohet edhe te ne, sepse konstatojmë, për këtë kemi biseduar edhe tjetër herë, që filozofët tanë e kuadro të tjerë që zotërojnë teorinë e marksizëm-leninizmit, dhe jam i bindur që ata e zotërojnë mirë, sepse e kanë mësuar në shkollë, nuk e lidhin atë sa duhet me jetën. Kështu, kur i dëgjon ata që flasin në televizion, të duket sikur ato që thonë po ua mësojnë nxënësve të shkollave. Por edhe mësimi që bëhet në shkolla, me atë mënyrë që bëhet, prapë është abstrakt, nuk të futet në kokë, për arsye se fare pak, për të mos thënë aspak, konkretizohet duke e lidhur me ngjarjet e jetës. Dhe, kur them kështu, nuk kam parasysh vetëm ngjarjet aktuale, që e bëjnë leksionin më të gjallë, sepse punojmë, luftojmë e jetojmë me këto ngjarje, por ata nuk e lidhin sa duhet as me ngjarjet kur kanë luftuar Marksisi, Engelsi, Lenini dhe Stalini. Për shembull, programi mund të parashikojë zhvillimin e luftës së klasave në Francë ose në ndonjë vend tjetër, por pedagogut, kur të flasë për këtë çështje, nuk i lejohet që të mos i referohet jo vetëm realitetit tonë, por edhe luftërave klasore në vende të tjera, sepse du-

ke vepruar kështu, e bën më të gjallë e konkrete teorinë dhe pjesën teorike që do të shpjegojë.

Prandaj, në përgjithësi, forma dhe përmbajtja e librave, e broshurave tona duhen trajtuar në këtë mënyrë, mendoj unë, dhe shembujt që do të përdoren në to për ilustrim, duhet të jenë, natyrisht, nga më karakteristikët, shembujt pozitivë të jenë nga më revolucionarët, progresistët dhe shembujt negativë nga më retrogradët, reaksionarët ose idealistët, kështu që teoria të konfrontohet me realitetin dhe të dalë ajo që duam ne.

Pikërisht për këtë mendoj të aktivizoni disa shokë, të cilët, duke ditur idenë dhe qëllimet e librit, si dhe tezat që zhvilloj unë aty, mund të ndihmojnë duke gjetur shembuj nga literatura dhe fakte të jetës që mbështetin pozicionet tona marksiste. Për këtë punë, lypset që ata që do të caktoni me këtë punë të njohin mirë teorinë, të kenë edhe dijeni historike, sepse kjo teori është trajtuar në një zhvillim konkret dialektik historik. Trajtimi i problemit në mënyrë të tillë shpjegon jo vetëm parimin, por i jep të kuptojë lexuesit që ky parim, bie fjala, është jo i gabuar, se edhe 200 vjet përpara i tillë ka qenë ai, jo i gabuar, edhe 100 vjet përpara ka qenë, gjithashtu jo i gabuar, edhe sot kështu është, jo i gabuar. Domethënë për një çështje ose tezë teorike që ngrihet në libër, këta shokë të sjellin ndonjë fakt historik ose argument, që vërtetojnë këtë ose atë tezë teorike. Kjo do ta bëjë materialin më interesant, do ta bëjë problemin më të kuptueshëm, kjo të bën që atë ta mbash mend dhe të mund ta zbatosh

më lehtë sesa kur jepen formulime abstrakte. Kjo është e përgjithshme.

Ato që kam shkruar unë për të tria partitë kryesore revizioniste të Evropës Perëndimore janë në këtë material, mirëpo ne e zgjeruam një çikë më shumë këtë temë.

*SHOKU RAMIZ ALIA:* Megjithatë jemi rreth një ideje.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Ashtu është, idetë kryesore mbeten gjithmonë po ato, çështjet e revolucionit. Kjo çështje përbën boshtin rreth të cilit vërtiten të gjitha çështjet e tjera.

Tash unë kam problemin: çfarë do të trajtoj më gjerë në këtë libër, si do t'i trajtoj çështjet dhe nga ç'këndvështrimi do t'i shikoj ato etj., etj. Sidoqoftë e shoh që materiali duhet përpunuar më tej, me qëllim që të bëhet i tillë që të jetë i vlefshëm për momentin, i domosdoshëm për aktualitetin, mbi bazën e vijës së përgjithshme të Partisë. Kësaj vije dhe ideje Partia jonë, me punën dhe me luftën e saj, i ka shërbyer që kur u krijua dhe deri tash; kësaj vije dhe ideje i kanë shërbyer edhe materialet e të tëra dokumentet e tjera, ku pasqyrohet lufta e paepur që ka zhvilluar e zhvillon Partia jonë kundër të gjithë armiqve të marksizëm-leninizmit. Këto nuk janë gjëra që i bëjmë për herë të parë ose që i bëjmë ne. Udhërrëfyesit tanë në këtë rrugë janë klasikët e marksizëm-leninizmit. Ne jemi nxënësit e tyre, që e zbatojmë teorinë e tyre të pagabuar në kushtet aktuale konkrete. Kështu, situatat që janë krijuar tashti ne përpiqemi t'i përgjithësojmë, duke u

bazuar te klasikët tanë dhe të nxjerrim prej tyre disa konkluzione.

Cilat janë konkluzionet që duhet të nxjerrim ne dhe cilat nga këto janë nga më akutet? Kjo duhet të jetë një nga pyetjet kryesore që ne duhet t'i përgjigjemi. Është akute të flasim për Internacionalen e Parë? Po si nuk është një çështje akute? Kjo është baza, por, aktualisht, kjo është një temë që mund ta trajtoj kalimthi dhe pa e zënë në gojë në momentet aktuale që janë shumë të nevojshme të trajtohen. Është e domosdoshme të flasim ne për Internacionalen e Tretë? Është, por, që të trajtoj Internacionalen e Tretë në formën që e kisha menduar përpara, duhet kohë dhe duhen kapur aspekte shumë të ndryshme, të cilat lypin një studim të thellë.

Tjetër, kur analizohet çështja e fitores së socializmit, domethënë e vazhdimësisë së fitores së revolucionit dhe të triumfit të ideve të marksizëm-leninizmit, pra është fjala për palcën e kurrizit të të gjithë kësaj çështjeje, duhet të dalë ideja që thamë.

Del pyetja: po për fitoren e socializmit është e nevojshme të flitet në këtë libër? Po si nuk është e nevojshme? Për kë po luftojmë ne? Për këtë çështje ne kemi folur dhe do të flasim, por në këto momente, kur po na del një rrymë tjetër armike e socializmit, revizionizmi modern i Evropës Perëndimore, i cili po lufton revolucionin dhe socializmin, ky problem bëhet akut, prandaj mendoj se këtu duhet vënë theksi më fort.

Në librin «Imperializmi dhe revolucionin» vumë një kapitull më vete: «Strategjia e imperializmit dhe e revizionizmit modern», ku shtjellohet ky problem. Aty



trajtohet në përgjithësi edhe çështja e luftërave nacionalçlirimtare, që janë faktorë ndihmës të revolucionit. Pastaj në tre kapituj më vete i ramë revizionizmit kinez, sepse ky u bë i rrezikshëm. Por në asnjë mënyrë të mos mendohet se me kaq ne e likuiduam këtë rrezik. Lufta jonë kundër tij nuk ka mbaruar, veçse duhet thënë se me këtë analizë kemi hedhur bazat dhe koha po vërteton që analiza jonë ishte e drejtë.

Për sa i përket titizmit, Partia jonë ka folur dhe ka luftuar vazhdimisht kundër tij. Titistët kanë kurdisur komplete kundër nesh dhe Partia jonë i ka demaskuar ata dhe i ka dënuar veglat e tyre, komplotistët.

Edhe kundër socialimperialistëve sovjetikë, po ashtu, ne kemi folur e kemi luftuar me ashpërsi, por në këtë libër për çështjen e Bashkimit Sovjetik mendoj të bëhet diçka më komplete.

Për sa i përket çështjes së eurokomunizmit, siç e kam shënuar në shkrimet e mia, mendoj të vihet mirë në dukje lufta që bëjnë partitë kryesore revizioniste të Evropës Perëndimore dhe të gjitha partitë e tjera revizioniste të vendeve kapitaliste për forcimin e krahëve të tyre në radhët e klasës punëtore, domethënë, të sindikatave. Këto grumbullojnë në organizatat e tyre klasën punëtore dhe punonjësit e tjerë, duke shërbyer si masa në duart e këtyre partive gjoja për t'i bërë presion pushtetit të kapitalit për pjesëmarrjen e tyre në këtë pushtet dhe që synon, në qoftë se ia arrijnë këtij qëllimi, të largojnë ose të shuajnë revolucionin në vendet kapitaliste. Me fjalë të tjera, do të dalë qartë që eurokomunizmi është ajo rrymë revizioniste, e njëjllotë kudo, që ka për qëllim degjenerimin e klasës punë-

tore, shuarjen e revoltave të saj kundër shtypësve, kundër borgjezisë dhe pushtetit të saj, që të mos ketë mundësi kurrë të marrë fuqinë. Pra, do të dalë ideja se eurokomunizmi përpiket të paraqitet i bashkuar, pse edhe kapitalizmi i Evropës Perëndimore bën orvatje të unifikohet në Evropën e Bashkuar dhe në Tregun e Përbashkët Evropian.

Partitë revizioniste dhe eurokomunizmi ndjekin pikërisht ndryshimet e strukturave të kapitalizmit në vendet e tyre dhe u përshtaten këtyre formave të reja të kapitalizmit monopolist, Tregut të Përbashkët Evropian, Evropës së Bashkuar, që, siç ka thënë Lenini, mund edhe të arrihet, por që mbetet kurdoherë një organizëm reaksionar.

Pra, eurokomunizmi u përgjigjet situatave aktuale të strukturës së re që krijon kapitalizmi i Evropës së Bashkuar, kurse partitë revizioniste të vendeve të Amerikës Latine, për shembull, nuk e kanë akoma perspektivën e krijimit të një strukture të tillë, për arsye se struktura kapitaliste në vendet e Amerikës Latine është krejt ndryshe nga struktura për të cilën bëhen përpjekje që të krijohet në Evropën e Bashkuar. Prandaj në vendet e Amerikës Latine edhe mund të arrihet në një «amerikanokomunizëm» (revizionizëm), por hëpërhë mundet edhe të mos arrihet.

Materiali do të bëhet më interesant, duke shpjeguar se ç'është eurokomunizmi, pse përdoret ky term dhe, pa i neglizhuar kontradiktat që ekzistojnë në mes partive të vendeve të Evropës Perëndimore, si edhe të Evropës Lindore, Bashkimit Sovjetik dhe titizmit, në libër do të tregohet se prapëseprapë revizionizmi në

të tria këto shfaqje, edhe në shfaqjen e revizionizmit kinez, paraqitet me të njëjtat tipare, që janë lufta kundër revolucionit, lufta kundër ndërtimit të socializmit, mohimi i luftës së klasave, për paqen shoqërore etj. Eurokomunistët dhe tërë revizionistët po i atakojnë klasikët e marksizëm-leninizmit, Marks, Engelsin, Leninin dhe Stalinin, kurse revizionistët hrushovianë, nuk i atakojnë hapur dhe maskohen duke atakuar vetëm Stalinin dhe sistemin socialist. Natyrisht, hrushovianët luftuan, shpifën e ç'nuk thanë kundër Stalinit, por ata hiqen sikur gjoja udhëhiqen nga mësimet e Leninit, kurse eurokomunistët dhe revizionistët e tjerë i atakojnë të katër klasikët tanë të mëdhenj, Marks, Engelsin, Leninin dhe Stalinin.

Prandaj mendoj që të ndalem një çikë në këto gjëra. Mua më duket sikur e ke pasur edhe ti njëherë këtë mendim, siç më ka thënë Nexhmija, «që Ramizi ngul këmbë për të botuar këtë material me analizën mbi të tria partitë revizioniste eurokomuniste evropiane, pa u zgjatur në shumë çështje të tjera».

*SHOKU RAMIZ ALIA:* Po, unë e kam atë mendim.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Drejt, se po ta zgjerohim shumë këtë analizë, atëherë kjo jo se do të humbishte, por do të shpërndahej. Prandaj mendoj të mbaj vetëm materialin bazë që kam shkruar, të trajtoj gjithashtu edhe problemin e Partisë Komuniste të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të Brauderit.

Dhe mua më rezulton nga gjykimet, nga ato që mendoj e që analizoj, se brauderizmi është orientimi kryesor i kapitalizmit, i imperializmit amerikan, për

degjenerimin e partive të Internacionales së Tretë pas Luftës së Dytë Botërore. Ai e hapi vijën dhe, siç e kemi thënë, po të konfrontohen partitë revizioniste, do të shohim se, natyrisht, me disa ndryshime, të tëra njësoj janë, të tëra një vijë kanë: pajtimin klasor, likuidimin e partisë, ndihmat amerikane etj., këtu janë të tëra.

Natyrisht, materialit që kam shkruar mendoj të mos i ndërrohet e tërë forma, por ne duhet ta kthejmë atë në formën e një libri teorik, se në materialin që kam në dorë unë jam marrë edhe me çështje personash: «ky tha kështu, ai ashtu, bëri kështu» etj., «për çështje vije, për çështje parimesh, ka mbrojtur këtë, ka mbrojtur atë», «në këtë influencë kanë qëndruar drejt me disa lëkundje pastaj «fëçësht» shkuan, shkanë» etj., për të vërtetuar atë që duam të vërtetojmë ne në këtë moment. Kur themi që këto janë rryma revizioniste, duhet kuptuar se ato janë rryma të kapitalit, që përpigën për të dëmtuar dhe minuar socializmin. Ne shohim se si këto parti që e morën veten dhe u rritën, më vonë degjeneruan. Domethënë, nëpërmjet zhvillimit të këtyre çështjeve, natyrisht, kjo duhet të dalë. Këtu, më duket mua, ashtu siç e kam thënë edhe herë tjetër, synoj të dalë mirë roli i Partisë sonë. Këtë mund të mos e nxjerr si një kapitull më vete, po ashtu siç e kemi, nëpër të; kjo ide ta përshkojë tërë materialin si një fill i kuq.

*SHOKU RAMIZ ALIA:* Po, ashtu siç është edhe në librin «Imperializmi dhe revolucioni».

*SHOKU ENVER HOXHA:* Po. Tash më preokupojnë edhe një problem tjetër. Kur flitet për partitë re-

vizioniste në vendet e zhvilluara kapitaliste mendoj të kemi parasysh edhe partitë «marksiste-leniniste» që janë në shërbim të revizionizmit kinez, që hiqen sikur janë marksiste-leniniste, por, në fakt, janë revizioniste, pse «mëma» e tyre është revizioniste, prandaj edhe bishtrat të tilla janë. Në libër, pa i përmendur këto parti me emër, do të karakterizojmë qëndrimet e tyre politiko-ideologjike, që vërtet janë pa vlera të mëdha, por shërbejnë për të hallakatur opinionin e shëndoshë marksist-leninist.

Këtu, mendoj unë, do të vihet si konkluzion që këtyre partive u është vënë emri «eurokomuniste» dhe ta shpjegojmë termin eurokomunizëm, duke thënë se ky nuk përfshin vetëm partitë revizioniste të Evropës, mbasi edhe partitë revizioniste të kontinenteve të tjera janë në të njëjtat pozita antimarksiste si edhe këto tri parti<sup>1</sup>, vetëm se në Evropë po vihet në zbatim policentrizmi toliatist. Eurokomunizmi është teoria e Toliatit, sipas së cilës duhen shumë qendra. Përveç eurokomunizmit është edhe «eurokomunizmi kinez», ose siç mund ta quajmë «aziokomunizëm», në Amerikë mund të shfaqet një «amerikanokomunizëm». Kjo çështje, pra, mendoj të trajtohet në këtë formë. Aty ku flitet për Brauderin, do të thuhet se këtu e ka burimin kjo rrymë revizioniste që ka dalë dhe do ta zhvillojmë këtë, pastaj më tutje do të vihet në dukje që eurokomunizëm është quajtur edhe teoria e Toliatit dhe ta shikojnë se si është zhvilluar. Më poshtë do të vazhdojmë me kinezët, që kanë filluar të krijojnë partitë e tyre maoiste, të cilat

---

1. Partitë revizioniste të Francës, të Italisë dhe të Spanjës.

janë në fakt revizioniste dhe që janë të përhapura si kërpudha edhe në vendet e Amerikës Latine, edhe në Azi, ku po degjenerojnë...

Tash të vijmë te një konkluzion tjetër që duhet të bëjmë në këtë libër. Këtë vit kemi 100-vjetorin e lindjes së Stalinit. Kjo më shtyn ta shtjellojmë një çikë këtë çështje, të vëmë në dukje që marksizëm-leninizmi po atakohet nga revizionizmi modern, të vëmë theksin në këtë rast te revizionistët hrushovianë që veprojnë në atdheun e socializmit, ku kanë luftuar Lenini dhe Stalini, të cilët e kanë zbatuar teorinë e Marksit në mënyrë konkrete dhe ekzakte. Prandaj në libër do të thuhet konkretisht përse akuzohet Stalini dhe do të vëmë në dukje që akuzohet për këtë, për këtë dhe për këtë dhe nëpërmjet argumenteve shkencore dhe historike t'i rrëzojmë të gjitha akuzat e tyre. Gjithashtu do të shpjegojmë se Stalini ka zbatuar luftën e klasave, ka realizuar kolektivizimin e bujqësisë, ndërtimin e socializmit, se baza e socializmit nuk mund të ndërtohej duke u lejuar pasuritë nepmanëve, kulakëve, çifligarëve etj., etj., siç bëri Mao Ce Duni dhe siç po bën Ten Hsiao Pini në Kinë. Stalini zbatoi pikërisht teorinë e Marksit e të Leninit, ndërtoi industrinë e rëndë, gjë që e bëri Bashkimin Sovjetik një shtet socialist të fuqishëm, që i rezistoi hitlerizmit dhe, me gjithë shkatërrimet e mëdha që pësoi, pas luftës ai u rindërtua në një periudhë shumë të shkurtër dhe ekonomia sovjetike filloi të ecte me hapa të mëdhenj përpara. Stalini ishte flamurtari i madh që mbajti lart flamurin e Marksit dhe të Leninit për mbrojtjen e pastërtisë së marksizëm-leninizmit kundër trockistëve, kundër buharinistëve, të ci-

lët ishin agjentë të imperializmit dhe elementë deviatorë që punuan për shkatërrimin e socializmit, siç ndodhi aktualisht me revizionistët modernë. Stalini i nxori në gjyq të gjithë armiqtë dhe nuk pati frikë ta bënte një gjë të tillë. Ky veprim ishte zbatimi i luftës së klasave dhe mbrojtja e fitoreve të revolucionit proletar. Në qoftë se Stalini nuk do ta kishte bërë këtë, ai do të gabonte dhe gjithë kjo që ngjau tash, do të kishte ngjarë kohë më përpara.

Me gjithë zhvillimin e luftës së klasave, elementët revizionistë pas vdekjes së Stalinit ngritën krye, sepse me vdekjen e tij u krijua «një kundërpeshë sentimentale, — mund të themi, — por edhe realiste, që vdekja e Stalinit do të dobësonte komunizmin». Nga kjo morën shkas revizionistët hrushovianë dhe arritën me një mijë djallëzi ta mbytnin me gënjeshtër elementin e shëndoshë të klasës dhe të Partisë.

Çështja tjetër që do të trajtohet lidhur me figurën e Stalinit është ajo se ky ka qenë edhe një strateg i madh i ushtrisë, se teoria e tij ushtarake luajti një rol të rëndësishëm dhe vendimtar për arritjen e fitores së Bashkimit Sovjetik në luftën kundër nazizmit. Të gjithë ata mareshalë e gjeneralë, që pas vdekjes së tij i hodhën baltë Stalinit, kanë pasë dalë pikërisht nga shkollat e tij ushtarake teoriko-ideologjike. Të gjithë ata që i kanë hedhur gurë Stalinit u bënë elementë ambiciozë, mendjemëdhenj dhe, pas vdekjes së tij, u duk kalbëzimi i tyre. Gjenia e Stalinit në çështjet strategjike u duk qartë kur u arrit fitorja, ndryshe jo Bashkimi Sovjetik, por tërë bota nuk do të zhvillohej siç u zhvillua. Ne konstatojmë se edhe borgjezia më reak-

sionare, që nuk e ka dashur kurrë Stalinin dhe të gjitha veprimet e tij marksiste-leniniste i ka quajtur dhe i quan krime të mëdha edhe aktualisht, veçanërisht atin ushtarak të ushtrisë sovjetike dhe të komandantit të saj në Luftën e Madhe Patriotike ajo e vlerëson drejt, objektivisht dhe e lavdëron për meritat e tij të mëdha. Kurse një edepsëz si Hrushovi ka arritur deri atje saqë të thotë se Stalini e drejtonte luftën me një glob shkolle.

Prandaj, për këtë çështje, mendoj të bëjmë një konkluzion se Stalini është besnik i marksizëm-leninizmit. Ai po trajtohet nga borgjezia dhe nga revizionistët si kriminel, por për borgjezinë dhe për revizionistët gjithë marksizmi, leninizmi, Marksi, Engelsi, Lenini dhe Stalini janë të dënueshëm, bile për ta do të ishte më e mira që të mos kishin ekzistuar fare, të ishin varur qëkurse lindën. Por klasikët tanë të mëdhenj nuk kanë vdekur, vepra e tyre i bën ata gjithnjë të gjallë dhe gjithë komunistët në botë, jo për çështje thjesht sentimentalizmi, por për çështje vije, për mbrojtjen e partitërisë së veprës së tyre, për çështjen e jetës, duhet t'i mbrojnë, sepse tash përveç Stalinit, po i hedhin baltë edhe Leninit, edhe Marksit. Kurse ne duhet të luftojmë deri në fund, siç kemi luftuar, për marksizëm-leninizmin, për socializmin, për revolucionin.

Prandaj, mendoj të qëndrojmë një çikë në këtë kuadër. Këto janë disa çështje që mendoj unë të trajtoj në këtë material.

**SHOKU RAMIZ ALIA:** Për këtë çështje ju, shoku Enver, keni diskutuar disa herë me mua. Fillimisht tamam këtë ide që po theksoni tani e kam dëgjuar nga



ju. Më vonë lindën ato mendimet e tjera. Në përgjithësi, të gjitha mendimet që ju lindën juve për këtë libër, edhe materialet që keni shkruar dhe që janë bazë e këtij libri, të gjitha janë aktuale, sepse vetë «Imperializmi dhe revolucioni» trajton problemin themelor, domethënë, duhet revolucioni apo nuk duhet, si duhet bërë dhe a mund të bëhet revolucioni? Ju konkludoni me të drejtë që aktualisht revolucioni është në rend të ditës, se ai duhet bërë dhe kushtet janë për ta bërë, ekzistojnë.

Tani vetvetiu dalin dy probleme, që ne duhet t'i kemi gjithmonë parasysh, që këtë revolucion pa dyshim e pengon borgjezia, por e pengojnë edhe lakenjtë e saj, revizionistët e çfarëdo ngjyre qofshin. Prandaj asgjë nuk mund të shkruhet pa atakuar borgjezinë, pa atakuar revizionizmin. Pse e them këtë? E them se nga kjo pikëpamje nuk duhet të na trembë ndonjë përsëritje eventuale, sepse sot në botë, siç e keni theksuar ju në shumë materiale të tjera, edhe tani e thalë, këto dy çështje janë kapitale, domethënë, kundër kujt drejtohet lufta jonë, lufta e proletariatit? Ajo drejtohet kundër borgjezisë dhe kundër revizionizmit, prandaj çfarëdo që të shkruhet, cilado që të jetë tema kryesore, goditja do të drejtohet gjithnjë kundër këtyre. Kjo përputhet edhe me idenë tuaj racionale që ne duhet të paraqesim realitetin e sotëm, jetën, jetën që plekset pikërisht me këta armiq. Prandaj nga kjo pikëpamje ne nuk duhet të na trembë fakti se mund të ketë ndonjë përsëritje, kur bëhet analiza e revizionizmit, qoftë e eurokomunizmit, qoftë e revizionizmit hrushovian, tistit etj. Jo në mënyrë artificiale, por në mënyrë reale,

atje ku është e nevojshme, në libër duhet të flitet dhe t'i atakojmë ata.

Nga kjo pikëpamje materialet që keni shkruar ju për këto tri parti të Evropës Perëndimore, dhe që unë mendoj se janë mjaft me rëndësi, duhet t'i shfrytëzojmë drejt, mirë, si duhet. Mua më duket se këtu na del problemi për eurokomunizmin, që ju e theksuat. Unë po them një mendim: ky libër duhet të drejtojë goditjen, si të thuash, pikërisht, kundër eurokomunizmit edhe nga një pikëpamje tjetër: jo vetëm për faktin që revizionizmi përgjithësisht është armiku i komunizmit dhe kundrejt tij duhet luftuar, por, po të shikojmë pak historikun e revizionizmit, në vija të përgjithshme, siç e thatë ju, është Brauderi ai që e hapi këtë rrugë. Analiza juaj, mendoj unë, është shumë e drejtë dhe kjo duhet evidentuar.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Pavarësisht se partia revizioniste e Shteteve të Bashkuara është një parti e vogël.

*SHOKU RAMIZ ALIA:* Pavarësisht nga kjo. Çështja qëndron këtu se është imperializmi i madh amerikan lidhshëm i luftës kundër komunizmit, është pra ai që frymëzoi në radhë të parë revizionizmin në vendin e vet, me synimin pastaj që ta shtrinte këtë edhe në vendet e tjera. Po të marrim zhvillimin e revizionizmit, shoku Enver, do të shohim se kemi dy momente me rëndësi, mendoj unë, që ndoshta duhet të përdoren në këtë material: i pari është lindja e revizionizmit braudërian, si një diversion mbi lëvizjen komuniste, që frymëzohet e nxitet nga imperializmi amerikan.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Me «Planin Marshall».

*SHOKU RAMIZ ALIA:* Dhe në të njëjtën kohë, kjo si të thuash, është ana e diversionit të brendshëm, në rrugë gjoja paqësore, por kemi edhe «Planin Marshall», domethënë presionin ekonomik e politik, ekspansionin ekonomik dhe politik dhe luftën e ftohtë, që në disa vende u kthye edhe në luftë të nxehtë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Domethënë «Plani Marshall» është përforcimi i aleatëve të rinj dhe baza e neokolonializmit. Këtu e ka burimin neokolonializmi.

*SHOKU RAMIZ ALIA:* Pikërisht këtu e kisha unë tani, që këto ndodhin edhe në kohë e në hapësirë, kur thashë në një kohë. Në vitet 1945, 1946, 1947, është periudha kur socializmi doli fitimtar nga lufta, dolën partitë komuniste në pushtet në shumë vende. Bashkimi Sovjetik dhe vetë Stalini influencuan për forcimin e lëvizjes komuniste ndërkombëtare, prandaj gjithë reaksioni veproi në këtë mënyrë. Po të shikojmë më tej, konstatojmë se revizionizmi tiftist dhe ai hrushovian janë dy variante të revizionizmit për degjenerimin e pushtetit proletar.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Se kanë qenë në pushtet këta.

*SHOKU RAMIZ ALIA:* Po, kanë qenë në pushtet. Pra, nga kjo pikëpamje analiza që i është bërë deri tani në gjithë materialet e Partisë sonë, në shkrimet tuaja, qoftë titizmit, qoftë hrushovizmit, është bërë e plotë. Mundet që kjo analizë të thellohet më tepër dhe ky është një tjetër problem, por çështja është se kemi të bëjmë me një rrymë antimarksiste që minon diktaturën e proletariatit.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Konkretisht kërkon transformimin.

*SHOKU RAMIZ ALIA:* Kurse tashti, mendoj unë, prandaj thashë që ta diskutojmë këtë, më duket se aktualisht edhe eurokomunizmi është ideologjia revizioniste që pengon revolucionin në vendet kapitaliste, jo vetëm në tre vendet ku ekzistojnë këto parti, për të cilat keni shkruar ju, po drejt e thatë që ka edhe një «aziokomunizëm», ka edhe një «amerikanokomunizëm» që mund të na dalë. Domethënë kjo është një ideologji që synon të shpartallojë revolucionin përgjithësisht në vendet kapitaliste. Nga kjo pikëpamje, më duket mua, eurokomunizmi bëhet joshës, tërheqës, për shumë nga këto parti që nuk janë në pushtet.

Prandaj si konkluzion jam i mendimit...

*SHOKU ENVER HOXHA:* Më parë se të konkludosh ne duhet të shtojmë këtë që hrushovizmi dhe tizmi ishin revizionizëm në pushtet dhe filluan transformimin e diktaturës së proletariatit dhe të partisë së tyre. Eurokomunistët, ashtu siç e the ti, janë revizionistë si këta dhe veprojnë për t'u infiltruar në pushtet që ta sjellin borgjezinë e këtyre vendeve në atë pozitë, siç e kanë sjellë në vendet ish-socialiste revizionizmi tivist e hrushovian.

*SHOKU RAMIZ ALIA:* Domethënë të reformohet borgjezia, kurse këta e ngritën borgjezinë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Po, të reformohet borgjezia, kurse këta e ngritën borgjezinë, kështu të likuidohet shoqëria e Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit, me një fjalë të mos ketë më revolucion.

*SHOKU RAMIZ ALIA:* Pikërisht këtu do të dilja

unë, që revizionizmit hrushovian dhe titist, për të shkatërruar diktaturën e proletariatit, u duhej medoemos të sulmonin Stalinin, për të gjitha ato arsye që thatë edhe ju. Prandaj mendoj që konkluzioni ynë duhet të jetë që çështja e Stalinit është çështje e revolucionit, është çështje e diktaturës së proletariatit, është çështje e socializmit. Nuk ka asnjë rezervë për këtë çështje. Kush ka rezerva për të, ai nuk është për socializmin. Për Stalinin nuk duhet të pranohet asnjë rezervë. Pra, ndërsa këta, revizionistët, e drejtuan sulmin kundër Stalinit, vëmë re se eurokomunistëve u prish punë edhe Lenini, sepse këta nuk duan as revolucionin. Kurse në vendet e tjera, për të cilat folëm, revolucionit është kryer dhe këtyre u duhej të hidhnin poshtë Stalinin, që të mund të përmbysnin diktaturën e proletariatit, kurse eurokomunistëve u duhet të hedhin poshtë edhe Leninin, që të mos ketë mundësi të kryhet revolucionit.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Po, po, drejt e ke idenë, drejt.

**SHOKU RAMIZ ALIA:** Prandaj, shoku Enver, nga kjo pikëpamje, megjithëse këto ide janë të tëra në materialet tuaja, këto duhen parë gjithmonë në këtë plan. Jam plotësisht dakord me mendimin tuaj që ky libër të jetë një përgjithësim i praktikës aktuale, pasi sot bota ndodhet përpara këtij rreziku, eurokomunizmin e nënvleftësojnë, por nuk është për t'u nënvleftësuar, se është tepër i rrezikshëm.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Dhe duhen kuptuar mirë të gjitha format dhe të gjitha qëllimet e tij, po ashtu edhe aleancat e shumta që kanë eurokomunistët me ra-

vizionizmin sovjetik, kinez etj., etj. Natyrisht ka kundërshtime midis tyre, ashtu siç kanë edhe imperialistët në mes njëri-tjetrit.

**SHOKU RAMIZ ALIA:** Këtë ide kisha unë, ndoshta duhet pasur parasysh.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Dakord. Kurse idetë e tjera të përgjithshme ia thashë edhe Nexhmijes, më duket se foli me ty.

**SHOKU RAMIZ ALIA:** Po, po, biseduam.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Këto ide ne duhet t'i kemi parasysh edhe se si mund të na shërbejnë për të ndërtuar një material teorik për Kongresin.

**SHOKU RAMIZ ALIA:** Po, ma tha Nexhmija këtë ide, domethënë për Kongresin. Në planin e jashtëm mund të vlejë ai problem, se në Kongres, ndoshta, duhet të ngremë edhe një problem tjetër që duhet ta zhvillojmë, çështjen e ndërtimit të socializmit në një vend të vogël.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Po, edhe atë, natyrisht, e ngremë.

**SHOKU RAMIZ ALIA:** Domethënë që e kemi në plan të brendshëm, si të thuash, kurse në plan të jashtëm mund të ngrihet çështja që thashë, ajo e proletariatit.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Po, po, më shumë se si ndërtohet në vendin tonë, pa u futur shumë në plan të jashtëm.

**SHOKU RAMIZ ALIA:** Jo, jo, ne e kemi në plan të përgjithshëm teorik, përgjithësimin e eksperiencës sonë në këtë fushë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Mirë, jemi dakord atë-

herë, vetëm që duhet të mendojmë një çikë për mënyrat se si, qysh e tek do të punojmë, si për plotësimin e materialit tim dhe për Kongresin. Këto mendime kisha unë.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga biseda  
e incizuar që gjendet në AQP*

## UDHËHEQJA E PK TË ITALISË (MARKSISTE- -LENINISTE) PO DEVIJON

Shënime

3 shkurt 1979

Shokët e ambasadës sonë në Romë na dërgojnë lajme jo të mira për Partinë Komuniste të Italisë (marksiste-leniniste). Del se kjo parti po devijon nga rruga marksiste-leniniste dhe është në shkatërrim e sipër. Siç duket, provat që e vërtetojnë një gjendje të tillë, po shtohen. Shokëve tanë të ambasadës u dërgojnë letra njerëz nga shumë qytete të Italisë, me emër dhe pa emër, ku vihet në dukje se kjo parti po devijon nga marksizëm-leninizmi. Në Novara, thonë, gjithë organizata, së bashku me komitetin e partisë dhe me një anëtar të Komitetit Qendror, janë ngritur kundër vijës revizioniste të udhëheqjes së Partisë Komuniste të Italisë (marksiste-leniniste). Kështu ndodh edhe në Padova e në Como, në Firenze e në Parma. Nga informimet që kemi, marrim vesh se ka shumë anëtarë të bazës që janë kundër, por ka edhe të tjerë që lëkunden. Në Milano gjendja është kaotike, ka anëtarë që janë kundër, ka të tjerë që janë të paqartë, por ka gjithashtu edhe nga ata që propagandojnë me zell vi-



jën e tanishme të paqartë e të turbullt revizioniste të udhëheqjes italiane.

Shumë nga anëtarët e kësaj partie, që kanë pasë ardhur edhe në Shqipëri, tani janë bashkuar dhe punojnë aktivisht në të famshmen gazetë «Otobre», duke propaganduar e duke përhapur vijën revizioniste dhe pikëpamjet antishqiptare.

Si përhapen këto pikëpamje antishqiptare? Një pjesë, që punon për gazetën «Otobre», thotë se Shqipëria është shumë sektare, se Shqipëria nuk i sheh në gjerësinë e tyre problemet, se Shqipëria nuk e kupton që Bashkinë Sovjetik është dobësuar; ose shprehin pikëpamje të tilla si: Bashkimi Sovjetik ecën drejt një ndryshimi rrënjësor të prirë nga ana e komunizmit të vërtetë. Gazeta «Nuova unita», për ta mbështetur këtë thënie, aktivizon që të shkruajnë njerëzit e vet, të cilët kanë qenë në Shqipëri, që gjoja fjalët e tyre t'i bindin ata që i lexojnë. Por, nga ana tjetër, manovra e tyre është e tillë që në gazetën «Nuova unita», e cila del një herë në javë, e jo në gazetën «Otobre» që del çdo ditë, boton ndonjë artikull proshqiptar, pro Partisë së Punës të Shqipërisë, ose ndonjë artikull të marrë nga gazeta «Zëri i popullit». Kjo bëhet me qëllim, për t'u lënë përshtypjen atyre që e kundërshtojnë devijimin e Partisë Komuniste të Italisë (marksiste-leniniste), se gjoja udhëheqja e saj është me Partinë e Punës të Shqipërisë. Kurse në të vërtetë, nga ana tjetër, ajo na lufton.

Informatat që kemi na thonë se udhëheqja revizioniste e kësaj partie i di reagimet e shokëve të bazës dhe u bën blisht takimeve me ta. Ajo kërkon të fitojë

kohë. Komitetet e provincave si në Marinel, Konstandin, dërgojnë anëtarë të partisë, edhe nga ata që kanë qenë në Shqipëri, në ato organizata që kundërshtojnë këtë vijë revizioniste të grupit tradhtar të kësaj partie për t'i bindur këta se gjoja kjo është një taktikë e partisë. Të lëkundurve u thonë se me këtë vijë shokët shqiptarë janë dakord, ose arrijnë deri atje sa t'u thonë shpifje të tilla se në Shqipëri ka një korrent të fortë fillosovjetik, ose që shqiptarët nuk marrin vesh nga politika.

Të tilla argumentime, natyrisht, bëhen nga armiq të e komunizmit, nga armiq të e Partisë sonë. Por armiku vetëm për njëfarë kohe maskohet, sepse vjen një ditë që i bie maska dhe, në qoftë se devijimi i Partisë Komuniste të Italisë (marksiste-leniniste) vërtetohet, dhe besoj se po vërtetohet, do t'i bjerë maska.

Propagandistët e këtij grupi thonë se në Bashkimin Sovjetik nuk kanë ndryshuar aspak marrëdhëniet socialiste në prodhim, se Bashkimi Sovjetik është kështjellë e socializmit në botë, ashtu si ishte edhe në kohët e para.

Me fjalë të tjera, në këtë parti ka një devijim të madh. Sikurse kanë thënë disa anëtarë të partisë në Milano, udhëheqja e kësaj partie ka pasur një takim sekret me «autoritete» të partisë revizioniste sovjetike dhe ky takim pritej me padurim prej saj, që prej dy vjetësh. Më duket se në këtë takim ka qenë ai që drejton gazetën «Otobre», anëtar i Komitetit Qendror, dhe një anëtar tjetër i këtij komiteti. Takimi është bërë me kryeredaktorin e gazetës sovjetike «Novosti». Thuhet që në këtë takim italianët u siguruan nga sovjetikët

se Bashkimi Sovjetik na qenka socialist, se një pjesë e udhëheqjes sovjetike kohët e fundit nuk është dakord me Kongresin e 20-të të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, se dënon Hrushovin, se vlerëson Stalinin e të tjera profka të tilla.

Dhe në fakt ne shohim në numrat e parë të gazetës së tyre «Otobre», organ i «komunizmit pa kufi», se jo vetëm flitet pak ose aspak kundër Bashkimit Sovjetik, por mbrohet edhe teza se gjoja të gjitha këto vështirësi në lëvizjen komuniste ndërkombëtare, këto ndryshime në partitë ish-marksiste-leniniste, i solli vetëm Kongresi i 20-të, pra Hrushovi, kurse Brezhnjevi për ta është burrë i mirë. Këtë, natyrisht, nuk e thonë në gazetë, por propagandistët e kësaj kthese revizioniste të partisë italiane e thonë me gojë.

Thuhet, gjithashtu, se sovjetikët i kanë premtuar udhëheqjes së kësaj partie që, për ta mbajtur gazetën «Otobre», do t'i japin rreth 500 milionë lireta në vit dhe nuk është çudi që ta bëjnë këtë gjë. Disa gazeta italiane e shprehin haptazi habinë se nga financohet botimi i një gazete të tillë kaq të madhe. Shumë letra vijnë për këtë çështje edhe në ambasadën tonë në Romë, por edhe vetë atyre u shkruajnë letra, ku ua bëjnë një pyetje të tillë.

Kështu që drejtuesit e gazetës «Otobre» janë të detyruar t'u përgjigjen këtyre pyetjeve dhe përpiqen të gjejnë ekspedientë, duke thënë se 200 milionë lireta i paskan mbledhur nga punëtorët. Ata ankohen duke thënë se «ne jemi në vështirësi të mëdha, mezi e nxjerrim këtë gazetë, përpiqemi e kërkojmë nga militantët të paguajnë diçka» etj., etj. Të tëra këto janë profka,

pse qeveria italiane, policia italiane, e dinë fare mirë sa të holla duhen për të nxjerrë një gazetë të tillë të përditshme, me aq shumë faqe. Kështu gjithë këto para nuk dalin dot as nga militantët dhe as nga kursimet apo kuotizacionet e anëtarëve të kësaj partie të vogël.

Pra, siç duket në sipërfaqe, gazeta «Oktobre» po merr në mbrojtje sovjetikët dhe ndihmon shoqatën e miqësisë Itali—Bashkimi Sovjetik për ta mbështetur udhëheqjen revizioniste të këtij vendi si një udhëheqje të revolucionit botëror, të luftërave nacionalçlirimtare e të pavarësisë së vendeve në botë. Shokët e bazës së Partisë Komuniste të Italisë (marksiste-leniniste) kërkojnë të ndihmohen nga Partia e Punës e Shqipërisë dhe na thonë që Partia jonë të mos e humbasë besimin te baza e partisë së tyre, e cila është kundër udhëheqjes. Ata kërkojnë që ne t'i ndihmojmë indirekt me materiale propagandistike të Partisë sonë e me «Vepra të shokut Enver», të cilat, — thonë ata, — «do të na shërbejnë për të luftuar mirë e si duhet kundër pikëpamjeve revizioniste të udhëheqjes sonë». «Ne, — thonë ata, — kemi nisur të propagandojmë pikëpamjet e Partisë së Punës të Shqipërisë, në radhë të parë, për të demaskuar mënyrat tendencioze e shpifjet e udhëheqjes kundër Shqipërisë dhe po shpërndajmë materialin e vërtetë të Partisë së Punës të Shqipërisë».

Natyrisht lufta jonë kundër armiqve vazhdon. Marksizëm-leninizmi ka armiq të hapët, po ka edhe armiq të fshehtë. Kjo ka ndodhur në çdo kohë, por idetë e Marksit, të Engelsit, të Leninit dhe të Stalinit kanë triumfuar e do të triumfojnë vazhdimisht, duke ndri-

çuar mendjet e zemrat e njerëzve, duke u shtuar atyre besimin dhe kurajën në luftë për të arritur rezultatet shumë të dëshiruara nga proletariati dhe nga popujt e botës.

Prandaj edhe në gjithë këtë lëvizje të re marksiste-leniniste, që filloi të ngrihet si një kundërshtim i rrymës moderne të revizionizmit aktual, është e natyrshme që do të ketë edhe fitore, edhe humbje, por fitoret do të jenë më të mëdha. Humbjet vërtet e dëmtojnë çështjen, por ato bëhen mësim për të ardhmen dhe njerëzit, të cilët për një kohë janë gënjyer, do të zgjohen edhe më mirë e do të përveshin hërët për ta vazhduar më me vrull e besim luftën për triumfin e socializmit dhe të komunizmit.

Gjatë rrugës së lavdishme për triumfin e plotë të marksizëm-leninizmit kanë dalë edhe armiq, deviatorë të doktrinës sonë. Kështu, duke e filluar që nga titistët, revizionistët sovjetikë, dje Gropa, Kina, eurokomunistët, pastaj dolën Zhyrkeja i Francës, Vilari i Portugalisë e të tjerë, afëherë pse të mos dalë sot edhe nga Partia Komuniste e Italisë?

Tani u bë e qartë, dhe kjo na binte në sy për shumë arsye, që i kam shënuar edhe në shkrime të tjera, përse shokët e kësaj partie kishin një vit ose dy vjet me radhë që dërgonin emisarë të tyre në vende të ndryshme të Evropës, të cilët gjoja merrnin kontakt me të ashtuquajturat parti marksiste-leniniste. Nën maskën e këtyre takimeve ata merrnin kontakt edhe me partitë maoiste, me të cilat aktualisht hiqen sikur gjoja nuk janë dakord për çështjen e Kinës, por pavarësisht nga kjo, punojnë në të njëjtin drejtim, në drejtim të

kundërt nga marksizëm-leninizmi, punojnë ose për socialimperializmin sovjetik, ose për socialimperializmin kinez, ose për policinë e vendit të tyre. Në rast se kjo parti e ka tradhtuar marksizëm-leninizmin, ka mundësi që ajo të jetë e subvencionuar nga sovjetikët, ashtu siç mund të jetë e subvencionuar nga policia italiane, e cila ka interesa të mëdhenj ta godasë me çdo mjet partinë revizioniste të Berlinguerit. Çdo mënyrë e përdorur në këto drejtime, për të fitim është se «brigadat e kuqe» dhe të gjitha grupimet e tjera të banditëve terroristë këtë punë po bëjnë, për të restauruar një diktaturë fashiste. Në mes tyre ata përdorin dhe udhëheqësit e kësaj partie, që hiqen si komunistë, dhe që me gazetën «Otobre» vihen në shërbim të tyre. Në këtë organ bëhet i njohur programi i partisë që është: lufta kundër partisë revizioniste italiane, natyrisht, kundër eurokomunizmit, kundër imperializmit amerikan, gjë që s'i prish punë qeverisë italiane; të mos flasë për Bashkimin Sovjetik, dhe kjo i vjen pas midesë qeverisë italiane, sepse kjo nuk e do luftën me Bashkimin Sovjetik, e, nga ana tjetër, dëshiron të bëjë tregti me të, të shesë disa mallra, se me Kinën sigurisht që do, por do të jetë e zorshme të konkurrojë me kapitalin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të Japonisë, të Gjermanisë Perëndimore, të Francës dhe të Anglisë që kanë vërshuar atje si mizat. Përpara tyre kapitali italian në tregun kinez do të jetë vrima e fundit e kavallit.

Prandaj policia italiane kërkon si e si të likuidojë kundërshtarët e saj brenda dhe përdor çdo mjet për këtë qëllim. Kështu, pavarësisht se gazeta «Otobre»

hiqet se është edhe kundër demokristianëve dhe i shan këta, punën ua bën. Qëllimi i këtyre është që të shpartallohet «komunizmi» e me këtë kanë parasysh partinë revizioniste të Berlinguerit, të cilën nuk duan ta futin në qeveri, nuk duan ta ndajnë pushtetin me të por ta mbajnë vetë ata, demokristianët.

Prandaj nuk ekskludohet mundësia që kjo parti të jetë një agjunkturë e karabinierisë dhe e policisë italiane, natyrisht, duke ruajtur maskat, që thamë më sipër, duke u treguar turfanda shumë anëtarë të saj dhe bile, me një mendjemadhësi të theksuar, duke pretenduar se do t'i kthejnë nga rruga dhe do t'i bashkojnë të gjitha partitë maoiste me partitë e tjera që qëndrojnë në pozita të forta marksiste-leniniste. Me fjalë të tjera do të përpiqen t'i heqin nga rruga e vërtetë partitë marksiste-leniniste. I tillë është pretendimi megaloman i këtyre elementëve, ndaj të cilëve ne kishim dyshime, jopolitike, por shihnim të manifestohej tek ata një mendjelehtësi, vinim re një sjellje prej lypësi, një qëndrim prej lakeu, që ne nuk e honëpsim kurrë.

Zhvillimin e tyre të mëtejshëm do ta ndjekim me vëmendje. Do t'u dalë shpejt boja, do t'u çirret maska dhe do të shohim deri në ç'shikallë do të vërtetohen ato që thuhet, sa vend ka zënë veprimtaria devianiste e kësaj partie, e nga kush varet, dhe baza e shëndoshë, në qoftë se ekziston, do të revoltohet kundër kësaj tradhtie të udhëheqjes së saj revizioniste e do të ngjassë ajo që ngjet: do të krijohen të tjera grupe marksiste-leniniste në Itali.

Natyrisht edhe kjo i intereson reaksionit, pra të shpartallojë unitetin në partinë marksiste-leniniste dhe

të lejojë grupime të vogla, pavarësisht se këto grupime mund të kenë ide të shëndosha sepse hëpërhë reaksionin e një vendi, ose reaksionin botëror ato nuk e dëmtojnë. Por ai nuk e kupton teorinë tonë marksiste-leniniste, nuk e kupton që krijimi i këtyre grupeve dhe krijimi i shumë partive me tendenca të ndryshme, të cilat kundërshtojnë me një mënyrë ose me një mënyrë tjetër, false ose me të drejtë, regjimin në fuqi, krijojnë atë turbullirë, atë moment objektiv që e shtyn revoltën e popullit përpara, krijon pengesa të panumërta për mbajtjen e pushtetit nga borgjezia në fuqi, shtyn përpara revolucionin.

*Marrë nga libri:*

*Enver Hoxha, «Ditar për çështje ndërkombëtare» (botim i brendshëm), nr. 12, f. 101*



## NJË VIZITË KARNAVALESKE. AKROBACITË E TEN HSIAO PINIT

Shënime

5 shkurt 1979

Vizita e Ten Hsiao Pinit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, që u kthye në një karnaval të vërtetë, patjetër ka sjellë rezultate të favorshme për Shtetet e Bashkuara të Amerikës, por të disfavorshme për Kinën. Me këtë dua të them që Kina vërtet do të marrë disa kredi, ndihma, teknologji dhe armatime të reja nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, por ajo do të futet edhe më tepër nën skllavërimin kapitalist, e veçanërisht nën influencën e imperialistëve amerikanë, të cilët nuk do të durojnë vickat e njëfarë «kauboji» të ri, që quhet Ten Hsiao Pin.

Amerikanëve u pëlqejnë shumë akrobacitë e kaubojve, të cilët i bëjnë schir në arenë. Atyre u pëlqejnë veçanërisht akrobacitë e të tjerëve në politikë. Mirëpo akrobatët bëjnë shumë lloj akrobacish dhe imperialistët amerikanë, që kanë mjaft eksperiencë në këtë drejtim, duartrokin ato akrobaci që janë në favorin e tyre dhe nuk duartrokin ato që nuk u pëlqejnë.

Kështu imperializmit amerikan në dukje i pëlqeu

karnavali tenhsiaopinesk gjatë qëndrimit të tij në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe e pagoi këtë kloun, i cili fitoi prej tyre disa pikë politike dhe ekonomike. Por unë mendoj se monopolistët amerikanë dyshojnë akoma për të ardhmen e kapitaleve që po investojnë në Kinë. Me fjalë të tjera, ata dyshojnë nëse Ten Hsiao Pini me njerëzit e tij do të jetë apo s'do të jetë në gjendje të vërë në zap gjithë atë Kinë të madhe, me grupime të ndryshme të fuqishme prej qindra milionë vetash, që do të ballafaqohen vazhdimisht në arenën kineze.

Pikërisht një ballafaqim i tillë s'u pëlqen amerikanëve, japonezëve dhe vendeve të tjera kapitaliste, të cilët gëzohen për këtë kthesë të Kinës, por në të njëjtën kohë i bën që të jenë edhe vigjilentë dhe të kenë dyshime nëse kjo kthesë do të jetë e fortë, do të jetë e qëndrueshme apo do të bëhen kthesa të tjera. Në qoftë se do të vazhdojnë këto kthesa, atëherë dollarët amerikanë, jenët japonezë dhe markat gjermane etj. nuk do të vërshojnë më aq kollaj në një Kinë të turbullt dhe pa një pushtet të stabilizuar.

Në përgjithësi unë mendoj se pushteti në Kinë nuk mund të stabilizohet, por edhe në qoftë se kjo ndodh, ai do të jetë i çalë dhe bile edhe për këtë do të duhet një kohë e gjatë. Duhet kohë e gjatë për vendosjen e diktaturës fashiste, do të mbushen burgjet e kampet me kundërshtarë, kundërshtimi do të sjellë kundërshtimin e revoltën dhe kështu do të arrihet në përmbyshjen e një klani nga një klan tjetër.

Ten Hsiao Pini në Shtetet e Bashkuara të Amerikës u përpoq të jepte përshtypjen e një diktatori të fuqi-

shëm kinez që bën ç'të dojë, që, në fakt, ka fuqinë, pavarësisht se mbi të ekziston një person tjetër, i quajtur Hua Kuo Fen. Sipas agjencive të lajmeve, në sy të udhëheqjes e të popullit kinez Teni e detyroi Hua Kuo Fenin të përulet përpara tij, të pohojë në Komitetin Qendror në formë autokritike se paska bashkëpunuar me «katërshen» dhe nuk ka qenë në gjendje të kuptojë gabimet e Mao Ce Dunit. Domethënë Ten Hsiao Pini deri tashti jo vetëm e ka ulur prestigjin e Hua Kuo Fenit, por ka diskredituar edhe Mao Ce Dunin, dhe ky është qëllimi kryesor i tij. Ai dëshiron të hiqet përpara kapitalizmit botëror se është me të vërtetë një element i fuqishëm kapitalist në Kinë. Bile mund të themi se nga pikëpamja e mënyrës së jetesës ai nuk është një kapitalist konservator, por një marionetë mjaft e manipulueshme në dukje, ndërsa në të folur nuk qëndron pas nga një arrogant i pasjellshëm, nga një element brutal. Në këtë mënyrë ai donte t'u thoshte Shteteve të Bashkuara të Amerikës se «Jam i predispozuar të bashkëpunoj me ju e njëkohësisht të shtyp në Kinë çfarëdo rezistence kundër meje e kundër kapitalit, kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe kundër vendeve të tjera kapitaliste; se unë jam në gjendje t'i likuidoje ose t'ua mbyll gojën kundër-shtarëve të mi, jam i zoti, në qoftë se ju vazhdoni të më jepni ndihma, të përballoj edhe «ariun polar»».

«Ariu polar», domethënë Bashkimi Sovjetik, ka qenë lajtmotivi i të gjitha fjalimeve të Ten Hsiao Pinit. Vetëm në banketin me Karterin ai e evitoi emrin e Bashkimit Sovjetik, por nuk harroi ta zinte në gojë çështjen e hegjemonizmit. Të gjithë e kuptojnë se, kur

bërtasin kinezët kundër hegjemonizmit, prapa kësaj fjale fshihet Bashkimi Sovjetik dhe ata bëjnë thirrje njëjloj si ai kusari që bërtet: kapeni kusarin! Pra, hegjemonisti flet kundër hegjemonizmit, kur që të dyja palët janë hegjemoniste.

Nga ç'kam lexuar në njoftimet që japin agjencitë e lajmeve e nga gazetatat amerikane, kam përshtypjen se një gjë e tillë edhe u pëlqeu imperialistëve amerikanë, por edhe nuk u pëlqeu, sidomos ekzagjerimi i Ten Hsiao Pinit në këtë drejtim. Kudo që shkonte, në çdo fjalim, në çdo banket, ai nuk mungonte të fliste kundër hegjemonizmit, bile duke e cilësuar edhe me emër Bashkimin Sovjetik e duke përdorur terma të atillë që i vinte në pozita të vështira mikpritësit e tij, sepse ata vërtet armiq të Bashkimit Sovjetik janë, duan t'ia ngushtojnë atij sferat e influencës, në mos mundshin dot ta shkatërrojnë fare, por këtë e bëjnë me takt në diplomaci, në ekonomi, në marrëveshjet e ndryshme ushtarake etj., etj., kurse Teni kishte zhveshur pallën dhe shpata e tij revizioniste kineze vringëllinte në crë dhe ua verbonte ca sytë imperialistëve amerikanë. Këta e kanë të qartë që Kina aktuale flet më shumë se ç'mund të jetë në gjendje të bëjë, se ajo provokon Bashkimin Sovjetik në një shkallë të tillë dhe kërkon t'i komprometojë sa më shumë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, sa që të pëlçasë një luftë e tretë botërore bërthamore.

Imperialistët amerikanë e dinë, gjithashtu, se ç'forcë ushtarake dhe ekonomike ka Bashkimi Sovjetik dhe ç'forcë ekonomike e ushtarake ka aktualisht Kina. E dinë se kjo e fundit është shumë larg potencialit ekonomiko-ushtarak të Bashkimit Sovjetik dhe nuk është

në gjendje të përballojë një sulm të provokuar ose jo nga ana e Bashkimit Sovjetik, prandaj ata i konsiderojnë disi sharlatanizëm thirrjet e Tenit për luftë. Unë mendoj se ata, bile, i konsiderojnë jo vetëm sharlatanizëm, por edhe mungesë serioziteti për një burrë shteti, i cili, sado armik që ta ketë një shtet tjetër, natyrisht ato që ka, duhet t'ia thotë në fytyrë; por të mburrct me zjarrin e luftës, kur nuk ka mundësi ta bëjë një gjë të tillë, kjo tregon mendjehetësi dhe amerikanët në këtë rast, sigurisht, nxjerrin deduksione.

Shprehje e këtyre deduksioneve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës duhet të jetë fakti që ata në mënyrë të dukshme nuk angazhohen, qoftë edhe indirekt, me rodmontadat<sup>1</sup> luftarake të Ten Hsiao Pinit, të cilin e lënë të flasë, e lënë të veprojë, kurse vetë ato bëjnë punën e tyre, domethënë mbajnë ato qëndrime që kanë caktuar të mbajnë ndaj Bashkimit Sovjetik.

Marrëveshjet që kanë nënshkruar Shtetet e Bashkuara të Amerikës me Kinën janë të gjitha të qena dhe të natyrshme. Këto i bën edhe Bashkimi Sovjetik, edhe Japonia, i bën edhe Anglia. Në qoftë se kanë nënshkruar marrëveshje të tjera që nuk thuhet, ky është një tjetër problem, por për të bërë një gjë të tillë amerikanët duhet të jenë të sigurt me partnerin e tyre, sepse, në mos sot, nesër, asgjë nuk mbetet e fshehtë dhe sidomos e fshehta kineze, në situatat që ndodhet Kina, është *secret de Polichinelle*<sup>2</sup>, siç thonë francezët. Teni

1. Nga frëngjishtja — fanfaronada, mburrja.

2. Një e fshehtë që e dinë të gjithë.

ka kërkuar të ketë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës një traktat miqësie dhe mbrojtjeje, siç thonë, dhe po bën sikur e ka këtë, bën sikur kjo është një çështje e mbaruar, kurse Shtetet e Bashkuara të Amerikës tërhiqen, nuk shprehen.

Nga ato që shkruan shtypi amerikan, i cili përfaqëson, natyrisht, sferat e larta të oligarkisë financiare, të qeverisë amerikane, kuptohet se në përgjithësi Shteteve të Bashkuara të Amerikës u pëlqeu kjo kthesë e Kinës dhe e favorizojnë grupin e Tenit dhe propagandën e tij. Shtetet e Bashkuara të Amerikës e favorizojnë programin e Tenit dhe, si rrjedhim, mund të themi se kanë pasur shumë besim te programi i Çu En Lait dhe i Maos, sepse e kanë provuar që këta të dy nuk ishin marksistë, por elementë të borgjezisë, që bënë një politikë shumë pragmatiste dhe fare lehtë mund të ktheheshin edhe nga e djathta, edhe nga e majta, mund të ndërronin këmbishë e flamur. Këto janë të provuara. Mao Ce Duni që nuk mungonte ta hiqte veten pro Bashkimit Sovjetik, pas vdekjes së Stalinit u bë pro-hrushovian, më vonë doli edhe kundër Hrushovit. Ai dhe Çu En Lai mbajtën qëndrim kundër Bashkimit Sovjetik dhe kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës, bile këto të fundit, për njëfarë kohe i konsideronin si armikun kryesor. Më pas e kthyen fytyrën nga këto dhe janë arkitektët e parë të kësaj aleance. Prandaj Shtetet e Bashkuara të Amerikës pse të mos kenë besim te Teni? Mundet që edhe ky të jetë një pragmatist, dhe është i tillë si edhe Çu En Lai, por më i vendosur në kundërshtimin ndaj Bashkimit Sovjetik.

Është e njohur tashmë se kur u rrëzua Hrushovi

dhe erdhi Brezhnjevi në fuqi, Çu En Lai na bëri thirrje të përgatitnim valixhet dhe të shkonim në Moskë për të përshëndetur ekipin e ri, ekip që, siç shpresonin kinezët, do të vinte në rrugën e marksizëm-leninizmit. Dihet që ne ia hodhëm poshtë këtë propozim dhe, në fakt, me vajtjen në Moskë, Çuja pësoi një disfatë të madhe politike. Kështu që nga ajo datë Maoja dhe Çu En Lai, duke parë se nuk ia arritën dot qëllimit për t'u bërë aleatë të revizionistëve sovjetikë, domethënë të ndiqnin një rrugë të përbashkët, u kthyen për një kohë, sa për sy e faqe, kundër të dyja superfuqive, për të përfunduar proamerikanë.

Prandaj Shtetet e Bashkuara të Amerikës, duke e favorizuar Tenin, përpiqen të krijojnë e të forcojnë një Kinë që të avancojë sa më shumë në aleancë me to dhe me fuqitë kapitaliste të Perëndimit, pse kjo shtytje është ilaçi më i mirë kundër një perspektive mundësisht të vërtetë, por të tmerrshme për to, të një afrimi kino-sovjetik. Si rezultat i pragmatizmit antimarksist të udhëheqjes kineze, sensibilitetit të tyre të madh, shovinizmit racist e ksenofobisë, që karakterizojnë revizionistët kinezë, si dhe i kontradiktave të thella që do të shkaktohen mjaft herë në momente të ndryshme gjatë marrëdhënieve kapitaliste, mundet që këta njerëz impulsivë, siç është Teni, të ndërrojnë këmishë dhe të kthehen me Bashkimin Sovjetik kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Atëherë për to dhe për Perëndimin situata do të bëhet shumë e rrezikshme.

Këtë eventualitet, mendoj unë, imperialistët amerikanë dhe perëndimorët e kanë parasysh dhe pikërisht për këtë qëllim ata e favorizojnë Tenin, që të mos

ngjasë një gjë e tillë. Megjithatë, qoftë amerikanët, qoftë japonezët dhe kapitalizmi botëror, sytë i mbajnë hapur e nuk i mbështetin forcat, shpresat dhe ëndrrat e tyre te një person, le të jetë ai edhe Teni, as edhe te një grup si i Tenit e sidomos në një det grupesh të tjera që po hahen në mes tyre si qentë në sallhane. Këta imperialistë po punojnë me perspektivë që të hedhin thellë bazat në këtë vend, baza ekonomike, ushtarake dhe politike, që të krijojnë një mbështetje të fuqishme me pasardhësit e Tenit, me ata që do të mbrojnë, mundet jo Tenin, por Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kapitalin amerikan, kapitalin perëndimor, me fjalë të tjera, që do të shtypin çdo lëvizje revolucionare. Për këtë gjë interesohen më shumë imperialistët amerikanë dhe të tjerë, pra, kush do të vijë prapa Tenit. Mundet që Teni të mos rrojë shumë, por, edhe në qoftë se do të rrojë sa Titoja, prapë atje jemi. Titoja s'ka lëvizur nga fuqia qëkurse u çlirua Jugosllavia; ai hëngri, piu, u bë mbret, u fut në borxhe, shiti Jugosllavinë, krijoi kuadro batakuçinj, po më në fund çfarë po lë pas? Një Jugosllavi të shkatërruar, një Jugosllavi të robëruar, një Jugosllavi që nuk di ku ka kokën dhe se ç'do të bëhet pas vdekjes së këtij sharlatani antimarksist.

Pra, megjithëse Perëndimi dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë të kënaqura që Jugosllavia dhe shumë vende të tjera të ish-demokracisë popullore u shndërruan në shtete kapitaliste, dhe kjo ishte një goditje që i jepej revolucionit, prapëseprapë nuk janë plotësisht të bindur, për arsye se frikën ia kanë çdo ditë e më shumë revolucionit, ia kanë edhe luftës bër-



thamore antiamerikane nga superfuqia tjetër, Bashkimi Sovjetik.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës e kanë atë eksperiencë që të kuptojnë situatën e brendshme në Kinë, dhe t'i turbullojnë akoma më shumë ujërat, të kuptojnë akrobacitë politike të Kinës, fjalën dhe veprën e saj siç janë deklaratat në hava të Çu En Lait për të ardhmen e Kinës pas vitit 2000, si edhe llafet e Tenit për «revolucionin e katër modernizimeve», që nuk dihet se kur do të arrihen. Për Shtetet e Bashkuara të Amerikës ka interes që në Kinë të vazhdojë një situatë e tillë, pse, po të ndodhë ndryshe, bëhet e rrezikshme për qenien e tyre dhe të Japonisë si shtete me një rend imperialist-kapitalist, sepse një luftë botërore ndër imperialiste s'dihet si do të zhvillohet dhe kush do të fitojë. Në themi se vërtet do të derdhet gjak, por proletariati dhe popujt do të dinë ta kthejnë këtë luftë, që mund të shpallin imperialistët, në një luftë civile, dhe do të jetë socializmi ai që do të fitojë.

Por imperialistët amerikanë, duke pasur këtë frikë, nuk janë ashtu fare të pakujdesshëm përballë sharlatanizmave të Ten Hsiao Pinit. Kjo u duk edhe gjatë kontakteve që presidenti e krerë të tjerë amerikanë patën me Ten Hsiao Pinin, kur ata bënë përpjekje të evitonin format, mënyrat, thëniet e të gjitha manovrat që bëri ai për të implikuar në lojën e tij Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kjo gjë mund të konsiderohet nga ana e amerikanëve si njëfarë frenimi që i bëjnë Kinës, sepse Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk mund të veprojnë dot aq lirisht, gjithashtu pa u konsultuar edhe me partnerët e tyre.

Në përgjithësi duket sikur Shtetet e Bashkuara të Amerikës veprojnë pas kokës së tyre, për arsye të forcës ekonomike e ushtarake që kanë, por çështja e NATO-s, çështja e alcancës me shtetet perëndimore dhe me vendet e tjera kapitaliste të së ashtuquajturës botë e dytë e botë e tretë i bëjnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës që të jenë prudente dhe kujdesen të mos bien në kontradikta me to. Edhe këtyre, shteteve të tjera, u pëlqen nxitja dhe mbështetja e Tenit, për arsyet që thashë më lart, por deri në njëfarë shkalle. Përkërisht kur Teni thotë ta shkatërrojmë «ariun polar», të tjerët thonë ta frenojmë atë, të rrojmë në bashkekzistencë hrushoviane me rusin, të kemi marrëdhënie tregtare dhe të kemi përfitime të mëdha për ta krimbur akoma më shumë nga brenda, atë dhe aleatët e tij, me fjalë të tjera, jo të shkojmë në luftë, por ta dobësojmë pa luftë armikun tonë kryesor, që është socialimperializmi sovjetik.

Prandaj Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë të gëzuara për vajtjen e Tenit, qeshën me klounëritë e tij, kanë nënshkruar kontrata të majme për shfrytëzimin e pasurive të Kinës, por janë treguar edhe prudente ndaj fjalëve kërcënuese të Tenit dhe thirrjeve që bënte ai për t'u bashkuar në luftë kundër socialimperializmit sovjetik, armikut të vetëm të të gjithë popujve të botës.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në fakt, duan dhe përpiqen që lidhjet me Kinën t'i kenë të mira, por të mira deri në atë shkallë që të mos dobësohen lidhjet që kanë me Bashkimin Sovjetik. Bile ato si kundërbalancë do të përpiqen t'i forcojnë lidhjet me Bashkimin Sovjetik. Imperializmi amerikan i lë të kuptojë Tenit:

«Ti ce përpara, por, për sa i përket luftës që mund të shkaktosh me Bashkimin Sovjetik, duhet ta dish, dhe historia e ka treguar, se unë nuk pleksem aq kollaj në një luftë të tretë botërore, se do të ndërlikohem pikërisht në ato momente kur ju t'ju shoh të dobësuar dhe kur unë të kem përfituar jashtëzakonisht shumë nga gjaku që do të derdhin popujt tuaj, dhe në orën e fundit do të vij si shpëtimtar të vendos hegjemoninë time në botë».

Nga ana tjetër, me Bashkimin Sovjetik Shtetet e Bashkuara të Amerikës, natyrisht, do të kenë kontradikta, të cilat mund edhe të thellohen, por ato do të përpiqen ta ruajnë këtë statukuo që ekziston, bile edhe ta përmirësojnë. Natyrisht, një gjë e tillë i intereson edhe Bashkimit Sovjetik, i cili dëshiron të ketë armik vetëm nga njëra anë dhe jo nga të dyja anët.

Rivaliteti midis vendeve imperialiste, në fushën ushtarake, dhe aleancat ndër imperialiste, po i shqetësojnë pa masë popujt e botës, revolucionarët, ata që nuk e duan shtypjen, ata që nuk e duan luftën grabitqare imperialiste, ato shtete dhe ata popuj që duan të rrojnë të lirë, të pavarur e sovranë.

Të gjithë këta shohin në aleancën kino-amerikane e kino-japoneze dhe në boshtin Kinë-Japoni-Shtetet e Bashkuara të Amerikës një rrezik të madh për të ardhmen, për arsye të fërkimeve të mëdha që do të krijohen në mes këtyre shteteve dhe Bashkimit Sovjetik, gjë që mund të degjenerojë në një luftë botërore. Por edhe shtetet e tjera të mëdha të industrializuara, megjithëse një marrëveshje e tillë deri në njëfarë shkalle u pëlqen, përsëri janë të shqetësuara. Njëpërmjet

leximit të shtypit të tyre mund të dallosh hijen e shqetësimit të udhëheqjeve kapitaliste të botës së Ëndustrializuar për këtë aleancë, për këtë bosht fashist që po krijohet dhe që, në një mënyrë ose në një tjetër, do të ketë konsekuenca të rënda edhe për ato.

Këto shtete, pavarësisht se janë të lidhura me NATO-n e nëpërmjet NATO-s me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, pavarësisht se Evropa e Bashkuar dhe Tregu i Përbashkët, natyrisht, kanë lidhje të ngushta ekonomiko-politike-ushtarake me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, prapëseprapë i tremben një përleshjeje me Bashkimin Sovjetik, gjë që do të sjellë, sigurisht, një shkatërrim të potencialit të tyre ekonomik dhe ushtarak, do të digjen vendet dhe pasuritë e tyre e do të ndryshojë patjetër edhe karakteri i luftës, e cila do të shndërrohet në luftë popullore kundër shtypësve e shfrytëzuesve dhe kështu do të fitojë revolucionin. Prandaj ato nuk duan që përleshja të ndodhë në Evropë dhe t'i nxjerrin gështenjat nga zjarri për Shtetet e Bashkuara të Amerikës ose për Bashkimin Sovjetik. Atyre u pëlqen që Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Kina të mos shkojnë më tej se ato vetë ndaj Bashkimit Sovjetik, por të krijojnë një statukuo kapitalisto-imperialiste pa një konflagracion të madh bërthamor. Domethënë ato duan që mbi popujt të vendoset një shfrytëzim e shtypje e atillë që këta të mos kenë mundësi të ngrenë krye kundër hegjemonizmit të tyre. Le të bërtasin popujt nëpër rrugë, kaq gjë s'u prish punë kapitalistëve të mëdhenj, vetëm fuqinë ta kenë kurdoherë këta në duart e tyre.

Këto kontradikta ekzistojnë e, natyrisht, jo vetëm

do të shfaqen, por edhe do të zgjerohen. Në shtypin kapitalist të Evropës Perëndimore duket vazhdimisht një shqetësim i tillë, që shprehet në mënyrën se si paraqiten rezultatet e arritura në marrëdhëniet në mes Kinës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Bëhen vlerësime të ndryshme dhe jo kurdoherë me eufori, por, përkundrazi, me një dyshim të rezervuar, se nuk preken vetëm interesat e mëdhenj jetikë të përjetësimit të fuqisë së tyre, por vihen, gjithashtu, në rrezik edhe marrëdhëniet tregtare të këtyre shteteve me Kinën, në rast se kjo bëhet pré e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe e Japonisë, gjë që do të dëmtojë përpjekjet për zhvillimin e kapitalizmit perëndimor në Kinë. Kështu, nga djersa dhe nga gjaku i popullit kinez nuk do të dalin ato përfitime që ata ëndërrojnë për vete, sepse pjesën e luanit do ta marrin Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Japonia.

Shohim, gjithashtu, që Gjermania Perëndimore ka deklaruar se nuk do t'i shesë armë Kinës. Këto janë deklarata, por realiteti mund të jetë ndryshe, kjo mund të jetë edhe një taktikë. Franca, më ndryshe nga Gjermania, nuk e fshih faktin që ajo i shet edhe avionë, edhe teknologji të përparuar luftarake dhe ekonomike Kinës, e cila, nga ana tjetër, e ndihmon Francën të ruajë interesat e vet ekonomike neokolonialistë në Afrikë kundër ekspansionit amerikan dhe sovjetik. Kurse Anglia i shet Kinës avionë «Herrier» me ngritje vertikale e nuk mungon të thotë se këta nuk janë avionë sulmues, por mbrojtës, dhe të tjera gjëra të tilla që thuhet për të hedhur hi syve, por që Bashkimi Sovjetik, natyrisht nuk i ha. Të gjitha këto tregojnë atë shqetësim

që kanë fuqitë imperialiste të Evropës Perëndimore nga një konflagracion dhe nga shpërthimi i një lufte të provokuar nga Kina ndaj Bashkimit Sovjetik.

Bashkimi Sovjetik e mund Kinën. Sa kohë do t'i duhet për këtë, ne nuk mund ta përcaktojmë, por edhe Kinën, edhe Japoninë ai i thyen në një luftë frontale, në një luftë moderne, në një luftë atomike, pavarësisht se populli kinez dhe populli japonez mund të vazhdojnë luftën guerile, gjoja siç po e vazhdon kriminelin Pol Pot në Kamboxhia.

Megjithatë Bashkimi Sovjetik merr masa dhe revizionistët sovjetikë janë dinakë, po janë edhe kërcënues, janë edhe luftënxitës, ata mund të shkojnë edhe në luftë. U kanë bërë nga një letër të gjithëve, duke filluar që nga italianët e deri tek anglezët, me të cilën i paralajmërojnë që të mos i shesin armë Kinës, se është një rrezik për shpërthimin e luftës botërore. Ashtu siç propagandon Kina ditë e natë se Bashkimi Sovjetik po kërcënon botën me luftë dhe veçanërisht Evropën, ashtu edhe Bashkimi Sovjetik merr nga ana e vet masa dhe flet se Kina po përgatit luftën dhe u bën paralajmërim atyre që e furnizojnë me armë. Por duhet thënë se luftën e përgatitin të gjitha këto klika që sundojnë qoftë në Bashkimin Sovjetik, në Kinë, në Japoni, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës e në shtetet borgjeze kapitaliste të fuqishme të Perëndimit. Vetëm popujt nuk e duan luftën dhe luftojnë që kjo të pengohet e të shkatërrohen planet e luftënxitësve. Prandaj në vlerësimet që duhet të bëjnë popujt dhe njerëzit përparimtarë, këto çështje t'i shikojnë në thellësinë e tyre e jo në paraqitjen koniunkturale dhe, në qoftë se

duan të mirën e vendit të tyre, në qoftë se duan përparimin, këto mbrohen duke luftuar klikat në fuqi, ata që nxitin luftën, kudo që janë, brenda dhe jashtë vendit të tyre, në përgatitjen e brendshme dhe në aleancat e jashtme.

Aktualisht, për gjithë botën shtrohet pyetja: A është në gjendje Ten Hsiao Pini t'i arrijë të «katër modernizimet» në afatin e caktuar e në kushtet aktuale të tronditura në të cilat ndodhet Kina? (Bile Ten Hsiao Pini caktoi vitin 1935, pra 15 vjet përpara datës që kishte caktuar Çu En Lai!)

Gjendja aktuale e turbullt në Kinë nuk është shumë e favorshme për realizimin e «katër modernizimeve». Atje mbretëron kaosi, mungon disiplina, politikisht njerëzit janë në luftë me njëri-tjetrin, kështu që t'i aplikosh të «katër modernizimet» me një shpejtësi të madhe, siç thotë Ten Hsiao Pini, me gjithë ndihmat e mëdha që i vijnë, nuk është e lehtë, bile është shumë e zorshme.

Unë mendoj se Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk kanë shumë bindje për realizimin e këtij programi të Tenit, ndonëse me fjalë e quajnë të rëndësishëm. Prandaj ato do të jenë prudente për një aleancë të padëshiruar me një politikan të tillë sharlatan dhe fashist.

Duke njohur gjendjen ekonomike aktuale të Kinës, nëpërmjet të dhënave që kemi, e duke ditur se të c'natyre janë ndihmat që merr ajo, neve na duket se objektivat ekstravagantë, që kanë caktuar Çu En Lai dhe Ten Hsiao Pini me Hua Kuo Fenin janë të parralizueshme. Bujqësia në Kinë është shumë prapa, fshatari nuk ka bukë e oriz. Fshatari kinez vërtet është

punëtor, por, që Kina të mund të krijojë atë bollëk që pretendon, i duhet një kohë shumë e gjatë.

Edhe në kohën e Mao Ce Dunit bujqësia kineze ishte përtokë, populli kinez rronte me një çafkë oriz, bile edhe atë një herë në ditë e kishte, ai hante pak lulëlakër, nuk shihte mish me sy, pale gjalp e të tjera ushqime e sende të nevojshme. Ne i dimë këto, sepse vetë Çu En Lai na thoshte se ju, shqiptarët, keni një nivel të lartë jetese dhe na fliste për nivelin e vërtetë mizerabël të Kinës. Këtë nivel jetese të popullit tonë dhe ritmet e prodhimeve bujqësore nuk na i ngriti Kina, por i ngritëm vetë me forcat tona, na i ngriti Partia me vijën e saj të drejtë politike, ideologjike dhe ekonomike, me punën e saj edukuese, bindëse e sqaruese me punonjësit e me kooperativistët.

Prandaj, në kushtet që është Kina, pretendimet e Ten Hsiao Pinit se do të arrijë bollëkun në vitin 1985, janë profka.

Ne kemi parë se, kur Hrushovi filloi të mburret për bujqësinë sovjetike, të cilën Stalini e kishte lënë në një gjendje, relativisht të mirë, pra pikërisht atëherë kur sharlatani Hrushov u mburr se do të krijohej bollëku, në Bashkimin Sovjetik dështoi bujqësia, dështuan aksionet për hapjen e tokave të reja. Në Bashkimin Sovjetik nuk u zhvillua industria e plehrave kimike, nuk kishte mekanikë bujqësore të mjaftueshme për hapësirat e gjera të mbjella me drithëra e me bimë industriale. Kështu që një nga arsytet e rrëzimit të Hrushovit ka qenë politika e tij e dështuar në bujqësi. Aktualisht Bashkimi Sovjetik, megjithëse ka marrë masa e kredi të shumta për ta forcuar sektorin e bujqësisë,



prapëseprapë, prej rënies së Hrushovit më 1964 e deri tashti, pra prej 14-15 vjetësh, e blen bukën, drithin, në sasi të mëdha nga Kanadaja, nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës etj.

Premtimet Ten Hsiao Pini i bën për të nxitur kapitalistët e ndryshëm që t'i japin Kinës sa më shumë kredi. Por kapitalistët e djallëzuar nuk bien kollaj në rrjetën e Tenit, që t'i japin Kinës kredi të panumërta. Shtetet e Bashkuara të Amerikës do t'i japin asaj kredi, Japonia gjithashtu do t'i japë, por ato më parë do të sigurohen për të stabilizuar gjendjen në Kinë në favor të tyre, pastaj për të ardhurat që duhet të nxjerrin nga investimet që do të bëjnë. Edhe miqtë e kinezëve, miqtë e rinj, natyrisht, do të kenë përfitimet e tyre në këtë mes. Jugosllavët janë protomiq me amerikanët, pastaj janë miq me sovjetikët, me të gjitha vendet e tjera kapitaliste të Perëndimit e më në fund janë me kinezët. Jugosllavia nuk ka ndonjë interes të madh nga Kina për ndihma, sepse këto, natyrisht, janë të pakta për të, por kjo punon në Kinë për interesat e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Megjithatë në komentet që u bën agjencia jugosllave rezultateve të vizitës së Ten Hsiao Pinit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, fjali-meve e qëndrimeve të tij, ajo mban një qëndrim, si me thënë, si ai akrobati mbi litar: asnjërit nuk do t'ia prishë. Kjo agjenci, po ashtu vë në dukje se në këtë plan politiko-ekonomiko-ushtarak humbet disi Bashkimi Sovjetik, sepse i krijohet atij një bllok i fuqishëm në Lindje, blloku i madh japono-kino-amerikan. Domethënë TANJUGU do edhe ta zbutë Bashkimin Sovjetik ndaj Perëndimit, edhe ta këshillojë atë që të ketë

mendjen nga Lindja. Pra, duke mbajtur këtë qëndrim politik, gjoja asnjans, gjoja në mbrojtje të shteteve të pavarura, me dinakëri dhe me diplomaci dhelparake, ai e sqaron pak a shumë opinionin e vendit të tij për këto ndodhi të çuditshme, për këto transformime regresive e përgatitje luftërash që ngjasin në botë.

Ç'duhet të bëjmë ne në këto situata? Cili duhet të jetë qëndrimi ynë?

Ne duhet të demaskojmë ashpër veprimtarinë e shfrenuar të revizionistëve kinezë, duke theksuar me forcë që Kina e Ten Hsiao Pinit, që është vazhduesja e asaj të Mao Ce Dunit e të Çu En Lait, jo vetëm po shkon me revan drejt kthimit në fuqi imperialiste, drejt kapitalizmit, por ajo po nxit edhe luftën botërore, kërkon të futë botën në luftë, duke menduar që prej saj të përfitojë ajo vetë. Pra, duke e quajtur veten një shtet të madh e të fuqishëm nga potenciali njerëzor dhe territorial dhe jo nga potenciali ekonomik e ushtarak, Kina mendon se është në gjendje ta evitojë luftën që mund të drejtohet kundër saj e ta nxitë atë në mes dy superfuqive të tjera dhe vendeve kapitaliste të Evropës Perëndimore dhe të përfitojë për vete, siç përfituan Shtetet e Bashkuara të Amerikës në dy luftërat e mëparshme botërore. Kjo është një utopi kapitaliste, fashiste, hitleriane e Ten Hsiao Pinit dhe këtë ne duhet ta demaskojmë.

Duhet të demaskojmë, gjithashtu, po me aq forcë imperializmin amerikan, sepse ky, siç dihet, është një nga imperializmat më të rrezikshëm në botë, nga çdo pikëpamje, nga potenciali ekonomik e ushtarak dhe nga forca e ndikimit të mënyrës së tij të jetesës, gjë që

shtur dhe degjeneron jetën e popujve. Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë një avantazh që e kanë fituar gjatë formimit të tyre; ato mund t'i asimilojnë lehtë vendet e tjera, domethënë influenza e mënyrës së jetesës së tyre dekadente është aq e fortë, sa depërton dhe përhapet shumë shpejt në popujt e vendeve, udhëheqjet e të cilave janë miq të imperializmit amerikan.

Ne shohim se, aktualisht, në Kinë, për t'u bërë qejfin imperialistëve amerikanë, po shkelen traditat e vjetra të mënyrës kineze të jetesës, për të cilat kinezët kanë qenë dhe janë aq xhelozë, por hiqen sikur nuk janë fare të tillë, për t'u bërë qejfin miqve të tyre amerikanë, duke dashur t'u krijojnë përshtypjen se ata kanë të bëjnë me një popull që modernizohet kollaj. Hyrja e qindra mijë amerikanëve dhe e kapitalistëve të tjerë si turistë, tregtarë, gjoja shkencëtarë, profesorë e të tjerë do ta shpejtojë këtë degjenerim të jetës në Kinë. Mënyra e jetesës në Kinë ka qenë shumë konservatore, e mbyllur, anakronike, si me thënë, s'ka qenë kurrë socialiste, kurse tash po kalohet në ekstremin tjetër, po bëhet e shturur, atje do të zhvillohet banditizmi, do të përhapen drogat, hipitë, prostitucioni e çdo e keqe tjetër kapitaliste.

Duhet t'i demaskojmë e t'ua zbulojmë qëllimet e vërteta dhe taktikat që përdorin për t'i mbuluar ato, qoftë kinezët, qoftë japonezët, qoftë amerikanët në gjithë këtë situatë të vrullshme revolucionare në botë. Ata, natyrisht, përdorin taktika e mënyra të shumta, me qëllim që ta kapërcejnë këtë situatë, dhe mendojnë se mund t'ia arrijnë qëllimit jo vetëm me forcën e tyre, por edhe me dhelpëri e me dinakëri e jo me ma-

rrëzi, siç po bën Ten Hsiao Pini. Ne duhet të vërtetojmë të kundërtën, duke u treguar popujve e revolucionarëve në botë se këto qëllime të imperialistëve nuk mund të realizohen dot për arsye se «derri nuk e ndërron qimen», pra këta mbeten agresorë, mbeten shtypës, grabitqarë dhe duhet luftuar për shkatërrimin e tyre të plotë.

Gjithashtu duhet të demaskojmë po me aq forcë Bashkimin Sovjetik, sepse edhe ai është luftënxitës, grabitqar, imperialist, është dinak dhe i fuqishëm. Ai mbulohet nën petkun e leninizmit dhe bën një politikë tamponazhi në perëndim të tij për të krijuar një katalizator dhe për t'i pasur duart e lira në Azi. Mund të ngjasë edhe e kundërta nesër, një kthesë e mundshme e Kinës drejt Bashkimit Sovjetik kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Evropës Perëndimore. Por sidoqoftë, ne duhet të demaskojmë edhe gënjeshtërën, edhe demagogjinë, edhe agresivitetin e imperializmin e Bashkimit Sovjetik revizionist, sepse aktualisht, në këto koniunktura, ka njerëz që mendojnë e thonë se Bashkimi Sovjetik është në pozita të dobëta, është një imperializëm që po dobësohet, bile edhe udhëheqës të Partisë Komuniste të Italisë që e quan veten marksiste-leniniste, siç po dëgjojmë, thonë se ai është një vend që nuk e ka ndërruar sistemin socialist, është një vend që ruan parimet leniniste e të tjera profka të tilla. Janë të gjitha shenjat që udhëheqja e Partisë Komuniste të Italisë ka tradhtuar marksizëm-leninizmin. E vënë në shërbim të borgjezisë italiane ose drejtpërdrejt në shërbim të sovjetikëve ajo përpiqet ta mbrojë Bashkimin Sovjetik, këtë shtet të egër imperialist, po aq të egër sa edhe imperializmi amerikan.

Tash këta njerëz pa parime, që për një kohë janë quajtur komunistë, ndryshojnë qëndrimin sipas rrethanave e koniunkturave dhe gjoja bëjnë një politikë të madhe, duke menduar se boshti Kinë—Shtetet e Bashkuara të Amerikës—Japoni, plus vendet e tjera kapitaliste, ku këto parti revizioniste vegjetojnë, po bëhet një fuqi e madhe, prandaj kësaj fuqie të madhe, mendojnë ata, duhet t'i rezistojmë duke u bashkuar me një fuqi tjetër imperialiste. Atë që thoshte Kina për imperializmin amerikan, pikëpamje të cilën ne e kemi luftuar, tash këta njerëz antimarksistë e thonë për socialimperializmin sovjetik. Domethënë teza e kinezëve «të bashkohemi me një imperializëm për të luftuar një imperializëm tjetër» gjen vend në drejtim të kundërt. Për kinezët Bashkimi Sovjetik është imperializmi më i egër e më i fuqishëm, kurse për pseudokomunistët italianë Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë imperializmi më i egër e më i fuqishëm.

Prandaj këta njerëz që humbasin toruan, shpresën dhe besimin te revolucioni, te proletariati e te lufta e drejtë çlirimtare, janë komunistë me ngjyrë portokalli, siç thoshte Aragoni në një vjershë, që ia kushtoi Kongresit të 22-të të Partisë Komuniste të Francës.

Pra, shtypi ynë duhet të mbrojë fuqimisht revolucionin, çlirimin e popujve, unitetin internacionalist të popujve, duke u bërë thirrje atyre që me përpjekje e me sakrificë të pengojnë luftën botërore që po përgatitet, me demonstrata, me greva të demaskojnë dhe t'u prishin planet, të mos i lënë të fllënë të qetë kapitalistët, t'ua bëjnë të pamundur qëndrimin në pushtet

atyre që i shtypin, me fjalë të tjera që popujt të ngrihen në revoltë të përhershme. Kjo i tmerron kapitalistët, revizionistët e imperialistët. Këtë rrugë duhet t'u tregojmë ne popujve, të cilën t'ua shpjegojmë politikisht në bazë të teorisë marksiste-leniniste, t'ua shpjegojmë me fakte konkrete e jo me ëndrra e me iluziona. Faktet që vërtetojnë tezën e drejtë marksiste-leniniste, janë të shumta dhe të pakundërshtueshme; këto fakte i bindin popujt dhe jo llomotitjet pa bukë, prandaj t'u nxjerrim bojën e t'i demaskojmë llomotitjet e krerëve të socialdemokracisë dhe të revizionizmit modern, t'u themi njerëzve të ndershëm të popullit: ndiqni rrugën e revolucionit, se është e vetmja rrugë e shpëtimit, kuptojini mirë situatat që po krijohen, përse po krijohen, ç'qëllime kanë dhe kush i shtrëngon këto shtete të krijojnë situata të tilla. Këtej të dalë ajo forcë e madhe e popujve të botës që kërkon qartësi, unitet, guxim dhe sakrificë, se pa sakrificë e pa guxim asgjë nuk mund të arrihet.

Popujt nuk mund dhe nuk duhet t'i lejojnë të tjerët, shtypësit, të luajnë me fatin e tyre, nuk duhet të lejojnë që kokat e njerëzve të mbushen me lakrat e kalbura të tyre dhe barku t'u mbetet bosh, në të njëjtën kohë kur krerët e tyre bëhen miliarderë me gjakun dhe me djersën e popujve. Pra t'u demaskojmë planet imperialistëve, t'u çjerrim maskën edhe shërbëtorëve të tyre dhe t'u tregojmë popujve rrugën e vërtetë. Kjo duhet të jetë politika jonë.

Rekomandova që për vizitën e Ten Hsiao Pinit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të shkruhet një arti-

kull<sup>1</sup> ku të inkludohen këto ide, në përgjithësi, por edhe të tjera, që artikulli të mos dalë si një shkrim vetëm me fjalë dhe fraza propagandistike. Natyrisht, artikulli do të konturohet edhe me ide të tjera.

*Marrë nga libri:*

*Enver Hoxha, «Ditar për çështje ndërkombëtare» (botim i brendshëm) nr. 12, f. 112*

---

1. «Aleanca kino-amerikane — një rrezik i madh për Il-rinë, pavarësinë dhe sigurimin e popujve», botuar në gazetën «Zëri i popullit» më 9 shkurt 1979.

# **E RRËNJOSIM TE KUADROT NDËRGJEGJEN KOMUNISTE PËR FORCIMIN E USHTRISË DHE MBROJTJEN E ATDHEUT**

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve  
të KQ të PPSH*

**9 shkurt 1979**

*Pasi u informua për zhvillimin e stërvitjes së Brigadës së Parë e mori fjalën*

**SHOKU ENVER HOXHA:** Është e domosdoshme që komitetet dhe organizatat-bazë të Partisë të punojnë intensivisht dhe të interesohen për rrënjosjen e ndërgjegjes së fortë komuniste te njerëzit tanë për çështjen e mbrojtjes së atdheut. Kjo detyrë e madhe shtrun disa kërkesa të forta, të rrepta dhe kërkon shpirt të lartë sakrifice. Për ne ka rëndësi çështja të punojmë si duhet që ushtarin ta bëjmë të ndërgjegjshëm në mënyrë që ai të kuptojë se në ndonjë rast, në kohë lufte, mund t'i qëllojë të mos ketë bukë, t'i mungojnë edhe rrobat, megjithatë ai nuk duhet të braktisë detyrën, pozicionin, por të rezistojë e të luftojë deri në fund. Eksperiencia e luftës sonë e tillë është. Ne e dimë se partizanët tanë gjatë Luftës Nacionalçlirimtare kanë



rezistuar, bile në kushte shumë të vështira. Por, kur flasim e jemi të ndërgjegjshëm për këto gjëra, duhet edhe t'i zbatojmë dhe jo të thuhet formalisht sa për t'i thënë dhe, kur të vijë çështja për zbatimin e tyre, të na mbeten në mes të rrugës, pa u realizuar.

Prandaj ta kuptojmë qartë që në komandat e shkollave të lira ushtarake duhet të inkuadrohen kuadrot më të mirë e më të ndërgjegjshëm, ata që janë njerëz të sakrificës, me horizont dhe me dijenj të gjera politiko-ushtarake. Edhe në qoftë se ndonjëri s'ka dijeni sa duhet nga ana ushtarake, t'i vihet detyrë që të mësojë, të bëjë përpjekje që të pajiset edhe me këto dijeni, të aftësohet e të jetë i përgatitur sa më mirë.

Në qoftë se kuadrove të ushtrisë aktive nuk u bëjmë të qartë që ushtria jonë aktive është diçka shumë e vogël, në krahasim me gjithë ushtrinë tonë të madhe popullore, nuk kemi bërë gjëkafshë. Pikërisht oficerët, kuadrot e ushtrisë sonë aktive, qofshin të vjetrit, apo të rinjtë që mësojnë në shkolla, duhet të edukohen që të interesohen jo vetëm për ushtrinë aktive, po për të tërë masën e popullit të armatosur. Mirëpo në këto çështje ka akoma koncepte e qëndrime të palejueshme. Unë kam lexuar raporte ku thuhet se ka kuadro të ushtrisë aktive që udhëhiqen nga koncepte se për shkollat e lira duhet të interesohet rrethi dhe jo komanda e njësisë që e ka në territorin e vet apo anasjelltas. Në qoftë se ekzistojnë me të vërtetë të tilla koncepte, këto do të na pengojnë në forcimin e kompaktësimin si duhet të të gjithë ushtrisë sonë popullore dhe nuk do të na lënë të përgatitemi mirë e si duhet për mbrojtjen e atdheut. Ushtria jonë, në formën leniniste që

kemi vendosur, kërkon edhe organizim të mirë. Por organizimi kërkon, në radhë të parë, një kuptim të qartë politik dhe ideologjik, ai ka pastaj nevojë edhe për veprime e masa që duhen realizuar plotësisht në jetë.

Në qoftë se e kuptojmë vetëm me fjalë rëndësinë e shkollës së lirë ushtarake, kurse në realitet këtë e neglizhojmë dhe për ta drejtuar atë ngarkojmë të mosshuarit, ose i ndajmë kuadrot e kësaj shkolle nga ata të ushtrisë aktive etj., atëherë mësimi i Leninit nuk do të zbatohet. Me një praktikë të tillë ne nuk bëjmë gjë tjetër veçse ngopemi me lugë të zbrazët.

Ky problem duhet parë mirë në dy drejtime. Unë mendoj se shkollat e lira nënvleftësohen, për to nuk ka akoma një koncept të drejtë jo vetëm nga ana e kuadrove të ushtrisë aktive, por një neglizhencë të madhe e të palejueshme ka edhe nga vetë komitetet e Partisë dhe nga organizatat-bazë të terrenit, në vend që këto të udhëheqin si duhet punën për të zbatuar me kujdes vendimet që kemi marrë për funksionimin sa më të mirë të shkollave të lira.

Për shembull, unë nuk i gjej aspak të drejta mendimet që kanë shprehur drejtuesit e ministrisë V. LL., M. S. që të bëhet edhe një herë stërvitja e Brigadës së Parë. Ata e drejtuan gabim stërvitjen, afati që ishte caktuar për të tash ka mbaruar. Gjithçka u bë gjatë asaj stërvitjeje u analizua dhe ata vetë morën notën zero. Për të metat në organizimin e në drejtimin e kësaj stërvitjeje disa kuadro morën dënime, me efektivin u mbajtën edhe konferenca. Tash, të urdhërojmë që kjo stërvitje të përsëritet siç kërkojnë drejtuesit e Minis-

trisë së Mbrojtjes, do të thotë që njerëzit t'i heqësh nga prodhimi edhe një herë për disa ditë të tjera për të njëjtën punë, që nuk u krye, jo për faj të tyre, por për faj të kuadrove drejtues të ushtrisë që ishin ngarkuar me përgatitjen e zhvillimin e kësaj stërvitjeje. Mirëpo kjo gjë, përveç shpenzimeve të mëdha materiale e monetare, do të thotë që pjesëmarrësit të bëjnë dyfishin e numrit të ditëve që ishin caktuar. Me ç'të drejtë bëhet një propozim i tillë? Duhet parë me kujdes këto gjëra, shokë, dhe jo të flitet me kaq mendjelehtësi. Pastaj, pse vetëm me Brigadën e Parë do të bëjmë ne stërvitje? Ajo e kreu stërvitjen dhe s'doli hiç mirë, prandaj zero t'u vihet nota drejtuesve të ngarkuar dhe jo t'u fërkohen krahët, por ama jo edhe siç u tha Mehmet Shehu: «Ju e turpëruat Brigadën e Parë». Jo, ata nuk turpëruan aspak Brigadën e Parë të Luftës Nacionalçlirimtare, po turpëruan veten e tyre. Stërvitja që u krye, ashtu si u krye, që një shembull shumë i keq. Po përse ndodhi kështu? Mos vallë, siç na thuhet, sepse njerëzit shkuan për të parë një ndeshje futbolli!? Mua, më duket se nuk është këtu çështja. Pati nga ata që u larguan se nuk i rezistonin të ftohtit, dhe nga kjo, në mënyrë të shpejtuar, arrihet në konkluzionin që s'janë të qëndrueshëm këta njerëz. Po në realitet nuk duhet të jetë kështu dhe nuk është e tillë ushtria jonë!

Prandaj kuadrot ushtarakë të nxjerrin mësim nga kjo që ngjau, t'i vënë gishtin kokës, të mos i marrin çështjet përciptazi. Në asnjë mënyrë të mos mendojmë se kjo që i ngjau Brigadës së Parë është një gjë e rastit. Unë mendoj se, krahas njerëzve të mirë, ka edhe ndonjë që na gënjen, prandaj këtyre t'u tregojmë vendin.

Të bëjmë shumë kujdes, shokë, që të ruhemi nga gënjeshtrat dhe këtë do ta arrijmë vetëm duke organizuar kontroll të fortë. Mirë, po kush do ta kontrollojë ushtrinë? Ashtu si çdo sektor tjetër atë do ta kontrollojë Partia. Po Partia do të kontrollojë vetëm në përgjithësi se si zbatohen detyrat? Jo, Partia do të kontrollojë e duhet të kontrollojë edhe konkretisht dhe të zbulojë e të korrigjojë deri ato shfaqje të dënueshme, siç janë, për shembull, edhe fyerjet e atij oficeri që në këtë stërvitje i bëri ushtarit. Pra, është Partia ajo që duhet të kontrollojë çdo gjë, punën dhe njerëzit, deri edhe komandantin, të kontrollojë edhe komisarin, të kontrollojë e të vlerësojë edhe në ushtri çdo veprim, si kudo.

E pyeta Mehmet Shehun, me këtë rast, se si punojnë në repartet e tyre oficerët aktivë. Meqenëse ishte fjala për këta të njësive të Tiranës, i vura në dukje se unë kërkoj që ata edhe të rrinë e të flenë në repart me trupën. Aq më tepër, i thashë, kur venë në stërvitje, ata duhet të qëndrojnë vazhdimisht tok me trupat që stërviten, të lodhen e të përballojnë vështirësi në borë e në shi, ditën dhe natën, t'i shikojnë njerëzit gjatë marshimit ose edhe kur pushojnë, të interesohen vazhdimisht për gjendjen e tyre, për nevojat, pajisjet, ushqimin, fjetjen, shëndetin etj.

«Po edhe venë me trupat», më tha ai.

Po edhe nuk venë, shtova unë, pse di që ka nga këta kuadro që gjatë stërvitjes në fjalë e patën lënë fare vetëm trupën, në vend që oficeri, siç e ka për detyrë, të lidhej ngushtë e të jetonte në këto ditë me ushtarët. Kur oficeri vete dhe u futet ushtarëve ose rezervistëve në çadër dhe i pyet: «Si jeni, more shokë,

si jeni, mor djema?» dhe ulet e bisedon pastaj shtruar me ta, atyre u lehtësohen vështirësitë, u ngrihet morali. Kur oficeri hyn në çadër në kohën e pushimit dhe mund t'i gjejë ushtarët duke fjetur, kur ndonjë e sheh që është zbuluar dhe e mbulon me batanije, ushtari, që në atë kohë qëllon të zgjohet, duke parë dashurinë e kujdesin e eprorit të tij, është i gatshëm të hidhet në zjarr për të. Si mund të jetë oficer i ushtrisë sonë një njeri, që nuk kujdeset kështu për vartësit e vet?! Ne asnjëherë nuk kemi thënë që oficeri të ndahet nga familja, nga fëmijët e të mos u kushtojë këtyre një pjesë të kohës së lirë që ka, por ama, jo ta ketë mendjen orë e çast vetëm te shtëpia e të mos qëndrojë pranë ushtarëve. Në rast se kemi ndonjë kuadër të tillë, ky nuk është i lidhur me masën e ushtarëve dhe atëherë më mirë të hiqet nga ushtria dhe të dërgohet në një punë tjetër që do të ishte më e përshtatshme për të.

Siç duket, është e domosdoshme që në ushtri të bëhet një punë politike dhe ideologjike shumë më e thelluar e më e organizuar se deri më sot, pse kam përshtypjen që ajo bëhet e përciptë. E kam përsëritur shumë herë, shoku Ramiz, dhe kurdoherë kam pasur merak për mënyrën e dhënies së mësimin në ushtri, se ajo futet në korniza e bëhet me formula nga ana e atyre që zhvillojnë punën politike, se këta nuk mendojnë ta lidhin ngushtë teorinë me jetën, ose nuk arrijnë ta lidhin mësimin teorik me problemet që u dalin përpara në repart, në stërvitje. Prandaj punëtorët e Partisë, kur venë të trajtojnë një problem politik apo teorik, këtë ta lidhin ngushtë me ngjarjet e vendit, me problemet ku jetojnë e punojnë njerëzit që kjo punë t'u shërbejë

përmirësimit të gjendjes, zgjidhjes në kohë dhe mirë të detyrave.

Mua më duket se në ushtri, ashtu siç ndodh në shumë raste në terren, puna politike dhe ideologjike bëhet në mënyrë formale. Kur lektorëve a propagandistëve u tërheq ca vërejtjen, punojnë mirë, por ka nga ata, për të cilët kam biseduar edhe me ty, Ramiz, që kur venë të flasin, për shembull, për librin «Imperializmi dhe revolucioni» u lexojnë dëgjuesve pjesë të tëra të tij. Për t'ua lexuar, më duket mua, nuk ka nevojë, sepse secili e lexon vetë librin. Rëndësi ka që t'u flitet njerëzve konkretisht për problemet, t'u bëhen zëbërthime. Referuesi edhe ndonjë frazë a ndonjë citat mund të marrë nga ky libër, me qëllim që ta bëjë më të gjallë tezën që shtjellohet atje, që dëgjuesit t'i ngulet mirë në kokë politika e Partisë, por jo t'ua lexojë njerëzve faqe të tëra nga libri.

Gjithashtu, kam mendimin se, veçanërisht në ushtri, praktikohet akoma mënyra e vjetër e konspektimeve dhe e zëbërthimit të mësimëve e orientimeve të Partisë. Mbajti një fjalim të gjatë për shumë orë në aktivin vjetor të ushtrisë në Durrës Mehmet Shchu dhe menjëherë pas aktivit u porositën kuadrot ushtarakë që ta zëbërthojnë këtë material për çdo çështje. Dhe ata po bëjnë përpjekje që ta kryejnë këtë punë. Mua më duket se të zëbërthohet ky material kaq i gjatë për çdo paragraf, është një punë pa kuptim. Një zëbërthim i tillë, ashtu siç po bëhet, nuk ka vlerë, për arsye se çdo çështje që trajtohet aty, është e lidhur me shumë probleme të tjera. Që t'i bësh një zëbërthim me vlerë një materiali, duhet të nisesh nga problemet që ke përpara

për të zgjidhur, pastaj të bësh përpjekje që të zgjerosh dijenitë e tua për këto probleme. Po të kesh gjëra të reja, duhet t'i paraqitësh edhe këto si shembuj për ta ilustruar materialin etj.

Unë mendoj se nuk bëhet kështu, se një punë e tillë nuk bëhet as në organizatat e Partisë në terren. Por kjo është e domosdoshme, sepse gjithë ajo masë, që mori pjesë në këtë stërvitje, përbëhet nga njerëz të ardhur në shumicë nga terreni. Këta që marrin pjesë në stërvitje janë të rinj, shumica dërrmuese e tyre s'janë as anëtarë partie, por ata kanë bërë pjesë ose janë edhe sot anëtarë të organizatës së rinisë. Prandaj punën me rininë, edukatën që jepet në këtë organizatë, duhet ta shikojmë një çikë më thellë, se më duket që kjo punë bëhet më shumë në mënyrë libeske. Prandaj të thellohem dhe të gjejmë arsyet pse na ngjasin shfaqje të mungesës së disiplinës në rini, të mungesës së disiplinës në fabrika, në ara apo gjetkë. Këtu të bëjmë kujdes që të mos e shohim në përgjithësi punën e rinisë, të mos na zërë sytë ajo që themi përditë dhe që është plotësisht e drejtë, që rinia ka dhënë dhe po jep një kontribut të madh për ndërtimin e socializmit dhe për mbrojtjen e atdheut, po ta shohim një çikë më konkretisht këtë fenomen në disa drejtime, për disa arsye. Me siguri që ka disa shkaqe përse ndodhin këto fenomene negative. Ne duhet të bëjmë përpjekje t'i gjejmë shkaqet, t'i vëmë në dukje, t'i lidhim me situatat konkrete dhe të nxjerrim pastaj edhe konkluzione teorike për përmirësimin e gjendjes.

Kam përshtypjen se në ushtri edhe gazetat lexohen sa për të kaluar kohën. Është bërë zakon që ngrihet,

fjala vjen, skuadërkomandanti ose përgjegjësi i rinisë dhe thotë: «Rrini tani ju, shokë të skuadrës, se do të bëjmë pak pushim dhe gjatë kësaj kohe unë do t'ju lexoj gazetën», pa i lënë njerëzit një çikë të lirë. Në vend të kësaj do të ishte mirë që ai t'u fliste shokëve të skuadrës disa minuta për një artikull me rëndësi që është botuar në gazetë e që lidhet edhe me problemet e tyre konkrete, duke nxjerrë mësim për ndreqjen e të metave e të dobësive të skuadrës e të repartit.

Të nesërmen ai mund t'u komentojë një artikull tjetër, që mund edhe të mos ketë lidhje drejtpërdrejt me problemet e repartit, por që trajton ndonjë problem të rëndësishëm dhe që i shërben formimit dhe edukimit të ushtarëve.

Pra puna ideopolitike me njerëzit duhet përmirësuar, ashtu si edhe në terren, edhe në ushtri.

Kisha, shokë, edhe një çështje tjetër, atë të organizimit të punës këtu në aparatit e Komitetit Qendror për të cilin duhet të mendojmë vazhdimisht për ta përsosur. Është mirë të shikojmë nëse e kemi pasur drejt e nëse na ka dhënë fryte forma e organizimit të aparatit, të cilën e kemi vendosur para disa vjetësh. Ne i shkruam atëherë drejtoritë, instruktorët i bëmë të profilit të përgjithshëm, diskutuam gjithashtu dhe për metodën dhe stilin e punës së tyre, si do ta çojnë ata në rrethe e në bazë vijën e direktivën e Partisë dhe si do të sjellin këtu në qendër eksperiencën e bazës. Gjithashtu kemi thënë se në punë e sipër do të edukojmë, në radhë të parë, shoku-shokun me të mirat e me të këqijat që hasen në punën e Partisë në bazë, në punën shtetërore, administrative, organizative, teorike, praktike, ushta-



rake, duke hapur horizont të gjerë në gjithë këtë veprimtari që na duhet ta zhvillojmë e ta çojmë përpara. Këto punë, natyrisht, bëhen me kontakte të gjalla luftarake të punonjësve e të sektorëve të aparatit me njëri-tjetrin dhe jo në forma shabllone, jo vetëm me paraqitjen e konstatimeve, por duke shkëmbyer e rrahur mendime. Fjala vjen, problemet e agjitacionit dhe të propagandës, si zhvillohen ato në terren, në organizatën e gruas, në atë të bashkimeve profesionale apo të rinisë, mendoj se nuk i interesojnë vetëm sektorit të propagandës, por edhe instruktorëve që kemi në aparat për çështjet ushtarake, të cilët i ka në vartësi shoku Hysni. Në qoftë se këta nuk dinë se si punohet edhe në terren, nuk mund ta bëjnë punën mirë as në ushtri. Prandaj instruktorët e sektorëve të tjerë të aparatit të Komitetit Qendror duhet të bashkëpunojnë ngushtë me ata të sektorit ushtarak, se mundet që në këtë bashkëpunim të ketë rutinë.

Organizativisht ne e bëmë bashkimin e instruktorëve, pse kuptuam rëndësinë e këtij organizimi, megjithatë disa i tërheq ana praktike, nuk luftohet nga të gjithë për përgjithësimin e këmbimin e përvojës. Instruktorët duhet të rrinë disa ditë që të dëgjojnë mendimet e vërejtjet e bazës, të bëjnë pyetje për punën, të diskutojnë e të gjejnë kush e ka fajin për gabimet, për dobësitë e punës në terren, në rini etj. Mendoj që organizata e Partisë, në rreth e në bazë dhe në ushtri duhet të gjallërohet nga kjo punë e tyre, se ajo do të ndihmohet që të merret më mirë dhe t'i shohë problemet nga të tëra anët, në aspektin ideologjik, politik e organizativ dhe të mos merret, bie fjala, vetëm me disiplinën. Në

jetë dalin mjaft probleme, si për shembull, i paguajnë komunistët rregullisht kuotizacionet, a zhvillohen si duhet mbledhjet e organizatës, si bëhen e si duhet të bëhen pranimet në parti, a punohet si duhet që komunistët të ngrenë nivelin e tyre ideologjik e politik, a vënë këta në rregull në stërvitjet që organizohen në ushtri apo nuk vënë dhe, në rast se jo, cilat janë arsytet, se mbase kanë halle apo ka disa koncepte e praktika që nuk janë në rrugën e Partisë etj. Të gjitha këto probleme ku do të shikohen? Këto do të shikohen e duhet të shikohen, në radhë të parë, në organizatën e Partisë. Prandaj të punohet kudo për ta forcuar Partinë. Por Partia nuk forcohet duke u interesuar vetëm nëse bëhen mbledhjet apo jo, por duke ndihmuar konkretisht që organizatat-bazë të diskutojnë, të rrahin mendime, të vendosin e t'u japin zgjidhje problemeve që kanë dalë, si për ushtrinë, për ekonominë, për edukimin dhe mobilizimin e rinisë, përse nuk punohet mirë në naftë etj. Të tëra këto probleme duhet t'i shohin organizatat e Partisë në ushtri, se ata që shërbejnë atje janë njëkohësisht edhe ushtarë, edhe ndërtues të socializmit.

Ne e shkëputëm Drejtorinë Politike nga Ministria e Mbrojtjes. Puna që bënte kjo drejtori, tani bëhet nga aparati i Komitetit Qendror. Kur e morëm këtë masë, ishte vërtetuar që në ushtri dominonte komanda mbi Drejtorinë Politike. Prandaj më duket se kjo punë tash është vënë drejt, vetëm se duhet punuar që të zbatohet mirë. Çështja këtu është si të ndiqen mirë problemet e ushtrisë e të mbrojtjes nga organet e Partisë e të pushtetit në terren.

**SHOKU HYSNI KAPO:** Është vepruar drejt, shoku:

Enver po, siç thatë ju, duhet që edhe të zbatohet mirë, sidomos në lidhje me terrenin, për shembull. Problemet e ushtrisë e të mbrojtjes duhen ndjekur më mirë, si nga ana e Partisë në ushtri, ashtu edhe nga Partia në terren, duke vendosur një bashkëpunim të ngushtë ose, si të thuash, të integrohet gjithë Partia për çështjet e mbrojtjes.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Hysni, ja çfarë mendoj unë për punën me ushtrinë. Së pari të këshilloj që të zbatosh mirë rregullat shëndetësore dhe porositë e mjekëve, me qëllim që të bëhesh sa më shpejt i aftë dhe në gjendje për punë. Unë kërkoj që ti të mos shkosh me shërbime kudo, ashtu siç shkoje shpesh më përpara, dhe bëje shumë mirë. Megjithatë edhe në kushtet aktuale shëndetësore që je, ushtria duhet të të shohë, ajo duhet të shohë herë pas here Komisarin e saj të Përgjithshëm, pse, në fakt, ti je Komisari i Përgjithshëm i Ushtrisë. Prandaj atje duhet të të shohin edhe ty, si Komisar të Përgjithshëm të Ushtrisë, që je, të shohin njerëzit se është Partia që komandon në ushtri.

Me këtë nuk dua të them që tash të fillosh të prisësh rregullat shëndetësore që të janë caktuar, se nga kjo Partia nuk fiton gjë. Unë nuk të këshilloj të mos preokupohesh, pse preokupimi për çështjet e ushtrisë është e duhet të jetë vazhdimisht i madh për të gjithë ne, natyrisht, jo për të gjitha problemet, por vetëm për ato më kryesoret. Ti duhet ta marrësh veten si duhet, dhe kjo arrihet duke zbatuar këshillat e mjekëve, por edhe duke i observuar me kujdes ngjarjet që zhvillohen në ushtri në disa objektiva të caktuar, gjë që mund ta bësh rregullisht me ndihmën e gjithë kuadrove që ke

në aparat për ushtrinë. Veçse të bësh kujdes që punën e Partisë në ushtri të mos përpiqesh ta ndjekësh të gjithë vetë. Duke pasur gjithnjë kujdes për shëndetin, ti duhet të vesh në disa mbledhje të rëndësishme në ushtri. Dhe atje s'është nevoja të flasësh disa orë, pse duke qenë konciz mjafton edhe vetëm një orë të flasësh dhe fjala jote do të bëjë efekt, bile pa e ngritur zërin fare<sup>1</sup>, t'ua thuash të vërtetat në fytyrë njerëzve që nuk janë në rregull, që të mbledhin veten. Kur ndodhin ngjarje të jashtëzakonshme ose mbahen qëndrime prej bajraktari nga ndonjëri, kjo duhet ndjekur me kujdes, pavarësisht ka apo nuk ka veprimtari armiqësore, ta shohim me shumë kujdes e të jemi vigjilentë në këtë drejtim.

Unë e lexova raportin që flet për stërvitjen e këllijviti dhe, siç ia thashë Mehmetit, nuk jam aspak i kënaqur me sa është bërë, programi nuk është plotësuar sipas planifikimit.

Ashtu është, m'u përgjigj ai, po këtë vit ushtria ka pasur përsipër edhe fortifikimet. Por këto, siç dihet, janë të gjitha të planëzuara, prandaj ajo që thotë ai nuk ka asnjë justifikim. Çdo gjë, si kudo edhe në ushtri, është e planifikuar veçse të bëjmë kujdes të madh që çdo gjë ta planifikojmë drejt dhe kryesorja e kryesoreve është që të realizohet plotësisht plani i stërvitjes, siç duhet të realizohen gjithashtu në rregull edhe fortifikimet, edhe çdo detyrë tjetër.

Kjo që ndodhi duhet të bëhet mësim dhe çdo gjë të zgjidhet me gjakftohtësi. Mehmeti na tha se i kishte

---

1. Është aluzion për Mehmet Shehun që kudo ku shkonte e kudo që fliste, ngrinte zërin e fliste me arrogancë.

hedhur në votë masat që mori dhe se të tërë ngritën duart dhe u shprehën se janë dakord me ato masa. Po rëndësi ka çështja që të analizohet mirë puna, të dalin shkaqet përse ngjanë. Në mbledhjet për këtë qëllim njerëzit të thellohen, ato të zhvillohen në qetësi se nuk është çështja për të hedhur masat në votë. Duhet punuar me mend e me shumë kujdes.

*SHOKU HYSNI KAPO:* Edhe dje ne biseduam me njëri-tjetrin, shoku Enver, me aq sa ishim informuar për stërvitjen e Brigadës së Parë, por ju, duke na folur sot këtu për këto probleme, na e zgjeruat edhe më shumë horizontin.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Ato që duhet të na interesojnë ne, udhëheqjen, të jenë problemet e mëdha. Unë nuk kërkoj që ju të merreni me gjëra të vogla. Veç kësaj, për ngjarje serioze që vërtetohen, qoftë në ushtri ose kudo gjelkë, duhet të fshihet nga defteri shprehja «të mos shqetësojmë Enverin». Jo, shokë, nuk është aspak e drejtë të mendohet kështu nga asnjëri<sup>1</sup>. Në qoftë se unë nuk duhet të shqetësohem për këto probleme të mëdha, atëherë përse duhet të shqetësohem?

*SHOKU HYSNI KAPO:* Jo ju, shoku Enver, që s'ka diskutim, por edhe unë u kërkoja shokëve të na raportojnë për këto probleme të rëndësishme, të na bëjnë konkluzionet e analizës me gojë dhe të na vënë sa më

---

1. Vërejtja ishte kryesisht për Mehmet Shelun e Kadri Hazbiun, të cilët, si armiq që ishin, nën maskën e kujdesit për shëndetin e shokut Enver Hoxha, me qëllim që ta mënjanonin, nuk e vlin në dijen për probleme të rëndësishme.

parë në dijëni, të na thonë, gjithashtu, edhe ç'mendime kanë për to.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Të bëhen edhe këto që thua, vetëm të them seriozisht se ti duhet të bësh kujdes që të marrësh veten. Për këto që ndodhën në Brigadën e Parë ti duhet të mos shqetësohesh shumë, sepse, si në çdo situatë, udhëheqësi duhet të jetë i qetë. Kjo që ndodhi me siguri e docmos do të rregullohet dhe s'ka dyshim që puna në ushtri do të forcohet. Unë kam bindjen e plotë se atje nuk do të ndodhë më kështu në të ardhmen. Natyrisht, ngjarje të vogla do të vërtetohen përsëri, po të tilla dhe në këtë masë siç ndodhën në stërvitjen e këtij viti të Brigadës së Parë, këtej e tutje duhet të marrim masa që të mos na ngjasin më dhe me siguri që nuk do të na ngjasin.

Çështja është që, siç të thashë, ti tani të marrësh veten mirë, të rritësh forcat fizike dhe ta organizosh punën në mënyrë që shokët që ke në vartësi të mësohen përse duhet të të informojnë, pra për çështjet kryesore dhe të të raportojnë shkurt e qartë. Ata vetë të përpiqen që ta vrasin më shumë mendjen në këtë drejtim dhe për këto që ndodhën të reflektojnë për të gjetur shkaqet e vërteta dhe të propozojnë ç'duhet bërë për shërimin e gjendjes jo të mirë që ekziston. Për këtë forcat dhe mundësitë i kemi të gjitha, si nga ana materiale, po sidomos nga ana morale, politike dhe ideologjike. Vetëm se duhet menduar thellë që me gjithë atë mori njerëzish, shtabesh e oficerësh, komisarësh politikë e sekretarësh partie që kemi, të punohet mirë që t'i bëjmë të ndërgegjeshëm për të zbatuar deri në fund të gjitha detyrat.

**SHOKU HYSNI KAPO:** Për zbatimin e rregullave shëndetësore, që më thatë, shoku Enver, unë po bëj përpjekje dhe po mundohem t'u përmbahem si atyre, ashtu edhe porosive të tjera të herëpashershme, duke gjykuar se, derisa Partia ka bërë gjithë këto për mua, unë e kam për detyrë që t'i zbatoj ato.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Këtu nuk është vetëm interesi yt personal. Tok me këtë është edhe interesi i Partisë. Janë të lidhura ngushtë të dyja këto anë, personalja me të përgjithshmen.

**SHOKU HYSNI KAPO:** Ashtu e kuptoj edhe unë këtë çështje, shoku Enver, prandaj po bëj përpjekje që t'u përmbahem normave mjekësore, nuk abuzoj në këtë drejtim dhe jam i vendosur t'i zbatoj ato me përpikëri. Edhe mjekët më këshilluan se, po iu përmbajta rregullave që më rekomanduan, vetvetiu do të arrij në gjendje që ta shtoj kohën e punës.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Me siguri që do ta shtosh. Tash ti vetë je i ndërgjegjshëm për këtë dhe, kur njeriu është i ndërgjegjshëm që duhet zbatuar kjo apo ajo normë, mendoj që s'është më nevoja të t'i përmen-dim ne.

**SHOKU HYSNI KAPO:** Çështja tjetër që doja të vija në dukje, shoku Enver, është se vitin e kaluar kam qenë i informuar për punën që bëhet në ushtri, po në reparte personalisht nuk kam shkuar dot, veçse në raste të rralla, kur janë bërë analiza të mëdha. Tani porosinë që më dhatë ju, do ta kem mirë parasysh, në mënyrë që në disa raste të rëndësishme të shkoj në mbledhjet e Partisë në ushtri, pasi të përcaktoj më parë se për ç'qëllim duhet vajtur.

Tashti mua më preokupon një gjë, që ju e theksuat edhe në Plenumin e fundit të Komitetit Qendror<sup>1</sup> dhe që duhet pasur parasysh jo vetëm nga organizatat e Partisë të terrenit, por edhe nga ato të ushtrisë: as të mos fluturojmë në eufori, por as të mos biem në pesimizëm. Në fakt, në ushtri vihet re njëanshmëri nga kjo pikëpamje. Kam bindjen që te kuadrot ushtarakë, si në komandat, ashtu edhe në komitetet e Partisë, ekziston njëanshmëri në raportimin e çështjeve. E vërteta është se Ministrisë së Mbrojtjes Popullore çështjet, si të metat ashtu edhe arritjet, i vijnë shumë të rrumbullakosura.

Për sa i përket punës këtu, në aparatit e Komitetit Qendror, me sektorin për ushtrinë, siç e kemi biseduar, instruktorët për anën ushtarake futen në shumë detaje kur dalin të meta e dobësi. Kjo është një gjë e mirë për ata, se kështu janë në gjendje t'i njohin të metat, po tek ata me të cilët punojnë, kjo nganjëherë krijon një situatë jo të mirë. Prandaj u kam thënë që të kapen edhe pas eksperiencës pozitive. Bile mendoj që kjo duhet kapur më fort dhe më mirë. Pra ka nevojë që si instruktorët e aparatit të Komitetit Qendror, ashtu edhe punonjësit e Partisë në ushtri të përmirësojnë stilin e metodën e punës së tyre. Nga të dhënat që na kanë sjellë instruktorët, si edhe nga ato që na vijnë nëpërmjet rrugës së komandës, del se ekziston eufori dhe prirje për zbukurimin e çështjeve. Mua kjo më ka tërhequr shumë vëmendjen dhe më merakos, se këtu kemi të bëjmë me çështje koncepti.

---

1. Është fjala për Plenumin e 8-të të KQ të PPSH.



**SHOKU ENVER HOXHA:** Është sigurisht çështje koncepti, se, megjithëse thuhet që edhe në ushtri si kudo drejton Partia, punëtorët e Partisë e ndiejnë veten inferiorë përpara disa kuadrove ushtarakë dhe sidomos përpara komandantëve. Prandaj kjo gjendje me doemos duhet ndryshuar dhe të vihet në rrugën e drejtë.

**SHOKU HYSNI KAPO:** Nganjëherë dalin disa çështje që kanë të bëjnë me koncepte të gabuara që më kanë tërhequr vëmendjen. Unë kam thirrur për këtë qëllim zëvendësministrat e Ministrisë së Mbrojtjes, për arsye se kuadrot drejtues ushtarakë, siç janë ata atje, duke bashkëpunuar me shokët tanë të aparatit, kanë shfaqur disa mendime që ia kanë paraqitur Mehmetit, pa u konsultuar më parë me ne. Ato janë çështje që kanë të bëjnë me vendimet e Komitetit Qendror, të Byrosë Politike dhe të Këshillit të Mbrojtjes. Për shembull, në çështjet e organizimit të ushtrisë sonë thuhet që s'ka komandant pa komisar. Kështu, krahas komandantit të batalionit, fjala vjen, duhet të ketë me doemos edhe komisar politik batalloni, krahas komandantit të shkollës së lirë duhet të ketë gjithashtu edhe komisar politik të shkollës së lirë etj. Mirëpo, kur bëhen organikat e shkollave të lira, ose të batalioneve, kuadrot drejtues në ministri i paraqesin Mehmetit organikën në kundërshtim me këto orientime duke nxjerrë pretekstin se nuk ka kuadro komisarë. Si është e mundur që batalionet të mos kenë në organikë komisarë, në një kohë që ka jo vetëm komandantë, shefa shtabi, shefa zbulimi, por edhe nja dy a tre të tjerë të profilit ushtarak? Kjo shpjegon një koncept të tërë dhe këtu flasim sidomos për batalione, pa bërë fjalë për kompanitë

dhe për shkollat e lira, për të cilat nuk kujtohen fare. Kur kemi komandantë në shkollat e lira, si të mos kemi komisarë? Në shkollat e lira komisarë duhet të ketë me domosdo, për arsye se në këto grumbullohet gjithë populli ynë ushtar.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Mehmeti nuk duhet t'i pranojë propozime të tilla nga ana e kuadrove të ministrisë.

*SHOKU HYSNI KAPO:* Kuadrot drejtues të Ministrisë së Mbrojtjes nuk i mbajnë mirë parasysh vendimet e Komitetit Qendror e të Byrosë Politike dhe nuk e sinjalizojnë atë rregullisht për zbatimin e tyre, a zbatohen drejt ato apo jo. Ata e kanë për detyrë ta sinjalizojnë atë. Defektet e tyre në këtë drejtim flasin se ata kanë akoma koncepte jo të drejta. Për këto ne kemi biseduar me shokët e aparatit të Ministrisë së Mbrojtjes Popullore, me zëvendësministrat.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Të kemi parasysh se konceptet e vjetra, shokë, nuk zhduken me tre-katër vjet. Puna që po bën Partia në ushtri këto vitet e fundit<sup>1</sup>, natyrisht, ka bërë efektin e vet pozitiv, por përpara një praktike prej 30 e ca vjetësh pune në një rrugë, gjatë së cilës janë bërë vërtet ndryshime e përmirësime, na janë futur edhe koncepte jo të drejta nga sovjetikët etj., që s'ka dyshim nuk fshihen aq lehtë. Mund të bësh sa të duash referate kundër koncepteve të tilla, rëndësi ka që vetë Partia të luftojë kundër koncepteve të huaja. Partia t'i mësojë njerëzit, t'u vërë atyre fort në dukje

---

1. Pas zbulimit dhe demaskimit të veprimtarisë armiqësore të grupit puçist të Beqir Ballukut me shokë.

ato që i kanë gabim. Nuk duhet të lejohet që komandanti ta ofendojë vartësin. Atij mund t'i bëhet një vërejtje. Edhe vartësi nuk mund t'i drejtohet komandantit me fjalë jo të përshtatshme. Po kush do t'ua mësojë mënyrën e të sjellurit masës së ushtarakëve tanë? Pajtjetër Partia dhe këtë do ta bëjë, me qëllim që të forcohet dashuria dhe respekti reciprok midis eprorëve dhe vartësve, si tani edhe në kohë lufte. Prandaj kanë rëndësi dhe duhet të vihen në rrugë të drejtë këto çështje.

*SHOKU HYSNI KAPO:* Edhe një çështje tjetër që doja të vija në dukje, shoku Enver, është prapë çështje koncepti. Për drejtimin dhe funksionimin e shkollës së lirë ushtarake duhet të përgjigjen, siç thatë ju, komandant e ushtrisë, por me to duhet të merren edhe organet e Partisë në terren. Unë mendoj se duhet të ketë një bashkëpunim të ngushtë midis ushtrisë dhe komitetit të Partisë të rrethit për çështjet e shkollave të lira ushtarake pasi ky bashkëpunim nuk është në lartësinë e duhur. Ka pasur një dallim midis disa shkollave të lira që komandën ushtarake e kishin më vete në krahasim me ato që drejtoheshin nga komandantët e batalionit të ushtrisë aktive që mbulojnë territorin ku veprojnë shkollat e lira. Ato që e kishin komandën më vete shkollën më mirë, kurse të tjerat që i kishte në juridiksion reparti ushtarak aktiv, po nuk drejtoheshin drejtpërdrejt nga komanda e tij, nuk na shkollnin mirë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Këta njerëz duhet të kenë një gjë të qartë: kryesorja dhe më e rëndësishmja për ne është tërë masa e ushtrisë popullore, gjithë efektiviteti që inkuadrohet në shkollat e lira dhe jo vetëm

ushtria aktive. Prandaj komandanti, zëvendëskomandanti, komisari apo sekretari i komitetit të Partisë të repartit, që e kanë në lidhje shkollën e lirë, duhet ta kryejnë me radhë detyrën e udhëheqjes ushtarake në këtë shkollë, ata duhet të mendojnë vazhdimisht për këtë shkollë dhe të jenë të lidhur me të, duke vajtur atje herë komandanti, herë komisari, herë shefi i shtabit, të cilët me radhë do të qëndrojnë e do të drejtojnë punët në shkollën e lirë. Kjo mënyre pune që bëhet tash, nuk është një punë e zhdërvjellët, revolucionare, nuk ka efikasitet që gjithë këtë efektiv rezervistësh ta ngrejë në një nivel të lartë politiko-ideologjik, njëkohsisht edhe ushtarak. Shumë herë kuadrot bëhen skllëvër të rutinës së vjetër të punës.

E kam thënë edhe herë të tjera se puna e Partisë është një çështje me shumë rëndësi, e shumanshme dhe që nuk duron rutinë. Në qoftë se vazhdojmë me një veprimtari rutinë, nuk do të nxjerrim gjë në rrugë. Puna e Partisë duhet të jetë e zhdërvjellët, e zgjuar, e gjallë, revolucionare, ajo kërkon që mendimet të zhvillohen nëpërmjet debateve.

*Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga biseda e incizuar që gjendet në AQP*

## **TE RUIHEMI NGA EUFORIA E PABAZUAR NE VLERESIMIN E GJENDJES NE USHTRI**

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve  
të KQ të PPSH*

**12 shkurt 1979**

**SHOKU ENVER HOXHA:** Çfarë doli në mbledhjen që u bë në Ministrinë e Mbrojtjes?

**SHOKU HEKURAN ISAI:** Atje u bisedua kryesisht për ngjarjet që ndodhën gjatë stërvitjes së Brigadës së Parë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Doli atje çështja përse ndodhën këto ngjarje në këtë brigadë?

**SHOKU HEKURAN ISAI:** Po, po. Ata thanë me habi: «Si na ndodhi!», «Është turp i madh, që i ndodhi kjo Brigadës së Parë» etj.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Nuk duhet menduar e nuk duhet folur me habi si na ngjanë këto gjëra dhe, meqenëse na ngjanë, të thonë «u turpëruam», domethënë «na ra nderi neve, efektivit të Brigadës së Parë, kurse të tjerëve po, mund t'u ngjasë». Këto pikëpamje s'janë në rrugën tonë, shokë.

**SHOKU HEKURAN ISAI:** Tek të gjithë kuadrot

e kësaj brigade, nga baza e deri lart, duket shqetësimi përse ndodhën këto gjëra.

*SHOKU RAMIZ ALIA:* Kjo u duk edhe në takimin që mbajti Mehmet Shehu me efektivin e brigadës.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Po, po, ai ma tha edhe mua këtë. Ai, nuk diskutoi, po mbajti një fjalim të tërë duke iu drejtuar efektivit: «Sot po ju flas si komandant i Brigadës së Parë dhe jo si ministër i Ministrisë së Mbrojtjes Popullore».

*SHOKU HEKURAN ISAI:* Po, shoku Enver, kjo është e vërtetë, ai ashtu u foli atje, si komandant i brigadës dhe jo si ministër. Ai foli se si ka qenë disiplina gjatë luftës, tregoi pastaj historinë si është luftuar në Spanjë<sup>1</sup>, si ka kritikuar atje Andrea Marti për dobësitë që kishte vënë re në një rast, se ka ndodhur që nuk janë zbatuar urdhrat.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Foli për luftën e Spanjës Mehmeti?!

*SHOKU HEKURAN ISAI:* Po, foli.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Po ç'që nevoja të kapej ai deri te lufta e Spanjës në këtë fjalim? Ushtria republikane në Spanjë nuk ka pasur ndonjë disiplinë shumë të fortë.

Në Plenumin e fundit të Komitetit Qendror, siç

1. Mehmet Shehu nuk vajtj vullnetarisht në Spanjë, por u dërgua atje me urdhër të agjunkturës amerikane për të pene-truar në radhët e brigadave Internacionaliste që të merrte «patentën» e «luftëtarit internacionalist» për ta përdorur për qëllime të largëta të mëvonshme në Shqipëri. Shih: Enver Hoxha, «Titistët», f. 543.

e dëgjuat, theksova të ruhemi nga euforia e pabazuar, pse, siç e thashë, ka eufori të bazuar, ka edhe të pabazuar. Në greqisht eufori do të thotë kënaqësi. Pra ka te kuadrot tanë kënaqësi të bazuar, ka edhe kënaqësi të pabazuar. Kur e thashë këtë, kisha parasysht të gjithë sektorët, pa përjashtuar ushtrinë. Partia e kupton ç'është njëra e ç'është tjetra. Pas kësaj kuadrot e Partisë duhet të thelloheshin për të bërë në praktikë dallimin midis euforisë së bazuar dhe euforisë së pabazuar. E po eufori e bazuar është ajo e anëtarit të Komitetit Qendror dhe shefit të Shtabit të Përgjithshëm, që në këto situata i thotë efektivit: «Bravo djema, e keni mbaruar me sukses këtë stërvitje!» kur në të ngjanë gjithë ato gjëra?! Nuk kishin vallë të drejtë ushtarët që, në bazë të disiplinës proletare, të thoshin në këtë rast: «Ti nuk ke hiç të drejtë, shoku shef i Shtabit të Përgjithshëm, se ne kemi 10 ditë në dëborë e në tufan, duke lëvizur ditë e natë pa gjumë, në një metër borë dhe vetëm dy herë fasule të ngrohta kemi ngrënë, s'kemi ndezur asnjëherë zjarr, na latë të vijmë me veshje behari në këtë stërvitje»?!

Po, kishin. Por, a e mendon shefi i Shtabit të Përgjithshëm se mund t'i bëhej kjo replikë, apo me të thënë një fjalë ushtari dhe ai na ofendohet dhe i thotë: «Ti je i padisiplinuar, je budalla»?

Si qenka i padisiplinuar ai, kur flet realitetin?! Po ne duhet të kujdesemi që ta ruajmë disiplinën ushtarake, mund të thotë shefi i Shtabit. Mirë, dakord, thotë ushtari, po disiplinën ushtarake ruaje më parë ti, komandanti, që ta ruaj edhe unë, se unë nuk jam dele, po ushtar i republikës, njeri me dinjitet, që kam dëshirë

të madhe të jem i disiplinuar. Por derisa shteti e ka caktuar të ha një herë fasule të ngrohta në ditë, ti, si komandant duhet të bësh përpjekje që të ma sigurosh këtë edhe në kohën e luftës, e jo më tash. Ose, në qoftë se nuk ka, më mirë të na thuhet që ato mungojnë dhe atëherë, kur dihet që s'ka, nuk i kërkojmë.

Është e vërtetë që në ushtri ka edhe njerëz të padisiplinuar, që atje mund të dalin edhe tradhtarë, si Beqir Balluku me shokë. Kjo s'ka si të mos pranohet, ndryshe duhet të jesh idealist, por ama nuk mund të pranohet në asnjë mënyrë ajo që thotë ndokush se e gjithë klasa jonë punëtore është e padisiplinuar, se rinia jonë është e tëra e shthurur. S'ka dyshim që në mes të gjithë këtyre ka edhe të padisiplinuar, ka edhe ndonjë të shthurur. Ne duhet të jemi komunistë realistë, gjendjen ta paraqesim siç është, as të mos e nxijmë, as ta bëjmë shesh me lule. Të flasësh, është e lehtë, po çdo gjë duhet të jetë e bazuar, e mbështetur në realitetin objektiv, e matur, e pjekur.

Na thuhet se gjatë këtyre katër vjetëve në ushtri çdo gjë është përmirësuar dhe kjo na thuhet me një ndjenjë euforie. Por euforia në këtë rast nuk është e bazuar. Që gjendja ka ndryshuar, nuk e mohon njeri dhe kjo medoemos kështu është, se nga një incident që ngjau në këtë stërvitje, nuk mund të themi që nuk ka ndryshuar gjendja në ushtrinë tonë, por, gjithashtu, duhet thënë se në të ekzistojnë akoma koncepte të vjotra e qëndrime të palejueshme, të cilat duhet t'i luftojmë. Si të mos preokupohet oficeri për ushtarin, që ky gjatë stërvitjes të ushqehet, të jetë i veshur? Si të mos kujdeset oficeri kur ushtari sëmuret etj.? Po atëherë



çfarë bëjnë oficerët tanë? Thuhet se për ato që ndodhën në këtë stërvitje e kanë pasur fajin organet e Partisë e të pushtetit në terren, drejtoritë e organizatat e Partisë të ndërmarrjeve e të qendrave të punës. E vërtetë është që edhe këto kanë përgjegjësi, por dihet, ato kanë edhe punë të tjera. Për mua është një kënaqësi kur dëgjoj se punëtorët e kombinatit të drurit «Misto Mame», në përgjithësi, janë të disiplinuar, sepse kështu ata do të jenë medoemos edhe ushtarë të disiplinuar. Por këtë të mos e idealizojmë, se midis tyre ka edhe ndonjë të padisiplinuar. Edhe në rininë tonë, që ka punuar e punon aq mirë, qoftë në aksione të panumërta, qoftë në shkolla, në fabrika, në hekurudha e kudo, qoftë në ushtri, nuk është karakteristike mungesa e disiplinës dhe shturja. Jo, por që ka elementë negativë në rini sigurisht që ka, vetëm se këta nuk janë aq shumë sa kjo të përgjithësohet e të merret si një karakteristikë për gjithë rininë e ushtrisë. E them këtë se duhet të ndryshojmë stilin e punës sonë me njerëzit, se gjendja nuk është siç thonë disa shokë.

Kur është fjala për edukimin e rinisë, na ngrihet çështja që ata të rinj që nuk ndjekin shkollat duhet të futen në punë, se duke ndenjur rrugëve, në përgjithësi këta janë të shturur. Ose na thuhet se të shturur janë edhe ata të rinj që janë në marrëdhënie pune, por meqë i kanë prindërit në punë s'kanë shumë nevojë për rrogë, prandaj dhe nuk shkojnë në punë, bëjnë mungesa pa arsye etj. Po prindërit çfarë bëjnë? Ata vërtet mund të mos kenë nevojë për rrogën e djalit, veçse e kanë për detyrë t'i edukojnë fëmijët që këta ta duan punën dhe të jenë të disiplinuar. Kur një i ri që punon, dëshi-

ron të vejë të pijë edhe një gotë birrë ose të hajë një pastë me shokët, le të vejë, se paratë e tij shpenzon, por një i ri i këtillë nuk mund të cilësohet i shthurur. Mund të ndodhë që një i ri të mungojë në punë një herë apo edhe dy herë, por jo t'i vëmë menjëherë epitetin «i shthurur», sepse edhe të moshuarve, a nuk u qëllon të mos venë ndonjëherë në punë? Ndodh. Atëherë, pse nuk flitet edhe për ta me të njëjtën gjuhë? Duhet të jemi të drejtë në këto qëndrime, shokë, as t'i fshehim të metat e dobësitë, as të mos qëndrojmë indiferentë përpara tyre dhe të mos i pastrojmë, por jo edhe të bëhet qimja tra.

Shkollat e lira ushtarake kanë rëndësi shumë të madhe, po përgjegjësi për mbarëvajtjen e tyre kanë të tërë: edhe terreni, edhe ushtria. Se vërtet ato i ka marrë përsipër Partia, në përgjithësi, por edhe ushtria duhet t'u rrijë mbi kokë. Si Partia në terren, edhe ushtria aktive, duhet ta kenë nën drejtimin e tyre efektiv shkollën e lirë. Edhe oficerët aktivë, që e njohin mirë zanatin, të bëjnë shumë përpjekje që të gjejnë kohën dhe ta bëjnë mirë këtë punë. Ata duhet të kenë parasysh se në shkollën e lirë ka edhe oficerë rezervë që kanë qenë më parë oficerë efektivë, ka pastaj plot të tjerë që kanë bërë nga dy e nga tre vjet shërbimin e rregullt ushtarak dhe mund t'i bëjnë oficerë rezervë. Këta e njohin punën e ushtrisë, por tani merren me punë të tjera, me bujqësi, me teknikë, kanë pastaj plus edhe detyrën e ushtrisë e megjithatë bëjnë përpjekje që edhe këtë ta kryejnë.

Partia na mëson që mbrojtja është detyra kryesore mbi kryesoret dhe të gjithë janë të ndërgjegjshëm për këtë. Ka, natyrisht edhe të pandërgjegjshëm, po këta

janë pakica. Atje ku oficerët aktivë që nga komandanti i brigadës e deri tek ata të togës të ushtrisë aktive, interesohen seriozisht dhe punojnë me zell të madh edhe për shkollat e lira, puna ndryshon, gjendja në këto shkolla është e mirë. Është e qartë se duke e marrë punën mirë në dorë, oficerët vendosin atje disiplinën, punët në shkollën e lirë ecin, por edhe vetë ata rrënjosin më mirë ndjenjën e drejtimit jo vetëm në ushtrinë aktive, por edhe në këto struktura të reja.

Tani duhen marrë masa që këto çrregullime të mos na ngjasin më në ushtri dhe nga këto që na ndodhën të nxjerrim mësim.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga biseda  
e incizuar që gjendet në AQP*

## NJË STUDIM ME VLERË MBI EPOSIN E KRESHNIKËVE

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve  
të KQ të PPSH*

13 shkurt 1979

Lexova në gazetën «Drita» materialin që kishte shkruar Ismail Kadareja «Mbi eposin e kreshnikëve»<sup>1</sup> dhe m'u krijua një përshtypje shumë e mirë për këtë shkrim. Mendimi im është se ky autor është njeri i zoti jo vetëm si romancier e poet, por edhe si studiues. Edhe romanet e tij kanë rëndësi të madhe, si nga brendia, se kanë shumë mendime, por edhe nga forma dhe stili ato janë shumë tërheqëse. Shkrimi i Ismailit për eposin e kreshnikëve që, sipas mendimit tim, më duket i rëndësishëm, është një studim shkencor i mirë.

Kam folur një herë për shfrytëzimin e arkivit të Institutit të Folklorit. Ky arkiv, ku gjendet një thesar i madh, nuk duhet të mbetet i vdekur. Kadareja ka kapur një kënd të këtij thesari të madh e duhet thënë se e ka kapur bukur. Jo bukur, thjesht në të shkruar, por bukur në kuptimin e zhvillimit materialist të problemit,

---

1. Botuar në datat 4 dhe 11 shkurt 1979.

duke e konfrontuar me studimet e huaja që janë bërë pro dhe kundër epikës sonë. Në këtë drejtim, sidomos studiuesit sllavë pretendojnë ta nxjerrin eposin tonë si një huazim të eposit të tyre, të përkthyer në shqip.

Ismail Kadareja, në studimin e tij, ka vërtetuar autenticitetin e eposit tonë, të provuar edhe nga dijetarë të huaj, nga të cilët ai citon veçanërisht Lambercin<sup>1</sup>. Aty del qartë se albanologu i vjetër Maksimilian Lambergi kësaj çështjeje i ka hyrë mirë. Kadareja e nxjerr shumë pozitiv këtë autor. Zakonisht studiuesit gjermanë dhe austriakë janë interesuar shumë për çështjen shqiptare. Nga këta popuj kanë dalë shumë studiues të historisë së popujve të tjerë në përgjithësi, por edhe shumë albanologë.

Pra, Kadareja, duke u mbështetur edhe në studimet e kryera nga këta albanologë, në përmbajtjen e eposit, në të dhënat historike të dyndjeve, të prejardhjeve të popujve, në karakteristikat e njërës epos e të tjetrit në periudha kohe të caktuara, e nxjerr eposin tonë jo vetëm më të bukur, por shumë më të vjetër nga ai i sllavëve dhe i boshnjakëve.

Epika e kreshnikëve tanë ekzistonte që më përpara se të vinin sllavët në Ballkan dhe për këtë ai jep arsye shumë të forta, duke bërë krahasimin e duke nxjerrë ndryshimet midis dy eposeve. Kadareja tregon edhe për ç'arsye kënga jonë epike zonë të sajën ka ma-

---

1. Prof. dr. Maksimilian Lamberg (1882-1963), gjuhëtar austriak, një ndër albanologët e shquar që ka dhënë një kontribut të çmuar për gjuhën shqipe. Një analizë të thellë e të gjithanshme u ka bërë problemeve të ciklit shqiptar të kreshnikëve në studimin «Epika popullore shqiptare», 1953.

lësitë e thella, bjeshkët; ajo nuk u këndua te ne asnjëherë në kafene ose në xhami, siç ka ndodhur me epikën boshnjake.

Kadareja në këtë studim bën një vërtetim shkencor të lashtësisë së eposit tonë, duke bërë edhe krahasimin e brendisë së të dy eposeve. Ai me të drejtë thekson se duhet t'i futemi thellë këtij problemi, mbrojtjes së autorësisë shqiptare të eposit të kreshnikëve. Këtë, thotë Kadareja, nuk do ta bëjmë në asnjë mënyrë, as për shovinizëm shqiptaromadh, as për mendjemadhësi nacionaliste, por për të vërtetën. Ka meritat e saj, thotë ai, edhe epika e sllavëve, e boshnjakëve e, natyrisht, të dyja palët kemi huazuar nga njëri-tjetri, por që të pranojmë se epika jonë ka lindur në shekullin e 17-të, është e pamundur, thotë Kadareja. Është evident fakti, vazhdon ai, që ne kemi poemat e arbëreshëve të Italisë, të ikur që në shekullin e 15-të por që e ruajtën një pjesë të epikës sonë. Kjo tregon se ky cikël ka pasë qënë formuar qysh para këtij shekulli.

Megjithëse Ismail Kadareja edhe me veprat e tij të mëparshme e ka provuar veten si njeri me kulturë e studiues, me këtë studim e vërteton edhe më mirë një gjë të tillë. Unë nuk kam lexuar ndonjë studim të tillë nga ndonjë autor tjetër.

Neve nuk na duhen parulla e slogane nga Instituti i Folklorit, por dëshirojmë që studiuesit tanë të hyjnë thellë në librat e sidomos në «Visaret e kombit»<sup>1</sup>.

---

1. Titulli i përbashkët i një cikli botimesh në 15 vëllime, me material nga tradita folklorike e gjuhësore shqiptare, që u publikuan në vitet 1937-1944.

«Visaret e kombit», sipas mendimit tim, kanë një rëndësi të jashtëzakonshme. Vërtet janë përmbledhur e botuar para Çlirimit por ato janë si një bibliotekë me vlerë të madhe, që, po u fute brenda, humbet dhe nuk del dot, po të mos dish të orientohesh, domethënë, po të mos u futesh në esencë problemeve, por t'i shikosh këto vetëm në sipërfaqe. Kjo ndodh edhe ngaqë ky thesar i botuar nuk është i sistemuar, se është marrë e mbledhur pa kujdes në ato kohë e nuk ka një klasifikim, si me thënë, shkencor, gjë që mendoj se tani duhet bërë. Në studimin e tij Kadareja u bën një kritikë të mirë edhe disa studiuesve tanë, pa ua zënë emrin në gojë dhe kritika që u bën ai është e drejtë. Gjithashtu ai bën në të edhe vlerësime, për shembull për Çabejn<sup>1</sup>.

Në përgjithësi, ne e dimë që kemi thesare të mëdha, por duhen vënë njerëz që t'i zbulojnë. Kur e lexon këtë studim të Kadaresë, që mua më pëlqeu shumë, të hapen horizonte. Unë kam një sërë mendimesh dhe, kur të gjej rastin të takohem me Kadarenë, do t'ia them, se duhet të vazhdohet kjo punë, natyrisht nuk e kam fjalën vetëm për problemin që trajtohet në këtë studim, por edhe për probleme të tjera.

Dhe njerëz që dinë të kapin çështje e t'i trajtojnë mirë, tash kemi. Të marrim Dhimitër Shuteriqin. Unë kam lexuar shkrime e studime të këtij autori. Vërtet Dhimitri është ca më narrativ, por edhe ky është, si me thënë, erudit dhe me atë bagazh të mirë njohurish që

---

1. Eqrem Çabej (1908-1980). Figurë e shquar e shkencës, e arsimit dhe e kulturës shqiptare. Emrin e tij e mban Instituti i Lartë Pedagogjik në qytetin e Gjirokastrës.

ka, jep shumë në fushën e letërsisë e me studime të ndryshme. Prandaj duhet të dimë t'i mbështetim këta njerëz.

Dhimitër Shuteriqi është koleksionist i shumë gjërave të vjetra, me fjalë të tjera, ka horizont të gjerë kulturor dhe, natyrisht, këtë e shfrytëzon sipas mënyrës së tij. Kadareja nxjerr konkluzione të thella, të peshuara. Unë mendoj se ky studim duhet të përkthehet dhe të botohet, të bëhet një libër i vogël me kapak të mirë. Në shqip patjetër që duhet ta bëjmë kështu, por mendoj që kjo broshurë të përkthehet edhe në serbo-kroatisht, në greqisht, në gjermanisht, në italisht dhe sidomos në turqisht. Tirazhi, natyrisht, të mos jetë i madh. Botime dhe libra të tillë shkencorë nuk ka nevojë të shpërndahen kudo, por të jenë nëpër biblioteka, t'u shërbejnë punonjësve shkencorë të folklorit që merren me këto probleme. Unë jam i bindur se kushdo që do ta lexojë këtë libër, do të habitet e do të thotë: «Ç'qenka kjo epika shqiptare kështu?! Ka nxjerrë disa krijime të çuditshme ky popull!»

Kadareja përmend në këtë shkrim edhe «Chanson de Roland» dhe «Nibelungët». Unë e di mirë, se e kam lexuar të tërë «Këngën e Rolandit», kur e kemi bërë në shkollë dhe e shoh se Ismail Kadareja e përcakton drejt. «Kënga e Rolandit» është një epike epike, që i përket një periudhe të caktuar. Në të flitet se si Karli i Madh shkoi të luftonte kundër maurëve në Spanjë e po kthehej fitimtar. Kur praparoja e tij, me Rolandin në krye, në luginën e Ronsëvalit rrethohet nga maurët, ai i ra bririt, por që tepër vonë dhe Rolandi ra heroikisht në fushën e betejës. Kur kthehet Karli, e gjen të vde-



kur me një gur në dorë. Pra, siç shihet, kjo këngë flet për një ngjarje të shkëputur.

Në Francë ka edhe këngë të tjera që i përkasin eposit heroik, siç është kënga «Tristani dhe Izolda» etj., etj., të cilat, po t'i marrësh të shkëputura, duken sikur nuk kanë lidhje, por, siç shprehet Kadareja me një figurë të bukur, ato kanë ndikime reciproke dhe kanë zënë njëra-tjetrën si borërat në bjeshkë. Pra, bien borërat dhe mbulojnë njëra-tjetrën, megjithatë midis dëborës mbin lulja, thotë ai. Edhe «Kënga e Rolandit», edhe «Kënga e Nibelungëve», edhe të tjerat, vërtet janë të një epoke, por, po të mos u futesh thellë, nuk e dallon dot vazhdimësinë për të cilën flet Kadareja. «Kënga e Nibelungëve» është një histori e gjatë, histori dashurie, histori e trimave të mëdhenj. Bile Vagneri<sup>1</sup>, i frymëzuar nga këto epose, kompozoi operën «Tristani e Izolda». Pra, Kadareja tregon edhe vazhdimësinë, edhe shkëputjen që kanë ato nga njëra-tjetra, shkëputje që e kanë diktuar rrethanat, por që s'e ka humbur kurrë lidhjen, vazhdimësinë që kanë.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga biseda  
e incizuar që gjendet në AQP*

---

1. Rikard Vagner (1813-1883), kompozitor gjerman, i frymëzuar në krijimtarinë e tij nga legjendat kombëtare gjermane.

# PROPAGANDA DHE PUNA E PARTISË TË NXITIN NJERËZIT, TË VRASIN MENDJEN E TË JENË KRIJUES NË PUNË

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve  
të KQ të PPSH*

14 shkurt 1979

Në materialin e përgatitur për zbatimin e udhëzimit të Byrosë Politike «Mbi ndërtimin e Partisë në ushtri dhe mbi lidhjet e organizatës së Partisë në ushtri me atë të terrenit» thuhet që «rezervistët komunistë të marrin pjesë në mbledhjet e organizatave-bazë të Partisë në ushtri jo vetëm gjatë kohës kur venë në stërvitje, por edhe jashtë saj, kur dalin probleme të veçanta që i ngre Qeveria, Komiteti Qendror, apo Komanda e Përgjithshme». Mirëpo, në qoftë se do të veprohet kështu, ata do të mbeten nëpër mbledhje. Mua më duket se kjo praktikë nuk është e rekomandueshme dhe materiali i përgatitur nuk i vë fre si duhet kësaj. Në këtë material nuk përcaktohet qartë që të bëhen mbledhje më pak. Baza e ushtrisë mund të kërkojë të bëhen më shumë mbledhje, po, kur nuk kryhen detyrat,

siç ka ndodhur në disa raste, kur stërvitjet nuk janë realizuar qind për qind, këto janë mbledhje për mbledhje, pra janë formale.

Baza të gjykojë mirë se çfarë urdhrash të ministrisë duhet të punojë ajo me gjithë komunistët. Kuptohet, nuk do të organizohen mbledhje në të gjitha rastet, se Komanda mund të lëshojë urdhra për të marrë dje-ni vetëm një rang oficerësh, pra urdhri mund të jetë i tillë që s'është aspak nevoja të mblidhen të gjithë komunistët. Ka pastaj urdhra që kanë karakter operativ. Komanda, për shembull, mund të lëshojë një urdhër të rëndësishëm, ta zëmë, për prapavijat, duke vënë në dukje se këto janë në një gjendje organizative jo të mirë, se ana financiare e tyre është e dobët etj. A duhet të mblidhen për këtë çështje edhe komunistët e terrenit ose ata të ndërlihdjes? Mendoj që kjo është e tepërt, se në një rast të tillë vetëm sa ngarkohen njerëzit me më shumë mbledhje. Prandaj, këto mbledhje t'i evitojmë dhe të punojmë që ta bëjmë sa më të fortë organizatën-bazë, që kjo të diskutojë për problemet më të rëndësishme që ndihmojnë për të forcuar kompaktësinë e saj ose të efektivit. Pra, çështja duhet parë konkretisht që të mos bëhen shumë mbledhje.

Masat për zbatimin e udhëzimit të Byrosë Politike, për të cilat po diskutojmë, mua më duket se, në përgjithësi, kanë qenë të drejta. Ajo që më shqetëson është se vendimet që merren në disa raste nuk zbatohen si duhet, as nga ushtria aktive, as nga terreni. Ka një varg çështjesh në mbledhjet e organizatave-bazë të terrenit që, kur shqyrtohen, duhet nënvizuar fakti që kanë lidhje edhe me ushtrinë. Për shembull, kur diskutohet

për administrimin e fondit të grurit në një kooperativë, duhet theksuar që komunistët të bëhen të ndërgjegjshëm për të ruajtur edhe kokrrën e vetme të grurit, se kjo çështje është e lidhur edhe me rezervat ushtarake për nevojat e kohës së luftës, pra me problemin e madh të mbrojtjes së vendit. Me çfarë do të ushqohet populli në kohën e luftës, po nuk vumë që tani rezerva, po nuk kursyem etj., etj.? Gjithashtu kur flitet për disiplinën në brigadën e ndonjë kooperative bujqësore, që nuk punon mirë, t'u theksohet anëtarëve të saj se është e domosdoshme të punojnë në mënyrë të organizuar dhe t'u shtrohet pyetja: Në qoftë se vazhdojnë të punojnë të shturur e secili të vejë në punë kur t'i dojë qejfi, po në kohën e luftës si do të bëjnë? Ja, në këto raste dhe në sa e në sa të tjera si këto, t'u futet punonjësve edukata e disiplinës, e dashurisë për punën dhe e shqetësimit për mbrojtjen. Për të tilla tema i duhet tërhequr vëmendja Partisë në terren, sepse kështu bëhet pleksja e edukatës së terrenit me edukatën ushtarake, bëhet, si i thonë, integrimi i tyre. Ç'domethënë integrim? Kjo do të thotë pleksja, ndërthurja e punës politiko-luftarake të ushtrisë e të terrenit, që njerëzit të përgatiten sa më mirë për mbrojtjen e atdheut. Po të zbatohet programi për këtë qëllim, do të shmangen mbledhjet e tepërta.

Nuk e di, po mendoj se kërkesat e bazës duhen parë më me kujdes dhe të mos thuhet thjesht: «Këtë gjë e kërkon baza». Mirë e kërkon kjo, po për ç'arsye e kërkon? Vallë këto propozime që vijnë nga baza, mos lindin nga prirja që komitetet e Partisë të shkarkohen nga përgjegjësitë? E them këtë se ka raste që organiza-

tës-bazë të Partisë në ushtri nuk i vihet rëndësia e duhur. Por kjo është e rrezikshme, sepse kështu me disa masa të marra sot, me disa të tjera të marra nesër, mund të shkohet drejt mënjanimit javash-javash të udhëheqjes së Partisë në njësitë dhe të lihet që çdo punë ta marrë në dorë komandanti.

Fjalën e kam që këto gjëra të mos bëhen në mënyrë dogmatike dhe automate, pa u thelluar shumë në problemet. Ku duhet thelluar? Mendoj se duhet thelluar në çështjet konkrete të punës, në organizimin dhe në ndarjen e punës në mes ushtrisë aktive dhe rezervës, ç'i përket njëres dhe ç'i përket tjetrës. Kur njësia nuk është në stërvitje, organizata e Partisë në ushtrinë aktive ka funksionet e saj dhe organizata e terrenit vazhdon punën e vet. Organizata e ushtarakëve aktivë, domethënë e repartit, mund të bëjë mbledhje të veçanta të organizatës-bazë, se ushtria ka problemet e saj, atje mund të venë urdhra nga komandanti, nga ministria etj. Po si duhet ta bëjë ushtria aktive detyrën ushtarake në terren, se kjo është kryesorja që duhet ta integrojë terrenin në çështjet e ushtrisë? Ushtria aktive është bërthama, po ajo është vetëm një pjesë e ushtrisë, kuadrot aktivë japin mësim nëpër shkolla, në akademi e në të tjera organc. Prandaj për integrimin ka shumë terren për të punuar.

Kjo nuk do të thotë që komunistët e terrenit të marrin pjesë të tërë në mbledhjet e organizatës-bazë të ushtrisë aktive. Në komitetin e Partisë të njësisë, për shembull, ne mund të kemi një sekretar të komitetit të Partisë të rrethit që të ketë kujdes për ushtrinë. Unë e dëgjova dhe më mbeti në vesh kritika që dikush i bëri

sekretarit të parë të një rrethi. Ky, nënvizoi diskutanti, interesohet për punët e ushtrisë, kurse për sektorët e tjerë nuk interesohet. Mirëpo mund të ndodhë edhe ndryshe, që ndonjëri të interesohet për të gjitha dhe të mos interesohet aspak për problemet e ushtrisë. Që të dy rastet janë për t'u kritikuar. Prandaj ne duhet t'i zgjedhim me kujdes këta shokë dhe t'i përgatitim mirë si kuadro drejtues politikë në ushtri. Në përgjithësi, këta të tillë janë, megjithatë duhet pasur më shumë kujdes që të zgjidhen elementë akoma edhe më të përshtatshëm.

Prandaj dy gjëra, mendoj, të kemi mirë parasysh:

Së pari, që mbledhje të shumta nuk duhen lejuar, po të integrohet mirë puna e Partisë terren-ushtri, të mos jetë e ndarë si me thikë kjo punë. Edhe njëri edhe tjetri ta kryejnë detyrën si duhet dhe, pa e kaluar numrin e mbledhjeve që janë parashikuar, duke përcaktuar mirë format, mënyrën, stillin e punës.

Së dyti, të ruhem nga njëfarë tendence e nënvlerësimit të rolit të Partisë në ushtri. Organizatën e Partisë në ushtri ta kemi të fortë dhe të punohet mirë që drejtuesit e saj të ngrihen në nivelin e duhur. Ne kemi thënë (dhe kjo është shumë e drejtë) që instruktorët e aparatit të Komiteti Qendror të Partisë të kryejnë akademinë ushtarake, por mendoj që më parë nga çdo gjë tjetër ata të mbarojnë Shkollën e Partisë, të jenë komunistë të fortë, pse është e pamundur që të mos u futen çështjeve ushtarake, në qoftë se do ta bëjnë mirë punën e Partisë. Ne kemi qenë fare pa shkollë partie, kemi qenë edhe pa shkollë ushtarake, megjithatë e bëme luftën. Natyrisht, jemi dakord të gjithë, se ajo që

bëmë ne ishte një luftë tjetër, kurse tash duhet të bëjmë përpjekje që t'i adaptohemi një luftë më moderne dhe shumë më të egër se Lufta e Dytë Botërore. Kjo nuk do të thotë që po mbarove akademinë, të flesh mendjen, por duhet të përpiqesh të kryesh detyrën si komunist e si kuadër dhe t'i njohësh mirë detyrat.

Edhe nga ana e Komandës së Përgjithshme duhet të kërkohet që kuadrot kryesorë të ushtrisë të mbarojnë Shkollën e Partisë për filozofi. Shumica e tyre kanë nevojë edhe për një përvetësim më të mirë të marksizëm-leninizmit dhe kjo nevojë duhet plotësuar. Të mos mendohet se ai që është ushtarak s'ka ç'i duhet ta njohë aq thellë marksizëm-leninizmin. Jo, nuk duhet të mbetemi në pikëpamjet e vjetra, të cilat, siç e shohim, herë pas here, na dalin përpara, gjë që tregon se ka edhe kuadro që nuk janë të edukuar në nivelin e duhur, si politikisht, edhe ideologjikisht. Një komandant që është ushtarak me eksperiencë, s'vlen në rast se ai nuk i kupton çështjet ideologjikisht dhe politikisht në rrugën e Partisë. Nuk je ushtarak i zoti, qoftë edhe pse mund të jesh trim (dhe kjo nuk ekskludohet te njerëzit tanë), po të mos jesh i përgatitur mirë ideologjikisht, ashtu sikurse komisar i apo sekretari i komitetit të Partisë të njësisë s'është kuadër i zoti ushtarak, në qoftë se nuk i njeh thellë problemet ushtarake, pavarësisht se mund të jetë edhe trim si komandanti.

Në qoftë se komandanti mendon se është i përgatitur në fushën ushtarake dhe s'ka pse të thellohet në studimin e marksizëm-leninizmit, t'i themi atij se komisar i apo sekretari i komitetit të Partisë të njësisë është edhe më i përgatitur se ti, sepse edhe ata, si të

gjithë, i bën të fortë, në radhë të parë, ideologjia dhe politika e Partisë, ajo u ngjall patriotizmin, nxit mendimin si duhet të zhvillohen taktikat e Artit tonë Usharak të Luftës Popullore në terren. Armiqtë tanë i kanë të sofistikuara armatimet e pajisjet, i dërgojnë trupat ose avionët valë-valë. Mirëpo, kur je i ndërgjegjshëm, bëhesh i qëndrueshëm dhe i përballon vështirësitë, sado të mëdha që të jenë këto dhe pastaj hidhesh në kundërsulm dhe fiton. Këto gjëra të kuptohen mirë.

Duhet ngulur këmbë shumë në këtë drejtim, duhet qëndruar mirë në këto gjëra. Sa më shumë të thellohen kuadrot tanë në studimin e marksizëm-leninizmit dhe në librat ushtarakë, aq më tepër do të bëhen ata të ndërgjegjshëm se nuk duhet mbivlerësuar armiku, se nuk duhet bërë pesimist, por në ta ai mëson që as në eufori të mos bjerë. Në luftë njeriu është faktori kryesor mbi kryesorët, pavarësisht se sot ka armë të tmerrshme. Duhet të dimë t'u rezistojmë armiqtë me trimëri të madhe. Me teorinë marksiste-leniniste, me strategjinë dhe me Artin Usharak të Luftës Popullore, duke e përvetësuar mirë këtë në kushtet e terrenit tonë, armiqtë, cilëndo qofshin këta, mund t'u bëjmë ballë me sukses.

*Pastaj biseda kaloi në problemet e revolucionit 'ekniko-shkencor. Paçi dëgjoi shokët sekretarë të Komitetit Qendror, duke marrë fjalën, shoku Enver Hoxha tha:*

Lexova sot një artikull<sup>1</sup> të botuar në «Zërin e popullit», ku arrihej në konkluzionin se ndërmarrjet du-

---

1. Është fjala për artikullin me titull «Një gabim që s'u korrigjua në gazetë».



het të shpejtohen për realizimin e detyrave në fushën e revolucionit tekniko-shkencor. Vallë është e mjaftueshme të thuhet vetëm kaq? Fakti që një detyrë, e cila është gjykuar të realizohet në dy vjet dhe, siç thuhet në artikull, kryhet një vit përpara afatit nuk i tërheq njeriu vëmendjen? Pikërisht këtu, mendoj unë, duhej të ndalej autori i artikullit dhe të vinte pyetjen: Po çfarë afati paska qenë ky? Po ta shtronte kështu çështjen, do të nxirrte konkluzionin se caktimi i afatit është bërë gabim që në fillim, përderisa realizimi i studimit është bërë një apo dy vjet para afatit të parashikuar. Kjo do të thotë se në ndërmarrjet dhe në dikasteret që përmenden në artikull, për përgatitjen dhe për miratimin e programeve të punës shkencore s'janë bërë llogari, por vetëm llafe. Ne s'ka shumë kohë që e shqyrtoam hollësisht problemin e thellimit të revolucionit tekniko-shkencor dhe diskutimi masiv i tij, siç del edhe në artikull, sa ka mbaruar, kurse një varg ndërmarrjesh i paskan realizuar detyrat me kohë. Si qenkan realizuar këto kaq shpejt, kaq përpara? Këtu, pra, duhej të ndalej mirë artikullshkruesi dhe të kritikonte fort, se në këtë drejtim ka shumë vend për kritikë, kurse ai numëron në shkrimin e tij rezultatet pozitive.

Unë e kam thënë që, kur janë bërë planet e studimeve, mund të jenë propozuar dhe planifikuar edhe studime, të cilat kanë qenë kryer me kohë, por që autori, për të bërë bujë, nxjerr sikur i ka realizuar tani! Po çfarë ka realizuar? Derisa këto kanë qenë përfunduar dhe nuk janë vënë në shfrytëzim, do të thotë që s'kanë hyrë në punë. Natyrisht, ne nuk e mohojmë faktin që në këtë drejtim bëhen përpjekje, por ama nuk është e

drejtë dhe nuk duhet të lejojmë të ndodhin raste të tilla që, për një studim, i cili duhet të mbarohet brenda gjashtë muajve, vihet me qëllim afati për dy vjet dhe tjetri pas një viti ta realizojë që t'i thonë: «Bravo të qoftë!». A, jo, kështu nuk vetel Kjo nuk është e drejtë.

Duhet ushtruar një kontroll i rreptë në hartimin e planeve studimore, të cilat të rishikohen vazhdimisht. Nuk them që të prishen tash planet e aprovuara, por të forcohet kontrolli në këtë drejtim. Dhe jo vetëm kaq, por një autori të tillë, që planifikon afate të gjata, vetëm e vetëm që të duket sikur e ka mbaruar studimin para kohe, t'i kërkohet llogari rreptë edhe për qëllimin e studimit, për vlerën e tij praktike. Studimet nuk bëhen për t'u lexuar nëpër konferencat e organizuara për zhvillimin e revolucionit tekniko-shkencor, por për t'u vënë në zbatim, prandaj për këtë qëllim duhen marrë të gjitha masat nga ndërmarrjet, nga ministria dhe, kur është e nevojshme, edhe nga Qeveria.

Çdo temë ose studim duhet vënë në zbatim përnjëherë, me t'u mbaruar, që në mbledhjet e në konferencat që do të bëhen të thuhet jo vetëm se studimi i caktuar mbaroi në kohë, por të raportohet që edhe u vu në zbatim. Bile të thuhet se disa nga këto studime ishin të përgatitura me kohë, prandaj përfunduan shpejt e jo pse u bënë përpjekje më të mëdha tani. Përpjekje të mëdha janë bërë që në fillim, kur i është hyrë punës, kurse tani nuk janë bërë sa duhet, është ecur me ngadalë. Pra, këto probleme duhen kuptuar mirë.

Pse i bëjmë ne gjithë këto studime? Natyrisht, për t'i vënë në zbatim, ndryshe bëjmë konferenca për konferenca, mbledhje për mbledhje dhe lëmë mënjanë ato

që thotë Hysniu [Kapo], lëmë të voglat, por që janë pikërisht ato që na japin bukën e përditshme.

Merren specialistë nga një ndërmarrje, merren edhe ca nga një tjetër dhe thuhet se nga një gjë e tillë s'prishet puna, detyrat kryhen edhe pa ata. Por pa ta kontrollojmë më mirë këtë çështje, bëhet apo nuk bëhet puna në këto ndërmarrje pa ata? Në qoftë se bëhet, atëherë t'u kërkojmë llogari ndërmarrjeve kur detyrat nuk realizohen, domethënë të kërkojmë që revolucioni tekniko-shkencor të vazhdojë të zhvillohet në shkallë ndërmarrjeje. Ndryshe duhet pritur sa të mbarohen këto studime, që nuk bëhen sa për të thënë që i bëmë, sa për të dhënë në mbledhje një raport formal, ku vetëm të flitet për rëndësinë e problemit, por për t'u vënë menjëherë në zbatim. Prandaj ato duhen mbaruar shpejt dhe jo vetëm kaq, por të shikohet se mos ka edhe rezervë, domethënë të vihet pyetja: Unë e kam bërë këtë studim, po e kam mbaruar vallë gjithë atë që duhet të bëja?

Pra, të ndalemi më mirë në këtë çështje! Tjetrin që është specialist e kemi shkëputur nga puna dhe e kemi caktuar në grupin e punës për revolucionin tekniko-shkencor. Por të kemi parasysh se këta janë 1 200 veta të angazhuar e të lidhur fort me këtë punë. Mirëpo, kur treçereku i punës së një studimi është kryer me kohë, ky ka mundësi të mbarohet edhe duke qenë specialisti në ndërmarrje, pra, pa u shkëputur nga puna. Në një rast të tillë, fjala vjen, mund të duheshin akoma vetëm tre muaj kohë që studimi të përfundonte, ndërsa për përfundimin e tij është caktuar pa asnjë arsye një afat prej dy vjetësh. Pse? Se aq kohë ka kërkuar autori.

Kjo s'është e drejtë, prandaj këto gjëra duhen parë me kujdes.

*Më poshtë, pasi shoku Prokop Murra informon për zhvillimin e një seminari për propagandën e prodhimit, e merr fjalën*

**SHOKU ENVER HOXHA:** Për një organizim sa më të mirë të propagandës së prodhimit në industrinë e tekstileve, për shembull, mendoj se duhet të shfaqin pikëpamjet e tyre edhe specialistët e teknikët me përvojë të Kombinatit të Tekstileve të Beratit, të Kombinatit të Trikotazheve të Korçës e të Fabrikës së Pëlhurave të Shkodrës. Sekretarët e komiteteve të Partisë mund të shkojnë në një seminar të tillë, por për problemin e propagandës së prodhimit konkretisht e në radhë të parë, ndihmojnë diskutimet e inxhinierëve dhe të teknikëve të prodhimit. Qëllimi është që të mos bëjmë mbledhje e takime pa bukë, sidomos kur është fjala për mbledhje të disa qendrave pune. Në Kombinatin e Autotraktorëve mund të mblidhen ca punonjës nga uzina mekanike e këtij kombinati, disa mund të vijnë nga një uzinë tjetër mekanike, ku e dimë që ka dobësi në drejtim të planit dhe me këta të diskutohet për propagandën e prodhimit. Mirëpo kush do ta bëjë propagandën e prodhimit, ta zëmë, në Kombinatin e Trikotazheve në Korçë? Kush do ta zbatojë përvojën e mirë, për shembull, të kombinatit të tekstileve «Stalin»? Këtë punë, mendoj unë, do ta bënte mirë inxhinierja e kombinatit të trikotazheve, që i kupton mirë nga ana profesionale problemet që kanë të bëjnë me prodhimin e tekstileve dhe jo sekretari i komitetit të Partisë ose ndonjë tjetër që nuk është specialist tekstilësh.

Çështja e propagandës së prodhimit, më duket mua, nuk është konceptuar mirë, përderisa edhe në seminarin e organizuar për këtë qëllim nuk marrin pjesë, pikërisht, ata që do ta organizojnë dhe do ta zhvillojnë konkretisht këtë propagandë në qendrat e prodhimit.

Vërtet në seminar demonstrohen të mirat dhe të këqijat e punës së pjesëmarrësve të ndërmarrjeve, por këto duhet t'i shikojnë ata të ndërmarrjeve simotra, me qëllim që përvojën e mirë ta zbatojnë në fabrikat e repartet e tyre.

**SHOKU PROKOP MURRA:** Sekretarëve të komiteteve të Partisë, shoku Enver, u dhamë porosi që në këtë frymë, në këto forma, siç na e demonstruan neve punën atje në kombinat, ashtu ta organizojnë edhe ata propagandën e prodhimit në rrethet e tyre.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Në këtë mënyrë, më duket, nxitet kulti i personit në një formë tjetër, kulti i sekretarit të parë ose i sekretarit të komitetit të Partisë të rrethit. Po ç'ka të bëjë sekretari i parë i komitetit të Partisë të rrethit me procesin e prodhimit, me mënyrën e prodhimit të kadifesë, që nga 80 për qind që këputet filli tash të zbresë në 50 për qind? Të kuptohemi, ky e trajton politikisht një gjë të tillë, por nga ana teknike fjalën e ka drejtori, e ka kryeinxhinieri i kombinatit të tekstileve dhe jo, për shembull, kryetari i komitetit ekzekutiv të rrethit. Unë mendoj se seminarret do të kenë më shumë rezultate dhe kërkesa e llogarisë do të bëhet si duhet, në qoftë se në to marrin pjesë pikërisht ata që do ta bëjnë punën.

Në mbledhje të tilla me rëndësi, pa dyshim, duhet të marrë pjesë edhe ndonjë shok nga ministria, ai që

merret në ministri me tekstilet në mënyrë të veçantë, por mundet edhe vetë ministri. Ma merr mendja se pas mbarimit të seminarit shokët e ministrisë mendojnë se s'kanë asnjë detyrë, pse atje qenë sekretarët e komiteve të Partisë të rretheve, dhe këta duhet t'i ndjekin punët. Mund të mos u shkojë në mendje drejtuesve të ministrisë që ta ndjekin këtë punë dhe të dinë të të thonë që të paktën në Korçë, ku prodhohen tekstile ose në Shkodër, në datën kaq u bë një mbledhje e posaçme për propagandën e prodhimit ku foli filan sekretar partie rrethi, i cili kishte marrë pjesë në mbledhjen apo seminarin që u bë për këtë problem në Tiranë. Sekretari i komitetit të Partisë duhet të shkojë atje, të shpjegojë ato që dëgjoi e pa në seminarin e Tiranës, duke vënë në dukje edhe gabimet që janë vërtetuar në atë ndërmarrje dhe pastaj drejtuesit, specialistët, teknikët të nxjerrin konkluzione e detyra për punën e tyre. Kështu duhej të vepronin. Ta vëmë në rrugë të drejtë stilin dhe metodën e punës. Këtë çështje vazhdimisht e kemi theksuar dhe po e theksojmë, se ka rëndësi të madhe në veprimtarinë e përditshme.

Punët midis ndërmarrjeve janë të lidhura. Prandaj me shokët kryesorë të këtyre gjashtë ndërmarrjeve, që morën pjesë në seminar, mund të bëhej mbledhje ku të nxirreshin konkluzione për një aktivizim më të mirë në të ardhmen për çështjet e propagandës së prodhimit. Një fabrike i duhen makineri, një ndërmarrjeje i duhet çeliku, një reparti diçka tjetër. Atëherë, në të gjashtë ndërmarrjet na dolën këto çështje, mendon sekretari i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit të Tiranës, që ka mbajtur shënime për këto, pa t'u mbledhemi

së toku me drejtuesit kryesorë të këtyre ndërmarrjeve e të bisedojmë për ato probleme që na dolën atje, që të dimë ta organizojmë e ta zhvillojmë si duhet propagandën e prodhimit! Ç'do të thotë të bësh propagandë për prodhimin?

Së pari, do të thotë të bësh të njohur në masat e gjerë të punonjësve anët e mira, por edhe anët e dobëta të veprimtarisë në punë të një kolektivi.

Së dyti, të shpjegosh e të argumentosh politikisht, duke vënë theksin në përvojën pozitive, se si reflektohet kjo përvojë në realizimin e planit, në prodhimin e mallrave me cilësi të lartë.

Në propagandën tonë të prodhimit nuk ka nevojë vetëm për reklamë, siç bëjnë drejtuesit e ndërmarrjeve në vendet kapitaliste, pra, të mos kuptohet ngushtë ky problem e të mjaftohemi vetëm me agjitacionin figurativ, i cili, pa dyshim, luan edhe ky një rol të rëndësishëm. Por, në mënyrë të veçantë, propaganda jonë duhet të nxitë njerëzit, të vrasin mendjen e të jenë krijues në punë, për të gjetur rrugët konkrete për rritjen e rendimentit, duke vënë në jetë përvojën e mirë të ndërmarrjeve simotra, duke siguruar një disiplinë të fortë në punë etj., etj. Pra, në këtë propagandë vend të rëndësishëm të zërë propagandimi i aksioneve të mira, i punës së mirë që është bërë, si rezultat i zbatimit të disiplinës shkencore, të disiplinës proletare, që siguron rendiment të lartë, kosto të ulët të prodhimit e të të gjithë treguesve të tjerë ekonomikë. Kjo është propaganda e prodhimit në vija të përgjithshme, e cila duhet të konkretizohet sipas kushteve të secilës ndërmarrje, fabrike apo reparti.

*SHOKU PROKOP MURRA:* Në seminar trajtuam edhe problemin e mungesave në punë, shoku Enver.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Edhe problemi i mungesave, edhe çështja e rendimentit, e kursimeve etj. duhen trajtuar e diskutuar në mbledhje të përbashkëta jo me shumë veta. Në të tilla mbledhje sekretari i komitetit të Partisë bën konkluzionet, duke vënë në dukje që nga sa u diskutua dhe nga shkëmbimi i përvojës që u bë në këtë takim të nxirren mësim, që të eliminohen të metat dhe veçanërisht të gjenden mënyra e rrugë të efektshme të përhapjes së përvojës së mirë.

Nga ana e organeve të pushtetit, ashtu si dhe nga ana e Partisë, të merren masa, veçanërisht për vënien në rrugë të drejtë të asaj që u tha këtu lidhur me administratën. Edhe sot, por edhe herë tjetër kam dëgjuar që administrata, në disa raste, me punën e saj burokratike, i pengon punëtorët të realizojnë detyrat. Ja, në fakt, del që administrata pengon për arritjen e rendimenteve të larta nga punëtorët e ndërresës së parë, në ato raste kur ajo kërkon t'i kryejë punët vetëm në zyrë dhe vetëm brenda tetorëshit. Në fakt, ndërresa e parë duhet të jetë më e gjallë dhe të sigurojë rregullisht rendiment të lartë në punë, pasi në mëngjes punëtorët vijnë nga shtëpia plot energji e zell të madh për të kryer detyrën sa më mirë, si individë dhe si kolektiv. Por, duhet luftuar që edhe administratat të vihen në pozita të mira pune që të mos ndikojnë për keq në disiplinën e punëtorëve dhe për pasojë edhe në realizimin e detyrave të planit.

Këto probleme ne po i bisedojmë shpeshherë, i diskutojmë në seminare dhe në aktive, megjithatë, fakt



është se drejtuesit e ekonomisë akoma nuk po i kuptojnë politikisht këto. Ja, sa herë e kemi shtruar në problemin e disiplinës shtetërore? Prandaj, tash duhet ndalur e të vihet para përgjegjësisë ai që vepron në kundërshtim me orientimet e dhëna nga Partia për këtë problem. Si ta thërresë përgjegjësi i administratës së ndërmarrjes gjatë kohës së punës në zyrë punëtorin? E di ç'do të thotë ta heqësh punëtorin nga tezgjahu qoftë edhe gjysmë ore apo një orë të tërë? Pastaj një orë tjetër ai e kalon duke pirë cigare, dhe kështu nga tetë orë, në fakt punon vetëm gjashtë orë. Duhet lejuar nga Partia një shkëlqe e tillë e disiplinës në punë? Sigurisht që jo. U duhet thënë qartë dhe në mënyrë të prerë punonjësve të administratës të çdo ndërmarrjeje se Partia vazhdimisht ka vënë në dukje që punëtori nuk duhet të lëvizë në asnjë mënyrë sipas qejfit nga tornoja, nga tezgjahu, nga makineria. Në qoftë se keni për t'i thënë gjë iks apo ipsilon punëtori, atëherë vetëm sa ta lajmëroni atje ku punon që të rrijë gjysmë ore më vonë pas mbarimit të ndërresës se do të bisedoni me të. Askush nuk duhet t'i heqë punëtorët nga puna. Ta kenë të qartë këtë të gjithë përgjegjësit e reparteve apo edhe drejtori i fabrikës qoftë. Në asnjë mënyrë të mos veprohet ndryshe, por të respektohet disiplina në punë.

*Botuar për herë të parë, me shkurtime, në librin: Enver Hoxha, «Për Partinë» (Përmbledhje vep-rash), vëll. 3, f. 444*

*Botohet i plotë sipas tekstit të nxjerrë nga biseda e incizuar që gjendet në AQP*

# PËR ÇDO VEPRIM, BAZË JANË PARIMET THEMELORE TË MARKSIZËM-LENINIZMIT

Shënime

15 shkurt 1979

Shoku Ramiz më foli për bisedën që kishte bërë mbrëmë gjatë darkës, me kryetarin e Partisë Komuniste të Kanadasë (marksiste-leniniste), Hardial Beins.

Shokët kanadezë i thanë Ramizit se nga fundi i marsit do të mbajnë konferencën e partisë së tyre dhe, me këtë rast, kanë ftuar të marrin pjesë edhe përfaqësues të partive të tjera komuniste marksiste-leniniste. Kur Ramizi e falënderoi për ftesën që na kanë dërguar dhe se ne kemi menduar të dërgojmë një delegacion për të marrë pjesë në këto manifestime, Beinsi u gëzua shumë. Pastaj ai ka thënë se mendojnë që në manifestimet e konferencës të mos ftojnë ato parti që mbajnë qëndrim pro Maos, të cilave u kanë pasë dërguar ftesë, por do t'ua tërheqin.

Situata në disa vende, si në Iran, Indi etj. është revolucionare, por duhet pasur parasysh se kushtet ndryshojnë sa nga njëri vend në tjetrin.

Së pari, në Iran ka ekzistuar monarkia feudale me një organizim fashist shtypës, plotësisht mesjetar. Im-

perializmi amerikan dhe ai anglez kishin futur atje duart deri në bërryl dhe e mbështetnin fuqimisht regjimin gjakatar, monarkinë feudale fashiste të shahut. Nën sundimin e monarkisë së Pahlevëve në Iran, nga njëra anë ishin feudalët e latifondistët e mëdhenj, grabitës të pangopur të djersës së popullit, nga ana tjetër populli i varfër, fshatarësia dhe klasa punëtore, që vuajnin nën shtypjen e shfrytëzimit të madh të tiranisë së shahut dhe të imperialistëve të huaj.

Së dyti, Irani është një vend i vogël në krahasim me Indinë që ka një popullsi prej rreth 640 milionë njerëz.

Së treti, ndarja administrative në Indi është ndryshe nga ajo në Iran. Pushteti atje nuk është i centralizuar si në Iran. Pushteti i maharaxhave thuajse është likuiduar. Jo se këta janë zhdukur, ose nuk janë të fuqishëm, por nuk e kanë më fuqinë e mëparshme politike, ekonomike dhe ushtarake. Centralizimi i pushtetit në Indi bëri të mundur lindjen e një republike demokratike borgjeze të sunduar nga borgjezia e madhe, e cila kishte infiltruar në pushtet. Atje që bërë «revolucionin» gandist, por ky ishte një revolucion pa dhunë, pasiv. Fjala e Gandit dëgjohej në Indi, po imperializmin britanik ai e kundërshtonte vetëm duke bojkotuar mallrat angleze. Kur Gandhi i thoshte dikujt: «futu në burg», ai shkonte vetë. Natyrisht, në Indi nuk munguan edhe përleshje, siç ishin, për shembull, ato që ndodhën kur vajti nënmbreti i fundit i Anglisë, lordi Mauntbetën.

Kështu, kur Anglia vendosi t'i jepte «liri» Indisë, atje u krijuan shtete me kompetenca të gjera për shumë probleme, por të gjitha këto shtete qenë të lidhura

me qeverinë qendrore indiane. Si dhe çfarë lidhesh organizative ekzistojnë midis tyre, nuk e di, por fakt është që atje ekzistojnë shtete të veçanta, që kanë njëfarë autonomie. Por edhe në të gjitha këto shtete, që e përbëjnë Indinë, gjendja nuk është e njëjtë. Një shtet indian mund të ketë 30-40 milionë njerëz, pra aq sa ka gjithë Irani. Këto shtete kanë karakteristika të veçanta, ndryshojnë nga njëri-tjetri nga relievi, nga zhvillimi i bujqësisë, i tregtisë, i industrisë etj. Për arsye të zhvillimit të industrisë e të minierave, për shkak të baseneve minerare që ekzistojnë, bile të një industrie të rëndë me shumë degë, si industria minerare e metalurgjisë, bile edhe industrisë atomike etj., atje ka një borgjezi të zhvilluar dhe një klasë punëtore të madhe, jo të përqendruar në një degë të vetme të industrisë, në atë të nxjerrjes dhe të përpunimit të naftës si në Iran, pavarësisht se edhe këtu ekzistojnë disa ndërmarrje të tjera industriale. Në Indi ka edhe shtete ku predominon bujqësia.

Si rrjedhim, pjesa dërrmuese e popullsisë indiane përbëhet nga fshatarësia. Ata fshatarë dhe punëtorë, që jetojnë në një mjerim të tmerrshëm, në Indi quhen paria, njerëz jashtë kastave, të përjashtuar nga shoqëria, të dënuar të bëjnë vetëm punët më të vështira, aq sa të pasurit i quajnë ata «të paprekshëm», gjoja për shkak se «nuk lahen kurrë», gjë që do të thotë: mos i zini as me dorë, se janë të ndyrë.

Të tilla janë kushtet në këto vende. Prandaj mendoj se në Indi situata është e ndryshme nga ajo në Iran. Këtu, shahu, jo vetëm komunistët, por edhe elementët përparimtarë, deri Ajatollah Khomeini, i kishte

persekutuar e burgosur. Kushedi pastaj sa të tillë kish-te vrrarë.

E rëndësishme është që marksizëm-leninizmi, teoria jonë universale, të zbatohet në përshtatje me kushtet ekzistuese. Forca e partisë komuniste qëndron në atë që, duke i njohur mirë parimet e marksizëm-leninizmit, të dijë t'i zbatojë ato pikërisht në kushtet e secilit vend. Çdo territor administrativ, çdo shtet, atje është një hallkë e tërë zinxhirit, ku ekzistojnë edhe hallka të dobëta, pas të cilave duhet të kapet partia marksiste-leniniste.

Shtrohet çështja: duhet të ketë atje një parti komuniste panindiane? Unë mendoj se duhet të ketë, që të japë një orientim të përgjithshëm të bazuar në parimet e marksizëm-leninizmit, po duke pasur parasysh që ky të zbatohet në kushtet e secilit shtet të veçantë. Për një shtet mund të dalë në plan të parë pjesëmarrja e partisë në sindikata, për një tjetër reforma agrare, për një të tretë me industri shumë të zhvilluar ka probleme të tjera. Në Indi ka varfëri të madhe, ka njerëz që vdesin nga uria; bujqësia nuk është e mekanizuar, tokat janë lënë djerrë. Prandaj rëndësi të madhe ka që partia komuniste të njohë mirë teorinë marksiste-leniniste, parimet e saj themelore, që duhet ta udhëheqin në veprimtarinë e saj revolucionare dhe të mos e zbatojë atë kudo në mënyrë shabllone.

Partitë marksiste-leniniste duhet të mbajnë parasysh mësimin e Leninit se revolucioni nuk eksportohet. Kjo do të thotë që edhe Partia Komuniste e Kanadasë, për shembull, mund e duhet ta njohë e ta studiojë eksperiencën tonë, apo të partive të tjera të vërteta ko-

muniste, por përfitimin që do të nxjerrë nga një studim i tillë, ta zbatojë në përshtatje me kushtet e vendit të vet. A mund t'u themi ne, fjala vjen, komunistëve të Kanadasë: luftoni sot për reformën agrare dhe tokat e fermave me nga 1 000 apo 1 500 ha t'u ndahen pesëdhjetë apo njëqind fshatarëve? Jo, këtë nuk mund t'ua themi, se nuk dimë çfarë kontradiktash ekzistojnë në mes partive në këtë vend, në ç'gjendje është klasa punëtore, çfarë kontradiktash ka në mes degëve të ndryshme të industrisë e të zhvillimit socialkulturore të vendit, si paraqitet problemi nacional, ç'influencë ka atje imperializmi amerikan, si ka depërtuar ky në këtë vend dhe nga duhet të kapet partia për të luftuar kundër influencës amerikane, se nuk bëhet lehtë një gjë e tillë. Më mirë se kushdo, se ç'rrugë do të ndiqet për zgjidhjen e këtij apo të atij problemi, këtë e di vetë kjo parti.

Pozita gjeografike e Iranit është e atillë që lejon një shpërthim kualitativ. Tash, siç po dëgjojmë, puna ka arritur deri atje sa Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë detyruar t'i heqin bazat e tyre nga Irani, sepse janë në rrezik, iranianët kanë arritur të futen deri në ambasadën amerikane, prandaj amerikanët kërkojnë që këto baza t'i vendosin në Turqi etj.

Aftësia vepruese e çdo partie komuniste në vepërimtarinë e saj për zbatimin në jetë të parimeve të marksizëm-leninizmit, në përshtatje me kushtet e vendit, qëndron në atë që ajo të dijë të kapet pas hallkave të dobëta, derisa të arrijë të japë grushtin dërrmues në hallkën kryesore të të gjithë zinxhirit kapitalist. Mund që ky grusht të mos shkaktojë menjëherë tron-

ditjen e plotë të të gjithë «ndërtesës» së kalbur, por kjo nuk duhet t'i sprapsë forcat revolucionare.

Rëndësi të madhe në këto situata ka që mësimet e Leninit, marksizëm-leninizmi, të zbatohen në mënyrë krijuese, në përputhje me kushtet konkrete të çdo vendi. Të gjithë komunistët duhet t'i studiojnë parimet bazë të marksizëm-leninizmit dhe të udhëhiqen prej tyre, t'i kenë ato busull për veprim. Kjo është e domosdoshme, se vetëm atëherë gjykohet e veprohet drejt.

Që ne komunistët t'i përballojmë me sukses situatat, siç na mësojnë Marksi dhe Lenini, duhet të lidhim mirë teorinë tonë luftarake dhe dinamike me situatat konkrete. Dihet që në revolucionin proletar nuk mund të shkohet përnjëherë. Çështja është që partia komuniste të mendojë në ç'rugë të kalojë për të mbërritur deri atje, ç'punë duhet të bëjë e ç'masa të marrë, nëpër çfarë etapash duhet të kalojë ky proces. Këtu nuk është fjala për etapat e mëdha, për kalimin nga revolucioni demokratiko-borgjez në një revolucion tjetër shoqëror më të lartë, siç është revolucionin proletar, por për një varg çështjesh e situatash, në të cilat partia duhet të kapë hallkat njëra pas tjetrës, për të kaluar nga një etapë më e ulët në një tjetër më të lartë për të siguruar triumfin e revolucionit. Kjo kërkon që partia të njohë thellë situatën, të punojë për të zëvendësuar format e vjetra të luftës me forma të reja, derisa të krijojë një gjendje të përshtatshme revolucionare, të shikojë nëse është koha për t'i dhënë një shtytje lëvizjes revolucionare apo për t'i dhënë grushtin «ndërtesës» së kapitalizmit. Për sa i përket kohës që do të duhet për përga-

titjen e revolucionit, është tjetër punë. Kjo varet nga shumë faktorë. Kryesorja është që partia medoemos të hidhet në veprime konkrete revolucionare dhe të mos mbetet në parime. Programi i partisë komuniste duhet të jetë sa më konkret, real, i drejtë, marksist-leninist, që të shohë perspektivën, e cila nuk realizohet menjëherë, por, duke e pasur atë të qartë në situatat konkrete dhe e mbështetur në marksizëm-leninizmin, partia të ndërmarrë veprime konkrete. Këtu del në pah çështja, të cilën vazhdimisht e kemi theksuar dhe e theksojmë, që marksizëm-leninizmi të mësohet në lidhje të ngushtë me procesin e zhvillimit materialist të shoqërisë, në të cilën komunisti jeton me qëllime që ta çojë më përpara këtë zhvillim. Në qoftë se marksizëm-leninizmi mësohet me formula, në mënyrë libeske e dogmatike, pa i lidhur parimet me praktikën, atëherë partia nuk do të jetë në gjendje ta zbatojë në jetë këtë shkencë revolucionare, nuk do t'u japë dot zgjidhje të drejtë problemeve, sidomos gjatë kalimit nga një etapë e revolucionit në një tjetër dhe nuk do të jetë në gjendje ta çojë atë deri në fund.

Natyrisht, gjatë veprimtarisë revolucionare, edhe veprime të gabuara mund të bëhen. Duke mos vlerësuar si duhet situatën dhe kontradiktat në planin kombëtar ose ndërkombëtar etj., etj., partia mund të bjerë në oportunizëm ose në sektarizëm. Prandaj është e rëndësishme që marksizëm-leninizmi të përvetësohet e të zbatohet në mënyrë krijuese. Kur teorikisht je i përgatitur dhe teorinë e lidh me situatën konkrete, kur e ke të qartë objektivin që synon të arrish, je në gjendje të kuptosh përse në një moment të caktuar duhet të bëhet edhe



ndonjë zigzag apo lëshim (por ky jo të jetë oportunist).

Tash, le të ndalemi përsëri te ngjarjet e Iranit. Për gjendjen në këtë vend unë mendoj çdo ditë, çdo mbrëmje. Lufta aktuale e popullit heroik iranian ka rëndësi jashtëzakonisht të madhe, sepse kemi të bëjmë me një revolucion. Ky nuk është një revolucion proletar, por demokratiko-borgjez, siç ka qenë Revolucioni Francez i vitit 1789. Ky revolucion përmbysi me dhunë regjimin monarkik feudal të Pahlevëve dhe shënoi një hap të madh përpara në rrugën e lirisë e të demokracisë. Tash, në përgjithësi, në Iran do të zhvillohen fraksionet, siç u zhvilluan dy shekuj më parë në Francë. Miraboja në fillim ishte kundër mbretit, por pastaj ai vetë u lidh me mbretin, pra tradhtoi revolucionin. Kështu ndodhi, por Miraboja donte një mbretëri konstitucionale.

Edhe në Iran revolucioni e ka këtë karakteristike tipike. Atje ekzistojnë minoranca të organizuara komuniste dhe jo një, por shumë. Shtrohet çështja: do të shkojnë këto minoranca në gijotinë apo do të jenë të tjerë ata, të cilëve do t'u pritët koka? Në qoftë se komunistët e vërtetë revolucionarë do të dinë ta shfrytëzojnë si duhet këtë revolucion, atëherë ai do të përparojë duke i dhënë një grusht të rëndë imperializmit.

Ngjarjet në Iran vërtetojnë tezat e Leninit për imperializmin si kapitalizëm monopolist në kalbëzim, kapitalizëm që jep shpirt, prag i revolucioneve proletare. Sot imperializmi amerikan është në kalbëzim, shkon drejt greminës, nuk është në gjendje të ndalë vrullin revolucionar të popujve, si atij të Iranit, që guxoi të futej dcri në ambasadën amerikane. Edhe Portiliosi, presidenti i Meksikës, u ngrit në një banket dhe i tha

Karterit që Shtetet e Bashkuara duhet të jenë më prude, të mos gënjejnë dhe ta respektojnë pavarësinë dhe sovranitetin e vendit të tij. Kjo ishte një shuplakë tjetër për qeverinë amerikane. Por, as në Iran, as në Meksikë, ku zhvillohen këto ngjarje, imperialistët amerikanë sot nuk ndërhyjnë dot me ushtri, për arsye se ushtarakisht kanë pësuar disfatë në Kore e në Vietnam, prandaj nuk e ndiejnë veten të sigurt të ndërmarrin veprime të tilla ndaj popujve të tjerë që ngrihen kundër tyre.

Tash mbetet problem se si do të zhvillohet më tej revolucioni në Iran. Përpyekjet e forcave të brendshme reaksionare feudale të përmbysura janë të mëdha. Ato, në bashkëpunim me reaksionin e jashtëm, duan të bëjnë një kundërrevolucion. Aktualisht opinioni ndërkombëtar luan një rol të madh, por baza, vendimtarja, përsëri është brenda.

Do të qëndrojnë në fuqi Khomeini?! Do të qëndrojnë Bazargani në krye të qeverisë?! Do të vijë të tjerë pas tyre?! A mund të ngjasë dhe a do të ngjasë në Iran, siç ndodhi në Revolucionin Demokratiko-Borgjez Francez? Këto janë pyetjet që bëhen, çështjet që shtrohen sot. Kjo është korniza e përgjithshme e revolucionit iranian. Tash si, qysh e tek, do të zhvillohen ngjarjet, do ta shohim. Varet shumë nga zhvillimi i situatës në këtë vend, po varet edhe nga gjendja jashtë. Edhe në revolucionin francez u ndërhy nga jashtë.

Akoma nuk dihet çfarë do të ngjasë në Iran. Kjo varet nga rruga që do të marrë revolucioni atje, çështja është në evolucion. Do të vijë në Iran një Bonapart, siç erdhi në Francë, apo do të vendoset atje një demo-

kraci më përparimtare, revolucionare, konsekuente, ku në pushtet të jenë përfaqësuesit më besnikë të popullit dhe të mos sundojë dot më borgjezia e vogël liberale, ku ushtria të jetë e popullit dhe oficerët të mos jenë një kastë pasanikësh, apo do të ketë më së fundi një restaurim?! Kjo nuk dihet, varet çdo gjë nga raporti i forcave që marrin pjesë në këtë revolucion. Për revolucionarët është jashtëzakonisht e domosdoshme që hekuri të rrihet sa është i nxehtë, siç thotë populli ynë. Neve na bie detyra që në këto kushte ta rrahim këtë hekur. Të mos kemi iluzione, por me sa mundësi kemi, të punojmë. Kjo është arsyeja që unë u vë rëndësi të madhe artikujve që botojmë për ngjarjet aktuale në Iran. Këta artikuj t'i përgatitim, pa prekur drejtpërsëdrejti fenë dhe pa ofenduar fetarët, të flasim për unitetin e popujve arabë e iranianë, për çlirimin e tyre nga imperializmi, nga reaksioni i shitur të huajt dhe nga borgjezia e madhe e shitur tek armiqtë e këtyre popujve, qofshin këta imperialistë ose socialimperialistë. Në këtë unitet, në këto të drejta që ka fituar, duhet të mbështetet populli iranian dhe jo në intrigat e në shpifjet e shumta tendencioze të botës borgjeze e revizioniste. Në Iran komunistët do të gjejnë mbështetjen e elementëve përparimtarë, të shtresave të varfra, të cilat në kurrizin e tyre kanë ndier peshën e rëndë të shfrytëzimit barbar të regjimit fashist, duke vepruar siç thashë.

Në artikujt tanë nuk u jepet ndihmë e përkrahje vetëm klasës punëtore dhe masave iraniane, por edhe vendeve arabe, për rrugën që duhet ndjekur. Në artikuj është vënë nga ne edhe një shprehje shumë sinjifikative: «Popujt arabë kanë në dorë një armë të fuqish-

me, naftën». Ne e kemi thënë dhe koha e vërtetoi një gjë të tillë. Por edhe në duart e popullit iranian nafta, që ka tronditur botën kapitaliste, është gjithashtu një armë e fuqishme. Natyrisht, ky popull ka shumë mjete të tjera për të mbrojtur e për të çuar përpara fitoret e revolucionit, por veçanërisht këtë armë, naftën, ai tash duhet ta mbajë fort në dorë.

Në këto situata nuk mund të themi se në vendet arabe feja myslimane është zhdukur, nuk ekziston më. Po ta themi kështu është gabim i madh. Feja në ato vende ekziston dhe ka influencë shumë të madhe. Ajo përbën një faktor subjektiv me rëndësi, mbi të gjitha është një armë ideologjike që përdoret nga borgjezia, nga sheikët, nga imamët për të shfrytëzuar popullin. Por ne, nëpërmjet artikujve dhe gjithë punës që bëjmë, duhet të dimë se si të influencojmë që fryma laike të depërtojë në masat e gjera të këtyre popujve.

Të gjithë e dimë ç'propagandë të madhe bënin në vendin tonë gjatë Luftës Nacionalçlirimtare ballistët dhe tërë reaksioni kundër nesh, duke i thënë popullit, për ta përçarë, se komunistët do t'u rrëmbejnë fëmijët, djalin, vajzën, do të shkatërrojnë familjen e të tjera e të tjera. Por çfarë mendon populli ynë sot për komunistët që udhëhoqën luftën, që çliruan vendin dhe tash ndërtojnë jetën e lumtur socialiste? Ai është në unitet të çeliktë dhe thotë se gjithçka tha Partia, po e bën realitet. Por, që të arrihej deri këtu, u desh një punë e madhe e shumë kohë që pikëpamjet e njerëzve të evoluonin, megjithëse ka akoma mentalitete kundër të cilave po luftojmë.

Fjalën e kam në atë që ne duhet të gjejmë mënyrat për t'u marrë krahët këtyre problemeve. Kjo është de-

tyra e partive të vërteta komuniste (marksiste-leniniste). Për vende e popuj të ndryshëm problemet janë të ndryshme. Për shembull, popujt e Afrikës kanë probleme të tjera, ata të Lindjes së Mesme të tjera e kështu me radhë mund të themi për popujt e rajoneve të ndryshme të botës.

Aktualisht, me situatat që krijoi revolucioni në Iran, duhet folur edhe për unitetin e popujve arabë, i cili është i nevojshëm, megjithëse pothuaj i pamundur. Trajtimi i kësaj çështjeje është i rekomandueshëm, i kohës, i domosdoshëm, për arsye se imperializmi dhe kapitalizmi botëror me të gjitha mënyrat kërkojnë që këta popuj t'i vënë në luftë me njëri-tjetrin. Këtij qëllimi ata përpiqen t'ia arrijnë, siç kam thënë herë tjetër, mbase jo aq, me luftën fetare, me antagonizmin fetar që gjoja shërbeu si shkak për shpërthimin e revolucionit në Iran. Pra bota arabe, bota e naftës, qenka për republikë islamike dhe, sipas tyre, lufton kundër botës kristiane. Edhe papa i Romës, nga ana e vet, po brendh dhe bën kudo mbledhje me besimtarët, sidomos me rininë, për të ringjallur te kjo ndjenja të forta fetare. Ky pra lufton për «unitetin» e kristianëve. Pra, nga njëra anë shohim se po aktivizohet kristianizmi, si një mbrojtës i kapitalizmit dhe i borgjezisë së madhe të vendeve të industrializuara, nga ana tjetër propaganda borgjezo-revizioniste predikon se qëllimi dhe tendenca e vendeve arabe, të cilat janë «të lira» e të tjera e të tjera, është të sigurojnë «unitetin» islamik. Në mënyrë të tërthortë me këtë ata duan të thonë që të dyja palët janë në luftë, në një përpjekje fetare, natyrisht, jo si në kohën e mesjetës me kryqëzata.

Borgjezia dhe revizionistët, duke i dhënë ngjyrë fetare luftës së popujve arabë, iranian e të tjerë, për çlirim e tyre nga shtypja e shfrytëzimi, synojnë t'i mbajnë këta nën zgjedhë të përhershme. Prandaj uniteti i popujve të kësaj zone ka rëndësi të madhe në luftën e tyre kundër shtypësve e shfrytëzuesve imperialistë, për të mbrojtur të drejtat nacionale dhe shoqërore dhe pavarësinë. Këtë duhet ta theksojmë në artikullin që do të shkruajmë për Iranin. Problemin e unitetit ta kemi të qartë, ta trajtojmë teorikisht dhe të nxjerrim në shesh falsitetin e intrigave të shumta të revizionistëve sovjetikë, imperialistëve amerikanë, sionistëve izraelitë e gjithë reaksionarëve të tjerë rreth kësaj çështjeje kaq të rëndësishme. Kontradiktat që ekzistojnë midis këtyre vendeve nuk mund të zhidhen, për arsye se këto janë vende kapitaliste, në to sundon borgjezia e naftës, mirëpo çlrimi nga zgjedha e imperializmit është një pikë e përbashkët për gjithë popujt e kësaj zone. Prandaj ata duhet të shtrëngojnë radhët me njëri-tjetrin.

Në artikull të vihet në dukje se kapitalizmi botëror përpigjet ta shtrembërojë karakterin e vërtetë të revolucionit në Iran, duke theksuar se ka karakter fetar. Por thelbi i revolucionit demokratiko-borgjez i Iranit, i këtij shpërthimi revolucionar të popullit kundër perandorisë së shahut dhe imperializmit amerikan, nuk ka karakter thjesht fetar, siç përpigjen ta propagandojnë imperialistët, që kanë interesa për naftën e këtij vendi. Pa mohuar dhe pa cenuar bindjet fetare të iranianëve, të theksojmë se ne nuk i besojmë këto intriga. Populli iranian, i rras-kapitur nga shtypja dhe nga grabitja e këtyre forcave, u ngrit në këmbë. Po ne jemi të bindur se nuk është ve-

tëm ndjenja fetare që e çoi në kryengritje. Ajo që e udhëheq atë në këtë luftë është ideja e çlirimit, ideja e mbrojtjes nacionale dhe e krijimit të një republike demokratike borgjeze, që ai t'i administrojë e t'i gëzojë vetë pasuritë e vendit dhe fatet e tij.

Vazhdimisht e kam thënë dhe përsëri e them se sa më shumë që lexojmë, aq më shumë e shohim se dimë pak. Në këtë kuptim shokët e sektorit të jashtëm të aparatit të Komitetit Qendror duhet të studiojnë mirë historinë e këtyre popujve. Nuk them që këta të mbarojnë tash Fakultetin e Historisë, por ama të studiojnë në biblioteka dhe në shtëpi, të sakrifikojnë edhe gjumin e natës për t'u njohur me historinë e popujve të këtyre vendeve. Librat që na njohin me historinë e tyre disa janë shkruar nga elementë borgjezë, po ka dhe nga ato që janë shkruar nga elementë përparimtarë, prandaj studimi i historisë në këta libra të bëhet nga pozita marksiste. Në bibliotekat tona ky ose ai punonjës i sektorit të jashtëm nuk do të gjejë libra që t'ia japin në dorë situatën e një vendi ashtu siç do t'ua jepte një libër i shkruar nga një marksist. Megjithatë, duke i studiuar ata, njeriu ynë do të njohë dhe do të kuptojë zhvillimin shoqëror të atij vendi, edhe ashtu siç e paraqet autori do të gjejë atje diçka që ta orientojë deri në njëfarë shkalle. Një gjë e tillë pra ndihmon që, kur të vijmë shokët e huaj, shoku ynë të dijë të kërkojë shpjegime se si është e vërteta për vendin e tij. Dhe miku do t'i shpjegojë atë situatë që ne akoma nuk e kemi të qartë, por që dimë se diçka ngjet në atë vend, se kemi studiuar për të. Kjo që dua të vë në dukje këtu është që shokët e sektorit të jashtëm nuk duhet të mjaftohen vetëm me

punën që bëjnë, duke shfrytëzuar shtypin e materialet e ndryshme që kanë në dispozicion. Natyrisht, edhe kjo është një punë që duhet ta bëjnë, domethënë të lexojnë gazetat, raportet e informacionet, t'i analizojnë e të nxjerrin konkluzione nga ato, por të studiojnë edhe historinë e popujve të njohin mentalitetin, zakonet, kulturën, gjendjen sociale dhe ekonomike të tyre. . .

Revolucioni antiimperialist i popullit iranian do të lërë mbresa të mëdha jo vetëm në Lindjen e Mesme, por edhe në të gjithë botën, veçanërisht në botën imperialiste, kapitalisto-revizioniste.

Siç kam shkruar edhe më përpara, ky ishte një revolucion popullor antifeudal e antiimperialist, me tiparet e një revolucioni demokratiko-borgjez. Karakterin popullor atij ia jep pjesëmarrja shumë e gjerë në të e masave punonjëse të qytetit e të fshatit, punëtorë të naftës e të degëve të tjera të ekonomisë, fshatarë të varfër, rini studenteske, elementë përparimtarë të inteligjencies, politikanë demokratë-borgjezë, udhëheqës të sektit shiit, ushtarë, bij të popullit. Por, nëse ai do të shndërrohet në një revolucion të vërtetë demokratiko-borgjez, për këtë, mendoj unë, duhet pritur, sepse varet nga reformat që duhet e që do të bëhen pas fitores së tij, sidomos nga zbatimi i një reforme të thellë agrare, e cila t'ua kthejë tokën e grabitur atyre që e punojnë, fshatarëve iranianë, nga reforma të tjera që t'i sigurojnë popullit liri të vërteta demokratike dhe të vazhdohet pa kompromis lufta kundër ndikimit dhe ndërhyrjes së imperializmit, të çdo ngjyre që të jetë, në punët e brendshme të Iranit. Këtë do të na e tregojë koha.



Populli iranian ishte lënë në errësirë, në prapambetje, veçanërisht fshati, ku latifondistët e mëdhenj bënë ligjin mesjetar. Edhe ai pseudomodernizim industrial që shihej ndër qytete, sidomos në kryeqytet dhe në qytetet e tjera kryesore, si Ispahani etj., ishte një industrializim i sforcuar, i krijuar nga inflacioni i madh i petrodollarit, që nuk e kishte nxjerrë popullin punonjës iranian nga varfëria dhe nga mizerja. Klasa punëtore iraniane, e shtypur dhe e shfrytëzuar, është me të vërtetë një klasë heroike; vetë populli iranian është një popull i zgjuar, me kulturë të lashtë e të shumanshme, nga gjiri i të cilit kanë dalë njerëz të mëdhenj, por shfrytëzuesit imperialistë anglezë dhe më vonë ata amerikanë kanë vepruar së bashku në mënyrë të atillë që ai të lihej në prapambetje dhe pasuritë e Iranit të kalonin në pronësinë e tyre, tokat e nëntoka me të gjitha pasuritë e saj, pra i gjithë Irani të bëhej pronë e kapitalizmit botëror.

Kötu, shoqëritë e mëdha të naftës, që nga ato angleze, amerikane, holandeze etj., kishin në Iran njerëzit e tyre, kuadro e specialistë të lartë dhe të mesëm, kurse klasa punëtore iraniane ishte lënë në atë gradë sa zor që nga radhët e saj të dilnin njerëz të kualifikuar që të drejtonin prodhimin në fabrikat, uzinat, rafineritë. Ata që kishin arritur të bëheshin drejtues të tillë dhe ishin dërguar nëpër shkolla, ishin njerëz të zgjedhur vetëm nga borgjezia, e cila ishte mahur dhe korruptuar në kulm, tok me shahun.

Në gjendjen në të cilën ishin katandisur «përparimi e zhvillimi» në Iran, arsimit dhe kultura ishin mbuluar nga një mjegull e dendur, për të mos thënë se nuk ekzi-

stonin fare. Kultura zhvillohej me një javashllëk të madh dhe ishte deformuar në mënyrë të tillë, që t'i mbante masat të shtypura nën regjimin e autokratëve. Natyrisht, në këtë mes kanë luajtur rol të madh përfaqësuesit reaksionarë të fesë që bënin punën e tyre obskurantiste, që në kohën e dinastisë së Haxharëve e të Pahlevëve. Për frenimin e zhvillimit të ndërgjegjes së popullit për çlirimin nacional nga zgjedha e okupatorëve imperialistë, ata ndërhyjnë veçanërisht në superstrukturë, pra, edhe në art e në kulturë. Arti dhe kultura e lashtë persiane ishin injoruar, kishin humbur dhe në artin e në kulturën iraniane dominonte filozofia islame e imamëve. Tash xhamitë nuk ishin më edhe shtëpi kulture, siç ishin në kohën e Sadiut e të Firdusiut, ku, përveç riteve fetare, zhvilloheshin edhe debate filozofike, debate mbi astronominë, mbi matematikën dhe mbi gjendjen sociale të njerëzve. Jo. Tani ato kishin të njëjtin funksion si ato të Perandorisë Osmane, shërbënin vetëm për t'iu falur Muhamedit dhe zotit, pasardhësve të Muhamedit, imam Aliut, imam Hyscinit dhe imamëve të tjerë.

Kjo gjendje rëndonte shumë mbi masat e popullit, por me kohë shtypja u thellua, nafta, kjo pasuri e madhe e nëntokës së Iranit, u bë një armë e mprehtë në duart e imperialistëve dhe në duart e shahut e të sheikëve, të cilët, të pangopur për pasuri, luanin me fatin e me pasuritë e popullit, në favor të perandorisë dhe të ushtrisë shtypëse që ata krijonin. Kështu që shahu i Iranit ishte nga pasanikët më të mëdhenj në botë. Ushtria iraniane, për nga armatimi e nga fuqia e zjarrit, numërohej si e katërta në botë. Por gjeneralët dhe ofi-

cerët madhorë të kësaj ushtrie përbënin një klikë të korruptuar, mbrojtëse të pasurive të panumërta të shahut dhe të pasuesve të tij. Midis kësaj klike oficerësh dhe ushtarëve, bijve të popullit, ekzistonte një hendek i madh. Këtë ushtri, siç thashë, të katërtën në botë e të armatosur me armët më të sofistikuara, revolucioni popullor antiimperialist i popullit të Iranit e bëri të pavlefshme. Kështu ushtria e shahut nuk mundi të luante atë rol që i kishin vënë si detyrë shahu dhe padroni i tij, imperializmi amerikan.

Pra kjo shtypje, kjo pakënaqësi e shtrirë mbi tërë masat e popullit, u konkretizua, u vërtetua kalimi nga sasia në cilësi dhe momentet më të përshtatshme, objektive e subjektive, u gjendën pikërisht nga ana e popullit, nga ana e punëtorëve, gjë që çoi në revoltën e popullit kundër shahut dhe kundër imperializmit amerikan e imperialistëve të tjerë.

Revolucionin, pra, e bëri populli Iranian, gra dhe burra, pleq e të rinj. Në radhët e para të këtij revolucioni kishte nga klasa punëtore iraniane, ishin punëtorët e naftës dhe të të gjitha degëve të tjera të ekonomisë.

Populli u ngrit në demonstrata të përgjakshme, marshoi përpara, edhe pse shahu, që mendonte se do ta trembte, qëlloi mbi të dhe vrau me qindra e me mijëra veta. Natyrisht, imam Khomeini e përdori këtë situatë objektive dhe me njerëzit e vet, me atë grupimin e konsiderueshëm, mund të themi, të besimtarëve shiitë, ashtu siç e propagandoi e gjithë bota, mundi të luante një rol në dukje shumë të rëndësishëm. Por duhet thënë se në këtë kryengritje popullore shikoje kryesisht të rinj e të

reja, burra dhe gra, që ngrinin grushtet përpjetë e që vriteshin nëpër rrugë. Këta dikush i udhëhiqte.

Agjencitë perëndimore të lajmeve i bënë shumë bujë Ajatollah Khomeinit dhe grupit të tij shiit, sikur ky ishte frymëzuesi. Por, unë mendoj se, pa ekskluduar influencën e saktit shiit dhe të besimit fetar, ky është një revolucion kryesisht antiimperialist i popullit iranian...

Luftërat për çlirim kombëtar e shoqëror, qoftë në Lindjen e Mesme, qoftë në Afrikë apo kudo gjetkë, janë luftëra me karakter nacionalçlirimtar e antiimperialist. Megjithëse në këto luftëra, për njërën apo për tjetrën arsye proletariati nuk është në krye të masave të popullit dhe nuk ka partinë e vet, në situatat revolucionare që do të krijohen elementi përparimtar, i cili ka bërë aleancë me fshatarësinë e mjeruar që kërkon tokë, do të krijojë kushtet që edhe proletariati luftarak të hidhet në luftë, të dalë partia e vërtetë e proletariatis, udhëheqja e vërtetë e shtetit, ushtria e vërtetë popullore që do t'i shërbejë popullit e jo borgjezisë së re teokratike, këtë herë gjoja e veshur me forma demokratike.

Për sa i përket Iranit, është fakt se proletariati, punëtorët e naftës që morën pjesë në kryengritjen popullore, fituan.

U fol shumë për Ajatollah Khomeinin, i cili u kthye në Iran. Baftjari bëri shumë fjalë, por më në fund u arratis bashkë me gjeneralët e tij. Shumë gjeneralë që mbetën në Iran u ekzekutuan. Ajatollah Khomeini, që nuk e ndien veten të sigurt, i bën thirrje popullit të qetësohet, por ai nuk qetësohet, vazhdon të jetë në

lëvizje dhe përgjigjet: «Nuk i hedhim armët!». Këto gjëra i shohim në axhanset e lajmeve.

Nga turbullirat që mund të nxiten në Iran kundër rendit që u vendos, do të përpiqen të përfitojnë imperia- lizmi amerikan e ai anglez, socialimperializmi sovjetik e të gjithë me radhë. Gjithçka në këtë drejtim varet shumë nga vigjilenca, nga zotësia dhe nga konsekuenca e njerëzve përparimtarë iranianë që iu futën revolucio- nit. Ata duhet ta vazhdojnë atë, duke kaluar nga një etapë në tjetrën e duke zgjidhur në çdo etapë probleme me rëndësi, me reforma rrënjësore e jo të sipërfaqshme, jo të rreme, jo vetëm për lustër, sepse të gjithë do të përpiqen ta qetësojnë këtë situatë. Ne shohim se vetë Karteri në intervistat e tij të fundit tregohet jashtëza- konisht i trembur dhe i lëkundur, i vranë ambasadorin në Afganistan e s'flet hiç. «Rojat e revolucionit» në kryeqytetin e Iranit sulmuan ambasadën amerikane, u futën në të dhe zunë rob titullarin, 60 nëpunës dhe 19 roja mörinsa, të cilët ngritën duart lart. Aty u kapën shumë dokumente, të cilat më vonë do t'i shërbejnë po- pullit iranian. U desh të ndërhynte kryeministri i ri provizor i Iranit, Bazargani, që t'i shpëtonte robërit.

Duhet thënë, gjithashtu, se ekziston rreziku i një ndërhyrjeje. Bile, në fakt, ajo ka filluar me kohë nga ana e socialimperialistëve sovjetikë, të cilët duan të kri- jojnë zonat e tyre të influencës në Lindjen e Mesme, sidomos në Iran ku ekziston një numër i madh azerbaj- xhanasish (gjysma e azerbajxhanasve jeton në BS e gjysma në Iran). Atje ekzistojnë kurdët, të cilët në këto momente janë në lëvizje jo vetëm në Iran, por edhe në Turqi. Mirëpo kurdë ka edhe në Bashkimin Sovjetik.

Në këto situata socialimperialistët sovjetikë po veprojnë edhe nëpërmjet KGB-së.

Çështja e Iranit i ka vënë Shtetet e Bashkuara të Amerikës në situata jashtëzakonisht të vështira edhe në Gjirin Persik, si në Kuvajt ku 35 për qind e popullsisë është palestineze, në Arabinë Saudite ku mund të kërkohet shtetëzimi i shoqërisë arabo-amerikane të naftës, ARAMCO.

Me dëbimin e shahut nga Irani, që ishte bërë xhandari i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Lindjen e Mesme dhe në Gjirin Persik, Izraelit iu pre burimi kryesor i naftës. Kështu rreziqet janë të mëdha. Prandaj ne duhet t'i ndjekim me vigjilencë të madhe dhe me kujdes të posaçëm këto çështje për të parë si dhe në favor të kujt do të zgjidhen ato.

Për ata që duan të na dëgjojnë, ne duhet t'i shpjegojmë qartë gjërat, hapur, ashtu siç janë, pa prekur ndjenjat fetare në këtë lëvizje të madhe revolucionare të popujve arabë.

*Marrë me shkurtime nga libri: Enver Hoxha, «Ditar për çështje ndërkombëtare» (botim i brendshëm), nr. 12,*

*f. 174*

# REKOMANDIMET PËR TË HYRË NË PARTI — NJË E DREJTË DHE DETYRË E ORGANIZATËS SË RINISË

*Nga biseda në takim in me shokun Hekuran Isai<sup>1</sup>*

16 shkurt 1979

*Pasi shoku Hekuran Isai e vuri në dijeni shokun Enver Hoxha për disa probleme të pranimeve të reja në Parti dhe për seminarët, që do të organizoheshin për këto çështje në bazë zone, e mori fjalën shoku Enver Hoxha:*

Ne asnjëherë nuk kemi thënë dhe as në Statutin e Partisë nuk ekziston asgjëkundi kjo që ndodh në disa raste në praktikë që duhet medoemos t'i rekomandojë organizata e Partisë organizatës së rinisë se kush duhet të futet në Parti. I riu 18, 20 apo 22-vjeçar ka të drejtë të bëjë lutje për t'u pranuar në Parti. Këtë lutje, që nuk përbën një dokument partie, ai ia drejton byrosë së Partisë të ndërmarrjes, organizatës-bazë të Partisë ose organizatës së rinisë, me një fjalë kujt të dëshirojë, se unë nuk di që të ketë ndonjë nen në Statutin e Par-

---

1. Anëtar i Byrosë Politike dhe sekretar i KQ të PPSH.

tisë sonë që të përcaktojë se i riu duhet medoemos t'ia bëjë lutjen organizatës-bazë të Partisë.

Edhe kur kërkesa i dërgohet organizatës-bazë, kuptohet se kjo i drejtohet organizatës së rinisë për të mësuar më mirë karakteristikat e tij. Pasi ka marrë të dhënat e nevojshme nga organizata e rinisë, organizata e Partisë gjykon se ky i ri, që ka bërë lutjen, i plotëson kushtet të pranohet në Parti. Prandaj e thërret atë dhe i thotë se është një gjë shumë e mirë që ke bërë lutje të futesh në Parti. Por, përveç lutjes, ne duhet të kemi edhe disa të dhëna të tjera për ty, prandaj plotësoji dokumentet dhe pastaj ne do të të thërresim e do të të pyesim për disa çështje, që të jemi më të qartë.

Kjo mënyrë pune, më duket mua, nuk është e ndaluar, por edhe e domosdoshme nuk është. E rëndësishme është që organizata e rinisë mund dhe duhet t'i rekomandojë organizatës-bazë të Partisë të rinj e të reja që i kanë kushtet për t'u pranuar në Parti. Kjo është një e drejtë dhe detyrë që asaj i njihet me Statut. Në rekomandimet e saj është, ta zëmë, edhe një i ri i mirë, por që s'ka bërë kërkesë për t'u futur në Parti. Atëherë, në këtë rast, Partia ndalet dhe rezulton se ky njeri i rekomanduar nga organizata e rinisë s'ka asnjë arsye objektive, veçse subjektive, që nuk bën kërkesë për t'u pranuar në Parti, sepse në mënyrë të gabuar mendon: «Po i mirë jam unë xhanëm për punën e rinisë etj., por barrën e Partisë nuk e mbaj dot». Kështu mendon ai, dhe fakti që thotë të drejtën, është një gjë pozitive, por edhe për punën e Partisë qëndrimi i tij është i vlefshëm, pse kjo nxjerr mësim se si duhet të punojë me këtë njeri që ka shumë cilësi të mira, por që i mungon, si të



thuash, njëfarë kurajoje. Ky i ri e vlerëson qenien e tij si anëtar i Partisë, e kupton se ky është një nder, por në të njëjtën kohë i duket edhe detyrë e rëndë, prandaj sprapset. Për të gjitha këto organizata-bazë e Partisë duhet ta rrethojë këtë njeri me disa elementë të shëndoshë, ta aktivizojë më shumë në punë, pa i kërkuar gjë që ai të bëjë dokumentet për në Parti, por të punojë me këtë mënyrë e ta parapërgatitë atë.

Punën e Partisë duhet ta karakterizojë elasticiteti, ajo nuk duhet të jetë asnjëherë statike dhe burokratike. Për shembull, organizata-bazë e Partisë, kur është fjala për të pranuar në Parti këtë apo atë kuadër të organizatës së rinisë, të mos mendojë se, po ta pranojë në Parti, ai do të ikë për të bërë stazhin e kandidatit dhe ndërmarrjes do t'i dëmtohet puna. Kështu nuk duhet menduar, veçanërisht për njerëz të dalluar për të cilët ne kemi nevojë të hyjnë në Parti. Por ja që ka nga këta njerëz edhe të tillë, që nuk e kanë atë guxim të bëjnë kërkesë për t'u pranuar në Parti, se kanë njëfarë druajtjeje. Si rezultat i punës që do të bëhet me të, i riu apo e reja interesohet vetë për të bërë lutjen për në Parti. Dhe, që të bëhet lutja nga vetë i riu ose e reja, kjo është një çështje me rëndësi shumë të madhe për Partinë. Një gjë e tillë tregon vullnetin e madh dhe shpirtin revolucionar të këtij elementi, tregon se ai e do Partinë dhe i ka forcuar bindjet e tij për të hyrë në Parti, prandaj dëshiron dhe kërkon që të bëjë pjesë në radhët e saj.

Pra, ajo që dua të vë në dukje këtu është se ka shumë rëndësi fakti kur të rinjtë e shikojnë se i plotësojnë të gjitha kushtet dhe me iniciativën e tyre i drejtojnë lutje organizatës-bazë të Partisë për t'u pranuar

anëtarë të saj. Komiteti i rinisë mbase dhe nuk e rekomandon këtë të ri, por ai çan vetë me vullnetin e tij të fortë, pra, nuk pret ta rekomandojë komiteti i rinisë, i cili, në fakt, rekomandon shumë pak dhe ky është një nga shkaqet e kësaj mcshtësie që vihet re në ndonjë rast tek të rinj të shquar dhe heroikë, punëtorë të vendosur, të cilët mbeten jashtë radhëve të Partisë. Bile unë mendoj se duhet ndalur më shumë te pranimet e pakta në Parti, sesa te dukuria që të rinjtë nuk bëjnë kërkesa pa u thënë dikush për ta bërë kërkesën, të nisur nga mendimi se gjoja vetëm atëherë janë të sigurt për pranimin në Parti etj., etj.

Natyrisht, rastet e mospranimit të atyre që bëjnë kërkesa, nuk janë të shumta, por edhe kur ky ose ai i ri apo e re nuk pranohet, sepse Partia mendon që akoma nuk i plotëson të gjitha kushtet, kjo s'ka përse të krijojë shqetësime te njerëzit e afërm të kandidatit. Pastaj, pse të vërë kandidati në korent gjithë «botën» se ka bërë lutje për t'u pranuar në Parti, se Partia i ka kërkuar të plotësojë dokumentet dhe se kur u diskutua për të s'u pranua? Kjo është çështje partie e personale dhe s'ka nevojë ta marrin vesh të gjithë. Përveç kësaj, atij që nuk pranohet, duhet t'i thuhet arsyet nga shokët e organizatës-bazë të Partisë.

Ai i ri që nuk pranohet në Parti në këto rrethana nuk ka asnjë arsye që t'i kuptojë gabim shpjegimet e këshillat që i japin shokët e organizatës-bazë të Partisë. Me këtë atij nuk i janë mbyllur përgjithmonë dyert e Partisë, por i kërkohet që të bëjë përpjekje më shumë për ngritjen e tij ideologjike. Pastaj, kur t'i ketë zbatuar

edhe këto këshilla, organizata-bazë do ta pranojë se të tëra kushtet e tjera i ka.

Ne kemi vënë njëfarë kriteri gojor, si të thuash, që, duke marrë parasysh se organizata e rinisë është ajo që e njeh më mirë të riun që dëshiron të hyjë në Parti, duhet ajo t'ia rekomandojë atë organizatës-bazë. Dhe kjo është e drejtë. Por e rëndësishme është, siç e vura në dukje, që vetë i riu të shprehë dëshirën për t'u futur në Parti. Përveç rekomandimit që ai merr nga organizata e rinisë për në Parti, ai duhet të marrë edhe dy rekomandime të tjera nga komunistë me një stazh të caktuar në Parti, sipas Statutit, të cilët e njohin më nga afër. Dhe kjo është një gjë e mirë.

Kur themi që organizata e rinisë është fidanishtja e Partisë, me këtë të nënkuptohet edhe puna e kujdes-shme që duhet bërë për përgatitjen e të rinjve për t'u futur në Parti. Partia në gjithë atë masë të madhe të rinjsh e të rejash të organizuar, të zgjedhë më të mirët, se vetëm elementë të tillë janë të vlefshëm që të hyjnë në Parti. Rezultat i gjithë punës që bëjnë organizatat-bazë dhe i aktivizimit të vetë të rinjve, duhet të jetë edhe fakti që ata ta bëjnë vetë lutjen për t'u pranuar në Parti. Rekomandimi që siguron kandidati është njëra anë, por dëshira për t'u futur në Parti është e të riut ose e së resë.

Vazhdimisht komiteti i Partisë, komiteti i rinisë u flasin të rinjve për rrugën e lavdishme të Partisë, për besimin e madh që ka ajo te rinia. Dhe të gjithë hidhen në ato aksione që u bën thirrje Partia. Aksioni që na besohet, u thuhet nga organizata e rinisë aksionistëve, është një nder që na bën Partia, prandaj të punojmë me

të gjitha forcat dhe të ecim në rrugën e Partisë. Me të tëra këto aktivitete dhe me gjithë veprimtarinë që zhvillojnë organizatat-bazë ne zgjojmë te rinia dashurinë e madhe për Partinë dhe dëshirën e zjarrtë për të punuar, ashtu siç punojnë edhe anëtarët e Partisë. Në të njëjtën kohë kjo rrit tek të rinjtë e të rejtat e devotshëm edhe dëshirën për të qenë anëtarë partie.

Por, mund të ndodhë që një i ri i tillë të ketë një pikë pak të errët në biografinë e tij. Këtë gjë ai t'ia thotë Partisë haptazi, por nuk duhet mjaftuar me kaq. Ai t'i vihet punës atje ku është që të tregojë bindjen e tij të plotë se kjo pikë e dobët që ka në biografi mund të shlyhet.

Ai ka, ta zëmë, një djalë xhaxhai që ka vjedhur, ka bërë burgun sipas vendimit të gjykatës dhe tani punon në kooperativë. Ky i ri i qepet kushëririt këmba-këmbës që ta ndreqë, ta bëjë të kuptojë se ka kryer një krim kundër pasurisë së përbashkët shoqërore dhe se burgu për të, për edukimin e tij, ka qenë i domosdoshëm. Pas punës që bën ky i ri me kushëririn e dënuar shihet se pikërisht ky njeri bëhet mbrojtës i pronës kooperativiste, hidhet i pari në punë e është i palodhur, lufton në mbledhjen e organizatës së Frontit kundër atyre që dëmtojnë kooperativën, u flet për të kaluarën, duke e dënuar veten për atë që ka bërë. Partia e shikon se i riu që ka kërkuar të hyjë në Parti e ka ndihmuar kushëririn e vet, i cili ka ndryshuar në krahasim me përpara kur vepronte si vjedhës. Pa dyshim që edhe shoqëria ka ndikuar në edukimin e këtij njeriu, por ama edhe i riu me punën e tij edukative, bindëse ka kontribuar në këtë drejtim.

Për sa u takon seminareve që do të bëni për pranimet në Parti, që t'i arrihet qëllimit për të cilin organizohen, këto të përgatiten si duhet e jo të bëhet një punë formale. Në seminarin që do të organizoni me sekretarët e organizatave të Partisë të organeve të drejtësisë të theksohet që gjyqtarët duhet t'u vënë kujdes të madh edukimit të ndihmësgjyqtarëve dhe vlerësimit të mendimit të tyre, në mënyrë që pjesëmarrja e tyre në gjykime të mos konsiderohet formale. Këta njerëz për aq kohë sa qëndrojnë si ndihmësgjyqtarë nuk duhet të jenë sa për formë. Ata kanë një detyrë të veçantë edhe për propagandimin e ligjeve. Gjyqtarët aktivë t'i ndihmojnë këta që jo vetëm të marrin dhe të lexojnë dosjet, por të dinë edhe si t'i studiojnë ato dhe si t'i lidhin problemet me ligjet. Domethënë ndihmësgjyqtarët, gjatë 15 ditëve që gjykojnë çështjet e ndryshme gjyqësore, jo vetëm të njihen me faktet që përbëjnë çështjen, jo vetëm të marrin kontakt me njerëzit për t'u njohur me shkaqet objektive dhe subjektive që e shtynë këtë apo atë person të bëjë krim, por gjithashtu t'i lidhin mirë këto veprime edhe me ligjin në fuqi.

Pra, ndihmësgjyqtarët duhet të dinë që për këtë lloj krimi parashikohet ky dënim, për atë tjetrin ai dënim, si dhe rrethanat lehtësuese e rënduese për çdo vepër që parashikon Kodi Penal. Kjo bën që prania e ndihmësgjyqtarëve, kur merren vendime, të mos jetë formale. Pra të mos mendohet nga gjyqtarët se ndihmësgjyqtarët janë atje vetëm sa për të marrë pjesë në gjykim, dhe jo për të vendosur. Ligjërisht ndihmësgjyqtarët kanë të drejtë të vendosin, por që të vendosin drejt, duhet të dëgjohet mirë fjala e tyre. Që të dëgjo-

het fjala e këtyre, që edhe këta ta luajnë mirë rolin e vet, me ta duhet punuar që t'i njohin mirë ligjet. Është e nevojshme të bëhet një gjë e tillë, se këta janë me qindra, në mos me mijëra, që venë në popull, në organizatat e Frontit, në lagje, në fabrikë e kudo dhe i këshillojnë njerëzit, i kritikojnë e u heqin veshin atyre që gabojnë. Për të tilla probleme ata organizojnë mbledhje e takime me banorët, pra ata janë propagandistë, agjitorë të ligjeve tona. Prandaj duhet kuptuar me seriozitet kjo çështje nga shokët e gjykatave. Të mos konsiderohet si gjë pa rëndësi shpjegimi i ligjeve ndihmësgjyqtarëve. Kjo punë të bëhet gjatë kohës që këta thirren në gjyq për të gjykuar. Ndryshe, kur do t'i mësojë ligjet punëtori, që është zgjedhur ndihmësgjyqtar, gjatë kohës kur punon në torno?! Atëherë ai s'ka kohë të merret me këtë punë.

Të kuptohemi, kur themi që ndihmësgjyqtarët të mësojnë ligjet, nuk është fjala për t'i bërë juristë. Këtë çështje e kam theksuar edhe tjetër herë. Ne kërkojmë që të ndihmohen ata për të kryer mirë detyrën që u është caktuar.

Partia dhe organizatat e masave, nëpërmjet punës politike dhe edukative, u mësojnë gjithë njerëzve normat e moralit tonë. Mirëpo ndihmësgjyqtari duhet të jetë propagandues i ligjeve të shokët e tij, ai jo vetëm ndikon tek ata që ta zbatojnë këtë normë apo atë ligj, por edhe i bën që të jenë vigjilentë ndaj keqbërësve, vjedhësve etj., etj. Një parim i njohur juridik thotë: «Çdo shtetas është i detyruar ta dijë ligjin». Ky parim është i drejtë, prandaj asnjëri nuk përjashtohet nga për-

gjegjësia penale kur vjedh ose kur kryen ndonjë vepër tjetër penale, duke pretenduar se «nuk e di ligjin».

Kur themi që njerëzit tanë, veçanërisht të zgjedhuvit në organet gjyqësore, duhet ta njohin ligjin, të njohin parimet ligjore, kjo do të thotë të njohin normat e moralit dhe të së drejtës sonë. Është e qartë se të gjithë nuk mund t'i mësojnë të tëra ligjet që janë në fuqi, por punëtori, të cilin e kanë zgjedhur ndihmësgjyqtar, kur asiston nga dy javë çdo vit në gjyq, kur kthehet në fabrikë apo kudo që punon, ka më shumë mundësi t'ua shpjegojë edhe të tjerëve ligjet. Për këtë ai vetë më parë duhet t'i njohë mirë ato.

*Botuar për herë të parë  
me shkurtime në librin:  
Enver Hoxha, «Për Partinë»  
(Përmbledhje vep-  
rash), vëll. 3, f. 449*

*Botohet i plotë sipas origji-  
nalit që gjendet në Arkivin  
Qendror të Partisë*

## **TË KUPTOIHEN DREJT NDRYSHIMET QË BËHEN NË KODIN TONË TË PROCEDURËS PENALE**

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve  
të KQ të PPSH*

**27 shkurt 1979**

*Pasi u shkëmbyen mendime për disa probleme të sektorit të naftës, biseda kaloi në çështjet e Kodit të Procedurës Penale<sup>1</sup>.*

**SHOKU ENVER HOXHA:** Duhet të jemi të qartë për pozitën e re procedurale të prokurorit në raport me hetuesinë.

Ne nuk kemi thënë se kemi vetëm prokurorin që mbron të drejtat e shtetasve, në këtë drejtim kemi theksuar sidomos gjykatën, e cila, si organ shtetëror i zgjedhur, vendos e zgjidh për çështje penale ose civile. Kemi arsyetuar se e heqim avokatinë për arsye se për sistemin tonë ishte bërë e panevojshme ekzistenca e saj. Ne jemi një vend socialist ku të drejtat dhe liritë e shtetasve

---

1. Trajtuar në vendimin e Byrosë Politike, nr. 19, datë 26.2.1979 «Mbi miratimin e Kodit të Procedurës Penale të RPSSH».



respektohen e sigurohen realisht, sepse për të është e interesuar klasa në fuqi dhe diktatura e saj. Avokatia ishte kthyer në një institucion formal dhe antiedukativ. Avokati që kthyer në një mbrojtës profesionist dhe si i tillë, ai mbronte edhe atë që nuk kishte të drejtë, që vidhte e gënjente. Mbrojtja që katandisur në shprehje e slogane juridike vetëm për të kërkuar mëshirë. Prandaj heqja e avokatisë nuk është mbështetur te puna e prokurorit. Por prokurorit mund t'i bëhen përsëri ankesa për veprime të paligjshme të hetuesit, dhe sipas kushtetutës, t'i godasë me protestë.

Prokurori nuk ka të drejtë të anulojë vetë aty për aty disa vendime të hetuesisë, por bën protestë dhe kur është i bindur në drejtësinë e protestës së tij, ka të drejtë të ankohet edhe më lart, bile deri në Komitetin Qendror të Partisë. Prokurorit i janë dhënë të gjitha të drejtat që i takojnë, duke u bazuar në mësimet e Leninit, i cili ka thënë:

*«... organet e prokurorisë nuk kanë asnjë pushtet administrativ dhe nuk gëzojnë të drejtën e asnjë vote deliberative mbi asnjë çështje administrative». Prokurori, — vazhdon Lenini, — e ka për detyrë të kundërshtojë çdo vendim të paligjshëm»<sup>1</sup>.*

Ligjshmërinë ne nuk ia ekskludojmë, përkundrazi, i japim akoma më tepër prokurorit të drejtën e mbikëqyr-

---

1. V. I. Lenin, Veprat, vëll. 33, f. 404, 405.

jes së zbatimit të ligjshmërisë socialiste. Kur hetuesinë e kishte vetë prokuroria, kjo nuk e kishte ngritur nevojën e një kontrolli të jashtëm. Tani që hetuesia, administrativisht, varet nga Ministria e Punëve të Brendshme drejtuesit e prokurorisë ngrenë çështjen që nga prokuroria duhet të ketë medoemos një kontroll të jashtëm që të ndërhyjë për vendimet e hetuesisë. Kjo pikëpamje është shumë e gabuar dhe tregon se nuk është kuptuar që sundimi politik i proletariatit realizohet te ne nëpërmjet sistemit të organeve shtetërore, të organizatave të masave, që drejtohen e udhëhiqen nga Partia.

Edhe kur hetuesia varej administrativisht nga prokuroria, nuk ndërhynte e nuk e kontrollonte asnjëri nga jashtë punën e saj! Tash hetuesia varet nga një organ tjetër, përse kërkohet të ketë medoemos një kontroll nga jashtë?

Pse bëhen të gjitha këto? Këto bëhen sepse nuk e kuptojnë mirë të gjithë sistemin tonë legjislativ dhe unë mendoj se në prokurori duhet të ketë ndonjë jurist të vjetër që kultivon të tilla pikëpamje. Edhe instruktori që kemi këtu në aparat për drejtësinë nuk është i qartë. Kjo duket nga shënimi i tij me dy pika për hetuesinë që m'u dërgua edhe mua për ta parë. Unë isha në dijeni të të dyja pikëpamjeve, por nuk desha të shprehesha që në fillim, për të mos frenuar debatin. Në një mbledhje të Presidiumit të Kuvendit Popullor bisedova me kryetarin e Gjykatës së Lartë dhe me prokurorin e përgjithshëm dhe mora shpjegime nga të dy. Prokurori vazhonte të qëndronte po në ato pozita, prandaj unë i tërhoqa vëmendjen për këto pikëpamje.

Kur lexova shënimin që bënte për hetuesinë instruktori i aparatit të Komitetit Qendror të Partisë, m'u krijua përshtypja sikur po më thuhej: «Shiko, shoku Enver, mos qëndron këtu padrejtësia që po i bëhet prokurorisë?». Për këtë çështje s'është çudi që, sidomos shokët e prokurorisë, të jenë influencuar nga disa prokurorë të vjetër, të cilët kanë punuar një periudhë të gjatë kohe dhe shkojnë me mendimin se janë ata që kanë bërë Luftën Nacionalçlirimtare, që dinë Artin Ushtarak, që kanë përvojë të pasur për punën e prokurorisë etj. Ka nga ata që mendojnë se prokurorët e sotëm, që kanë mbaruar studimet e larta për drejtësi, s'janë gjë, pasi këta nuk e kanë jetuar atë periudhë të ashpër të zhvillimit të luftës së klasave kur vendosej diktatura e proletariatit. Këto qëndrime janë të gabuara. Edhe karakterin klasor të ligjeve borgjeze s'e kuptojnë drejt disa nga këta prokurorë, për të cilët po flasim. Në aparencë prokurorëve borgjezë u janë dhënë kompetenca të mëdha. Por të gjithë këta, në ushtrimin e të drejtave që kanë, marrin urdhra prapa perdes nga fuqi të jashtme borgjeze, që janë në gjendje t'i imponohen shtetit borgjez, që ky të jetë i pafuqishëm për të vepruar edhe kur atje vritet ish-kryeministri, si, për shembull, Aldo Moro në Itali e ndonjë tjetër. Prandaj propaganda borgjeze për «pavarësinë» e gjykatave, për plotfuqishmërinë e prokurorëve, është fasadë për të zbuluar shtetin borgjez dhe për të mbuluar karakterin e tij shfrytëzues.

Kur e morëm në vendimin për unifikimin e hetuesisë, këtë e bëmë sepse u gjykua se kështu mund të veprimej më mirë. Për ushtrimin e kompetencave të përcaktuara me ligj mund të bëhet fjalë vetëm te ne,

ku populli është në fuqi. Prokurori s'ka të drejtë të votojë e të vendosë për asnjë çështje administrative, por, sipas Leninit, ai ka të drejtën të kundërshtojë çdo vendim të paligjshëm, që të vendoset kuptimi dhe zbatimi i njëllojtë i ligjshmërisë socialiste. Ai mund të ndërhyjë, të protestojë, por zakonisht jo të vendosë e të anulojë vendimet e të tjerëve.

*SHOKU RAMIZ ALIA:* Tashti, në bazë të të gjitha vërejtjeve që u bënë, u plotësua më tej kuadri i kompetencave të prokurorit.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Mendoj se duhen gjetur rrugë të drejta dhe parimore për argumentimin e pikëpamjeve të ndryshme, por jo të mbrohet një mendim me frymë të sëmurë.

Kush e ka për detyrë drejtpërdrejt të zbulojë armiqtë, të zbulojë kriminelët? Organet e Ministrisë së Punëve të Brendshme, Sigurimi i Shtetit. Kjo është një punë e madhe dhe me shumë përgjegjësi, prandaj s'ka përse të pretendojë prokurori që hetimin e krimeve ta ketë ai në dorë. Është e vërtetë që ka mundësi që hetuesi të bëjë gabime, por prokurori ka të drejtën të jetë i pranishëm në veprimet hetimore të hetuesit dhe të reagojë me protestë. Hetuesi e vë në dijeni prokurorin për materialin në ngarkim të personit që propozohet për t'u arrestuar, por ai ka edhe hollësi të tjera në dorë, se i rezulton, për shembull, që para 10-15 vjetëve i akuzuari ka bërë diçka të vogël, që mund të ketë lidhje me krimin për të cilin akuzohet sot. Në një rast të tillë hetuesi ngre një version, e pyet të akuzuarin dhe vazhdon punën e tij.

*SHOKU HYSNI KAPO:* Çështja është tek të dyja

palët, që edhe prokurorët, edhe hetuesit, t'i kuptojnë drejt ndryshimet që bëhen në kodin tonë të Procedurës Penale.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Natyrisht, të dyja palët, sepse nuk mohohet që në praktikë ka pasur gabime edhe nga disa hetues që kanë bërë shkelje të ligjeve, por edhe nga disa prokurorë, që po ashtu kanë shkelur ligjet. Prandaj edhe këta duhet të përgjigjen penalisht për veprimet e kryera kundër ligjit.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga blseda  
e Incizuar që gjendet në AQT*

## **NË NXJERRJEN E NAFTËS TË MBËSHTETEMI MIRË NË TË DHËNAT SIKENCORE**

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**28 shkurt 1979**

Kam edhe unë disa mendime, që dëshiroj t'i them në këtë mbledhje. Po e filloj nga një çështje e tillë: vjen një moment kur shtresa ku gazi ishte i kondensuar me naftë, mbaron dhe arrijmë në një shtresë, në një nivel, ku nuk ekziston më gaz kondensat. Në këtë rast iku kapela gazore dhe tok me të bllokohet edhe nafta. Mirëpo ne duhet ta marrim këtë naftë, atëherë çfarë duhet të bëjmë? Të përdorim metodat intensifikuese?

Ose, ta zëmë, se jemi duke shpuar një pus tjetër, në thellësi jo 4 100 metra, por edhe më shumë, mundësisht aq sa të arrijë ujin. Por, kur e marrim këtë kapelë gazore, kemi parasysh që ky gaz qëndron kurdoherë mbi naftë dhe kjo kapelë gazore nuk mund të jetë një

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua për kualifikimin e punonjësve të shpim-kërkimit të naftës dhe të gazit.

shtresë me një trashësi shumë të madhe; trashësia e saj mund të jetë derisa ekziston ai «tavan», në qoftë se nuk lejon më naftën të ngjitet lart, gazi gjën vend brenda në naftë dhe tretet me të. Natyrisht, ne nuk dimë se sa gaz është tretur, ai mund të jetë tretur edhe deri në fund fare dhe kjo do të thotë se tërë nafta që po gjejmë, mund të jetë plot me gaz, i cili ka një fuqi të madhe shtytëse, përveç ujit. Por uji nuk dihet se ku mund të gjendet, pse ne nuk kemi sonda të tilla për të shkuar në thellësi shumë të mëdha, atëherë ç'do të bëjmë? Do të shpojme, do të shfrytëzojmë në kapelë gazore, pra në naftë të kondensuar? Prandaj, se sa e kondensuar është kjo naftë, këtë do ta shikojmë gjatë rrugës, duke shpuar puse të tjera. Por teknikisht mund të ndodhë edhe një gjë e tillë, që kjo kapelë gazore nuk është e thënë të jetë edhe dy kilometra larg atij pusi. Mund të jetë një kilometër, ose një çikë më tutje, nafta mund të jetë fare pa kapelë gazore, por brenda ajo ka gaz, ka fuqi shtytëse. Atëherë, që ta përcaktosh shtrirjen e kësaj kapele gazore, duhet të shposh shumë puse. Por a është e nevojshme që të bëhet një gjë e tillë për këtë qëllim?! Ne, aktualisht, shohim që kemi një kapelë gazore dhe nafta është e kondensuar, gazi ka një fuqi shtytëse të madhe dhe nafta del.

Shpojme pusin tjetër për të matur shtresat. Ne kemi vajtur, për shembull, në thellësinë 4 500 metra, matim shtresat dhe shkojmë në një drejtim tjetër, dhe në 4 300 metra thellësi gjejmë në 300 metra prapë një kampion me naftë, mbi të gjejmë edhe gaz. Këtu vërtetojmë që shtresa ngjitet ose ka këtë rënie, më tutje nuk gjejmë hiç fare ose gjejmë diçka. Zbresim në inkli-

nacionin tjetër, atje, në 2 500 metra thellësi gjejmë një kapelë gazore tjetër, gjejmë dhe naftë. Pra edhe këtu, në 300 metra gjejmë po këto gjëra. Pse ndodh kështu? Sepse janë vazot komunikuese, siç tha shoku Simon [Stefani], që është naftëtar i vjetër dhe i di mirë këto gjëra. Pra, në një vend është mbyllur kapela gazore, por gazi përpiket të gjejë një vrimë dhe të dalë në inklinimin tjetër, por këto inklinime të tjera nuk duhen konsideruar përnjëherë si fushë e re naftë, me kapelë gazore. Gjithë këto janë teorira!

Mua më duket se në shkencën e naftës ka disa parime të përcaktuara, nga të cilat duhet të udhëhiqen specialistët tanë në këtë fushë, pastaj çdo vend ka karakteristikat e veta që varen nga terreni, por në një vend si ky yni, me një sipërfaqe të vogël, nuk ka ndryshime shumë të mëdha nga një zonë në tjetrën. Ndryshime të mëdha nuk ka as në Sahara, as në Arabinë Saudite e në vende të tjera si këto e jo më të ketë këtu! Nuk duhet menduar që Arabia Saudite ose Saharaja janë vende vetëm me fusha. Jo, në sipërfaqe duket kështu, por në Sahara ka edhe male të mëdha, siç janë malet e Hogarit, për shembull, por atje nuk ka naftë, veçse edhe atje ku ka, ka edhe thyerje tektonike, çarje të mëdha.

Fusha e naftës nuk është fushë futbollit, njëlloj kudo, por është me të ulura e me të ngritura dhe gazi është fluid, ku gjen vrimë, ai futet, ecën, ecën. Prandaj mendoj se nuk mund të ketë një përcaktim ekzakt të përpjesëtimeve të naftës me gazin. Në një zonë, për shembull, nuk ka kapelë gazore, sepse gazi, ta zëmë, ka ikur. Po ku ka vajtur, nuk dihet. Ka vajtur ku ka



gjetur vend. Rëndësi për përcaktimin e përpjesëtimeve të gazit me naftën kanë edhe studimet gjeologjike e tektonike të strukturave. Në qoftë se strukturat janë të tilla, që këtu ku është nafta ka edhe gaz, natyrisht shtrirja e kapelës gazore mund të thuash se është tre kilometra, por mund të jetë më shumë. Gazi, po gjeti një vrimë ikën, naftën e lë në vend dhe vetë largohet dhe shkon në një vend tjetër, në qoftë se nuk gjen mundësi për të dalë, atëherë mbetet atje.

Çështja është këtu që shokët e ministrisë dhe disa specialistë kanë bërë gabim që kanë vajtur në kundërshtim me ju, shokët e bazës, dhe me porosinë e Komitetit Qendror. Komiteti Qendror nuk e ka dhënë kot porosinë që, po takuat në naftë, përvetësojeni atë, pastaj shkoni më tej. Kjo është thënë për arsye se kriza energjetike e botës influencon edhe në Shqipëri. Në këtë situatë nafta përbën një nga problemet kryesore, se çmimi i saj në botën kapitalisto-revizioniste është ngritur në qiell. Në kushte të tilla, pas dhjetë vjetësh, pas një sabotimi të madh në këtë degë jetike të ekonomisë, ne gjejmë një fushë nafte. Pra kemi nevojë që të gjejmë naftë dhe ta shfrytëzojmë në mënyrë shkencore vendburimin, pusin e naftës, dhe jo ta zgjatim afatin e përvetësimit të pusit duke bërë teorira. Nafta të thotë: ja ku jam, më nxirr nga pusi! Kështu do t'i japim shtetit shqiptar naftë, për të plotësuar nevojat që ka ekonomia jonë dhe për të eksportuar. Duam naftë edhe për eksport, ndryshe me se do t'i blejmë makineritë që na duhen për këtë apo për atë sektor? Kemi nevoja për Kombinatin Metalurgjik, për Fabrikën e Ferrokromit, për turbina për Hidrocentralin e Komanit etj. Po si do t'i

përballojmë këto nevoja për ndërtim e shfrytëzim? Me punë të vazhdueshme këmbëngulëse, duke u mbështetur në të dhënat shkencore dhe duke i shfrytëzuar ato si duhet që të arrijmë rezultate sa më të mira në sektorin e naftës dhe në të gjithë sektorët e tjerë të ekonomisë.

Për naftën kanë rëndësi projektet që hartohen sipas orientimit të Komitetit Qendror që thotë: shko nga lart-poshtë, në qoftë se gjen naftë, merre atë dhe fillo pusin tjetër, shko më poshtë, gjete dhe atje, merre, po s'gjete, shko më poshtë, sipas projektit. Një projekt që nuk zbaton këtë orientim, s'ka ç'na duhet. Pra, të re-  
tlektohet dhe të merren masa që pusët të mos bien në avari. Prandaj kemi një numër të madh inxhinierësh e specialistësh. Këta duhet të punojnë me përgjegjësi. Punëtori e dëgjon inxhinierin dhe e zbaton urdhrin e tij. Pse? Se e kupton që inxhinieri di, e ka mësuar Partia në shkollë. Por kur pusi bie në avari, kush e ka fajin? Brigadieri, përgjegjësi, punëtori, tekniku i mesëm? Po inxhinieri? Po urdhrin që të futej në pus një tub, kush e dha? Inxhinieri! Por ky nuk mund të projektojë e të veprojë pa përgjegjësi.

Pra struktura duhet vëzhguar vazhdimisht në shpim nga inxhinieri gjeolog, i cili të mos mendojë se e njeh si në pasqyrë strukturën e këtij apo të atij pusi. Edhe komandanti i një reparti ushtarak nuk duhet të shkojë me mendimin se e njeh plotësisht e si duhet atë kodër, për të cilën ka urdhër ta zaptojë, qoftë edhe pse ka shkuar andej dhe e ka parë me sy kodrën. Inxhinieri gjeolog ka të bëjë me një shkencë, e cila i jep të dhëna, 90 për qind të të cilave mund të përputhen me realitetin, kurse 10 për qind jo.

Në qoftë se përgjegjësi i pusit nuk i qëndron mbi kokë punës në pus, derisa të vejë sonda në thellësinë e parashikuar në projekt, atëherë mund të ndodhë që gjatë shpimit të ecet shumë shpejt, të punohet për metrazh, duke mos respektuar rregullat teknike, duke mos bërë matjet e nevojshme dhe duke mos zbatuar projektin. Kështu që pusi devijon. Atëherë ngrihet lart sonda dhe bëhet taposja. Përse ndodh devijimi? Për arsye se punëtori do të ikë me të shpejtë, por më poshtë takon në një terren të fortë dhe atje nuk mund të ecë me atë normë që i është caktuar për shpimin në një terren të butë. Prandaj norma në këtë rast duhet parë. Norma nuk varet plotësisht nga punëtori, as nga ç'i ka thënë atij ndonjë drejtor i ministrisë. Për realizimin e normës ai vë para së gjithash interesin e Partisë, që duhet të shpenzojë sa më pak dhe të bëjë sa më shumë shpime sondë-muaj (por pa harruar këtu strukturën e tokës). Punëtori nuk e di se me ç'strukturë toke ka të bëjë, këtë e di inxhinieri gjeolog, ai i shpimit e të tjerë. Pra «doktori» që i jep ilaçin e di, ai i thotë këtij: «Mos i merr me grushte «aspirinat», po një aspirinë në çdo vakt. Më tepër s'të jap». Kështu, kur inxhinieri s'i ndahet pusit, por e ndjek punën hap pas hapi, atëherë ai është në dijeni në kohën e duhur për çdo gjë në procesin e shpimit. Për shembull, kur shikon se sonda nuk ecën si në fillim, atëherë ai jep urdhër: «Të ulet shpejtësia derisa të arrijë atje ku duhet». Pra, kërkoet kujdes! «Shpejtësinë, — thotë ai, — do ta shtojmë më vonë, tani duhet të ecim me kujdes e me ngadalë».

Në këtë mënyrë vepron inxhinieri edhe për zgjidhjen e problemeve të tjera të shumta që lindin në pu-

në e sipër, veçse të gjitha këto bëhen në qoftë se ai rri pranë pusit. Po ç'bën ai në realitet? Inxhinieri gjeolog shkon në zyrë, punon atje në bazë të hartave gjeologjike me përgjithësime, duke u bazuar edhe në të dhënat, të cilat unë i besoj, por mendimi im është se ato nuk ta japin në asnjë mënyrë qind për qind ndërtimin gjeologjik. Rol të madh në këtë çështje luan eksperiencia e përditshme. Që mjeku të përcaktojë me saktësi se një pacient ka ulcer apo kancer në stomak, ai duhet ta operojë atë dhe të ndjekë gjendjen e pacientit pas operacionit. Po kështu edhe gjeologu duhet ta shohë sondën si ecën gjatë shpimit. A takon në atë shtresë që ka parashikuar? Në qoftë se nuk takon, ai mund të urdhërojë punëtorin e shpimit të bëjë devijim, duke ia shpjeguar qartë se sa duhet të jetë ky devijim, me qëllim që pusi të mos bjerë në avari. Tash, unë nuk di se si veprohet konkretisht në këto raste, por flas në parim.

Është fakt, që një numër pusesh na bien në avari, duke i shkaktuar dëm ekonomisë. Kjo tregon edhe dobësinë e punës së Partisë në sektorin e naftës. Pikërisht për këtë arsye bëri pyetje edhe shoku Hysni [Kapo]. Këtu u tha se punëtori preokupohet për të mos ndodhur avaritë. Mirë, dakord, është e vërtetë që ai preokupohet, por jo aq sa duhet dhe kurdoherë. Pse e them këtë? E them se ka edhe punëtorë që, duke dashur të marrin para sa më shumë, rendin pas metrazhit, pa menduar si duhet se ku shkojnë. Pra, nga kjo del se ka punëtorë që nuk preokupohen sa duhet, se po të qe ndryshe, ata sapo të hasnin në rezistencë, do të reagonin menjëherë ndaj gjeologut ose inxhinierit. Dhe në qoftë se inxhinieri ose gjeologu i thotë punëtorit: «Bjeri or ti nor-

mës, shtojë shpejtësinë!»), punëtori i ndërgjegjshëm i përgjigjet: «Jo, nuk e shtoj, sepse këtu gjej një rezistencë. Ma shpjego, pse hasa në këtë rezistencë? E ke parashikuar drejt gjeologjikisht apo nuk e ke parashikuar? Tashti që më urdhëron të bëj devijim, më jep të dhëna se sa duhet të devijoj, sa duhet ta çoj këndin, sa duhet ta pakësoj shpejtësinë» etj., etj. Po të ketë të tillë kërkesë llogaric me siguri që punët do të ecin mirë edhe në këtë sektor. Pse preokupim i thonë atij kur inxhinieri shkon e fle pa merak fare në shtëpi kur sonda punon?!

Ju pyes ju, shokë, që diskutuat sot këtu: a jeni të ndërgjegjshëm se për të gjitha këto që ndodhin në sektorin e naftës ka përgjegjësi vetëm organizata e Partisë e këtij sektori? Përgjegjësi kanë punonjësi i Partisë, inxhinieri, punëtori i thjeshtë, qoftë ky anëtar partie ose jo, me një fjalë, gjithë punonjësit e naftës. Mirëpo a punohet me ndjenjë të lartë përgjegjësie nga të gjithë? Mua më duket se nuk punohet kështu. Po ç'duhet bërë? Unë jam i bindur se ju (gjeologë, inxhinierë, kryeinxhinierë, mjeshtër dhe punëtorë të vjetër) i kuptoni të gjitha këto gjëra edhe politikisht, edhe ideologjikisht, edhe nga ana organizative. Moszbatimi i rregullave tekniko-shkencore, mungesa e disiplinës etj., etj., të tëra ndodhin sepse ju nuk i mbani parasysh si duhet në punën tuaj parimet bazë të Partisë. Ka mbeturina, ka vetëkënaqësi, siç theksuat gjatë diskutimit tuaj, ka fodullëk, ka indiferentizëm etj. Të gjitha këto janë të lidhura me realizimin e planit, reflektohen në deficitet që i kanë krijuar ekonomisë mosrealizimet. Në qoftë se konstatohet që ka mungesë disipline nga punonjësit e pusit, punëtori i Partisë të bëjë një bisedë me ta. Por nuk mja-

fton vetëm kjo. Njerëzit duhen bindur e duhen kontrolluar se si punojnë për zbatimin e detyrave. Medoemos duhet disiplinë e fortë atje ku punon sonda. Por, që të kërkohet llogari e të ushtrohet kontroll i vazhdueshëm, është e domosdoshme që përgjegjësi i pusit të jetë një njeri që ta kuptojë rëndësinë e detyrës së tij. Edhe ai që ka bërë projektin, që ka studiuar shtresat, duhet të rrijë natë e ditë atje te pusi e ta ndjekë shpimin në proces. Po të bëhet kështu, atëherë me siguri që gjendja do të ndryshojë dhe pusët nuk do të bien në avari njëri pas tjetrit.

Për projektvendimin që na është paraqitur, unë kam shkruar një vërejtje: «Litar pa mbarim». A do të mësohemi, shokë, të bëjmë projektvendime? T'ju them të drejtën e lexova dhe e lexova këtë material dhe hiç nuk mora vesh se ç'kërkohet. Sipas mendimit tim, gjysmë faqe, e shumta një faqe, do të ishte e mjaftueshme për këtë projektvendim, duke e bërë të qartë qëllimin, jo të bëhet kjo e të bëhet ajo dhe si përfundim ideja nuk del qartë. Prandaj të studiohen më parë këto gjëra dhe të mos na paraqiten kështu. Të na paraqitet një projektvendim i mirë e konkret për kualifikimin e punonjësve të shpim-kërkimit të naftës e të gazit.

Në radhë të parë, ju shokë që ju kemi thirrur këtu të keni parasysh këtë këshillë: të forconi punën e Partisë, kontrollin për zbatimin e detyrave. Anëtarët e Partisë e kryejnë detyrën e Partisë kur realizojnë planet e shtetit që ka aprovuar Partia. Kur dikë nuk realizohen këto plane, do të thotë se organizata e Partisë nuk udhëhoq si duhet, nuk është në pozita të shëndosha dhe kjo e parë në të gjithë gamën e saj. Kur Partia

është e bindur për një problem të caktuar, atëherë ky duhet mbrojtur deri në fund, çështja të çohet deri në Komitetin Qendror, po të jetë nevoja, dhe të mos lejohet në asnjë mënyrë imponim, centralizëm burokratik, por gjithmonë të gjejë zbatim parimi i centralizmit demokratik. Në qoftë se ti më bind me arsyetimet e tua duke m'i hedhur poshtë argumentet e mia, atëherë unë duhet t'i nënshtrohem mendimit tënd të drejtë, pavarësisht se cili jam. Edhe ti duhet t'i nënshtrohesh mendimit tim, në qoftë se është i drejtë, i arsyeshëm. Ç'e vërteton më mirë drejtësinë e mendimit të njërit ose të tjetrit? Natyrisht, e vërteton rezultati, por megjithatë, duke u mbështetur në njohuritë e fituara dhe në përvojën e punës, për këtë apo për atë problem, një vendim duhet marrë. Rezultati e provon kush e ka pasur drejt dhe kush nuk ka pasur të drejtë, se nganjëherë dhe mund të gabojmë. Edhe baza mund të gabojë, por edhe udhëheqja mund të gabojë në dhënien e vendimeve. Prandaj duhet të njihet gabimi nga kushdo që të jetë bërë, nga baza ose nga udhëheqja, ndryshe puna e Partisë nuk kuptohet si duhet.

Këtë e tutje të bëni shumë kujdes për realizimin e planit të naftës. Kjo ka shumë rëndësi se nafta është një nga lëndët e para nga më të rëndësishmet të vendit tonë, që përbën një burim kryesor për të ardhurat e shtetit. Kur ngjajnë avari të tilla, të shumta e merren rezultate të pakënaqshme vazhdimisht në këtë sektor, Partia nuk duhet të qëndrojë vetëm në pikëpamjen që këto ndodhin sepse nuk zbatohen rregullat teknike ose për shkak të studimeve jo të plota, për shkak të asaj ose të kësaj. Në fakt kështu është, rregullat nuk zba-

tohen, studimet nuk bëhen si duhet, por duhet parë nëse këto gjëra bëhen pa dashje ose me dashje. Këtu qëndron zgjuarsia e Partisë, këtu duket vigjilenca e saj. Në qoftë se projektet e rregullat nuk zbatohen me dashje, atëherë kjo duhet parë se mos ka punë armiqësore. Avaritë e shumta nuk mund të shpjegohen vetëm me pakujdesi, vetëm për shkak të mendjemadhësisë, të arrogancës së njërit apo të tjetrit. Edhe me këto shpjegohen, sepse puna armiqësore bëhet edhe nga të tillë njerëz, që nuk janë në rrugë të drejtë, që e lënë punën në mes të rrugës, që e sabotojnë atë. Kjo do të thotë që ata nuk punojnë në bazë të vijës së Partisë, nuk kuptojnë rëndësinë, dhe si rrjedhim nuk çajnë kokën fare se vuan populli shqiptar, se Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë vihet në vështirësi.

Shokëve të ftuar për këtë pikë të rendit të ditës u urojmë punë të mbarë!

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Sekre-  
tariatit të KQ të PPSH,  
që gjendet në AQP*



# NË PROGRAMET E KURSEVE TË KUALIFIKIMIT TË ZËRË VEND MIRË ANA TEORIKE DHE AJO PRAKTIKE

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

28 shkurt 1979

Tani kemi çështjen e dytë të rendit të ditës. Kush ka pyetje ose ndonjë vërejtje rreth projektdeklarave për thellimin e lëvizjes së novatorëve e të racionalizatorëve? Kush dëshiron të diskutojë?

*Pasi folën disa nga shokët e ftuar në këtë mbledhje, e mori fjalën shoku Enver Hoxha:*

Mua më duket se në punën e Bashkimeve Profesionale ka shumë llafe dhe pak gjëra konkrete. Ja, për shembull, për ç'disiplinë mund të flitet në sektorin e naftës kur ngjajnë avari? I caktoni vetes detyra konkrete ju kuadrot drejtues të Bashkimeve Profesionale për ndjekjen e problemeve në këtë apo në atë ndër-

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua për detyrat që dalin nga mbledhja e Sekretariatit të Komitetit Qendror për thellimin e mëtejshëm të lëvizjes së novatorëve e të racionalizatorëve.

marrje? A e keni parë ju përse ndodhin avari në pusët e naftës? Ju ngritët këtu problemin e kualifikimit të punëtorëve. Po ç'prisni që nuk kërkonit të merren masa për kualifikimin e tyre?

Ju, sigurisht, punoni, përpiqeni, nuk them se jo, por duhen analizuar një çikë këto gjëra një e nga një e në mënyrë konkrete, se flasim e flasim, po rezultati? Pastaj ju keni kompetenca. Organizata e Bashkimeve Profesionale është një levë e Partisë, prandaj të shkoni atje në Komitetin e Partisë të Rrethit të Fierit apo të Vlorës dhe bisedoni shtruar me ta, si për punën, edhe për kurset e kualifikimit për punëtorët e naftës. Por atje do të shkoni pasi të keni marrë edhe mendimin e punëtorëve që duan të kualifikohen.

Kurset, mendoj unë, duhet të bëhen jashtë orarit të punës; dy orë para se të flenë, të venë në kurs. Edhe kohë për të pushuar kanë boll. Pse, nuk sakrifikojnë dot këta një orë, një orë e gjysmë apo dy orë për një gjë të tillë? Po ju, të Bashkimeve Profesionale, nuk jeni në gjendje që të konsultoheni me ta, të merrni masa për sigurimin e lokaleve, të bankave dhe të personelit që do të japë mësim? Pastaj pasi të keni marrë të gjitha masat u thoni atyre të komitetit të Partisë që të tëra i kemi gati, që nga bankat dhe deri te lokali dhe mësuesit dhe kështu të hapen kurset. Por në to të mos bëhet punë formale, siç u tha këtu.

Gjatë procesit të mësimdhënies, inxhinierët, specialistët, të mos bëjnë teori për teori, por të shpjegojnë procese konkrete, si për shembull, si të bëjë punëtori regjistrimin e lëkundësit, apo ndonjë gjë tjetër. Për këtë mund të aktivizohen edhe mjeshtrit më të mirë,

të cilët kanë përvojë të gjatë pune dhe u mësojnë punëtorëve të rinj gjëra konkrete. Dhe ky është qëllimi i kurseve të kualifikimit që t'i ndihmojmë konkretisht punëtorët të kualifikohen për ta kryer sa më mirë detyrën e caktuar.

Kurset e kualifikimit, mendojmë, ndihmojnë edhe për atestimin dhe nuk e pengojnë këtë. Punëtori do ta ketë më të lehtë të japë provim për atestim, kur ai ka mësuar në këto kurse disa gjëra kyçe, konkrete, të rëndësishme për punën e tij. Punëtori, vërtet atestohet me shkollën, por mendoj që në disa raste shkolla bën një punë të sipërfaqshme dhe ua jep atestimin punëtorëve edhe pse këta nuk futen thellë në ato probleme, për të cilat është i domosdoshëm një kualifikim i veçantë. Detyra e shkollës është që ata që venë atje të mësojnë mirë përmbajtjen e plotë të kësaj apo të asaj lënde dhe jo thjesht t'u përgjigjen disa pyetjeve që bën mësuesi.

Pastaj, megjithëse një punëtor ka mbaruar shkollën teknike, unë mendoj se ai duhet të ndjekë edhe kurset e kualifikimit, sepse në shkollë ai ka mësuar parimet dhe gjërat më të përgjithshme, por proceset konkrete ai i ndesh në praktikë. Kursi e ndihmon atë që t'i njohë konkretisht ato e t'i kryejë sa më mirë në punën e përditshme.

Çështjen e kishim këtu, që Bashkimet Profesionale duhet të interesohen e të merren më mirë me këto probleme. Puna e tyre nuk duhet në asnjë mënyrë të reduktohet vetëm në agjitacionin politik e në organizimin e garave. Edhe organizimi i garave ka rëndësi të madhe, prandaj duhen organizuar me synime të

caktuara. Çdo garë ka disa objektiva, të cilët mund të arrihen me punë të kualifikuar nga ata që konkurrojnë. Por në qoftë se gara organizohet vetëm sa për të fituar një titull, siç shikojmë nganjëherë në gazetë, për shembull: kush do të fitojë titullin e 35-Vjetorit të Çlirimit etj., kjo nuk është e mjaftueshme. Të kuptohemi, edhe kjo është gjë e bukur dhe duhet praktikuar, por flamuri nuk jepet kot. Duhet punë e gjithanshme në këtë drejtim. Organizatat e bashkimeve profesionale (dhe në çdo qendër pune ne i kemi këto organizata) duhet të merren me të gjitha problemet që kanë të bëjnë me ngritjen ideopolitike dhe profesionale të punëtorëve. Një nga këto probleme kyç është hapja dhe funksionimi si duhet i kurseve të kualifikimit. Programin e këtyre kurseve ato ta hartojnë me specialistët, në përputhje me problemet, me dobësitë që ka kjo apo ajo ndërmarrje. Pra, të ndikoni që të bëhen të qarta drejtimet e punës të këtyre kurseve.

Ose një pikë tjetër e rëndësishme për të fituar garën mund të jetë çështja e disiplinës shtetërore. Këtu organizata e bashkimeve profesionale të ndalet e t'i caktojë vetes detyra se çfarë duhet të bëjë që kjo disiplinë të zbatohet sa më mirë. Punë politike, por edhe punë administrative, po të jetë nevoja, do të bëhet.

Kështu duhet menduar e duhet vepruar për të gjitha problemet me radhë. Por mua më duket, mbase gabohem, se nuk punohet kështu nga Bashkimet Profesionale, të cilat, si leva të Partisë, e kanë për detyrë

dhe të drejtë që, për zbatimin e një vendimi të Partisë apo të vendimeve që keni marrë ju si sekretariat i Këshillit Qendror të Bashkimeve Profesionale, të aktivizojnë kuadro e komunistë të ndryshëm, si anëtarë të Bashkimeve Profesionale, dhe të ndjekin e të ndihmojnë për zbatimin e vendimeve e të direktivave të Partisë. Në këtë drejtim, ju shokë të Bashkimeve Profesionale, keni një punë të madhe për të bërë.

Për sa i takon përvojës së shokëve të Uzinës së Instrumenteve në Korçë që e thjeshtuan dhe e lidhën programin e kursit me nevojat konkrete për aftësimin e punëtorëve për prodhimet e reja, mund të zbatohet në ndonjë rast, por nuk është kjo e tëra. Them kështu, se ka punëtorë që nuk njohin bazat e proceseve të ndryshme të punës, për zotërimin e të cilave ata duhet të përgatiten. Pra, në qoftë se thjeshtimi i programit të kursit të kualifikimit bëhet duke lënë mënjanë përveçsimin e njohurive bazë të proceseve të punës, kjo është e gabuar. Kështu punëtori specializohet, por vetëm në një drejtim, për një instrument të caktuar.

Ne të synojmë që të ngrihet niveli arsimor dhe teknik i punëtorëve. Prandaj t'i kushtohet vëmendje përgatitjes së programeve të kurseve të kualifikimit, të shikohet sa vend duhet të zërë ana e përgjithshme teorike dhe sa ana praktike, të rregullohet një raport i arsyeshëm midis tyre. Përveç kësaj, unë mendoj se punëtorëve duhet t'u japim edhe kulturë të përgjithshme, sepse për këtë kanë nevojë, që ta kuptojnë më mirë rëndësinë e kryerjes së detyrave. Në të kundërtën, ai që bën avari nuk e vret mendjen për mangësitë.

Është një kompleks i tërë ky. Prandaj të punohet që punëtorët të marrin edhe kulturë profesionale, por edhe kulturë të përgjithshme.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Sekre-  
taratit të KQ të PPSH,  
që gjendet në AQP*

**TREGUESIT**





## TREGUESI I LËNDËS

### A

*Aftësia prodhuese, shfrytëzimi i saj* — 58-60.

*Ambasadat e RPSSh në vende të ndryshme të botës* — 181, 282, 285.

*Arkivat, dokumentet arkivore* — 342-343.

*Armiqtë, veprimtaria armiqësore dhe lufta kundër tyre* — 207, 246, 258, 354.

*Arsimi në RPSSh — metodat e mësimdhënies; mësuesit, pedagogët* — 263-264.

*Arti Ushtarak i Luftës Popullore — përvetësimi i tij; roli i njeriut dhe i armëve në luftë* — 354.

### B

*Bashkimet Profesionale të Shqipërisë; detyrat e tyre* — 19-20, 62, 411-415.

*Bashkimi Sovjetik (1917—1953)* — 63-65, 75, 153, 272-273.

*Bashkimi Sovjetik, socialimperializmi sovjetik*

— gjendja e brendshme, degjenerimi kapitalist; strategjia e taktikat; politika e jashtme ekspansioniste e luftënxitëse — 77, 91, 92, 117-118, 119, 168-169, 170, 171-172, 196, 198, 206-207, 273, 304, 306-307, 310, 383-384;

— qëndrimi ndaj Kinës e ndaj Vietnamit; qëndrimi ndaj revolucionit iranien — 54, 75-76, 78, 117-119, 177, 304.

*Blegtoria në RPSSh; baza ushqimore, foragjeret* — 18-19.

*Borgjezia* — 114, 203-204, 205, 273-274, 376.

*Britania e Madhe; imperializmi anglez* — 85, 101, 102, 187-188, 189, 283, 295, 303, 365.

*Bujqësia në RPSSh; organizimi i punës; perimet, patatja* — 18-19.

### C

*Centralizmi demokratik* — 409.

## D

- Dekorimet, kriteret e dekorimit* — 226-229.  
*Demokracia borgjezo-revlzioniste* — 139-140, 148, 150.  
*Diktatura e proletariatit, forcimi i saj* — 35.  
*Disiplina proletare; forcimi i pandërprerë i saj* — 19-20, 27, 362-363, 414.

## E

- Edukimi komunist; edukimi ideopolitik* — 314, 392.  
*Ekonomia popullore — politika e Partisë për zhvillimin e saj* — 28-29, 237-240, 243-250, 258.  
*Emulacioni socialist* — 413-414.  
*Engels, Fridrih* — 42, 64, 66, 76, 125, 186, 263, 269, 274, 278, 286.  
*Enver Hoxha — të dhëna autobiografike* — 4, 251-252, 255, 342, 345, 354.  
*Evropa, «Evropa e Bashkuar»; aleancat dhe kontradiktat me superfuqitë* — 86, 87, 88, 89, 90, 92, 102, 115, 161, 169, 170-171, 173, 174, 268, 302, 303, 304, 308, 310.

## F

- Familja — roli i saj në edukimin e fëmijëve* — 339.  
*Feja, karakteri reaksionar i saj* — 374, 375.  
*Financat — ndërmarrjet që subvencionohen nga shteti dhe ato që dalin me humbje* — 15.  
*Folklori* — 343-344.  
*Franca; politika e jashtme, lidhjet me Kinën* — 85, 101, 102, 105-106, 171, 255, 288, 303, 347, 371, 372.  
*Fuqia punëtore — kurset e kualifikimit, atestimi* — 412-416.

## GJ

- Gjeologjia, studimet gjeologjike; gjeologët* — 242, 403, 404-407.  
*Gjykata e Lartë* — 218, 219, 396.  
*Gjykata popullore; kompetencat; organizimi; gjyqtarët, ndihmës gjyqtarët* — 217-221, 223-225, 391-393, 394.

## H

- Hetuesia, riorganizimi i saj* — 222, 223, 396, 398.

*Historia e popujve të botës, e kulturës dhe e qytetërimit të tyre* — 187, 377-378.

## I

*imperializmi* — karakteristika; përcaktimi leninist për tiparet dhe natyrën e imperializmit — 189, 251, 364, 365, 371;

— strategjia dhe taktikat; politika hegjemoniste dhe ekspansioniste; aleancat dhe kontradiktat ndër-imperialiste — 74, 110, 112-113, 114-115, 116-119, 121-122, 160-161, 173, 188-190, 297-299, 301-303, 308-309;

— kriza, pashmangësia e zhdukjes së tij; lufta e popujve të botës kundër imperializmit — 89-90, 114-115, 122, 167, 174, 299, 304-305, 311-312, 376-377, 332-333.

*India; gjendja e brendshme* — 90, 91, 114, 164, 170, 172, 173, 364, 365-366, 367.

*Irani; gjendja e brendshme* — 91, 92, 114, 125, 187-191, 364, 365, 366-367, 368;

— revolucioni demokratiko-borgjez antimperalist Iranian; faktorët objekti-

vë dhe subjektivë të shpërthimit të tij — 89, 164-167, 192-199, 241-242, 371-373, 375, 376-377, 378-383.

*Italia; gjendja e brendshme; politika e jashtme* — 205, 253-254.

## J

*Japonia; gjendja e brendshme; politika e jashtme; marrëdhëniet me Kinën* — 49, 50, 85, 89, 90, 101, 104-105, 109, 113, 117, 156-159, 160-161, 162-164, 172, 288, 295, 307.

*Jugosllavia, revizionizmi jugosllav; lidhjet me imperializmin amerikan, qëndrimi ndaj Kinës* — 298, 307;

— qëndrimi armliqësor ndaj PPSH dhe RPS të Shqipërisë — 253, 267.

## K

*Kamborhia; gjendja e brendshme, lufta e saj kundër imperializmit amerikan* — 90, 113, 118, 179-181, 182-183, 184, 185, 304;

— marrëdhëniet dhe qëndrimi ndaj Kinës e Vietnamit — 179, 183.

**Kapitalizmi** — karakteristika të përgjithshme; kriza dhe pasëmangësia e zhdukjes së tij — 250, 257-258, 267, 270, 278, 368-369, 376, 403.

**Këshillat popullorë, komitetet ekzekutive të këshillave popullorë të rrethëve** — 17, 31, 231, 232, 239.

**Këshilli i Ministrave (Qeveria), Kryesia e Këshillit të Ministrave** — 2, 3, 8, 10, 14, 15, 18, 59, 212-213, 356.

**Kina, revizionizmi kinez; Partia Komuniste e Kinës, fraksionet në parti** — 51, 73-74, 138, 143, 144-145, 146-155, 156-157;

— vija e saj antimarksiste; politika e jashtme pragmatiste, hegjemoniste dhe luftënxitëse — 50, 54-55, 66-79, 92, 101-102, 106, 112, 115, 121, 129, 137-138, 151-152, 179, 181-182, 292-294, 296-297, 303;

— zhvillimi i kapitalizmit në Kinë, degjenerimi i bazës dhe i superstrukturës, depërtimi i kapitalëve të huaja; demagogjia e tyre për ndërtimin e socializmit — 44, 49, 54-55, 71-72, 74-75, 104, 105, 119-120, 136-137, 139,

147-155, 161-162, 303-304, 307, 309;

— gjendja e brendshme; lufta e grupeve për pushtet, qëndrimi ndaj «katerëshes»; Revolucioni Kulturor. Zyra e Përgjithshme — 43-57, 63, 70, 73-76, 77, 79-80, 83-85, 94-100, 102-104, 111-112, 120-121, 123-124, 125-130, 131, 132, 133-137, 140, 144-149, 151, 152-153, 159-160, 292-293, 305-306;

— klasat dhe lufta e klasave në Kinë; qëndrimi ndaj borgjezisë — 53, 55, 70-72, 131;

— lidhjet dhe bashkëpunimi me ShBA, me Japoninë e me shtetet e tjera kapitaliste; marrëdhëniet e kontradiktat me revizionistët sovjetikë — 49-50, 53, 76-78, 81-82, 83, 85-87, 88, 94, 98-99, 100-101, 102, 104-105, 106-110, 115, 116, 117, 118, 130, 143-144, 145, 159, 162-164, 170, 174, 176, 177, 291-294, 295-296, 299-300, 303;

— marrëdhëniet me revizionistët jugosllavë e rumunë — 50, 101-102, 104, 154-155, 176;

— përkrahja për klikat rea-

- ksionare — 125, 151-152, 191-192;
- qëndrimi ndaj Bashkimit Sovjetik (1917—1953) e ndaj Stalinit — 75;
- strategjia dhe taktikat; synimet dhe përpjekjet për t'u bërë superfuqi — 44-45, 55, 75-89, 90-91, 100-101, 106, 113, 115, 116, 144, 159, 169;
- marrëdhëniet e kontradiktat me Vietnamin, qëndrimi ndaj çështjes vietnameze dhe ndaj konfliktit kamboxhiano-vietnamez — 113, 176-177, 178-179, 181-182, 183;
- qëndrimi ndaj çështjes së Tajvanit — 107-103, 119-120;
- qëndrimi armiqësor ndaj PPSH dhe RPS të Shqipërisë — 13, 102, 176, 177, 247, 251.
- Klasa punëtore në RPSSH; cilësitë e saj* — 245, 339.
- Klasa punëtore në vendet borgjezo-revizioniste* — 122, 299, 379, 382.
- Kompetencat, përgjegjësitë* — 6, 8-10, 11, 15, 23-24, 27, 215-216, 238, 407.
- Komunisti — detyrat e tij* — 11, 12, 32, 33, 37, 38, 237-240, 408.
- Kontradiktat e epokës sonë* — 88-89, 112-113, 302-303.
- Kontrolli dhe kërkesa e llogarisë* — 34, 59-60, 256, 356, 357, 408.
- Kontrolli i Partisë, i shtetit dhe i klasës punëtore* — 60-62, 318.
- Kreditë, ndihmat ndërmjet shteteve; kuptimi marksist-leninist i tyre* — 254.
- Kuadrot, specialistët; detyrat e tyre* — 6, 7, 16, 251, 263, 358, 359, 360;
- marrëdhëniet kuadër-masë; lufta kundër shfaqjeve të huaja te kuadrot — 36-37, 240;
- kuadrot e Partisë — 4-5, 34, 210-211, 319-320, 337, 338.
- Kultura përparimtare botërore* — 131-132, 252, 346-347, 380.
- Kushtetuta në RPSSH* — 252-253.
- Kuvendi Popullor, Presidiumi i Kuvendit Popullor* — 26, 214, 215-216, 228, 398.

## L

- Lenin, Vladimir Iliç* — 41, 42, 61, 63, 64, 66, 76, 122, 188, 259, 262, 263, 269, 272, 274, 278, 286, 316, 367, 369, 371, 395, 398.

*Letrat, kërkesat e ankesat e*

popullit — 219-220.

Lëvizja komuniste marksiste-leniniste ndërkombëtare — 287;

— partitë komuniste marksiste-leniniste; programi, detyrat e tyre; krijimi e forcimi i partive të reja marksiste-leniniste — 164, 198, 204, 367, 368-371;

— përpjekjet e borgjezisë për shpartallimin e lëvizjes marksiste-leniniste — 289-290.

Liberalizmi, lufta kundër shfaqjeve të tij — 4-5, 24-25, 60, 62.

Ligjet ekonomike objektive të socializmit — 241, 248-249.

Ligjshmëria, ligjet në RPSSH; njohja, kuptimi dhe zbatimi i tyre — 30, 215, 238, 391-393, 395-396, 397-398, 399.

Literatura e huaj, qëndrimi kritik ndaj saj — 252, 377-378.

Lufta, rreziku i luftës; shkaqet dhe shkaktarët e shpërthimit të luftërave — 92-93, 104, 106, 110, 114-115, 164, 168-170, 173, 251, 302-305.

## M

Marksizëm-leninizmi — armë dhe busull për udhëheqje e

veprim; njohja, përvetësimi dhe zbatimi krijues i tij — 38-39, 40-42, 261, 262, 263-264, 265-266, 274, 286-287, 312, 353, 354, 367, 368-369, 370.

Marks, Karl — 41, 42, 64, 66, 76, 125, 186, 262, 263, 269, 272, 274, 278, 286, 369.

Mbështetja në forcat e veta — 248, 249-250, 251, 252, 254, 256.

Mbrojtja e Atdheut — forcimi i gatishmërisë luftarake të ushtrisë, të popullit dhe të gjithë vendit — 314-315, 340-341.

Metoda dhe stili në punë — 263, 319-320, 360.

Ministritë dhe kuadrot e tyre; kompetencat, përgjegjësitë — 5-7, 30, 31, 33, 233, 256, 355, 356, 359-360, 403, 405;

— Ministria e Punëve të Brendshme — 396;

— Ministria e Mbrojtjes Popullore — 316-317, 335;

— Komisioni i Planit të Shtetit — 2, 25;

— Ministria e Bujqësisë — 18;

— Ministria e Ndërtimit — 59;

— Ministria e Tregtisë së Jashtme — 253.

## N

*Nafta dhe gazi — shpimet për naftë e gaz; lufta kundër të metave e dobësive — 241, 242-246, 403-410.*

*Ndërmarrjet socialiste — drejtimi ekonomik i tyre — 6-8, 15, 22, 32-33, 60-62.*

*Ndërtimi i socializmit në Shqipëri; parime të ndërtimit socialist, rëndësia e tij ndërkombëtare — 246-247, 248, 252-253.*

## O

*Organet shtetërore dhe ato ekonomike — 15, 237, 238, 362.*

*Organizata-bazë e Partisë; roli udhëheqës dhe detyrat e saj — 32-35, 61, 62, 314, 321, 323-324, 339, 348-352, 386-387, 403-409.*

*Organizatat e masave, detyrat e tyre — 19-20, 392.*

## P

*Partia e Punës e Shqipërisë — vija, vendimet, direktivat, ndërtimi dhe jeta e brendshme*

— vija, vendimet, direktivat; njohja dhe zbatimi

i tyre — 59, 60, 61, 213, 215, 216, 238, 240, 265, 306, 349-350, 362-363, 403, 404, 414-415;

— roli udhëheqës i Partisë — 237-240, 325, 340, 396;

— forcimi dhe gjallërimi i jetës së brendshme të Partisë — 32-33, 324;

— pranimet në Parti, kriteret e pranimit; rekomandimet, rekomanduesit — 385-390;

— normat e Partisë, zbatimi i tyre; kritika dhe auto-kritika. Statuti — 3-5, 7, 8, 10, 24-25, 27, 232, 233-234, 235, 385-386;

— puna e Partisë, metoda dhe stili i saj në punë; ndihma e kontrolli për bazën — 8-10, 37-39, 211-212, 232-233, 234, 237, 238-240, 322-323, 334, 352, 387, 409, 410;

— puna e Partisë me një-rëzit, qëndrimi ndaj një-rëzve që gabojnë — 25, 35-36, 230-234, 237, 240;

— materialet e Partisë, studimi dhe përvetësimi i tyre; informimi në Parti — 26-28, 238-239, 320-321, 327;

— materialet, raportet për organet udhëheqëse — 2-3, 209-213, 231-232, 408.

*Partia e Punës e Shqipërisë*  
— organet udhëheqëse qendrore dhe në rrethe

- Kongresi VII i PPSH (1—7 nëntor 1976) — 21, 59, 257;
- Plenumi i 6-të i KQ (29—30 janar 1979) — 230-234, 235-259, 336-337;
- Komiteti Qendror, Byroja Politike, Sekretariati — 1, 2, 3, 4, 5, 10-11, 12, 21, 23, 25, 26, 59, 209, 211, 213, 214-215, 216, 223, 230, 235, 236-237, 348, 349, 403;
- aparati i KQ, Instruktorët — 2, 23, 25, 322-323, 352-353, 377-378;
- komitetet e Partisë në rrethe; sekretari i parë — 12, 17, 24, 27-28, 230-231, 351-352, 358, 359, 360-361, 362, 389;
- komitetet e Partisë të rretheve të Fierit dhe të Vlorës — 34-35, 412;
- komitetet e Partisë në ushtri — 316, 334.

*Partia e Punës e Shqipërisë* — politika e jashtme

- analiza marksiste-leniniste e situatës ndërkombëtare, mbrojtja dhe zbatimi krijues i marksizëm-leninizmit — 261, 263-266, 272-274;

- lufta e saj për demaskimin e revizionizmit modern; përkrahja për popujt që luftojnë për liri — 115, 174-175, 207, 266, 267, 297, 308, 364, 373-374.

*Partia Komuniste e Italisë (marksiste-leniniste)* — 200-208, 286-287;

- degjencrimi i saj në parti revizioniste; përkrahja për revizionistët sovjetikë — 201, 202, 282-283, 284-285, 286, 288-289, 310-311;
- qëndrimi i saj ndaj PPSH e RPSSH — 283, 284.

*Partia Komuniste e Kanadasë (marksiste-leniniste)* — 364, 367-368.

*Partia Komuniste (marksiste-leniniste) e Iranit* — 195.

*Partia Komuniste (revizioniste) e Francës* — 204, 311.

*Partia Komuniste (revizioniste) Italiane* — 200, 201, 203, 204-205, 288.

*Partia Komuniste (revizioniste) e ShBA* — 260-270, 276.

*Planifikimi i ekonomisë popullore* — politika e Partisë në fushën e planifikimit dhe të realizimit të planeve, ndihma dhe kontrolli — 10-11, 28-31, 236, 240-241, 242-246, 249-251, 256-257;

- metodologjia e planifikimi-



- mit; pjesëmarrja e masave në planifikim dhe në realizimin e planeve — 3, 20-21, 241, 256-257, 258-259;
- organet e planifikimit; lufta kundër të metave e gabimeve në realizimin e planeve; realizimi i planeve në bujqësi — 3, 5-10, 13-14, 15, 16-19, 22, 23, 26-27, 28-31, 230-231, 233-234, 236, 239-241, 242-246, 248-251, 254-255, 256-258;
- plani i gjashtë (1976—1980) dhe i shtatë (1981—1985) pesëvjeçar — 10, 13, 26, 235, 247, 256-257, 259.
- Politika dhe ideologjia — trajtimi ideopolitik i problemeve* — 37-39, 236.
- Politika e jashtme e RPSSH — parimet themelore të saj; rritja e prestigjit dhe e autoritetit të PPSH dhe RPSSH në botë. Të huajt për Shqipërinë* — 246, 248, 254, 258;
- marrëdhëniet me vendet fqinje — 253-254;
- marrëdhëniet, qëndrimi parimor ndaj Kamboxhias, Vietnamit dhe Laosit — 180, 182, 185-186, 373-374;
- lufta për demaskimin e imperializmit, revizionizmit e reaksionit — 308-310.
- Populli shqiptar, cilësitë* — 228, 246.
- Prodhimi material — rritja e pandërprerë e tij; cilësia* — 249, 255, 256.
- Prokuroria, prokurorët; kompetencat* — 221-223, 394-399.
- Propaganda, agjitacioni — përmbajtja, forma, mjetet; propagandistët* — 260-262, 263-265, 309-310, 319-320, 376, 377;
- propaganda për botën e jashtme — 311-313, 316, 373-374, 375.
- Propaganda e prodhimit, organizimi dhe zhvillimi i saj* — 358-361.
- Propaganda, shtypi borgjezo-revizionist dhe agjencitë e lajmeve* — 71, 96, 105, 111, 117, 123-124, 127-128, 129-131, 132-137, 138, 139, 141, 142, 200-202, 203, 204, 253, 254, 282-283, 284-285, 286, 304, 307-308, 375, 382.

## R

*Revizionizmi modern, thelbi dhe strategjia e tij; lufta e tij kundër marksizëm-leninizmit, kundër Stalinit dhe veprës së*

tij — 268-269, 270-271, 272-274, 278, 287;

— brauderizmi; eurokomunizmi — 266, 267-270, 271, 278, 279-280.

*Revolucioni në Kinë* — karakteri, forcat lëvizëse të tij. *Lufta nacionalçlirimtare (1931—1949)* — 65-66, 67-68, 69-71.

*Revolucioni proletar; faktorët objektivë dhe subjektivë për shpërthimin e tij* — 122, 167, 290, 312, 369-370, 382.

*Revolucioni tekniko-shkencor; studimet shkencore* — 355-358. *Rezervat shtetërore* — 251.

*Rinia dhe Bashkimi i Rinisë së Punës të Shqipërisë; edukimi ideopolitik; lufta kundër shfaqjeve të huaja* — 321-322, 339-340, 388, 389.

## RR

*Rrethimi, bllokada e presioni imperialisto-revizionist dhe lufta për përballimin dhe çarjen e tyre* — 36, 241, 246, 247-248.

## S

*Stalin, Josif Visarionoviç* — 42, 63, 64, 66, 75, 76, 98, 130, 158, 166, 186, 201, 202, 259, 263, 269, 272-274, 278, 285, 286, 296, 306.

*Superfuqitë, politika e luftës dhe agresionit* — 85, 168, 195-196, 197-198;

— aleancat dhe rivaliteti midis tyre — 110-111, 112-113, 162-164, 171, 195-196, 248, 301.

## SH

*Shkenca* — politika dhe kujdesi i Partisë për shkencën; institucionet shkencore dhe punonjësit shkencorë; studimet shkencore — 251, 342, 344-346.

*Shkollat e Lira Ushtarake, forcimi i tyre* — 316, 340.

*Shtetet e Bashkuara të Amerikës; politika e jashtme e luftës dhe e diktatit; strategjia e taktikat* — 82, 85, 114, 119, 153, 162, 172-173, 196, 294;

— qëndrimi ndaj Kinës, lidhjet dhe bashkëpunimi me të; lidhjet me Japoninë — 53, 82-83, 94, 109, 117, 119, 143, 157, 291-292, 294-296, 297-298, 299-301, 305;

— qëndrimi armiqësor ndaj Iranit dhe revolucionit iranian; disfatat — 165, 189-191, 194, 195-196, 197, 372.

*Shtypi dhe botimet në RPSSH; shfrytëzimi i tyre; gazetaret* —

58-59, 60-61, 263-265, 266-267, 311-312, 321-322, 346, 373-374, 376, 377.

## T

*Teoria dhe praktika, uniteti dialektik i tyre* — 40-42, 262-265, 319-320, 369-371, 412-413.

*Teoritë borgjezo-revizioniste dhe kritika ndaj tyre*

- teoritë e revizionistëve kinezë për «tri botët», për «lulëzimin e 100 luleve dhe konkurrimin e 100 shkollave», për mbështetjen në një imperia-lizëm për të luftuar tjetrin, për revolucionin proletar dhe rolin e proletariatit e të fshatarësisë në revolucion — 66-67, 68, 69, 86, 101, 111-112, 120-121, 125-126, 131, 311.

*Të ardhurat kombëtare; akumulimi socialist* — 14-15.

*Tregtia e jashtme — eksporti, importi* — 27, 250, 253-254, 255, 256, 257-258.

## U

*Ushtria në vendet borgjezo-revizioniste* — 45-47, 96, 380-381.

*Ushtria popullore — organizimi,*

*përgatitja dhe edukimi ideopolitik e ushtarak i saj* — 315-316, 319-322, 353-354;

— kuadrot ushtarakë, rezervistët, ushtarët; marrëdhëniet kuadër-ushtar — 227, 228, 229, 314, 315, 317, 318-319, 333, 334, 338-339, 340-341, 353-354;

— forcimi i lidhjeve ushtarakë — 318-319, 350;

— disiplina ushtarakë; urdhëri, zbatimi i tij — 337-338, 349;

— lufta kundër veprimtarisë armiqësore dhe koncepteve të huaja në ushtri — 315-317, 324, 326-327, 328, 331, 332-333, 337-339.

## V

*Vështirësitë, lufta për kapërcimin e tyre* — 20-21, 239-240, 247, 251.

*Vietnami; gjendja e brendshme, politika e jashtme* — 90, 113, 118, 170, 177-178, 184-185;

— qëndrimi ndaj Kamboxhias — 179, 182-183.

*Vigjilanca revolucionare* — 215, 250, 318, 326, 384, 410.

## ZH

*Zhvillimi dialektik* — 262-263.



## TREGUESI I EMRAVE

### A

- Alia, Ramiz — 11, 27, 39-40,  
41, 260, 261, 263, 265, 269,  
270, 274-276, 277, 278-279, 280,  
319, 336, 364, 393.  
Andreoti, Xhulio — 206.  
Aragon, Lui — 311.

### B

- Baftjar, Shapur — 197, 382.  
Balluku, Beqir — 332, 338.  
Bazargan, Mehdi — 372, 383.  
Beins, Hardial — 364.  
Berlinguer, Enriko — 201, 288,  
289.  
Brauder, Erl — 269, 271.  
Brezhnjev, Leonid — 150, 285,  
297.

### Ç

- Çarçani, Adil — 19.  
Çeliku, Hajredin — 251.  
Çabej, Eqrem — 345.

- Çan Kai Shi — 63, 67, 103, 157,  
158.  
Çela, Aranit — 217, 219, 223.  
Çen Hsi Lien — 146.  
Çen Po Ta — 96.  
Çian Çin — 148.  
Çu En Lai — 43-44, 47, 77, 80,  
81, 83, 84, 85, 94, 95-96,  
97, 98, 99, 100, 109, 116, 123,  
127, 128, 129, 131, 136, 137,  
138, 144, 145, 146, 151, 176,  
177, 181, 184, 192, 296, 297,  
299, 305, 306, 308.

### D

- D'Estën, Zhiskar — 206.

### F

- Firdusi (Abu el-Qazim Hasan)  
— 187, 380.

### G

- Gandi, Mahatma — 365.  
Gripa, Zhak — 287.

## H

- Hoxha, Nexhmije — 260, 269, 230.  
 Hazbiu, Kadri — 223, 327.  
 Hrushov, Nikita — 37, 79, 130, 150, 274, 285, 296, 306, 307.  
 Hua Kuo Fen — 44, 45, 47-48, 50, 51, 52, 53, 54, 55, 56, 83, 85, 94, 97, 100, 101, 102, 103, 104, 107, 111, 115, 121, 124, 126, 127, 128, 136, 140, 141, 143, 144, 145, 146, 148, 152, 191, 293, 305.

## I

- Isai, Hekuran — 11, 22, 26, 34, 37, 335-336, 305.

## J

- Jan Shan Kun — 56.  
 Jch Çien Jin — 84, 85.  
 Jeng Sar — 160-181, 182, 183, 184.

## K

- Kapo, Hysni — 11, 236, 323, 324-325, 327-328, 329-330, 331, 332, 333, 357, 398-399, 406.  
 Koleka, Spiro — 13.

Kadare, Ismail — 342-344, 345, 346, 347.

Kallagan, Xhejms — 206.

Kanapari, Shyqyri — 40.

Kan Shen — 56.

Kao Gan — 74, 128, 139.

Karter, Xhimi — 107, 109, 165, 195, 293, 372, 383.

Khajam, Omar — 187.

Khomein, Ajatollah — 165, 166, 193, 196, 197, 366, 372, 381, 382-383.

Kieu Samfan — 180.

Kisinger, Henri — 82, 98, 100.

## L

Lamerc, Maksimilian — 343.

Lera, Spiro — 40.

Li Çian — 151.

Li Hsien Nien — 128, 151, 192.

Lin Biao — 79, 84, 96, 97, 126, 128, 129, 135, 137, 145, 146, 148, 151, 152.

Liu Shao Çi — 56, 73, 74, 75, 77, 78, 79, 80, 94, 127, 128, 135, 137, 138, 139, 144, 146.

## LL

Lleshi, Haxhi — 214, 215-216, 217, 226.

## M

Murra, Prokop — 10, 11, 359, 362.

Mao Ce Dun — 43-44, 47, 48,  
51, 52, 54, 55, 56, 67, 68, 69,  
70, 72, 73, 74, 75, 76, 77, 78,  
79, 80, 81, 82, 83, 84, 92, 94,  
95, 96, 97, 98, 99, 100, 103,  
111, 115, 121, 126, 127, 128,  
129, 130, 131, 132, 133, 134,  
135, 136, 137, 138, 139, 140,  
141, 142, 143, 144, 146, 147,  
150, 151, 153, 158, 176, 177,  
180, 181, 184, 191-192, 272,  
293, 296, 297, 306, 303, 364.

Marshe, Zhorzh — 204.

Mauntbetën (lordi) — 365.

Mirabo, Honore Gabriel — 371.

Moro, Aldo — 397.

Musadek, Mohamed — 166,  
189, 194.

## N

Nguyen Van Thieu — 178.

Nikson, Riçard — 82, 93, 100,  
109, 116, 144, 177.

## P

Peristeri, Pilo — 227.

Pahlevi, Ashraf — 192.

Pahlevi Muhamed Reza — 125,  
190-191, 193, 365, 366.

Pahlevi, Reza — 187, 189.

Papa Xhiovani Pavli II — 375.

Pen Çen — 79, 128, 147.

Peza, Myslim — 216-217.

Pin De Hua — 74, 79, 128, 129,  
137, 139, 147.

Pol Pot — 180, 182, 183, 184,  
304.

Portilio, Hoze Lopes — 371-  
-372.

## R

Rusvelt, Teodor — 157.

## S

Stefani, Simon — 402.

Saadi (Muslah al-Din) — 187,  
380.

Sihanuk, Norodom — 180, 183,  
184.

Spahiu, Xhafer — 3.

Sun Jat Sen — 157.

## SH

Shehu, Feçor — 223.

Shehu, Mehmet — 318, 320,  
326, 327, 332, 336.

Shuteriqi, Dhimitër — 345-346.

## T

Toska, Haki — 25.

Ten Hsiao Pin — 44, 45, 46,  
47, 48, 49, 50-51, 52-54, 55,  
56, 73-74, 77, 79, 83, 84, 85,

- 88, 94, 97, 99, 100, 101, 102,  
 103, 104, 107, 109, 111, 115,  
 121, 124, 125, 126, 127, 128,  
 129, 130, 131, 132, 134, 136,  
 137, 140, 141, 144, 145, 146,  
 147, 148, 149, 150, 151, 152,  
 153, 161, 163, 184, 191, 272,  
 291, 292-293, 294, 295-296,  
 297, 298, 299, 300, 305, 306,  
 307, 308, 310, 312.
- Ten Jin Çao — 146.
- Tito, Josip Broz — 153, 190,  
 253, 298.
- Toliati, Palmiro — 271.
- V
- Vagner, Rikard — 347.  
 Van Hun Ven — 124.  
 Van Tun Hsin — 55-56.  
 Vens, Sajrus — 107.  
 Vilar, Hednino Gomes — 287.  
 Vu Teh — 146.
- ZH
- Zhyrke, Zhak — 287.



## TREKUESI GJEOGRAFIK DHE I EMËRTIMEVE TË TJERA

### A

- Abadan (Iran) — 138.  
Aden — 171.  
Afganistan — 91, 170, 172, 383.  
Afrika e Jugut — 102.  
Afrikë — 90, 102, 164, 170, 171,  
173-174, 303, 375, 332.  
Akademia Ushtarake e RPSSh  
— 228.  
Amerika Latine — 89, 268, 272.  
«Anglo-Persian Oil Kompani»  
(shoqëria ~) — 183.  
Angolë — 171.  
Arabia Saudite — 92, 167, 384,  
492.  
ARAMCO (Shoqëria Arabo-  
-Amerikane e Naftës) — 384.  
ASEAN (Organizata e Vende-  
ve të Azisë Juglindore) — 182.  
Australi — 113, 157.  
Azerbajxhan — 383.  
Azi — 50, 90, 106, 157, 161, 163,  
169, 170, 172, 173, 272, 310.

### B

- Beograd — 50, 154, 253.

- Birmanl [Mjanma] — 90, 91,  
113, 114, 173.  
Bishti i Pallës — 244.  
«Borba» (gazeta ~) — 253.

### C

- CIA (Agjencia Qendrore e  
Shërbimit Informativ në  
ShBA) — 165, 166, 189, 194.

### D

- Deti i Kuq — 163.  
Dibër — 231.  
«Drita» (gazeta ~) — 202, 342.  
Durrës — 258, 320.

### E

- Emiratet e Gjirit Persik — 167.  
Eritre — 171.  
Etiopi — 171.

### F

- Fabrika e Ferrokromit [Uzina

e Ferrokromit], Burrel — 403.  
 Fabrika e Pëlhurave, Shkodër  
 — 358.  
 Filipine — 113, 117.  
 Firenze (Itali) — 282.

## G

Gadishulli Arabik — 164.  
 Guomindan (Partia Naciona-  
 liste, Kinë) — 108.

## GJ

Gjermania Perëndimore (RF e  
 Gjermanisë) — 50, 85, 87, 101,  
 190, 288, 303.  
 Gjiri Persik — 92, 165, 172,  
 173, 183, 198, 384.

## H

Hajfong (Vietnam) — 118.  
 Hajnan (ishujt ~) — 157.  
 Hidrocentrali i Komanit [Hid-  
 rocentrali «Enver Hoxha»] —  
 403.  
 Hogar (malet ~) — 402.  
 Hong-Kong — 161.  
 HSINHUA (Agjencia Kina e  
 Re) — 123, 154.

## I

«Imperializmi dhe revolucioni»  
 (E. Hoxha, vepra ~) — 260,  
 266-267.

Indokinë — 157, 163, 164, 184.  
 Indonezi — 117.

Instituti i Folklorit [Instituti i  
 Kulturës Popullore], Tiranë —  
 342, 344.

Internacionalja e Parë — 266.  
 Internacionalja e Tretë Komu-  
 niste — 266, 270.

Irak — 172, 198.

Ispahan (Iran) — 164, 379.

Izrael — 91, 165, 193, 384.

## J

«Jasuba» (shoqëria shumëko-  
 mbëshe ~) — 160.

## K

Kanada — 307.

Kanton (Kinë) — 157.

«Kënga e Nibelungëve» (li-  
 bri ~) — 346, 347.

«Kënga e Rolandit» (libri ~)  
 — 346, 347.

KGB (Komiteti i Sigurimit të  
 Shtetit në BS) — 384.

KNER (Këshilli i Ndhmës  
 Ekonomike Reciproke) — 113,  
 168, 182.

Kombinati i autotraktorëve  
 «Enver Hoxha», Tiranë — 358.

Kombinati i drurit «Misto Ma-  
 me», Tiranë — 339.

Kombinati i Tekstileve, Berat  
 — 358.

Kombinati i trikotazheve «Drapër e Çekan», Korçë — 358.  
 Kombinati metalurgjik «Çeliku i Partisë», Elbasan — 251, 403.  
 Komo (Itali) — 282.  
 Kooperativa Bujqësore e Bashkuar e Donofrosës, Berat — 12.  
 Koreja e Jugut — 158, 163.  
 Koreja e Veriut (RDP e Koresë) — 90.  
 Kostandin (Itali) — 234.  
 Krujë — 231.  
 Kuvajt — 384.

## L

Laos — 90, 113, 118, 170, 181, 184, 185.  
 Lezhë — 233.  
 «Lë Mond» (gazeta ~) — 103, 204.  
 Lindja e Largme — 91, 117.  
 Lindja e Mesme — 89, 92, 110, 114, 163, 167, 170, 197, 198-199, 375, 382, 383, 384.  
 Lufta e Dytë Botërore (1939-1945) — 157-158.  
 Lushnjë — 14, 231.

## M

Malajë — 157.  
 Malajzi — 113.

Mançuri (Kinë) — 157.  
 Marinel (Itali) — 284.  
 Marshad (Iran) — 164.  
 «Mbi eposin e kreshnikëve» (studimi ~, I. Kadare) — 342, 346.  
 Meksikë — 371, 372.  
 Mesdhe (deti, zona ~) — 92, 172.  
 «Micubishi» (shoqëria shumëkombëshe ~) — 160.  
 «Micui» (shoqëria shumëkombëshe ~) — 160.  
 Milano (Itali) — 282, 234.  
 Miniera e Qymyrgurit e Vallasit, Tiranë — 2.  
 Mongoli — 118, 158, 172.

## N

Nankin (Kinë) — 157.  
 NATO (Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior) — 86, 87, 111, 113, 117, 169, 172, 173, 300, 302.  
 «Nipon Stil» (shoqëria shumëkombëshe ~) — 160.  
 Novara (Itali) — 282.  
 «Novosti» (gazeta ~) — 284.  
 «Nuova unità» (gazeta ~) — 201-202, 208, 223.

## O

OKB (Organizata e Kombeve të Bashkuara) — 81.

Qeani — 173.

Qeani Indian — 173.

«Otobre» (gazeta ~) — 200,  
201, 202, 203, 204, 208, 283,  
284, 285, 286, 288-289.

## P

Padova (Itali) — 282.

Pakistan — 114, 164, 170, 172.

Paqësor (zona, ishujt ~) —  
106, 157.

Paris — 193, 196, 252.

Parma (Itali) — 282.

Pekin — 48, 82, 93, 104, 107,  
109, 127, 134, 144, 157, 183.

Perandoria Osmane — 380.

Pirl-Harbor (ishujt Havai) —  
157.

«Plani Marshall» — 276, 277.

Pnom-Pen — 181, 183.

Porti i Durrësit [Porti detar  
«Enver Hoxha»] — 256.

«Pravda» (gazeta ~) — 117,  
163.

## R

Revolucioni Demokratiko-Bor-  
gjez Francez (1789—1794) —  
371, 372.

Romë — 189.

Ronséval (lugina ~) — 346.

Rumanl — 50, 101, 104, 176.

## S

Sahara (shkretëtira ~) — 402.

Sajgon [«Ho Shi Min»] — 119.

SALT (Traktati për Kufizimin  
e Armëve Strategjike) — 111,  
168.

San-Francisko (ShBA) — 109.

SAVAK (Shërbimi i fshehtë i  
shahut në Iran) — 125, 166, 191,  
196.

Siberi (Bashkimi Sovjetik) —  
118, 158, 163, 172.

Singapor — 113, 157.

Sinkiang (Kinë) 118.

Siri — 167, 172.

Somali — 171.

Spanjë — 346.

«Sumidomo» (shoqëria shumë-  
kombëshe ~) — 160.

## SH

Shangai (Kinë) — 103, 149.

Shkodër — 253.

Shkolla e lartë e bashkuar e  
oficerëve «Enver Hoxha», Ti-  
ranë — 228.

Shkolla e mesme ushtarake  
«Skënderbej», Tiranë — 228.

## T

Tabriz (Iran) — 164.

Tajlandë — 90, 113, 118, 185.

Tajvan — 81, 82, 101, 119, 126.

TANJUG (Agjencia Telegrafike e Jugosllavisë së Re) — 307.

Teheran — 125, 164, 189, 190, 383.

Tiencin (gjiri ~) — 157.

Tiranë — 318.

Traktati i Varshavës — 111, 113, 168.

Tregu i Përbashkët Evropian — 86, 87, 101, 102, 113, 119, 171, 173.

«Tristani dhe Izolda» (kënga ~) — 347.

«Tristani dhe Izolda» (opera ~, R. Wagner) — 347.

«Tudeh» (partia ~, Iran) — 166, 189, 196.

«Tufan» (partia ~, Iran) — 166.

Turqi — 368, 383.

## U

Uashington — 107, 109, 163.

Uzina e instrumenteve «Petro Papi», Korçë — 415.

## V

«Visuret e Kombit» (vëllimet ~) — 344.

Viadivostok (Bashkimi Sovjetik) — 158.

Vlorë — 244.

## Z

«Zëri i popullit» (gazeta ~) — 58, 283, 354.

## ZH

«Zhenminzhibao» (gazeta ~) — 123, 124, 127, 129, 132, 133, 134, 139, 141.



# LE N D A

PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 69-TË ..... V-IX

1978

PARA POPULLIT PËRGJEGJËSI PËR MOSREALIZIMET KANË DREJTUESIT E PARTISË E TË PUSHTETIT NË RRETH E NË BAZË — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (6 dhjetor 1978) .....	1-21
ATYRE DREJTUESVE QË BËHEN PENGESË NË PUNË T'U TREGOHET VENDI — Nga blseda në takimimin ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (7 dhjetor 1978) .....	22-42
REHABILITIMI I GJITHË REAKSIONIT TË ZI — Shënime (7 dhjetor 1978) .....	43-57
KONTROLLI PUNËTOR LUAN ROL TË RËNDËSISHËM KUR KUPTOHET E ZBATOHET DREJT — Shënime (9 dhjetor 1978) .....	58-62
BILANC I TMERRSHËM I NJË REGJIMI KU KA SUNDUAR PUSHTETI PERSONAL — Shënime (13 dhjetor 1978) .....	63-93
TYMI I BARDHË I ALEANCAVE NDËRIMPERIALISTE FSHEH RREZIQE TË MËDHA PËR NJERËZIMIN — Shënime (18 dhjetor 1978) .....	94-115
POPUJT DHE PROLETARIATI DUHET TË BËHEN TË VETËDIJSHËM PËR ÇKA PO NGJET NË BOTË — Shënime (21 dhjetor 1978) .....	116-123

RRETH NGJARJEVE NË SHESHIN TIEN AN MEN — Shënime (26 dhjetor 1978) .....	123—142
PLENUMI I 3-TË I KOMITETIT QENDROR TË 11-TË TË PKK — Shënime (28 dhjetor 1978) .....	143—155
KINA DHE JAPONIA — Shënime (29 dhjetor 1978)	156—167
PËR GJENDJEN NDËRKOMBËTARE GJATË VI- TIT 1978 — Shënime (31 dhjetor 1978) .....	168—175

## 1979

DISFATA TË KINËS REVIZIONISTE — Shënime (7 janar 1979) .....	176—186
LAVDI POPULLIT IRANIAN! — Shënime (14 ja- nar 1979) .....	187—199
MBI ÇESHTJEN E PARTISË KOMUNISTE TË ITA- LISË (MARKSISTE-LENINISTE) — Shënime (19 ja- nar 1979) .....	200—208
MBLEDHJET E BYROSË POLITIKE TË JENË TË GJALLA, ME DEBATE — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (25 janar 1979) ...	209—213
ZBATIMI I VIJËS SË PARTISË DHE I LIGJSHMË- RISE KËRKON RRAHJE MENDIMESH DHE RRU- GËZGJIDHJE TË DREJTA — Diskutim në mble- dhjen e Presidiumit të Kuvendit Popullor të RPSSH (27 janar 1979) .....	214—225
DEKORIMI — STIMUL I LARTË QË NXIT DHE FRYMËZON PËR ARRITJE TË REJA — Diskutim në mbledhjen e Presidiumit të Kuvendit Popullor të RPSSH (27 janar 1979) .....	226—229



METODA DHE STILI TË JENË TË ZHDËRVJELLËT, TË ÇOJNË PUNËN PËRPARA — Diskutim në Plenumin e 6-të të KQ të PPSH (29 janar 1979)	230—234
NË LUFTË PËR REALIZIMIN E PLANIT TË FORCOJMË KONTROLLIN E ZBATIMIT TË DETYRAVE — Konkluzione në Plenumin e 6-të të KQ të PPSH (30 janar 1979)	235—259
PËR NJË LIDHJE MË TË MIRË E SHKRIRJE ORGANIKE TË PROBLEMEVE NË MATERIALIN PËR PARTITË REVIZIONISTE EUROKOMUNISTE — Bisedë me shokun Ramiz Alia (31 janar 1979)	260—281
UDHËHEQJA E PK TË ITALISË (MARKSISTE-LENINISTE) PO DEVIJON — Shënime (3 shkurt 1979)	282—290
NJË VIZITË KARNAVALESKE. AKROBACITË E TEN HSIAO PINIT — Shënime (5 shkurt 1979)	291—313
TË RRËNJOSIM TE KUADROT NDËRGJEGJEN KOMUNISTE PËR FORCIMIN E USHTRISË DHE MBROJTJEN E ATDHEUT — Nga biseda në takim ditë të sekretarëve të KQ të PPSH (9 shkurt 1979)	314—334
TË RUHEMI NGA EUFORIA E PABAZUAR NË VLERËSIMIN E GJENDJES NË USHTRI — Nga biseda në takim ditë të sekretarëve të KQ të PPSH (12 shkurt 1979)	335—341
NJË STUDIM ME VLERË PËR EPOSIN E KRESHNIKËVE — Nga biseda në takim ditë të sekretarëve të KQ të PPSH (13 shkurt 1979)	342—347
PROPAGANDA DHE PUNA E PARTISË TË NXITIN NJERËZIT TË VRASIN MENDJEN E TË JENË KRIJUES NË PUNË — Nga biseda në takim ditë të sekretarëve të KQ të PPSH (14 shkurt 1979)	348—363

PËR ÇDO VEPRIM, BAZË JANË PARIMET THE-MELORE TË MARKSIZËM-LENINIZMIT — Shë-nime (15 shkurt 1979) .....	364—384
REKOMANDIMET PËR TË HYRË NË PARTI — NJË E DREJTË DHE DETYRË E ORGANIZATËS SË RINISË — Nga biseda në takimín me shokun Hekuran Isai (16 shkurt 1979) .....	385—393
TË KUPTOHEN DREJT NDRYSHIMET QË BËHEN NË KODIN TONË TË PROCEDURËS PENALE — Nga biseda në takimín ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (27 shkurt 1979) .....	394—399
NË NXJERRJEN E NAFTËS TË MBËSHTETEMI MIRË NË TË DHËNAT SHKENCORE — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (28 shkurt 1979) .....	400—410
NË PROGRAMET E KURSEVE TË KUALIFIKI-MIT TË ZERË VEND MIRË ANA TEORIKE DHE AJO PRAKTIKE — Diskutim në mbledhjen e Se-kretariatit të KQ të PPSH (28 shkurt 1979) .....	411—416
Treguesi i lëndës .....	419
Treguesi i emrave .....	431
Treguesi gjeografik dhe i emërtimeve të tjera .....	435

---

**Shtypur: Kombinati Poligrafik  
Shtypshkronja «8 Nëntori» — Tiranë, 1990**